2025



# RAPORTI VJETOR

PËR REVIZIONET E KRYERA DHE PUNËN E
**ENTIT SHTETËROR PËR REVIZION**



**Titulli origjinal:**
Годишен извештај за извршените ревизии и за работата на Државниот завод за ревизија за 2025 година

**Botues:**
Enti Shtetëror i Revizionit – Shkup
Rruga Pavel Shatev nr. 2,
Pallati Emanuel Çuçkov, Shkup

**Për botuesin:**
mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

**Redaktor:**
mr. Maksim Acevski, Kryerevizori shtetëror

**Shtypi:**
Shoqëria për aktivitetin e shtypjes grafike, tregtinë, prodhimin dhe shërbimet GETEO print Pero SHPKNJP eksport - import - Shkup

**Përpunimi kompjuterik dhe teknik:**
Jana Sajkovska Dimitrievski, Nadica Donevski, Vesna Bogdanovic, Elena Dogazanska

**Përkthim maqedonisht-shqip:**
Sefedin Rexhepi

**Viti:**
2026
**Tirazh:**
100 kopje
**Vendi i botimit:**
Shkup

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

657.6(497.7)»2025»(047.31)

RAPORTI vjetor për revizionet e kryera dhe punën e Entit shtetëror
për revizion për vitin 2025 / [redaktor Maksim Acevski] ; përkthim
maqedonisht-shqip Sefedin Rexhepi]. - Shkup : Enti shtetëror i
revizionit, 2026. - 264 стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Годишен извештај за извршените ревизии и за работата
на Државниот завод за ревизија за 2025 година

ISBN 978-608-5006-13-7

а) Државен завод за ревизија (Скопје) -- 2025 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 69035525

ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development and Cooperation SDC**

Zbatuar nga:

NDI

IDSCS

ЦЕНТАР ЗА УПРАВУВАЊЕ СО ПРОМЕНИ

Ky publikim është përgatitur në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), projekt i Qeverisë së Zvicrës nën patronazhin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. PSP zbatohet nga Instituti Nacional Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve (QMP). Përmbajtja e këtij publikimi nuk mund të konsiderohet, në asnjë mënyrë, se pasqyron pikëpamjet e SDC.

PËRMBAJTJA


| | | |
|---|---|---|
| **01** | **PËR ENTIN SHTETËROR TË REVIZIONIT** | **17** |
| **1.1** | KORNIZA JURIDIKE | **22** |
| **1.2** | PËR ENTIN SHTETËROR TË REVIZIONIT | **23** |
| **1.3** | DOKUMENTET DHE AKTIVITETET STRATEGJIKE DHE ATO VJETORE | **35** |
| **02** | **KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUARA** | **37** |
| **2.1.** | KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA NË PUNË | **39** |
| **2.2.** | BASHKËPUNIMI ME KUVENDIN, ORGANET SHTETËRORE, ASOCIACIONET DHE INSTITUCIONET PROFESIONALE, ORGANIZATAT CIVILE DHE PUBLIKUN E GJERË | **42** |
| **2.3.** | BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET E TYRE | **46** |
| **2.4.** | KONTRIBUTI I ESHR-SË NË STRATEGJINË NACIONALE TË ZHVILLIMIT 2024-2044 | **48** |
| **03** | **KAPACITETET ADMINISTRATIVE** | **49** |
| **3.1.** | STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE | **51** |
| **3.2.** | RRITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHTETËRORË | **52** |
| **3.3.** | BURIMET E TI-SË | **54** |
| **3.4.** | MJETET FINANCIARE PËR PUNËN E ESHR-SË | **56** |
| **3.5.** | ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR | **60** |
| **04** | **BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR** | **61** |
| **4.1** | BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR | **63** |
| **4.2** | AKTIVITET E PROJEKTEVE | **74** |
| **4.3** | INTEGRIMI NË BE | **81** |
| **05** | **REVIZIONET E KRYERA** | **83** |

| | | |
|---|---|---|
| **5.1** | VLERA E SHTUAR NGA REVIZIONET | **93** |
| **5.2** | REVIZIONET E KRYERA | **95** |
| 5.2.1 | BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT | 95 |
| 5.2.2. | GJYQËSORI DHE SUNDIMI I SË DREJTËS | 118 |
| 5.2.3 | TRAFIKU, TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMET | 124 |
| 5.2.4 | CILËSIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE GRUMBULLIMI, SHPENZIMI DHE SHFRYTËZIMI I MJETEVE DHE BURIMEVE PUBLIKE | 132 |
| 5.2.5 | VEPRIMTARITË KOMUNALE PUBLIKE | 136 |
| 5.2.6 | VETËQEVERISJA LOKALE DHE ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL | 143 |
| 5.2.7 | PARTITË POLITIKE | 148 |
| 5.2.8 | SIGURIA DHE MBROJTJA SHTETËRORE | 151 |
| 5.2.9 | MEKANIZMAT E KONTROLLIT DHE FUNKSIONIMI I TYRE NË SISTEMIN SHTETËROR | 160 |
| 5.2.10 | ARSIMI DHE SHKENCA | 168 |
| 5.2.11 | BE | 172 |
| 5.2.12 | EKONOMIA | 177 |
| 5.2.13 | ENERGJETIKA | 184 |
| 5.2.14 | SISTEMI SHËNDETËSOR | 195 |
| 5.2.15 | KULTURË DHE SPORT | 204 |
| 5.2.16 | PUNË DHE POLITIKË SOCIALE | 209 |
| 5.2.17 | SISTEMET E TI-SË DHE SIGURIA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE | 221 |
| 5.2.18 | MARRËDHËNIET NDËRMJET BASHKËSIVE | 226 |
| 5.2.19 | LOJËRAT E FATIT | 229 |
| **06** | **DOBËSITË SISTEMOREE** | **235** |
| **07** | **RAPORTET FINANCIARE TË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT DHE RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR** | **243** |



## Të nderuar lexues,

Raporti vjetor për revizionet e kryera dhe punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025 paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të realizuara, rezultateve të arritura dhe kontributit të institucionit në avancimin e llogaridhënies dhe transparencës në menaxhimin e mjeteve publike. Përmbajtja e tij pasqyron profesionalizmin, ekspertizën dhe përkushtimin e të punësuarve në ESHR, si dhe përcaktimin tonë për zbatimin e vazhdueshëm të parimeve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në realizimin e misionit tonë – "gardian i mjeteve publike".

Enti Shtetëror i Revizionit, si Institucion Suprem i Revizionit i pavarur, e ushtron rolin e tij ligjor në drejtim të avancimit të menaxhimit me mjetet dhe politikat publike. Përmes revizioneve të pavarura, objektive dhe profesionale, misioni ynë është të kontribuojmë në përdorimin më efikas të burimeve publike dhe në krijimin e vlerës së shtuar për qytetarët.

Gjatë vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit realizoi aktivitetet e planifikuara të revizionit në përputhje me Programin Vjetor të Punës, duke përfshirë të gjithë strukturën e institucioneve në shtet, përfshirë institucionet e pushtetit qendror dhe lokal, shoqëritë aksionare, partitë politike, ndërmarrjet publike, agjencitë, fondet dhe subjektet e tjera që disponojnë me mjete publike. Përveç kësaj, u përfshinë edhe fusha të veçanta me interes për qytetarët dhe personat juridikë përmes revizioneve të suksesit, revizioneve të TI-së dhe revizioneve të pajtueshmërisë.

Përmes revizioneve të kryera identifikuam një numër gjendjesh që tregojnë nevojën për avancimin e mëtejmë të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit financiar, përmirësimin e menaxhimit me rreziqe, forcimin e kontrolleve të brendshme dhe të revizionit të brendshëm, si dhe për përdorim më efikas të mjeteve publike.

Gjendjet e konstatuara me revizionet konfirmuan edhe një herë se menaxhimi i mirë i financave publike nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një parakusht për ndërtimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve. Për këtë arsye, vëmendje të veçantë i kushtuam formulimit të rekomandimeve të qarta, të zbatueshme dhe të matshme, të orientuara drejt eliminimit të dobësive të konstatuara dhe parandalimit të përsëritjes së tyre.

Gjatë vitit të kaluar vazhduam me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna më parë, pasi vlera e vërtetë e revizionit pasqyrohet në ndryshimet që ai nxit. Është inkurajues fakti që pushteti ekzekutiv i obligon subjektet e përfshira në revizione të përgatisin plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe të raportojnë për realizimin e tyre. Megjithatë, edhe pse te një numër i konsiderueshëm subjektesh është vërejtur përparim, mbeten fusha ku nevojitet një nivel më i lartë përkushtimi dhe përgjegjësie nga personat kompetentë.

Përveç aktiviteteve të rregullta të revizionit, Enti Shtetëror i Revizionit edhe gjatë vitit 2025 punoi në mënyrë aktive për forcimin e kapaciteteve të veta institucionale përmes edukimit të vazhdueshëm të kuadrit, avancimit të metodologjive të revizionit dhe përshpejtimit të digjitalizimit të proceseve. Gjatë vitit u miratuan disa akte metodologjike dhe u zhvilluan mjete të reja për mbështetjen e punës së revizionit, duke përfshirë edhe zgjidhje të bazuara në analizën e të dhënave dhe inteligjencën artificiale, me qëllim të rritjes së efikasitetit, efektivitetit dhe cilësisë së revizioneve.

Njëkohësisht, forcuam bashkëpunimin me Kuvendin, me komisionet kompetente parlamentare, si dhe me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, duke qenë të bindur se revizioni efektiv dhe mbikëqyrja efektive parlamentare janë elemente të ndërlidhura të qeverisjes demokratike.

Revizioni në vetvete nuk sjell ndryshime. Ndryshimet i sjellin institucionet përmes veprimit në kohë dhe të qëndrueshëm sipas rekomandimeve të revizionit. Prandaj, përdorimi i raporteve të revizionit si instrument për përmirësimin e punës së institucioneve mbetet përgjegjësi e përbashkët e të gjithë bartësve të funksioneve publike.

Për të mbështetur zbatimin e rekomandimeve nga Raportet përfundimtare të revizionit, ESHR-ja komunikoi në mënyrë të vazhdueshme me palët e interesuara (2.417 komunikime) dhe e rriti dukshmërinë e saj në publik. Krahasuar me vitin 2020, vizitat në faqen e internetit janë rritur 6,3 herë, duke arritur në 305.404 vizita, ndërsa është shënuar edhe rritje e vazhdueshme e numrit të ndjekësve në rrjetet sociale. Njëkohësisht, edhe në vitin 2025, ESHR-ja e ruajti vendin e parë në Sistemin Kombëtar të Integritetit dhe ndan vendin e parë në fushën e qasjes së lirë në informacionet me karakter publik.

Enti Shtetëror i Revizionit do të vazhdojë të punojë në mënyrë profesionale, të pavarur dhe të paanshme, i udhëhequr nga parimet e integritetit, transparencës dhe interesit publik, pa u larguar nga misioni i tij, pavarësisht sfidave dhe interpretimeve të ndryshme publike të punës së tij. Qëllimi ynë nuk është vetëm të identifikojmë dobësitë, por edhe të kontribuojmë në institucione më efikase, menaxhim më të mirë dhe besim më të madh të qytetarëve. Në këtë drejtim, përparësi u japim masave parandaluese dhe korrigjuese, ndërsa sanksionimi mbetet mjeti i fundit për sigurimin e veprimit të ligjshëm dhe të përgjegjshëm.

Në emër të Entit Shtetëror të Revizionit, shpreh mirënjohjen time të sinqertë ndaj Kuvendit për mbështetjen dhe bashkëpunimin në realizimin e rolit tonë ligjor.

Mirënjohje shpreh edhe ndaj pushtetit ekzekutiv, ministrive kompetente dhe të gjitha institucioneve që bashkëpunuan në mënyrë konstruktive gjatë proceseve të revizionit.

Mirënjohje të veçantë meritojnë të punësuarit në Entin Shtetëror të Revizionit, profesionalizmi, përkushtimi dhe ekspertiza e të cilëve përbëjnë themelin e rezultateve të arritura dhe forcën shtytëse të zhvillimit të vazhdueshëm të institucionit.

Besoj se në periudhën e ardhshme, së bashku do të krijojmë kushte për menaxhim të ligjshëm dhe të përgjegjshëm të mjeteve publike, shërbime më cilësore për qytetarët dhe besim më të madh në institucionet. Njëkohësisht, është e domosdoshme të sigurojmë vlerësimin e duhur të punës dhe ekspertizës së të gjithë të punësuarve, përfshirë edhe revizorët shtetërorë si bartës të llogaridhënies publike.



NË FUND DO TË THEKSOJA SE INSTITUCIONET E FORTA NDËRTOHEN PËRMES PAVARËSISË, INTEGRITETIT, LLOGARIDHËNIES DHE AVANCIMIT TË VAZHDUESHËM. TË UDHËHEQUR NGA KËTO PARIME, ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT EDHE NË TË ARDHMEN DO TË VAZHDOJË TA PËRMBUSHË ME PËRKUSHTIM ROLIN E TIJ NË MBROJTJEN E INTERESIT PUBLIK DHE NË AVANCIMIN E QEVERISJES SË MIRË.

JU FALEMINDERIT

Kryerevizori shtetëror

mr. Maksim Acevski

# **REZULTATET KYÇE**
## NGA PUNA E ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT

në 000 denarë

## VLERA E SHTUAR E REVIZIONEVE

**213.483.452**
Aktiva / pasiva e reviduar nga Bilanci i Gjendjes

**24.886.482**
Taksat / kompensimet publike të papaguara / më pak të paguara në Buxhetin e Shtetit

**33.127**
Kërkesat nga shteti

**3.338.526**
Kompensimet e papaguara / më pak të paguara në Buxhetin e komunave të reviduara

**945.937**
Shfrytëzimi i paligjshëm i mjeteve

**1.909.386**
Regjistrimet korrigjuese në Bilancin e Gjendjes

**28.054.651**
Gjendjet e konstatuara që ndikojnë në veprimtarinë e subjektit që është lëndë e revizionit, detyrimet e papaguara dhe investimet kapitale

**8.911.380**
Anulimi / ngecja e granteve të investimeve

**1.499.739**
Provizionet e paguara / llogaritura për mjetet e patërhequra nga kreditë / huatë

**4.671**
Detyrime të paraqitura më pak

**576.275**
Më pak TVSH të llogaritur

**178.907**
Tatime të përllogaritura më pak – kamata

**822.368**
Më pak kontribute të llogaritura

**25.436**
Tatim mbi të ardhurat personale i përllogaritur më pak

**1.218.392**
Tatim mbi fitimin i përllogaritur më pak

**1.189.441**
Kërkesat e parashkruara

**805.931.606**
Vlera e kërkesës së padisë në procedurat gjyqësore në të cilat subjekti që është lëndë e revizionit paraqitet në rolin e të paditurit dhe të paditësit

**4.094.209**
Shuma e procedurave të humbura gjyqësore

**20.939**
Shuma e shpenzimeve të avokatëve, noterëve dhe shpenzimeve të përmbaruesve

**14.906.062**
Efektet financiare nga revizionet/ mjetet e paguara gjatë revizionit / kamatat e zvogëluara

**58.513.801**
Vlera tjetër e shtuar e revizionit / kompensimet e paguara jo në kohë

**378.170.928**
Shuma totale e prokurimeve

**145.415.176**
Përfshirja e prokurimeve publike me revizion

**233.895**
Kërkesa të shlyera

**14.308.603**
Shuma totale e parregullsive të konstatuara në prokurimet publike

**1.171.372**
Prokurimet e kryera për të cilat nuk është zbatuar procedura e prokurimeve publike

## **PROGRAMI VJETOR** I PUNËS SË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT PËR VITIN 2025

- Buxheti shtetëror
- Njësia e vetëqeverisjes lokale
- Fondet e shtetit
- Drejtësia
- Sigurimi shëndetësor
- Arsimi
- Energjetik
- Regjistrimi
- Shërbimet publike komunale
- Barazia gjinore
- Mjedisi jetësor
- Zhvillimi teknologjik dhe ekonomik
- Sistemi për sigurim socia
- Fondet e BE-së
- Fondet ndërkombëtare
- Kulturë
- Sistemi i TI-së
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Sistemi politik
- Mbrojtja
- Pronësia shtetërore
- Infrastruktura
- Zhvillim rajona
- Trafiku

## REVIZIONET E KRYERA **76**

| | |
|---|---|
| **57** | Revizione të rregullshmërisë |
| **9** | Revizione të suksesit |
| **4** | Revizione të TI-së |
| **6** | Revizione të pajtueshmërisë |

## **OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM** TË PËRFSHIRA ME REVIZIONET




## STRATEGJIA KOMBËTARE E ZHVILLIMIT **2024-2044**

- Ekonomi e qëndrueshme, inovative dhe konkurruese
- Zhvillimi i qëndrueshëm lokal dhe rajonal
- Zhvillim social dhe kulturor
- Shoqëri e sigurt, e mbrojtur dhe rezistente
- Sundimi i ligjit dhe qeverisje e mirë
- Transformim i gjelbër

## REVIZIONET PËRMES NUMRAVE

**120**
RAPORTET E REVIZORIT

### OPINIONET E REVIZORIT – REVIZIONI I RREGULLSHMËRISË

**100** opinione për raportet financiare

- **22** pa rezervë
- **19** me rezervë
- **57** opinione të pafavorshme
- **2** abstenime nga opinioni

**94** opinione për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat

- **14** pa rezervë
- **33** me rezervë
- **47** opinione të pafavorshme
- **/** abstenime nga opinioni

### KONKLUZIONET

REVIZIONI I PAJTUESHMËRISË / REVIZIONI I SUKSESIT

- **6** konkluzione për revizionin e pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit
- **9** konkluzione për revizionin e suksesit
- **4** konkluzione për revizionin e TI-së

### 1.500

GJETJE DHE ÇËSHTJET TË DETEKTUARA ME REVIZIONET

- **1.047** revizione të rregullshmërisë
- **239** revizione të suksesit
- **132** revizione të pajtueshmërisë
- **82** revizione të TI-së

### 244

SUBJEKTE TË PËRFSHIRA ME REVIZIONET

- **52** revizione të rregullshmërisë
- **152** revizione të suksesit
- **30** revizione të pajtueshmërisë
- **5** revizione të TI-së
- **5** parti politike

### 149

DOBËSI TË KONSTATUARA NË GJETJET E PROKURIMEVE PUBLIKE

SHUMA TOTALE E PROKURIMEVE PUBLIKE
**378.170.928**
(në 000 denarë)

PROKURIMET E REVIDUARA PUBLIKE
**145.415.17**
(në 000 den

**14.308.603**
PARREGULLSI TË KONSTATUARA NË PROKURIMET PUBLIKE
(në 000 denarë)

**1.171.372**
PROKURIME TË KRYERA PËR TË CILAT NUK ËSHTË ZBATUAR PROCEDURA E PROKURIMIT PUBLIK
(në 000 denarë)

- dobësitë në fazën e planifikimit të prokurimeve publike
- parregullsitë në përgatitjen e dokumentacionit të tenderit
- dobësitë në fazën e realizimit të kontratave
- parregullsitë në vlerësimin e ofertave
- procedurat e pazbatuara të prokurimeve publike

## TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË REVIDUARA

GJITHSEJ **542.550 MILION DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **287.827 MILION DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2025.

| | Të ardhurat publike të reviduara | Shpenzimet publike të reviduara |
|---|---|---|
| Buxheti Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut | 299.161<br>264.348 | 27.982<br>59.574 |
| Buxhetet e fondeve | 172.744<br>149.216 | 167.031<br>145.363 |
| Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale | 9.225<br>7.018 | 8.947<br>3.760 |
| Shfrytëzuesit e mjeteve nga buxheti i FSSH-së | 1.720<br>3.386 | 1.646<br>3.360 |
| Partitë politike dhe pjesëmarrësit në fushatat zgjedhore | 704<br>1.276 | 529<br>1.067 |
| Ndërmarrjet publike | 1.070<br>1.381 | 1.259<br>1.534 |
| Ndërmarrjet dhe institucionet e tjera publike / Personat juridikë në të cilat shteti është aksionar dominues | 15.955<br>1.896 | 13.783<br>4.811 |
| Të përfshira me Revizionet e Suksesit | 41.971<br>23.355 | 26.472<br>8.302 |
| Të përfshira me Revizionet e Pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizioneve | 0<br>0 | 40.178<br>3 |

Programi Vjetor 2025 (first value) · Programi Vjetor 2024 (second value)

në 000.000 denarë

# 2025



1.073
TOTALI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA
350 REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DORËZIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
723 REKOMANDIMET PËR TË CILAT NUK KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONEVE KTHYESE
106 REKOMANDIMET PËR TË CILAT NUK ËSHTË PËRCAKTUAR STATUSI PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DORËZIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
86% VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE
244 REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR
209 REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT
35 nuk janë të zbatuar
/ Të pazbatueshme

# 2024


889
REKOMANDIME TË DHËNË
889 REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
142 REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
76 %
VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE
747
REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR
569 REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT
158 nuk janë të zbatuar
20 Të pazbatueshme

# 2023


697
REKOMANDIME TË DHËNË
697 REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
69%
VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE
616
REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR
81 REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
423 REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT
178 nuk janë të zbatuar
15 Të pazbatueshme

## PASQYRË E HUAMARRJES ME HUA/GRANTE, MJETET E PËRGJITHSHME TË TËRHEQURA DHE TË PATËRHEQURA DHE SHPENZIME PËR PROVIZION TË MJETEVE TË PATËRHEQURA PËR PROJEKTET RRJEDHËSE, NGA INSTITUCIONET KOMPETENTE, ME GJENDJE **31.12.2024**

në 000 denarë

| | | | | | | | Dinamika e realizimit, në përputhje me periudhën e huamarrjes me hua/grant |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ministria e Financave | 3.068.601 | 431.058 | 2.637.543 | 14% | 86% | 11.567 | 2 projekte nga viti 2021 dhe 2023 |
| Ministria e Transportit dhe Lidhjes | 8.663.108 | 4.724.440 | 3.938.668 | 55% | 45% | 46.774 | 3 projekte nga vitet 2019-2023 dhe 1 pojekt nga viti 2019 |
| Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor | 6.456.975 | 29.210 | 6.427.765 | 0% | 100% | 0 | 2 projekte nga vitet 2022 dhe 2023 |
| MPSDR | 4.304.650 | 1.711.068 | 2.593.582 | 40% | 60% | 24.461 | 3 projekte nga vitet 2018, 2020 dhe 2024 |
| MD- DREJTORIA PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE | 2.890.265 | 1.291.395 | 1.598.870 | 45% | 55% | 0 | 1 projekt nga viti 2010 |
| Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave | 7.994.350 | 378.388 | 7.615.962 | 5% | 95% | 63.474 | 1 projekt nga viti 2019 dhe 1 projekt nga viti 2021/2022 |
| MASH | 4.943.280 | 3.234.414 | 1.708.866 | 65% | 35% | 19.894 | 3 projekte nga vitet 2011/2022 dhe 2021 dhe 1 projekt nga viti 2019 |
| SHA Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut | 12.299.000 | 5.945.522 | 6.353.478 | 48% | 52% | 0 | 2 projekt nga viti 2023 dhe 1 projekt nga viti 2024 |
| NPRRSH | 82.211.910 | 49.843.717 | 32.368.193 | 61% | 39% | 613.680 | 6 projekte nga vitet 2014-2022 dhe 1 projekt nga vitet 2014/2019 |
| NP për Infrastrukturë Hekurullorë HRMV Shkup | 47.567.848 | 4.928.435 | 42.639.413 | 10% | 90% | 405.539 | 2 projekte nga viti 2012 dhe vitet 2014/2018 dhe 1 projekt nga viti 2023 |
| SHA Elektraat e Maqedonisë së Veriut - ESM | 16.565.902 | 8.142.117 | 8.423.785 | 49% | 51% | 89.509 | 4 projekte nga vitet 2015 - 2023 dhe 1 projekt nga vitet 2018/2019 dhe 2 projekte nga viti 2024 |
| SHA MEPSO | 6.297.088 | 3.011.103 | 3.285.985 | 48% | 52% | 146.400 | 2 projekte nga vitet 2013 dhe 2015/2016 |
| SHA NOMAGAS Shkup | 12.361.971 | 0 | 12.361.971 | 0% | 100% | 0 | 1 projekt nga viti 2021 dhe 1 projekt nga viti 2024 |
| M-NAV SHA SHKUP | 625.773 | 192.390 | 433.383 | 31% | 69% | 5.696 | 1 projekt nga viti 2022 |
| Qyteti i Shkupit | 4.304.650 | 0 | 4.304.650 | 0% | 100% | 0 | 1 projekt nga viti 2021 |
| NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi Shkup | 12.039.754 | 1.573.042 | 10.466.712 | 13% | 87% | 0 | 1 projekt nga vitet 2019/2023 |
| | **235.448.492** | **85.444.007** | **150.004.484** | | | **1.499.739** | |

Institucioni kompetent

Shuma totale e huave / granteve investuese

Shuma e mjeteve të tërhequra

Shuma e mjeteve të patërhequra

% e mjeteve të tërhequra

% e mjeteve të pa tërhequra

Shpenzimet e provizioneve për mjetet patërhequra

## PUBLIKIMI RPR NË VEB FAQEN E ESHR-SË

- 2021 — 78 publikime
- 2022 — 56 publikime
- 2023 — 211 publikime
- 2024 — 54 publikime
- 2025 — 92 publikime

**Facebook**

- 2021 — 87 publikime
- 2022 — 161 publikime
- 2023 — 182 publikime
- 2024 — 173 publikime
- 2025 — 92 publikime




**Video të lidhura me RPR**

- 1 video — 2021
- 7 video — 2025

**Video të lidhura me ESHR**

- 2 video — 2022
- 12 video — 2025

## VIZITA NË WWW.DZR.MK




| | |
|---|---|
| 2020 | **48.148** vizita |
| 2021 | **102.665** vizita |
| 2022 | **100.640** vizita |
| 2023 | **144.640** vizita |
| 2024 | **221.718** vizita |
| 2025 | **305.404** vizita |

Deri vitin 2025 numri i vizituesve të faqës së internetit është rritur për **634%** ose për **6.3** herë në krahasim me vitin 2020.

# PROCESI I REVIZIONIT





01

# PËR ENTIN SHTETËROR TË REVIZIONIT



# ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është Institucion Suprem i Revizionit i pavarur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili për 26 vjet ka informuar në mënyrë transparente, në kohë dhe objektive institucionet kompetente dhe publikun për gjendjet e konstatuara nga revizionet e kryera. ESHR-ja i kryen revizionet në përputhje me parimet, standardet dhe udhëzimet e revizionit të përmbajtura në Kornizën e Publikimeve Profesionale të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI). Pavarësia e institucionit përcaktohet me Ligjin për revizion shtetëror, i cili rregullon kompetencat e ESHR-së, përcakton një mandat të gjerë për kryerjen e revizioneve, me qasje të lirë në të gjitha informacionet e domosdoshme, dokumentacionet dhe evidencat e nevojshme për të zbatuar revizionin shtetëror. ESHR-ja e përcakton në mënyrë të pavarur Programin Vjetor të Punës, vendos në mënyrë objektive për subjektet që janë lëndë e revizionit, si dhe për mënyrën e raportimit mbi revizionet e kryera, pa paragjykime dhe e liruar nga ndikimet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.



# MISIONI

## PSE EKZISTOJMË DHE ÇFARË PUNOJMË?

Enti Shtetëror i Revizionit është organ shtetëror me status të Institucionit Suprem të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ka mandat sovran për zbatimin e revizionit shtetëror.

Qëllimi ynë i ekzistencës është të krijojmë vlerë të shtuar nga revizionet në dobi të qytetarëve, shtetit dhe shoqërisë përmes kryerjes së shqyrtimeve të thelluara, vlerësimeve profesionale dhe dhënies së opinioneve të paanshme, të bazuara në standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit – INTOSAI.

Ne kryejmë revizion të raporteve financiare, pajtueshmërisë me rregullativën ligjore dhe vlerësim të efikasitetit në funksionimin e institucioneve të sektorit publik.

Përmes mandatit tonë, qëndrojmë fuqishëm në shërbim të interesit publik, duke promovuar llogaridhënie maksimale, objektivitet dhe transparencë në punën tonë.

Ne jemi partner të organeve kompetente të shtetit, punojmë në dobi të qytetarëve dhe të komunitetit në tërësi, në misionin për menaxhim ekonomik, të ndershëm dhe të përgjegjshëm me mjetet publike.



# VIZIONI

## DREJT ÇFARË SYNOJMË DHE ÇFARË GJURMË LËMË PAS NESH?

Në përpjekjen tonë të palëkundur për realizimin e misionit tonë, mbetemi të lidhur fort me parimet e pavarësisë, profesionalizmit dhe integritetit etik.

Vizioni ynë është të jemi shembull frymëzues i inovacionit dhe objektivitetit, duke mbrojtur interesin publik me nivelin më të lartë të ndershmërisë dhe qëndrueshmërisë ligjore.

Synojmë të jemi institucion që gëzon besimin e publikut dhe që me shembullin e vet e tregon rrugën e qeverisjes transparente dhe menaxhimit me mjetet publike, rrugë të cilën e ndërtojmë së bashku me të punësuarit tanë, profesionistë të profilizuar lartë, të cilët me përkushtim personal dhe integritet mbrojnë vlerat dhe dinjitetin e profesionit të revizionit.



# 1.1 KORNIZA JURIDIKE

## 1.1.1. PAVARËSIA DHE KOMPETENCAT LIGJORE

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është Institucion Suprem i Revizionit (ISR) të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila kompetencat e saj i kryen mbi bazën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ligjit për revizionin shtetëror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15, 27/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/21, 3/25).

Me Ligjin për revizion shtetëror rregullohen kushtet dhe mënyra e kryerjes së revizionit shtetëror, organizimi, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e ESHR-së, si dhe sigurimi i pavarësisë, profesionalizmit dhe llogaridhënies së tij.

Revizioni shtetëror kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare për institucionet supreme të revizionit (ISSAI), të miratuara nga INTOSAI – Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit.

ESHR është organ shtetëror i pavarur dhe autonom, **i cili kryen revizione financiare, revizione të pajtueshmërisë (rregullshmërisë) dhe revizione të suksesit tek:**

Shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal, fondet dhe shfrytëzuesit e tjerë të mjeteve buxhetore;

Ndërmarrjet publike, shoqëritë aksionare dhe personat e tjerë juridikë që disponojnë me mjete publike;

Partitë politike dhe pjesëmarrësit në fushatat zgjedhore.

ESHR konstaton gjendje, jep opinione dhe ofron rekomandime për përmirësimin e menaxhimit me resurset financiare publike të subjekteve lëndë të revizionit.

Përveç ligjit bazë, çështje të caktuara nga kompetencat e Entit Shtetëror të Revizionit rregullohen edhe me ligje të veçanta të legjislacionit kombëtar, e në veçanti:

**Ligji për buxhete,** në lidhje me revizionin të Propozim-llogarisë përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

**Ligji për Prokurimet Publike,** në lidhje me revizionin e përdorimit dhe shpenzimit të mjeteve për prokurime publike nga ana e organeve kontraktuese;

**Ligji për financimin e partive politike,** në lidhje me revizionin e pasqyrave financiare të partive politike;

**Kodi Zgjedhor,** në lidhje me revizionin e raporteve financiare të pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore;

**Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe Ligji për vetëqeverisjen lokale,** në lidhje me revizionin e raporteve financiare të komunave, si dhe ligje të tjera të veçanta.

Këto dispozita ligjore mundësuan mbulim gjithëpërfshirës dhe efikas të fushave kyçe të përdorimit dhe menaxhimit të mjeteve publike në vitin 2025.

Enti Shtetëror i Revizionit është pjesëmarrës aktiv në realizimin e **Programit Kombëtar për Miratimin e së Drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) 2021-2025,** veçanërisht në Kapitullin 32 – Kontrolli financiar.

Në vitin 2025, ESHR vazhdoi të japë kontribut të vazhdueshëm në grupet e punës për negociata, si dhe në raportet për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në procesin e integrimit evropian. Kontributi i institucionit është veçanërisht i rëndësishëm në numër më të madh kapitujsh, ndër të cilët:

### KONTRIBUTI I INSTITUCIONIT



Enti Shtetëror i Revizionit është faktor aktiv në arritjen e objektivave, marrjen e masave dhe zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në një nga dokumentet programore më të rëndësishme të shtetit – **Programin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2025 – 2028.**

Në vitin 2025, ESHR vazhdoi me zbatimin e **Udhëzuesit për raportimin e gjendjeve të konstatuara gjatë kryerjes së revizionit shtetëror,** për të cilat ekziston dyshim se subjekti i revizionit ka kryer vepër penale, në kuadër të realizimit të programit të tij të punës për vitin 2025. Në përputhje me këtë Udhëzues, ESHR vazhdoi të realizojë bashkëpunim të vazhdueshëm dhe efikas me Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes raportimit në kohë dhe ndjekjes së rasteve në të cilat gjatë revizioneve janë konstatuar dyshime të bazuara për vepra penale të kryera.

Miratimi i propozim-amendamenteve për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim të vendosjes kushtetuese dhe sigurimin e garancisë më të lartë juridike të pavarësisë dhe autonomisë së Entit Shtetëror të Revizionit, si dhe miratimi i Ligjit të ri për revizionin shtetëror – i cili është përgatitur dhe plotësisht i harmonizuar me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit (ISSAI), legjislacionin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira të anëtarëve të EUROSAI **– mbeten një nga sfidat kryesore për organet e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ edhe në periudhën e ardhshme.**

# 1.2 DOKUMENTET DHE AKTIVITETET STRATEGJIKE DHE ATO VJETORE

## 1.2.1. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË ESHR-së PËR VITET 2023 – 2027

Strategjia e Zhvillimit të ESHR-së për vitet 2023-2027 e pasqyron perspektivën pesëvjeçare të zhvillimit të institucionit suprem të revizionit në vendin tonë.

Kjo perspektivë përkufizohet përmes 4 qëllimeve strategjike për zhvillimin e ESHR-së, përkatësisht:

**01 QËLLIMI STRATEGJIK**

Sigurimi dhe ruajtja e pavarësisë së plotë të Entit Shtetëror të Revizionit – pavarësia institucionale dhe korniza institucionale ligjore nga Korniza e Ndërtimit të Kapaciteteve [3].

**02 QËLLIMI STRATEGJIK**

Ruajtja e mëtejshme e kapaciteteve të menaxhimit të brendshëm, mbështetja institucionale, synimi për përmirësimet e vazhdueshme, marrëdhëniet/komunikimi me palët e interesuara, kapacitetet njerëzore, metodologjia e revizionit dhe standardet nga Korniza e Ndërtimit të Kapaciteteve.

**03 QËLLIMI STRATEGJIK**

Realizimi/përmbushja e vlerës sonë të shtuar - ofrimi i rezultateve të matshme nga kryerja e revizionit shtetëror, drejt ofrimit të revizioneve me cilësi të lartë, revizioneve me interes publik dhe rritjes së besimit publik, me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve (Rezultatet nga Korniza e Ndërtimit të Kapaciteteve).

**04 QËLLIMI STRATEGJIK**

Hartimi i planit strategjik për të përkufizuar fushat e mundshme të revizioneve përmes vlerësimit të sfidave në fushat me interes dhe sipas vlerësimit të rreziqeve për periudhën 2023 – 2027. Këto do të merren parasysh në planifikimin vjetor në nivel të ESHR-së.

Realizimi i Strategjisë për zhvillimin e Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2023–2027 gjatë vitit 2025 ishte i orientuar drejt forcimit të pavarësisë institucionale, avancimit të kapaciteteve të revizionit, zhvillimit të akteve bashkëkohore strategjike dhe metodologjike, si dhe rritjes së transparencës dhe besimit të publikut.

Në kuadër të aktiviteteve të realizuara, ESHR zhvilloi trajnime të shumta, bashkëpunim ndërkombëtar, revizione kooperative dhe paralele, si dhe avancim të komunikimit me palët e interesuara dhe publikun.

Theks i veçantë iu kushtua digjitalizimit të proceseve të revizionit, avancimit të vazhdueshëm profesional, zhvillimit të akteve të reja metodologjike dhe sigurimit të vlerës së shtuar nga revizionet për jetën e qytetarëve.

Qëllimet strategjike dhe të drejtpërdrejta të përcaktuara në Strategjinë për zhvillimin të ESHR-së janë integruar në Programin vjetor të punës të ESHR-së për vitin 2025, ndërsa realizimi i tyre është përfshirë dhe prezantuar në këtë raport.

Në drejtim të përgatitjes së planit të ri strategjik për periudhën e ardhshme pesëvjeçare, ESHR, në bashkëpunim me ISR-në e Norvegjisë, gjatë vitit 2026 filloi aktivitetet fillestare për formimin e ekipit për hartimin e tij, si dhe për përcaktimin e hapave të ardhshëm.

## 1.2.2. STRATEGJIA E TI-së E ESHR-së PËR VITET 2023 – 2027

Qëllimet strategjike të përcaktuara në Strategjinë e TI-së kanë për qëllim të mundësojnë zhvillimin e duhur dhe qëndrueshmërinë e kapaciteteve të TI-së dhe të sistemit informativ, për të ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe cilësore për funksionimin e ESHR-së, në përputhje me objektivat strategjike të TI-së:

### Qëllimet strategjike të TI-së të ESHR-së për 2023 – 2027




Në përputhje me Strategjinë për zhvillimin e Entit Shtetëror të Revizionit 2023–2027, ESHR kryen analizë të vazhdueshme të proceseve të TI-së dhe burimeve të nevojshme të TI-së, duke ndërmarrë hapa konkretë për avancimin e tyre material dhe teknologjik.

Në bazë të indikatorëve të përcaktuar për monitorim, shkalla e implementimit të Strategjisë së TI-së 2023–2027 deri në dhjetor 2025 arrin në 89,06% të aktiviteteve të planifikuara, gjë që tregon një nivel të konsiderueshëm të zbatimit në realizimin e prioriteteve strategjike, por edhe rëndësinë e përdorimit të teknologjisë informative në avancimin e vazhdueshëm të funksionimit dhe rritjen e efikasitetit të proceseve të revizionit.

## 1.2.3. STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE PËR VITET 2024 – 2027

Qëndrueshmëria e procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore në Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR) është aspekt i rëndësishëm në arritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në punë. Me Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për periudhën 2024-2027, ESHR-ja u kushton rëndësi disa fushave vendimtare që janë të domosdoshme për krijimin e mjedisit të qëndrueshëm dhe të suksesshëm të punës:

**01 PUNËSIMI**

Sigurimi i kushteve përkatëse të punësimit, si dhe tërheqja dhe mbajtja e personave të talentuar dhe të kualifikuar.

**02 KARRIERA DHE AVANCIMI**

Sigurimi i kushteve të barabarta për punonjësit për avancim dhe zhvillim në karrierë, gjë që do të kontribuojë në motivimin dhe kënaqësinë e tyre në vendin e punës.

**03 PËRSOSJA E VAZHDUESHME PROFESIONALE**

Inkurajimi i punonjësve për të përsosur veten dhe për të fituar aftësi dhe njohuri të reja përmes programeve të ndryshme të arsimit dhe trajnimit, të cilat do të rrisin kompetencën e tyre dhe do të përmirësojnë performancën e tyre.

**04 MATJA E PERFORMANCËS**

Vlerësimi i punës dhe arritjeve të punonjësve, me qëllim të ndjekjes së rregullt të produktivitetit dhe rezultateve të tyre, si dhe shpërblimin e atyre që janë të suksesshëm.

**05 QËNDRUESHMËRIA E MJEDISIT TË PUNËS**

Krijimi i mjedisit të punës që është pozitiv dhe që inkurajon produktivitetin, inovacionet dhe zhvillimin personal të punonjësve.

**06 DIGJITALIZIMI I PROCESEVE**

Integrimi i mjeteve digjitale në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat do t'i lehtësojnë dhe avancojnë proceset e evidentimit, trajnimit, vlerësimit dhe menaxhimit të të dhënave.

ESHR-ja i ka realizuar plotësisht aktivitetet e parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, gjë që konfirmohet nga indikatorët për shkallën e realizimit. Deri në fund të vitit 2025, ESHR-ja i kishte realizuar aktivitetet të planifikuara, gjë që tregon suksesin dhe qëndrueshmërinë e këtij procesi.

Kjo është bazë e rëndësishme për avancimin dhe mirëmbajtjen e mëtejshme të burimeve njerëzore, funksionaliteti i saj i përgjithshëm dhe rezultatet e punës, ndërsa rritja e njohurive dhe aftësive të të punësuarve në ESHR mbetet një nga angazhimet themelore të institucionit, të cilat janë përfshirë në planet vjetore për avancim të vazhdueshëm profesional.




## 1.2.4. STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RREZIQEVE TË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT

Në përputhje me parimet e përcaktuara në ISSAI 140 dhe INTOSAI-P 20, Enti Shtetëror i Revizionit edhe në vitin 2025 vazhdoi me aktivitete për menaxhimin sistematik të rreziqeve që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave strategjike, cilësinë e punës së revizionit dhe funksionimin efikas të institucionit.

Gjatë vitit 2025, sistemi për menaxhimin e rreziqeve u përmirësua më tej dhe u harmonizua me Ligjin e ri për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik dhe me Metodologjinë e re për menaxhimin e rreziqeve. Në këtë drejtim, ESHR miratoi Strategjinë e re për menaxhimin e rreziqeve 2025–2028 dhe krijoi regjistra të veçantë për rreziqet strategjike dhe operative. Me këto aktivitete, ESHR e forcon më tej qasjen sistematike dhe dinamike të menaxhimit të cilësisë të bazuar në rreziqe të përcaktuara, në përputhje me udhëzimet e ISSAI 140 të reviduara.

Sipas metodologjisë së re, rreziqet ndiqen përmes dallimit të qartë ndërmjet rreziqeve strategjike dhe operative, duke vënë theks të veçantë në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga korrupsioni. Për më tepër, u përcaktuan koordinatorë për rreziqet strategjike dhe operative, si dhe koordinatorë në nivel të njësive organizative, me qëllim monitorimin më efikas, raportimin dhe ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e rreziqeve.

Me këtë qasje, ESHR konfirmon fokusin e tij të vazhdueshëm në avancimin e menaxhimit të brendshëm, integritetit institucional, transparencës, përgjegjësisë dhe cilësisë së punës së revizionit.

## 1.2.5. PLANI STRATEGJIK PËR REVIZIONET PËR VITET 2024 – 2027

Korniza e Publikimeve Profesionale të INTOSAI-t (IFPP), përmes Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (ISSAI) dhe Udhëzimeve të INTOSAI-t (GUID), i përcakton parimet themelore për planifikimin strategjik dhe operacional të institucioneve supreme të revizionit.

Kërkesat për planifikimin strategjik dhe operativ të institucioneve supreme të revizionit janë në drejtim të përcaktimit të prioriteteve të ISR-ve, përmbushjes së mandatit të tyre ligjor dhe detyrimeve të tjera në përputhje me rregullativën dhe zbatimin e kritereve profesionale gjatë përzgjedhjes së fushave dhe subjekteve për revizion. ISR-t kanë detyrimin të planifikojnë dhe zbatojnë revizione

në mënyrën që do të ofrojë siguri se merren parasysh pritshmëritë e të gjithë palëve të interesuara dhe të gjitha rreziqeve të parashikueshme dhe të pritshme.

**Në përputhje me Vizionin dhe Misionin e ESHR-së, mandatin e tij dhe objektivat strategjike të përcaktuara, aktivitetet e lidhura me planifikimin strategjik dhe operacional janë të orientuara drejt sigurimit të transparencës, llogaridhënies, integritetit dhe objektivitetit në funksionimin e Entit Shtetëror të Revizionit.**

**Në këtë drejtim, Enti Shtetëror i Revizionit miratoi Udhëzuesin për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve, me të cilin rregullohet mënyra e planifikimit strategjik dhe vjetor të revizioneve dhe i cili paraqet bazën** e Planit Strategjik për Revizionet të miratuar për periudhën 2024–2027.

Qëllimet strategjike për revizionet për periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2027, janë përcaktuar me **Vendimin për përcaktimin e qëllimeve strategjike për revizionet e Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2024 - 2027 dhe për fushat prioritare për revizione sipas sektorëve që kryejnë revizion**, e cila është përgatitur në bazë të procedurave të zbatuara nga sektorët që kryejnë revizione në Entin Shtetëror të Revizionit dhe informacioneve të marra mbi fushëveprimin, rëndësinë dhe rreziqet, të cilat rrjedhin nga qëllimet strategjike (QS) dhe qëllimet e drejtpërdrejta (QD) të Strategjisë së Zhvillimit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitet 2023 – 2027.

Me Vendim, kryerevizori shtetëror i përcaktoi qëllimet strategjike për revizionet për periudhën 2024 - 2027, si në vijim:

- Dhënia e opinionit për prezantimin e vërtetë dhe objektiv të raporteve financiare dhe rezultateve të aktiviteteve financiare të subjekteve që janë lëndë e revizioneve në përputhje me Kornizën e Publikimeve Profesionale të INTOSAI-t (The INTOSAI Framework of Professional Pronouncements (IFPP), Ligjin për revizion shtetëror dhe standardet dhe parimet e pranuara të kontabilitetit;

- Dhënia e opinionit për shfrytëzimin me dedikim dhe të ligjshëm të mjeteve në përputhje me rregullativën ligjore pozitive - shqyrtimin e transaksioneve financiare që janë të ardhura dhe shpenzime publike;

- Dhënia e vlerësimit për shfrytëzimin e burimeve publike në aspektin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të arritur;

- Njoftimi transparent dhe llogaridhënës mbi gjendjet e konstatuara, rekomandimet e dhëna dhe veprimet e ndërmarra/mosndërmarra nga subjektet që janë lëndë e revizionit pas kryerjes së revizioneve, si dhe inicimi i propozimeve për përmirësimin e kornizës juridike para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, publikut dhe të gjitha palëve të interesuara;

- Marrja e veprimeve për të njoftuar dhe bashkëpunuar me organet kompetente në RMV, në lidhje me rreziqet, dyshimet, veprimet dhe transaksionet e paligjshme të mundshme ose të zbuluara, të cilat tregojnë mbi konfliktet e mundshme të interesave, korrupsionin dhe mashtrimin, gjatë kryerjes së revizioneve dhe lëshimit të raportit të revizorit, me qëllim të përcjelljes së veprimit të tyre të mëtejshëm;

- Përzgjedhja e revizioneve që do të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve publike;

- Përzgjedhja e revizioneve që do të kontribuojnë në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit publik dhe rëndësisë së fushave prioritare të mjedisit jetësor dhe qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm;

- Përzgjedhja e revizioneve me interes publik;

- Përzgjedhja e revizioneve si pjesë e aktiviteteve ndërkombëtare të Entit Shtetëror të Revizionit me qëllim të rritjes së njohurive, kapaciteteve dhe aftësive të revizorëve;

- Vlera e shtuar nga revizionet duke ofruar rekomandime të qarta, konkrete dhe konstruktive që tregojnë dobësi ose probleme të caktuara, në drejtim të përmirësimit të gjendjeve, veçanërisht në mënyrat e menaxhimit, shfrytëzimit dhe mbikëqyrjes së mjeteve publike dhe parandalimit të korrupsionit dhe menaxhimit të rreziqeve nga korrupsionit, si dhe në menaxhimin e borxhit publik dhe investimeve kapitale.



Fushat dhe prioritetet e mundshme të sektorëve që kryejnë revizion në Entin Shtetëror të Revizionit për periudhën 2024 - 2027, janë përcaktuar në përputhje me kornizën e përgjithshme të definuar në Strategjinë për zhvillim të Entit Shtetëror të Revizionit 2023–2027, Vendimin, si dhe mbi bazën e planeve strategjike të revizionit të paraqitura në nivel të sektorëve të revizionit, dhe të njetit përfshijnë:




Realizimi i Planit strategjik të revizionit për periudhën 2024–2027 zhvillohet përmes revizioneve të rregullshmërisë, revizioneve të suksesit dhe revizioneve të pajtueshmërisë të përcaktuara në Programin vjetor të punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025. Në Programin vjetor të punës për vitin 2025 janë përcaktuar aktivitetet prioritare për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të ESHR-së, përkatësisht realizimin e objektivave strategjike të institucionit, përmes sigurimit të mbulimit adekuat të mjeteve publike të reviduara, zbatimit të revizioneve të suksesit të programeve dhe projekteve, vlerësimit të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në funksionimin e sektorit publik, si dhe informimit në kohë të palëve të interesuara dhe publikut për gjendjet e konstatuara në raportet përfundimtare të revizionit dhe kontributit në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike që sektori publik ka detyrim ti siguroi personave juridikë dhe fizikë.

## 1.2.6. STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT TË ESHR-së PËR VITET 2024 – 2027

Enti Shtetëror i Revizionit vazhdon të forcojë proceset e komunikimit përmes Strategjisë së Komunikimit për periudhën 2024–2027, e cila synon të përfshijë në mënyrë më efikase publikun, mediat dhe sektorin civil në angazhimin e përbashkët për llogaridhënie dhe transparencë. Si pjesë e Strategjisë, ESHR-ja vendosi regjistër të palëve të interesuara, i cili pas përditësimit të fundit numëron 2.417 kontakte, duke zgjeruar ndjeshëm rrjetin e faktorëve të informuar dhe të përfshirë. Në mënyrë plotësuese, për të lehtësuar qasjen te gjendjet e konstatuara të përfshira në RPR, ESHR-ja ka prezantuar abstrakte të revizorit dhe njoftime për publikun, përmes të cilave informacionet kryesore nga raportet përfundimtare të revizorit bëhen më të arritshme dhe të kuptueshme. Për raportet e caktuara vendimtare të revizorit për të cilat ESHR-ja konsideron se kërkojnë informim shtesë për publikun e gjerë, përgatit video duke përdorur Inteligjencën Artificiale, ku videoja përfshin edhe të folurit, përveç tekstit të shkruar [1].

Përveç komunikimit të drejtpërdrejtë me mediat dhe sektorin civil, Enti Shtetëror i Revizionit në mënyrë të vazhdueshme e avancon transparencën e tij online dhe qasjen për publikun. Të gjitha informacionet, raportet e revizionit dhe analizat e rëndësishme publikohen rregullisht në faqen e internetit (www.dzr.mk), si dhe në profilin zyrtar të institucionit në Fejsbuk, ndërsa nga janari 2025 ESHR komunikon në mënyrë aktive edhe përmes Instagram, me qëllim që të arrijë te një publik më i gjerë dhe të forcojë ndërveprimin me qytetarët.

Gjatë vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit tregoi një nivel të lartë përkushtimi ndaj transparencës dhe llogaridhënies publike, duke realizuar 17 nga gjithsej 24 aktivitete të planifikuara në kuadër të Strategjisë së Komunikimit. Një pjesë e aktiviteteve nuk u realizuan për shkak të arsyeve/faktorëve objektivë dhe nevojës për koordinim me institucione të tjera. Megjithatë, përmes aktiviteteve të realizuara, ESHR përmirësoi ndjeshëm modelin dypalësh të komunikimit me publikun dhe përforcoi më tej rolin e tij si aktor relevant dhe i besueshëm në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin institucional.




[1] https://www.youtube.com/watch?v=ZQJp0ypHMs0

## NË STRATEGJI JANË PËRKUFIZUAR DY QËLLIME STRATEGJIKE TË KOMUNIKIMIT:

### QËLLIMI I PARË STRATEGJIK I KOMUNIKIMIT TONË

Për të mundësuar përfshirje më të thellë dhe gjithëpërfshirëse, me bazë strategjike të grupeve të synuara në fushën civile, në luftën e përbashkët për efikasitet më të madh, transparencë dhe llogaridhënie të aktorëve në sistemin institucional të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**1** QËLLIMI SPECIFIK

T'i sjellim gjetjet tona për punën e institucioneve më afër qytetarëve dhe t'ua afrojmë misionin tonë të përgjithshëm atyre, duke forcuar nivelin e tyre të njohurive dhe besimit në institucionin tonë.

**2** QËLLIMI SPECIFIK

Të forcojmë eko-sistemin e komunikimit në të cilin zhvillohet biseda e vazhdueshme midis ESHR-së dhe aktorëve në fushën civile: gazetarët dhe aktivistët në organizatat qytetare, në mënyrë që bashkërisht të motivojmë qeverisjen e mirë me institucionet.

**3** QËLLIMI SPECIFIK

Të zgjerojmë fushëveprimin e komunikimit me aktorët në fushën civile që punojnë jashtë kryeqytetit dhe që ofrojnë shërbime për qytetarët e cenueshëm dhe të margjinalizuar.

### QËLLIMI I DYTË STRATEGJIK I KOMUNIKIMIT TONË

T'u mundësojmë aktorëve në sistemin institucional që të njohin më qartë punën tonë si bazë për forcimin e qeverisjes së mirë, ndërsa institucionin tonë si katalizator të demokratizimit.

**4** QËLLIMI SPECIFIK

Të strukturojmë dhe të intensifikojmë dialogun me Prokurorinë Publike të RMV-së për të vendosur praktikë të diskutimit të rregullt të revizorëve me prokurorët publikë rreth gjetjeve prej revizioneve tona.

**5** QËLLIMI SPECIFIK

Duke e rritur njohurinë e deputetëve dhe shërbimeve të Kuvendit për revizionin, të sigurojmë që gjetjet prej në raportet e revizorit revizorit të diskutohen rregullisht dhe sipas rëndësisë në diskutimet e komisioneve dhe seancave plenare.

**6** QËLLIMI SPECIFIK

Le të hapim dialog me Qeverinë për rëndësinë e gjetjeve të ESHR-së për ndërtimin e politikave të përgjithshme në vend.

Si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme për integritet profesional, Enti Shtetëror i Revizionit **për të tretin vit radhazi është renditur në vendin e parë nga** Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KShPK). Sipas matjeve zyrtare, institucioni arriti një nivel përmbushjeje prej 88,46%, i cili është vlerësuar me kualifikimin **më të lartë "shumë mirë"**. Ky pozicion në krye përbën një dëshmi thelbësore për pjekurinë institucionale dhe përparimin e palëkundur drejt standardeve më të larta etike, me ç'rast ESHR konsolidohet si një shtyllë e besimit në sistemin kombëtar të integritetit.

## 1.2.7. PROGRAMA E REFORMËS SË MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE PËR VITET 2025 – 2028

Në Programin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2025 - 2028 i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut përcaktohen prioritetet për revizionin e jashtëm dhe mbikëqyrjen parlamentare në kompetencë të Entit Shtetëror të Revizionit. Qëllimi i këtyre prioriteteve është:

- Forcimi i menaxhimit me financat publike dhe sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies për shfrytëzimin e mjeteve publike duke forcuar kornizën juridike për revizionin e jashtëm, forcimi i kapaciteteve institucionale dhe kapaciteteve të burimeve njerëzore të ESHR-së, duke përfshirë edhe pjesën e revizionit të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike në nivel lokal dhe qendror, si dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore, respektivisht:
    - forcimi i pavarësisë kushtetuese, financiare dhe operative të Entit Shtetëror të Revizionit përmes ndryshimit të Kushtetutës dhe miratimit të Ligjit të ri për revizionin shtetëror dhe akteve nënligjore, në përputhje me parimet, standardet dhe udhëzimet e INTOSAI dhe
    - forcimi i kapaciteteve institucionale dhe kapaciteteve të burimeve njerëzore të ESHR-së me qëllim rritjen e efekteve nga revizionet e kryera (përfshirja e plotë e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe qytetit të Shkupit, ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në nivel qendror dhe lokal) dhe sigurimi i vlerës së shtuar në punën e ESHR-së, zbatimi i kërkesave për revizion në përputhje me Ligjin e ri për buxhetet (revizioni i pasqyrave financiare të buxhetit bazë), si dhe revizioni i Instrumentit për Reforma dhe Rritje (IRR);
- Forcimi i menaxhimit me financat publike dhe sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies për shfrytëzimin e mjeteve publike respektivisht:
    - forcimi i mekanizmit institucional për shqyrtimin e raporteve të revizionit nga ana e Kuvendit dhe
    - forcimi i mekanizmit institucional për shqyrtimin e raporteve të revizionit në Kuvend.

Në Planin e Veprimit për Zbatimin e Programit të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike për vitin 2025 përmbahen aktivitetet për zbatimin e masave dhe për arritjen e treguesve që u referohen prioriteteve për revizionin e jashtëm dhe mbikëqyrjen parlamentare në kompetencë të ESHR-së.

Enti Shtetëror i Revizionit thekson se mori pjesë aktive në përgatitjen e Raportit Vjetor për monitorimin e zbatimit të Programit për reformën e menaxhimit të financave publike, për periudhën janar–dhjetor 2024, Programit për reformën e menaxhimit të financave publike për vitet 2025–2028 si dhe Plani të Veprimit për vitin 2025, në pjesën që ka të bëjë me prioritetet për revizionin e jashtëm dhe mbikëqyrjen parlamentare në kompetencë të Entit Shtetëror të Revizionit.

## 1.2.8. PROGRAMI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2025

ESHR, në përputhje me Ligjin për revizionin shtetëror, e miratoi Programin vjetor të punës për vitin 2025 dhe ia dorëzoi Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për informim.

Programi vjetor i punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025 është miratuar në bazë të dispozitave të Ligjit për revizionin shtetëror, Rregullores për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror dhe Udhëzuesit për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve. Në përputhje me dispozitat e Ligjit për revizionin shtetëror, ESHR detyrimisht një herë në vit kryen revizion të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të buxheteve të fondeve, duke përfshirë edhe Agjencinë e Punësimit, ndërsa te subjektet e tjera revizionet kryhen në afate të përcaktuara me Programin vjetor të punës. Përzgjedhja e subjekteve për revizion është bërë në përputhje

me nenet 22 dhe 23 paragrafi (1) të Ligjit për revizionin shtetëror, Rregullores për mënyrën e kryerjes së revizionit shtetëror, Udhëzuesit për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve, Vendimit për përcaktimin e objektivave strategjike për revizione të Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2024–2027 dhe fushave prioritare për revizion sipas sektorëve, si dhe Planit strategjik të revizionit të Entit Shtetëror të Revizionit për periudhën 2024–2027, me ç'rast në procesin e planifikimit janë marrë parasysh edhe Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombet e Bashkuara, fushat prioritare të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2024–2044, kriteret e përcaktuara në metodologjinë për vlerësim të SIGMA, propozimet nga palët e interesuara, si dhe burimet në dispozicion të Entit Shtetëror të Revizionit. Duke ndjerë nevojën për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë së tij në ushtrimin e kompetencave të deleguara me ligj, gjatë përgatitjes së Programit vjetor të punës së ESHR-së për vitin 2025, ESHR dërgoi njoftim për dorëzimin e kërkesave/propozimeve për kryerjen e revizioneve deri te 1.215 palë të interesuara. Përmes përdorimit të rrjeteve sociale (FB) u publikua thirrje drejtuar të gjitha personave juridikë dhe fizikë të interesuar për të paraqitur kërkesë për kryerjen e revizionit, ndërsa në faqen e vet zyrtare në internet është vendosur në mënyrë të vazhdueshme formulari „Kërkesë për revizion". Nga gjithsej 122 kërkesat e pranuara, në kuadër të përgatitjes së Programit Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025 u miratuan 44 kërkesa, të cilat kanë të bëjnë me 33 revizione, pra 36% e kërkesave të dorëzuara. Këto janë në përputhje me dokumentet strategjike, kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara sipas standardeve profesionale të INTOSAI, kriteret e përzgjedhjes në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit, kriteret e përzgjedhjes të OECD-SIGMA si dhe me resurset e disponueshme për revizion.

## Kërkesat e mbërritura dhe kërkesat e pranuara sipas llojeve të subjekteve që kanë dorëzuar kërkesa

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Institucionet, personat juridikë | Kërkesat e mbërritura | 72 | Kërkesat e pranuara | 28 |
| Organizatat civile, Qytetarët dhe Anonimë | Kërkesat e mbërritura | 45 | Kërkesat e pranuara | 13 |
| NJVL | Kërkesat e mbërritura | 2 | Kërkesat e pranuara | 0 |
| Media | Kërkesat e mbërritura | 3 | Kërkesat e pranuara | 3 |
| | Gjithsej | 122 | Gjithsej | 44 |

Enti Shtetëror i Revizionit e ka zbatuar në tërësi Programin Vjetor të Punës për vitin 2025. Me Programin Vjetor për vitin 2025 janë kryer gjithsej 76 revizione, prej të cilave 57 revizione të rregullshmërisë, 13 revizione të suksesit dhe 6 revizione të pajtueshmërisë.

Revizionet e kryera dhe fushat e përfshira me revizionet japin bazë për përcaktimin e mënyrës së veprimit nga organet kompetente, por në të njëjtën kohë sigurojnë edhe kontribut aktiv të Entit Shtetëror të Revizionit përmes dhënies së rekomandimeve për mënyrën e veprimit të tyre, vlerësimit të zbatimit të proceseve reformuese, dhënies së këshillave për mënyrën e realizimit të të hyrave publike dhe përdorimit të mjeteve publike, mënyrën e shfrytëzimit të burimeve, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përmirësimin e mjedisit kontrollues.

## 1.2.9. PLANI VJETOR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT PËR VITIN 2025

Aktivitetet e Entit Shtetëror të Revizionit në lidhje me parandalimin e korrupsionit kryhen në përputhje me kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Udhëzimin për revizionin e parandalimit të korrupsionit - GUID 5270 dhe rregullativën tjetër ligjore relevante. Në drejtim të parandalimit të korrupsionit, forcimit të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës në punë, Enti Shtetëror i Revizionit miratoi „Planin Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025", me të cilin përcaktohen masat dhe aktivitetet për:

- demonstrimin e vullnetit të kuadrit udhëheqës të ESHR-së për të parandaluar korrupsionin dhe konfliktin e interesave;
- forcimi i etikës dhe integritetit përmes zbatimit konsekuent të Kodit të Etikës së ESHR-së, në përputhje me praktikat më të mira të INTOSAI, EUROSAI dhe Standardet Ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit;
- ndjekja e vazhdueshme dhe përmirësimi i rregullativës ligjore që lidhet me revizionin shtetëror, parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave;
- digjitalizimi dhe modernizimi i vazhdueshëm i proceseve në kryerjen e revizionit shtetëror, me qëllim rritjen e efikasitetit, sigurisë dhe transparencës në punë;
- forcimi i llogaridhënies dhe transparencës në punën e ESHR-së përmes publikimit të rregullt dhe në kohë të raporteve përfundimtare të revizionit dhe informacioneve me interes publik;
- menaxhimi i rreziqeve nga korrupsioni përmes krijimit dhe përditësimit të rregullt të Regjistrit të rreziqeve, ndjekjes së fushave të rrezikshme dhe ndërmarrjes së masave për zvogëlimin e tyre;
- përmirësimi i burimeve njerëzore përmes edukimit të vazhdueshëm, përsosjes profesionale dhe ngritjes së vetëdijes tek të punësuarit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave;
- respektimin e parimeve të përcaktuara në dispozitat e Ligjit për prokurimet publike gjatë dhënies së kontratave të prokurimeve publike dhe Ligjit për buxhete gjatë ekzekutimit të planit financiar (buxhetit) për ESHR-në dhe njoftimit mbi ekzekutimin e tij;
- bashkëpunimin e vazhdueshëm me organet e tjera kompetente që janë të obliguar për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe bashkëpunimi me ISR të tjera për përdorimin e praktikave të mira;
- certifikimin e ESHR-së për sistemin e zbatuar për trajtimin e korrupsionit në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 37001:2017 dhe menaxhimin e sigurisë së informacioneve në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 27001:2017.

Realizimi i aktiviteteve të përcaktuara në Planin Vjetor ndiqet në mënyrë të vazhdueshme, përmes raportimit të rregullt dhe vlerësimit të shkallës së zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara, për të cilat informohet Kryerevizori shtetëror.

## 1.2.10. PLANI VJETOR PËR PËRSOSJEN E VAZHDUESHME PROFESIONALE PËR VITIN 2025

Rritja e njohurive dhe aftësive të të punësuarve në Entin Shtetëror të Revizionit, që e bën institucion që mëson vazhdimisht, është përfshirë në Planin vjetor për PVP për vitin 2025 të Entit Shtetëror të Revizionit. Përgatitja e PV për PVP është krijuar përmes një hulumtimi të brendshëm të realizuar mbi nevojat e të punësuarve nga njëra anë dhe duke ndjekur trendet dhe nevojat bashkëkohore nga ana tjetër, duke përfshirë edhe inteligjencën artificiale.

Edukimi i të punësuarve, përkatësisht realizimi i aktiviteteve të përcaktuara në planin e përmendur, është zbatuar duke përdorur burimet e brendshme të institucionit dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë nga fushat përkatëse. Aktivitetet e dedikuara për rritjen e njohurive dhe aftësive të të punësuarve janë realizuar në atë mënyrë që janë përfshirë më shumë se 60 fusha të ndryshme.

Me qëllim të marrim informacione kthyese mbi cilësinë e edukimeve të mbajtura, ESHR-ja zbaton rregullisht vlerësime të edukimeve të organizuara, të cilat kanë treguar se më shumë se 80% e punonjësve kanë ndikim pozitiv nga trajnimet e organizuara dhe se ato do të kontribuojnë në përmirësimin e punës së tyre. Realizimi i aktiviteteve të përcaktuara në Planin Vjetor ndiqet në nivel gjashtëmujor dhe vjetor, ndërsa për shkallën e zbatimit të tyre informohet Kryerevizori Shtetëror. Gjatë vitit 2025, u zbatuan edhe trajnime të dizajnuara posaçërisht për

revizorët shtetërorë të punësuar rishtazi, me qëllim të lehtësimit të përshtatjes së tyre profesionale në mjedisin e ri të punës, duke u mundësuar njëkohësisht të fitojnë përvojë për vendin e duhur të punës përmes kryerjes së detyrave të ndryshme të revizorit, si dhe përmes pjesëmarrjes në trajnime të ndryshme. Forcimi i njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së kryhet edhe përmes zbatimit të revizioneve paralele, ndërkombëtare të përbashkëta dhe kooperative në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të ISR-së (INTOSAI) dhe bashkëpunimit bilateral midis ESHR-së dhe ISR-ve të tjera.

## 1.2.11. PLANI VJETOR I SIGURIMIT TË CILËSISË PËR VITIN 2025

Enti Shtetëror i Revizionit ka për detyrë të zbatojë kontrolle, të ofrojë vlerësime dhe të japë opinione për revizionet e kryera që do të kenë vlerë të shtuar për të gjithë komunitetin. Rezultatet e punës dhe mandatit të ESHR-së janë në funksion të përmbushjes së nevojave dhe pritshmërive të palëve të interesuara, me qëllim të promovimit dhe sigurimit të llogaridhënies, objektivitetit dhe transparencës në mbështetjen e shtetit, ndërsa në drejtim të menaxhimit të mençur dhe të hapur të mjeteve publike. Sfida kryesore me të cilën përballen të gjitha ISR-të është ofrimi i vazhdueshëm i revizioneve me cilësi të lartë. Puna cilësore e kryer nga ISR-ja ndikon në reputacionin dhe besueshmërinë e tyre, si dhe në aftësinë e tyre për të përmbushur mandatin e tyre.

Funksioni i sigurimit të cilësisë së revizioneve (monitorimit) është i pavarur nga procesi i revizionit dhe paraqet kontroll të cilësisë së revizioneve të kryera nga persona të pavarur nga revizionet për të ofruar siguri për menaxhmentin e Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) se cilësia e revizioneve të kryera është në nivel të pranueshëm. Udhëzimet kryesore për realizimin e funksionit të sigurimit të cilësisë (monitorimit) në ESHR janë dhënë në Udhëzimin e Sigurimit të Cilësisë së Revizioneve* nr. 01-1365/1 nga 03.10.2022 në përputhje me standardin ndërkombëtar të INTOSAI-t, ISSAI 140.

Funksioni i sigurimit të cilësisë së revizioneve (monitorimit) nga ekipi i kontrollit i punonjësve të ESHR-së pas përfundimit të revizioneve siguron:

- përmirësimin e punës dhe rezultateve të revizioneve të kryera,
- mundësinë e vetëvlerësimit të punës së kryer të revizorit,
- përcaktimin e nevojave të mundshme nga trajnimet e revizorëve, të cilat do të kontribuojnë në ruajtjen e shkallës së lartë të integritetit, llogaridhënies dhe kompetencës së punës së revizorit.

Në përputhje me Planin Vjetor të Sigurimit të Cilësisë për vitin 2025 dhe procedurat e përcaktuara në Udhëzimin e Sigurimit të Cilësisë së Revizioneve, kontrollet zbatohen në periudhën nga 01.04.2025 deri më 31.12.2025, duke mbuluar gjashtë (6) revizione nga Programi Vjetor i Punës së ESHR-së për vitin 2024 nga gjashtë (6) sektorë të revizionit. Bazuar në kontrollet e kryera të cilësisë së revizioneve të zbatuara përmes procedurave dhe dokumentacionit të revizorit të anuluar në dosjen e revizorit në AMS nga anëtarët e ekipit të revizorëve, u arrit në përfundimin se revizioni u zbatua në përputhje me metodologjinë e përcaktuar të ESHR-së.

## 1.2.12. RAPORTI VJETOR PËR REVIZIONET E KRYERA DHE PËR PUNËN E ESHR-SË PËR VITIN 2024

Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024 është përgatitur dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut brenda afatit të përcaktuar me ligj - deri në fund të qershorit 2025. Raporti është i disponueshëm në ueb-faqen zyrtare të ESHR-së në tri gjuhë: maqedonisht, shqip dhe anglisht*.

Në drejtim të avancimit të transparencës dhe llogaridhënies në punën e vet, Enti Shtetëror i Revizionit e vazhdoi praktikën e ndarjes aktive dhe ofrimit të qasjes në të dhënat dhe informacionet e përmbajtura në Raportin Vjetor. Raporti u dorëzohet rregullisht institucioneve supreme të revizionit, Gjykatës Evropiane të Revizorëve, Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI), Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Revizionit (EUROSAI), Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare, si dhe misioneve diplomatike të akredituara në vend. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e 68-të të mbajtur më 12 shtator 2025, e shqyrtoi dhe miratoi Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e ESHR-së për vitin 2024. Kuvendi miratoi 17 konkluzione që synojnë mbështetjen e aktiviteteve të ESHR-së, avancimin e zbatimit të rekomandimeve të revizorit, tejkalimin e dobësive dhe mospërputhjeve sistematike në rregullativën ligjore dhe nënligjore, si dhe forcimin e bashkëpunimit midis ESHR-së dhe Kuvendit.

* Me numër 01-1365/1, të datës 03.10.2022
* https://dzr.mk/sites/default/files/2025-06/GI_DZR_2024_MKD.pdf

# 1.3 DOKUMENTET METODOLOGJIKE DHE ZBATIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA

Në drejtim të avancimit të cilësisë së revizionit dhe harmonizimit me standardet ndërkombëtare, Enti Shtetëror i Revizionit gjatë vitit 2025 ndërmori aktivitete të rëndësishme për miratimin dhe revidimin e dokumenteve metodologjike. Këto aktivitete kanë për qëllim forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetin në menaxhimin e mjeteve publike.

Në vitin 2025 u miratuan aktet metodologjike në vijim:

- Udhëzues për revizionin e suksesit të investimeve publike, i përgatitur me mbështetjen e projektit **„Ndihmë teknike për Entin Shtetëror të Revizionit për revizionin e suksesit të investimeve publike"**, i financuar nga Banka Botërore, i orientuar drejt forcimit të mbikëqyrjes, transparencës dhe llogaridhënies në shpenzimin e mjeteve publike;

- Udhëzues për revizionin e zbatimit dhe ndikimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i përgatitur në kuadër të projektit **„Mbështetje për reformën e menaxhimit me financat publike"**, i zbatuar nga UNDP.

- Udhëzues për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni në nivel qendror dhe lokal, si dhe sipas sektorëve të veçantë, i përgatitur në kuadër të të njëjtit projekt të mbështetur nga UNDP.

- Kornizë metodologjike për revizionin sistemor të Instrumentit për Reforma dhe Rritje të Maqedonisë së Veriut, përkatësisht Udhëzues për revizionin e Agjendës Reformuese, i hartuar në bashkëpunim me Ernst & Young, në kuadër të projektit „Mbështetje për zbatimin e revizionit të Planit të Rritjes", i financuar nga Banka Botërore.

- Udhëzues i reviduar për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve.

Gjatë vitit 2025, i nxitur nga nevoja për harmonizim me standardet e reja ndërkombëtare të INTOSAI (ISSAI 140 – Menaxhimi i cilësisë për ISR dhe ISSAI 150 – Kompetencat e revizorit), Enti Shtetëror i Revizionit zbatoi analizë të harmonizimeve të nevojshme dhe filloi procesin e revidimit të akteve të brendshme metodologjike.

Paralelisht, filloi edhe harmonizimi i Doracakut për revizionin e rregullshmërisë, si dhe i të gjitha formularëve shoqërues për shfrytëzuesit buxhetorë dhe ndërmarrjet publike me standardet relevante ndërkombëtare. Këto aktivitete realizohen në kuadër të projektit „Support to the Implementation of the PFM Reform Programme" (Mbështetje për zbatimin e Programit të reformave në menaxhimin e financave publike).



A3P



# 02

# KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESUARA



# 2.1. KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA NË PUNË

Sigurimi i shkallës së lartë të transparencës dhe llogaridhënies në punën e Entit Shtetëror të Revizionit gjatë vitit 2025 ishte një nga përcaktimet strategjike kryesore me rëndësi thelbësore për sigurimin e besimit, menaxhimit të përgjegjshëm të financave publike dhe llogaridhënies institucionale. Enti Shtetëror i Revizionit nëpërmjet publikimit të raporteve përfundimtare të revizorit, së bashku me abstraktet e bashkëngjitura/njoftimet për mediat dhe/ose prezantimin përkatës në formë video, si dhe komunikimit të hapur dhe në kohë me mediat, organizatat civile dhe palët e tjera të interesuara, ka siguruar shkallë të lartë të informimit të qytetarëve dhe publikut të gjerë në lidhje me rezultatet e punës së ESHR-së.

Gjatë vitit 2025, nëpërmjet pjesëmarrjes proaktive në intervistat në mediat nacionale dhe deklaratave nga menaxhmenti dhe udhëheqësia e ESHR-së në lidhje me gjendjet e konstatuara në raportet përfundimtare të revizionit, Enti Shtetëror i Revizionit e forcoi imazhin e vet duke e promovuar veten në një nga institucionet më të besueshme dhe transparente në vend. Enti Shtetëror i Revizionit si partner i mediave dhe organizatave civile, përdor mjete të ndryshme të komunikimit me publikun, duke u përpjekur t'i prezantojë gjendjet e konstatuara në raportet e revizorit në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme përmes abstrakteve, njoftimeve për mediat dhe video materialeve mbi gjendjet e konstatuara kryesore në raportet e revizionit, me qëllim të informimit të publikut rreth mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve publike. Qasja e tillë proaktive ndaj komunikimit dhe transparencës ka për qëllim veprimin në kohë nga institucionet kompetente, veçanërisht sipas rekomandimeve të dhëna të Entit Shtetëror të Revizionit dhe zbatimin e tyre adekuat. Rezultatet dhe aktivitetet e realizuara me sukses në pjesën e komunikimit me palët e interesuara dhe shkallën e lartë të transparencës së Entit Shtetëror të Revizionit janë paraqitur në grafikët e mëposhtëm:

**LISTA - MEJLING E ESHR-së** DHE KOMUNIKIMI ME **2417** PALË TË JASHTME TË INTERESUARA



Gjatë vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit ndërmori aktivitete shtesë për rritjen e numrit të palëve të interesuara, i cili deri më 31.12.2025 arriti në 2.417. Aktivitetet e ndërmarra për përcaktimin e palëve të interesuara sipas viteve janë si vijon:.

### **LISTA - MEJLING E ESHR-së** DHE KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTME TË INTERESUARA
2020-2025




Rritja e vazhdueshme e dukshmërisë digjitale dëshmon përparim të rëndësishëm gjatë periudhës 2020–2025. Numri i vizitave është rritur nga 48.184 në vitin 2020 në 305.404 vizita në vitin 2025, që paraqet një rritje prej afërsisht 634%, respektivisht 6,3 herë më shumë vizita:

### VIZITA NË WWW.DZR.MK




| | |
|---|---|
| 2020 | **48.148** vizita |
| 2021 | **102.665** vizita |
| 2022 | **100.640** vizita |
| 2023 | **144.640** vizita |
| 2024 | **221.718** vizita |
| 2025 | **305.404** vizita |

Deri vitin 2025 numri i vizituesve të faqës së inter netit është rritur për **634%** ose për **6.3** herë në krahasim me vitin 2020.

Transparenca matet përmes interesit të qytetarëve, ndërsa në vitin 2025 platformat tona u konfirmuan si një shërbim aktiv për publikun, me 1.645.287 vizita dhe 9.940 ndjekës në faqen e Facebook-ut si dhe 130.914 vizita në profilin e Instagram-it, çka pasqyron qartë rritjen e dukshmërisë digjitale dhe besimit.

**https://www.facebook.com/ enti shtetëror i revizionit**

Është hapur

**17.11.2021**

Ndjekës të faqe

| | |
|---|---|
| **762** | 31.12.2021 |
| **6.967** | 31.12.2022 |
| **9.116** | 31.12.2023 |
| **9.324** | 31.12.2024 |
| **9.380** | 31.03.2025 |

Numri i përgjithshëm për 3 përmbajtjet me më shumë shikime të arritura

| | |
|---|---|
| **8.000** | 31.12.2021 |
| **62.869** | 31.12.2022 |
| **76.697** | 31.12.2023 |
| **82.346** | 31.12.2024 |
| **22.368** | 31.03.2025 |

Numri mesatar i frekuentimeve ditore

| | |
|---|---|
| **518** | 31.12.2021 |
| **2.232** | 31.12.2022 |
| **858** | 31.12.2023 |
| **2.678** | 31.12.2024 |
| **3.745** | 31.03.2025 |

Numri i përgjithshëm për 10 përmbajtjet e fundit të publikuara

| | |
|---|---|
| **8.637** | 31.12.2021 |
| **25.021** | 31.12.2022 |
| **56.281** | 31.12.2023 |
| **15.972** | 31.12.2024 |
| **29.315** | 31.03.2025 |

Profile të ndryshme të cilat kanë shikuar një përmbajtje

| | |
|---|---|
| **8.982** | 31.12.2021 |
| **104.908** | 31.12.2022 |
| **114.465** | 31.12.2023 |
| **116.273** | 31.12.2024 |
| **118.862** | 31.12.2025 |

Numri i përgjithshëm i vizituesve **2.299.935**

| | |
|---|---|
| **22.808** | 31.12.2021 |
| **710.301** | 31.12.2022 |
| **844.417** | 31.12.2023 |
| **500.242** | 31.12.2024 |
| **222.167** | 31.03.2025 |

## ANKETA PUBLIKE – SHKALLA E KËNAQËSISË

Në drejtim të avancimit të transparencës dhe cilësisë së punës së vet, Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) zbaton rregullisht anketa publike për të matur perceptimin dhe kënaqësinë e palëve të interesuara. Për këtë qëllim, siguruam pyetësor të disponueshëm publikisht që u vu në ueb-faqen zyrtare të ESHR-së, ndërsa në mënyrë plotësuese u ishte dorëzuar pyetësor ankete përfaqësuesve të sektorit publik dhe privat, mediave dhe organizatave civile. Anketa u publikua edhe në faqen zyrtare të Fejsbukut të ESHR-së.

Rezultatet e anketës tregojnë nivelin e lartë të kënaqësisë - 90% e të anketuarve e vlerësuan bashkëpunimin me ESHR-në si pozitiv, veçanërisht në pjesën e informimit në kohë mbi raportet e revizionit dhe transparencën ndaj mediave dhe sektorit civil.

Puna e ESHR-së u vlerësua si e paanshme, e pavarur, ligjore, objektive, transparente dhe profesionale, ndërsa raportet e revizionit u vlerësuan lart. Rezultatet e anketës janë tregues i rëndësishëm për forcimin e llogaridhënies dhe avancimin e komunikimit me publikun dhe palët e interesuara. Rezultatet tregojnë edhe për nivelin e lartë të besimit dhe perceptimit pozitiv tek palët e interesuara në lidhje me praktikat dhe mjetet e komunikimit të përdorura nga ESHR-ja, si dhe në drejtim të informimit të palëve të interesuara me informacione nga puna e vet dhe gjendjet e konstatuara të cilat janë prezantuar në raportet përfundimtare të revizorit. Kënaqësia e lartë me mjetet e ndryshme të komunikimit konfirmon se qasja ndaj transparencës dhe disponueshmërisë së informacioneve ofron përgjigje efektive dhe përkatëse ndaj nevojave të publikut.

### STRUKTURA E TË ANKETUARVE:



# 2.2. BASHKËPUNIMI ME KUVENDIN, ORGANET SHTETËRORE, ASOCIACIONET DHE INSTITUCIONET PROFESIONALE, ORGANIZATAT CIVILE DHE PUBLIKUN E GJERË

## 2.2.1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Enti Shtetëror i Revizionit e njofton Kuvendin në kohë dhe në mënyrë objektive mbi punën e vet, mbi gjendjet e konstatuara nga revizionet e kryera, dhe i ofron mbështetje Kuvendit në përmbushjen e një pjese të kompetencave të tij duke konstatuar dhe raportuar parregullsitë, mosrespektimin e rregullave ligjore, veprimin e paligjshëm me mjetet publike dhe rastet e mundshme të korrupsionit, prandaj komunikimi me Kuvendin konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm. Bashkëpunimi midis ESHR-së dhe Kuvendit zhvillohet vazhdimisht në më shumë drejtime dhe në përputhje me Ligjin për revizion shtetëror dhe Memorandumin e Bashkëpunimit midis Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Entit Shtetëror të Revizionit të nënshkruar më 21 tetor 2022.

Në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar, në vitin 2025, u përgatitën dhe iu dorëzuan Kuvendit katër raporte përmbledhëse, të cilat paraqesin përmbledhje të gjendjeve të konstatuara nga revizionet individuale të kryera në përputhje me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2024.

Në qershor të vitit 2025, Kryerevizori shtetëror i dorëzoi Kryetarit të Kuvendit, Raportin Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024. I njëjti u shqyrtua nga Komisioni për financim dhe buxhet si organ amë punues në seancën e dyzet e tetë të mbajtur më 5 shtator 2025, dhe më pas në seancën plenare të gjashtëdhjetë e tetë të Kuvendit të mbajtur më 12 shtator 2025, ku Raporti Vjetor u shqyrtua dhe mbi të u miratuan konkluzione.

Propozimi i llogarisë përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024, së bashku me Raportin Përfundimtar të revizorit shtetëror të autorizuar për revizionin e kryer të pajtueshmërisë së Buxhetit Bazë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u shqyrtua në seancën e dyzet e tretë të Komisionit për financim dhe buxhet të mbajtur më 21 korrik 2025 dhe u miratua në seancën plenare të gjashtëdhjetë e dytë të Kuvendit të mbajtur më 22 korrik 2025.

Në vitin 2025 u shqyrtua një raport përfundimtar i revizionit dhe u organizua një debat publik në seancën e nëntë të Komisionit për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, me temë „Zbatimi i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), me fokus tek shërbimet e specializuara për gratë viktima të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës familjare".

Në muajin korrik 2025, u ndërmorën aktivitete të orientuara drejt forcimit të mbikëqyrjes parlamentare të buxhetit, veçanërisht përmes intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit dhe Entit Shtetëror të Revizionit, me mbështetjen e NDI u organizua trajnim për trajnerë, në të cilin morën pjesë të punësuar nga ESHR dhe nga Shërbimi i Kuvendit, duke i forcuar aftësitë e tyre në këtë fushë. Zbatimi i kësaj veprimtarie ishte në funksion të realizimit të përgatitjes së planit të trajnimit për deputetët dhe personelin e Kuvendit në lidhje me raportet e revizionit dhe përgatitjen e debatit për raportet e revizionit.

Në fund të vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit i dorëzoi Institutit Parlamentar pranë Kuvendit propozime për tema dhe trajnime, me qëllim përfshirjen e tyre në Programin për realizimin e trajnimeve për deputetët, shërbimin, asistentët e grupeve të deputetëve dhe asistentët në zyrat e deputetëve për kontakt me qytetarët për vitin 2026. Në përputhje me nenin 42 të Ligjit për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe në kuadër të bashkëpunimit ekzistues të përcaktuar me Memorandumin e bashkëpunimit dhe Planin Strategjik të Kuvendit 2026–2030 të miratuar nga Këshilli Buxhetor i Kuvendit, Programi i propozuar për vitin 2026 u shqyrtua dhe u miratua nga Këshilli Drejtues i Institutit Parlamentar në muajin janar 2026.

Në kuadër të vizitës së Kryetarit të Senatit të Institucionit Shtetëror të Revizionit të Malit të Zi (muaji mars), Kryetarit të Gjykatës së Revizionit të Republikës së Italisë (muaji mars), Kryetares së Gjykatës së Llogarive të Rumanisë (muaji tetor), u zhvilluan takime pune me Kryetarin, respektivisht Nënkryetarin e Kuvendit të RMV, në të cilat

u diskutua për aktivitetet e përbashkëta të deritanishme dhe rezultatet e bashkëpunimit reciprok, praktikat pozitive në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, rolin e institucioneve më të larta të revizionit në mbështetje të proceseve demokratike dhe mbikëqyrjes parlamentare, si dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet parlamenteve të RMV dhe vendeve të lartpërmendura.

Në kuadër të shënimit solemne të 26-vjetorit të ekzistencës së Entit Shtetëror të Revizionit, si institucion me zhvillim të vazhdueshëm institucional dhe punë të përkushtuar në shërbim të interesit publik, Nënkryetari i Kuvendit, z. Antonio Milloshoski, theksoi se **„institucion i fortë dhe i pavarur i revizionit suprem është parakusht i domosdoshëm për mbikëqyrje parlamentare efikase dhe për forcimin e proceseve demokratike"**, duke nënvizuar mbështetjen e vazhdueshme të Kuvendit për zhvillimin e mëtejshëm dhe avancimin e funksionit të revizionit.

## 2.2.2. PROKURORIA PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit e vazhdoi bashkëpunimin me Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në drejtim të sigurimit të një veprimi më efikas ndaj parregullsive të konstatuara, përmirësimit të shkëmbimit të të dhënave dhe informacioneve si dhe forcimit të koordinimit ndërinstitucional në trajtimin e çështjeve të lidhura me raportet përfundimtare të revizionit, në përputhje me Memorandumin e bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2022.

U vazhdua me zbatimin e mekanizmave të vendosur për komunikim dhe koordinim ndërmjet dy institucioneve, përmes dorëzimit të rregullt të raporteve përfundimtare të revizionit për të cilat ESHR ka shprehur dyshime tek Prokuroria Publike, shkëmbimit të informacionit dhe dokumenteve relevante, si dhe sigurimit të sqarimeve shtesë profesionale lidhur me gjendjet e konstatuara në raportet përfundimtare të revizionit. Në këtë drejtim, u realizuan disa takime pune ndërmjet revizorëve shtetërorë dhe prokurorëve publikë, në të cilat u shqyrtuan çështje konkrete të formuara mbi bazën e raporteve përfundimtare të revizionit të Entit Shtetëror të Revizionit, me qëllim të veprimit më efikas dhe sigurimit të informacionit të nevojshëm.

Mbi bazën e kërkesave të dorëzuara tek Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ESHR në mënyrë të vazhdueshme siguron informacione kthyes për aktivitetet e ndërmarra lidhur me raportet përfundimtare të revizionit të lëshuara gjatë tetë viteve të fundit, në përputhje me Memorandumin e bashkëpunimit të nënshkruar.

Për më tepër, gjatë vitit u organizua edhe një punëtori e përbashkët në të cilën përfaqësues të të dy institucioneve shkëmbyen përvoja dhe praktika të mira, me ç'rast u shqyrtuan mundësitë për avancimin e mëtejshëm të koordinimit në veprimin sipas lëndëve të formuara në bazë të raporteve përfundimtare të revizionit.

Aktivitetet e realizuara kontribuan në avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit institucional dhe veprimit më efikas ndaj parregullsive të konstatuara, duke përfshirë edhe përmes aktiviteteve të koordinuara në lidhje me gjendje dhe parregullsi të caktuara të konstatuara gjatë zbatimit të revizioneve.

Këto aktivitete u realizuan me mbështetjen e WFD, në kuadër të projektit "Praktiko demokracinë", i financuar nga Ambasada Britanike në Shkup.

## 2.2.3. KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

**Црвен крст на Република Северна Македонија**

Bashkëpunimi ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut vazhdoi edhe në vitin 2025, me fokus në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe veprimtarisë humanitare. Ky partneritet përfaqëson shembull të sinergjisë institucionale të suksesshme, përmes së cilës promovohen vlerat e përbashkëta dhe kontribuohet në avancimin e interesit publik dhe mirëqenies së qytetarëve.

Në shenjë mirënjohjeje për këtë përkushtim, Entit Shtetëror të Revizionit iu dha një falënderim nga Kryqi i Kuq, si dëshmi për kontributin e të punësuarve dhe menaxhmentit të ESHR në promovimin e vlerave humane. Njëkohësisht, aksionet e dhurimit të gjakut, të cilat tashmë po shndërrohen në traditë, edhe këtë vit bashkuan të punësuarit në një mision të përbashkët – të ndihmojnë aty ku nevoja është më e madhe.

Për më tepër, përmes sigurimit të mbështetjes financiare për familjet e prekura nga ngjarja tragjike në Koçan, Enti Shtetëror i Revizionit e dëshmoi në praktikë solidaritetin e tij. Këto aktivitete pasqyrojnë përcaktimin e Entit Shtetëror të Revizionit se përgjegjësia ndaj publikut nuk matet vetëm përmes rezultateve profesionale, por edhe përmes mbështetjes së menjëhershme, humanizmit dhe gatishmërisë për veprim në momentet e nevojës më të madhe.










## 2.2.4. INSTITUTI I KONTABILISTËVE DHE KONTABILISTËVE TË AUTORIZUAR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2025, ESHR e përmirësoi bashkëpunimin me Institutin e Kontabilistëve dhe Kontabilistëve të Autorizuar (IKKA) përmes nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimi, me qëllim intensifikimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, shkëmbimin e të dhënave, njohurive dhe përvojave, si dhe avancimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të profesionit të revizionit dhe kontabilitetit në shtet. Me zbatimin e Memorandumit të bashkëpunimit, anëtarët e Institutit dhe punonjësit e ESHR morën pjesë në trajnime të organizuara, konferenca, ngjarje profesionale dhe iniciativa të tjera me interes të përbashkët, me ç'rast u forcuan më tej njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, veçanërisht në fushën e raportimit financiar dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare.

## 2.2.5. INSTITUTI I REVIZORËVE TË AUTORIZUAR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

ESHR e vazhdoi bashkëpunimin me Institutin e Revizorëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në kuadër të Memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar. Gjatë vitit 2025 u realizuan aktivitete të orientuara drejt forcimit të njohurive të punonjësve të ESHR-së, përmes pjesëmarrjes në trajnime të organizuara në kuadër të Planit Vjetor për përmirësim të vazhdueshëm profesional të Institutit të Revizorëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u trajtuan kërkesat e standardeve të revizionit dhe zbatimi i tyre praktik.

## 2.2.6. KËSHILLI FISKAL I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Enti Shtetëror i Revizionit, në shkurt të vitit 2024, nënshkroi Memorandum bashkëpunimi me Shërbimin Profesional të Këshillit Fiskal, me qëllim përmirësimin e marrëdhënieve të ndërsjella dhe bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët.

Memorandumi përfshin aktivitetet për:

- komunikimin dhe koordinimin e rregullt në fushën e makroekonomisë, politikës fiskale dhe menaxhimit me financat publike;
- shkëmbimin e të dhënave, analizave, raporteve dhe opinioneve me interes të ndërsjellë;
- organizimin e përbashkët të trajnimeve dhe ngjarjeve edukative, prezantimeve dhe këshillimeve mbi tema me interes të përbashkët për punonjësit e Entit Shtetëror të Revizionit, Shërbimit Profesional të Këshillit Fiskal, si dhe për punonjësit e sektorit publik.
- vendosjen e kushteve për bashkëpunim të vazhdueshëm, duke përfshirë edhe mbështetjen hapësinore dhe teknike.

Sipas Ligjit për buxhete, një nga anëtarët e Këshillit Fiskal zgjidhet me propozim të Entit Shtetëror të Revizionit.

Gjatë vitit 2025, Këshilli Fiskal dhe Shërbimi Profesional, në bashkëpunim me Zyrën e Bankës Botërore në shtet, realizuan zhvillim profesional për një pjesë të punonjësve të ESRH, përmes trajnimeve të organizuara për:

- Vlerësimi i qëndrueshmërisë së borxhit – Debt Sustainability Assessment Training, i mbajtur në periudhën nga 09.04.2025 deri më 11.04.2025 dhe
- Modelimi i tatimeve dhe vizualizimi i të dhënave – Tax Modeling and Data Visualization, i mbajtur në periudhën nga 07.07.2025 deri më 11.07.2025.



## 2.2.7. PUBLIKU I PËRGJITHSHËM

ESHR-ja është institucion i pavarur që u mundëson qytetarëve të ndjekin se si shpenzohen paratë publike, nëpërmjet informimit mbi punën e institucioneve publike dhe mbi masat që duhet të ndërmerren për të siguruar menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent të mjeteve publike. Në këtë drejtim, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë te informacionet me karakter publik, gjatë vitit 2025, janë marrë 7 kërkesa për informacione me karakter publik, 6 prej të cilave janë përgjigjur pozitivisht brenda afatit të përcaktuar me ligj, ndërsa 1 kërkesë është refuzuar, për shkak se ESHR në atë moment nuk e kishte krijuar informacionin e kërkuar. Në të njëjtën kohë, ESHR-ja, në përputhje me Planin Nacional të Veprimit për Partneritetin e Hapur Qeveritar dhe angazhimin për „Publikimin proaktiv të informacioneve me karakter publik në ueb-faqet e institucioneve», i publikon me kohë në ueb-faqen e vet të gjitha dokumentet që janë lëndë interesi për publikun e përgjithshëm.

# 2.3. BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET E TYRE

Për të arritur qëllimin themelor të revizionit shtetëror, përkatësisht kujdesin për mjetet publike dhe avancimin e menaxhimit të tyre, zbulimin në kohë të lëshimeve nga standardet e pranuara dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit në menaxhimin e mjeteve publike, ESHR-ja jep rekomandime të qarta dhe efektive, me qëllim të ndërmarrjes së hapave për t'i parandaluar ose për t'i vështirësuar lëshimet dhe shkeljet në të ardhmen. Masat korrigjuese për zbatimin e rekomandimeve i mundësojnë udhëheqësisë së subjektit që është lëndë e revizionit, të përmirësojë efektivitetin, efikasitetin dhe ekonomicitetin në punë.

Enti Shtetëror i Revizionit edhe në vitin 2025 përmes informacioneve të qarta, reale, objektive dhe në kohë mbi parregullsitë e konstatuara, mosharmonizimin e rregullave ligjore, veprimin e paligjshëm të mjeteve publike dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe abuzimit të detyrës zyrtare, kontribuoi në përmbushjen e një pjese të kompetencave të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. ESHR-ja i kushton vëmendje të duhur përpunimit dhe analizës së informacioneve që rezultojnë nga Raportet Përfundimtare të Revizionit të revizorëve të autorizuar shtetërorë. Këto të dhëna përpunohen rregullisht me aplikacionin softuerik të integruar, autonom dhe funksional për përpunimin dhe analizën e të dhënave nga Raportet Përfundimtare të Revizionit. Në këtë mënyrë, ofrohen informacione të sigurta, të përditësuara, në kohë dhe relevante për nevojat e ESHR-së, organeve kompetente dhe palëve të tjera të interesuara. Duke i dorëzuar rregullisht raportet përfundimtare të revizionit në Kuvend dhe organet kompetente, ESHR-ja e tërheq vëmendjen ndaj dobësive të konstatuara në punën e subjekteve të reviduara.

Vazhdimisht i evidentojmë, ndjekim dhe analizojmë informacionet e marra kthyese nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, MF-ja - Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut i ngarkuar për qeverisjen e mirë, për veprimin

sipas Raporteve Përfundimtare të Revizionit të dorëzuara atyre.

Efekti i gjendjeve të konstatuara që i tregojnë parregullsitë dhe paligjshmëritë në punën e subjekteve në menaxhimin më të mirë të mjeteve publike mund të pritet vetëm nëse institucionet kompetente i marrin masat e nevojshme për t'i tejkaluar. Ndjekja dhe informimi për aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente për t'i tejkaluar parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara në punën e subjekteve është një nga qëllimet strategjike të ESHR-së. Aktivitetet e ESHR-së në lidhje me parandalimin e korrupsionit kryhen në përputhje me autorizimet dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror, Ligjin për Prokurorinë Publike, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, memorandumet e bashkëpunimit të lidhura si dhe rregullativën tjetër ligjore relevante.

Në kuadër të realizimit të Programit Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2025, raportet e revizorit janë dorëzuar në institucionet kompetente si në vijim:

- Në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë dorëzuar 42 raporte të revizionit;
- Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit i janë dorëzuar 6 raporte të revizionit, në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Revizion Shtetëror;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave – Drejtorisë së Policisë Financiare i janë dorëzuar 10 raporte të revizionit.

Në dhjetor 2025 dhe maj 2026, ESHR-ja u dorëzoi kërkesë organeve kompetente për të siguruar informacione kthyese mbi aktivitetet e ndërmarra pas dorëzimit të raporteve përfundimtare të revizionit të lëshuara në 8 vitet e fundit. Në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur, janë siguruar informacione kthyese nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha organet shtetërore në drejtim të parandalimit dhe zvogëlimit të korrupsionit, në kuadër të Protokollit për Bashkëpunim për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave.

Enti Shtetëror i Revizionit merr pjesë në realizimin e Programit Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) përmes aktiviteteve të parashikuara në Kapitullin 23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore, 23.2 politika antikorrupsion, në fushën Funksionimi i institucioneve demokratike, fusha: Procesi zgjedhor, në fushën Reforma e administratës publike, fusha: Korniza strategjike për reformën e administratës publike, Kapitulli 5 – Prokurimi publik, Kapitulli 32 – Kontrolli financiar, fusha Funksionimi i institucioneve demokratike, Fusha: funksionimi i Kuvendit në sistemin demokratik, si dhe në punën e organeve dhe trupave të tjera për parandalimin e korrupsionit.

## RAPORTE TË REVIZIONIT TË DORËZUARA TE ORGANET KOMPETENTE

**42**

**RAPORTE TË REVIZIONIT**

raporte të revizionit të dorëzuara në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut

**6**

**RAPORTE TË REVIZIONIT**

të dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Revizion Shtetëror

**10**

**RAPORTE TË REVIZIONIT**

të dorëzuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave – Drejtorisë së Policisë Financiare.

# 2.4. KONTRIBUTI I ESHR-SË NË STRATEGJINË NACIONALE TË ZHVILLIMIT 2024-2044

Strategjia Nacionale e Zhvillimit (SNZH) 2024–2044, e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 29 tetor 2024, përfaqëson dokumentin udhëheqës afatgjatë strategjik që përcakton objektivat kryesore nacionale të zhvillimit, fushat strategjike dhe prioritetet për zhvillim të përshpejtuar, gjithëpërfshirës, të barabartë, të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe të qëndrueshëm.

Strategjia është në përputhje të plotë me Agjendën 2030 dhe bazohet mbi tre objektiva themelore nacionale të zhvillimit:

- forcimi i konkurrueshmërisë së ekonomisë përmes ekosistemit funksional dhe inovativ;
- vendosja e modeleve të menaxhimit që janë të hapura, llogaridhënse, gjithëpërfshirëse dhe rezistente, dhe;
- përfshirja sociale përmes shërbimeve të përmirësuara sociale, shëndetësore dhe arsimore.

Këto objektiva janë operacionalizuar përmes gjashtë fushave kyçe strategjike:

- Ekonomia e qëndrueshme, inovative dhe konkurruese
- Zhvillimi i qëndrueshëm lokal dhe rajonal
- Zhvillimi social dhe kulturor
- Shoqëria e sigurt, e mbrojtur dhe rezistente
- Sundimi i së drejtës dhe qeverisja e mirë
- Transformimi i gjelbër

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) mori pjesë aktive në përgatitjen e Strategjisë Nacionale të Zhvillimit 2024-2044 përmes pjesëmarrjes në trupat e punës dhe në trupin këshillëdhënës të themeluar për këtë qëllim. Kryerevizori shtetëror është anëtar i Trupit Këshillëdhënës, me anë të të cilit ESHR-ja ka dhënë kontribut të rëndësishëm në drejtim të sigurimit të transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së procesit të planifikimit strategjik. Duke marrë parasysh rëndësinë e Strategjisë Nacionale të Zhvillimit 2024-2044, ESHR-ja, në procesin e përgatitjes së Programit Vjetor të Punës për vitin 2026, si kriter shtesë në përzgjedhjen e revizioneve që janë pjesë përbërëse e Programit Vjetor të Punës së ESHR-së, i përcaktoi edhe qëllimet e Strategjisë Nacionale të Zhvillimit dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhe në të njëjtën kohë i lidhi revizionet me qëllimet dhe aktivitetet e SNZH-së dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Me këtë forcohet orientimi i aktiviteteve të revizorit në vlerësimin e efektivitetit dhe shkallës së zbatimit të strategjisë, duke ofruar kështu mbështetje në arritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve publike.

Në drejtim të mbështetjes së zbatimit të masave të përcaktuara në Strategjinë Nacionale të Zhvillimit, si dhe harmonizimin me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ), gjatë vitit 2025, ESHR-ja mori pjesë edhe në përgatitjen e Hartës së Investimeve, për identifikimin e fushave prioritare për investime me potencial dhe ndikim të lartë.

Gjithashtu, në revizione të caktuara të suksesit, ku fushat objekt i revizionit janë të lidhura me fushat e SNZH 2024–2044, është dhënë koment përkatës për ndikimin e gjendjeve të konstatuara mbi to.

Në periudhën e ardhshme, ESHR do të vazhdojë me integrimin e prioriteteve të SNZH-së në programin vjetor të punës, me fokus të veçantë në revizionet që ndjekin efikasitetin e investimeve publike, qëndrueshmërinë e financave publike dhe zbatimin e parimeve të barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale.

# 03

# KAPACITETET ADMINISTRATIVE





# 3.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE

Enti Shtetëror i Revizionit, në kuadër të kompetencave dhe aktiviteteve të tij, vazhdimisht investon përpjekje në zhvillimin e një sistemi modern, efikas dhe funksional për menaxhimin e burimeve njerëzore. Ky sistem është ngushtë i lidhur me rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit organizativ si dhe me sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve përmes:

- Përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të punës;
- Zhvillim dhe specializim të njësive organizative të brendshme;
- Sigurim të avancimit të vazhdueshëm në karrierë përmes mundësive për ngritje;
- Shpërblim të drejtë dhe të përshtatshëm në bazë të rezultateve të arritura;
- Sistemim të stafit në përputhje me kualifikimet profesionale, përvojën e punës dhe aftësitë;
- Tërheqje dhe angazhim të stafit të ri, profesional dhe të kualifikuar në fushën e revizionit shtetëror.




Enti Shtetëror i Revizionit vazhdon të përballet me sfidën e sigurimit të burimeve të mjaftueshme njerëzore në përputhje me aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin, me qëllim që edhe më tej të përgjigjet me sukses ndaj kërkesave për rritjen e numrit të revizioneve të kryera, veçanërisht revizioneve të suksesit në fushën e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm dhe Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit, duke dhënë kontribut në implementimin e tyre të pandërprerë.

# 3.2. RRITJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHTETËRORË

Njohuritë dhe aftësitë e të punësuarve në ESHR, themelimi i procesit të të mësuarit të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës në punën e rregullt të ESHR-së dhe shndërrimi i ESHR-së në institucion që mëson janë parakushti themelor që funksionimi i ESHR-së, revizionet e kryera dhe rekomandimet e dhëna të jenë me cilësi të lartë dhe të sigurojnë ndryshime përkatëse në sektorin publik.

Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (ISSAI), të zhvilluara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI), kanë për qëllim të promovojnë revizionin e pavarur dhe efektiv nga institucionet supreme të revizionit.

Duke marrë parasysh se një nga detyrat e rëndësishme të revizionit të sektorit publik - revizionit shtetëror është të inkurajojë dhe zbatojë ndryshime pozitive që do të kontribuojnë për një standard më të mirë jetese të qytetarëve që janë shfrytëzues të mjeteve publike dhe shërbimeve publike, është e pakontestueshme nevoja për përsosje të vazhdueshme profesionale të revizorëve shtetërorë. Ky aktivitet është në përputhje edhe me kërkesat e ISSAI-së.

Enti Shtetëror i Revizionit kujdeset dhe zbaton kujdesin për trajnime relevante dhe cilësore nga fusha të ndryshme me interes për revizorët shtetërorë, gjithsesi në funksion të nevojave të subjekteve që janë lëndë të revizionit. Përmes aktiviteteve të ndryshme për fitimin e njohurive dhe aftësive gjatë vitit 2025, mbi bazën e Planit Vjetor të miratuar për përmirësim të vazhdueshëm profesional për vitin 2025, u planifikuan dhe u realizuan një sërë aktivitetesh me interes për ruajtjen dhe plotësimin e njohurive dhe aftësive të revizorëve shtetërorë.

Plani Vjetor për përmirësim të vazhdueshëm profesional për vitin 2025 u realizua në tërësi dhe u zhvilluan trajnime në fushat e mëposhtme:




Gjithashtu, për një pjesë të punonjësve u sigurua trajnim në lidhje me mënyrën e funksionimit të sistemit informativ, përdorimin e duhur të burimeve TI, përdorimin e mjeteve softuerike, aplikacioneve dhe Sistemit për menaxhimin e procesit të revizionit (AMS).














Në pjesën e rritjes së njohurive dhe aftësive të të punësuarve në ESHR janë përdorur qasje të ndryshme, duke përfshirë pjesëmarrje në ngjarje edukative të dizajnuara posaçërisht për nevojat e të punësuarve të ESHR-së nga ISR të tjera, pjesëmarrje në ngjarje edukative të organizuara nga organizata dhe institucione të tjera ndërkombëtare, si dhe në ngjarje të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAI.

## 3.3. BURIMET E TI-SË

Enti Shtetëror i Revizionit ndërmerr aktivitete, në kuadër të mjeteve të disponueshme, drejt modernizimit të vazhdueshëm të kapaciteteve ekzistuese të TI-së dhe zhvillimit të teknologjisë informative, si bazë për realizimin e suksesshëm të revizionit.

Duke u udhëhequr nga objektivat strategjike të përcaktuara dhe nga hulumtimi i vazhdueshëm i tregut në fushën e TIK dhe nga nevojat e punonjësve të ESHR-së, gjatë vitit 2025 u realizuan blerjet e planifikuara në pjesën e:

- zgjidhje të re firewall, me të cilën ESHR siguron nivel të lartë mbrojtjeje në vitet e ardhshme;
- licenca për punë zyre (MS Office 365), me ç'rast unifikohet përdorimi i mjeteve për punë zyre;
- furnizim me desktopë dhe laptopë për një pjesë të të punësuarve, me karakteristika që mbulojnë procesin e revizionit dhe ndjekin zgjidhjet moderne të TI-së dhe avancimet e sistemeve operative;
- furnizim me licenca për zgjidhje shumë profesionale për backup (nga kuadranti Gartner për zgjidhje në fushën e backup-it të të dhënave), me ç'rast realizohet mbrojtja e të dhënave;
- furnizim me pajisje të re multifunksionale për printim, plotësisht të integruar në sistemin për printim elektronik zyrtar, me profile dhe role të përcaktuara të përdoruesve;
- furnizim me licenca për softuer për dizajn grafik, me të cilin të punësuarit e ESHR-së, të cilët kanë ndjekur trajnime për dizajn grafik, krijojnë zgjidhje bashkëkohore ilustruese për informim të lehtë dhe të qartë të palëve të interesuara;
- furnizim me shërbim për telefoni mobile dhe internet mobil, si dhe
- furnizim për mirëmbajtjen e sistemit për menaxhimin e procesit të revizionit.

Për rritjen e njohurive dhe aftësive të të punësuarve në fushën e TI-së, u sigurua mundësia për trajnim të specializuar në TI (gjithsej katër kurse) nga programi i Microsoft për edukim në TI.

Praktika e përdorimit të një platforme profesionale për zhvillimin e videokonferencave dhe takimeve me palë të brendshme dhe të jashtme vazhdoi të përdoret në vazhdimësi edhe këtë vit.

ESHR, si Institucion Suprem i Revizionit, në procesin e revizionit përdor teknika të revizionit të mbështetura me kompjuter, të njohura si CAAT's.

CAATs paraqesin mjete të bazuara në kompjuter, me ndihmën e të cilave revizori kryen një sërë testesh të automatizuara për vlerësimin e sistemit të informacioneve të subjektit ose të dhënave elektronike. CAATs sigurojnë nivel më të lartë të besueshmërisë dhe sigurimin e dëshmive të mjaftueshme dhe adekuate të revizionit. Gjithashtu, ESHR në revizion përdor softuerin IDEA për analizën e të dhënave nga të cilat gjenerohen pasqyrat financiare dhe për përzgjedhjen e mostrës për nevojat e procesit të revizionit.

Për vizualizimin dhe dokumentimin adekuat të gjendjeve të konstatuara në procesin e revizionit përdoren dronë, me ç'rast ESHR praktikon, nga njëra anë, të sigurojë dëshmi të rregullta dhe të besueshme, ndërsa nga ana tjetër të sigurojë dukshmëri më të madhe të gjendjeve të konstatuara për organet kompetente dhe palët e interesuara.

Në vazhdimësi është siguruar funksionimi i pandërprerë i infrastrukturës së sistemit informativ dhe aplikacioneve, duke pasur kujdes për parimet dhe rregullat për::

**Në vazhdimësi është siguruar funksionimi i pandërprerë i infrastrukturës së sistemit informativ dhe aplikacioneve, duke pasur kujdes për parimet dhe rregullat për:**




Në përputhje me aktivitetet e përcaktuara të projektit, ESHR në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Norvegjisë, në komponentin për zhvillimin e Laboratorit Inovativ në ESHR, në muajin qershor 2025 u mbajt Hakaton me temë **"Mjete inovative në interes të aktiviteteve të revizionit dhe prezantimit të rezultateve të tyre para publikut".**

Në kuadër të laboratorit inovativ u zhvillua zgjidhje për kërkimin dhe analizën e të dhënave për kontratat e lidhura të prokurimit publik, bazuar në të dhënat nga Sistemi elektronik për prokurime publike (SEPP), e cila u nda me njësitë e vetëqeverisjes lokale. Aplikacioni është i dedikuar për të punësuarit në ESHR të përfshirë në procesin e revizionit shtetëror dhe mundëson kërkim sipas subjektit, bartësit të prokurimit dhe periudhës kohore, si dhe pasqyrë të statistikave bazë (numri dhe vlera e kontratave dhe kontratave me një ofertë), me ç'rast kontribuohet në përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitetit të procesit të revizionit.

Duke ndjekur arritjet bashkëkohore në teknologjinë e TI-së dhe inteligjencën artificiale, ESHR në bashkëpunim me ISR-në e Norvegjisë filloi zhvillimin e chatbot-i në kuadër të ESHR-së. Kjo zgjidhje teknike përdor inteligjencën artificiale për qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në standardet dhe metodologjinë e revizionit, të disponueshme për revizorët për kryerje më efikase të revizionit. Përdorimin e inteligjencës artificiale në aktivitetet aktivitetet e revizionit, ESHR e nënkupton si proces për rritjen e efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit në punën e revizorëve, por jo si zëvendësim të punës së tyre.

Vazhduan aktivitetet në komponentin "Revizioni i TI-së dhe mjetet TIK", të orientuara drejt avancimit sistematik të njohurive dhe aftësive në fushën e revizionit të TI-së dhe sigurisë, me ç'rast në një pjesë të ngjarjeve morën pjesë edhe përfaqësues nga ISR tjerë.

## 3.4. MJETET FINANCIARE PËR PUNËN E ESHR-së

Enti Shtetëror i Revizionit është Institucion Suprem i Revizionit i pavarur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili për më shumë se 26 vjet në mënyrë transparente, të azhurnuar, llogaridhënëse dhe objektive i informon organet kompetente, institucionet, palët e interesuara dhe subjektet e sektorit publik në shtet për gjendjet e konstatuara nga revizionet e zbatuara dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve publike.

Enti Shtetëror i Revizionit e kreu punën e vet të rregullt në vitin 2025 përmes 4 llogarive të mëposhtme:

- Buxheti themelor i Entit Shtetëror të Revizionit-020021504063710;
- Buxheti themelor i Entit Shtetëror të Revizionit - të hyra vetanake - 020021504063119;
- Llogaria buxhetore e donacioneve e Entit Shtetëror të Revizionit – 020021504078579 – EUROSAI, projekt i ri i revizionit.
- Llogaria buxhetore e donacioneve e Entit Shtetëror të Revizionit – 020021504078583 – revizion paralel EUROSAI.

Buxheti i miratuar fillimisht i Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025 është në shumën totale prej 204.627 mijë denarë nga të cilat për llogarinë:

- Llogarinë e buxhetit themelor (637) u miratuan mjete në shumë prej 201.927 mijë denarë;
- Buxheti themelor i të hyrave vetanake (631) u miratuan mjete në shumë prej 2.700 mijë denarë.

Në bazë të analizave të kryera për mjetet e miratuara në Buxhetin fillestar të miratuar për vitin 2025 për ESHR-në, planin vjetor për prokurime publike për vitin 2025, gjendjen e të punësuarve, punësimet dhe avancimet e planifikuara për vitin 2025, u konstatua se nevojiten mjete financiare shtesë për funksionimin e rregullt të Entit Shtetëror të Revizionit me qëllim realizimin e planeve strategjike, programeve dhe aktiviteteve për këtë vit.

Në bazë të kërkesës së dorëzuar për ndryshim dhe plotësim të buxhetit të ESHR-së për vitin 2025, Ministria e Financave ka dhënë mendim pozitiv dhe janë miratuar mjete financiare shtesë për vitin 2025. Pas miratimit të mjeteve financiare me ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit të RMV-së (rebalansit) për vitin 2025 dhe në përputhje me kërkesën e dorëzuar dhe të miratuar për zgjerimin e buxhetit të ESHR-së për vitin 2025, buxheti i përgjithshëm i ESHR-së për vitin 2025 arrin në 211.651 mijë denarë, përkatësisht sipas llogarive si vijon:

- **Llogarinë e buxhetit themelor (637) u miratuan mjete në shumë prej 208.051 mijë denarë;**
- **Buxheti themelor i të hyrave vetanake (631) u miratuan mjete në shumë prej 2.700 mijë denarë.**
- **Llogaria e buxhetit të donacioneve (785) revizion paralel EUROSAI u miratuan dhe planifikuan mjete në shumë prej 900 mijë denarë.**
- **Llogaria e buxhetit të donacioneve (785) EUROSAI- projekt i ri, nuk ka mjete të miratuara dhe të planifikuara për vitin 2025. Projekti është implementuar dhe realizuar gjatë vitit 2024, ndërsa llogaria është mbyllur në vitin 2025.**

**211.651**
mijë denarë
buxheti total i
planifikuar për vitin
**2025**

mjetet e siguruar nga buxheti themelor në llogarinë **63710**
**208.051 mijë denarë** → **98.30%**

mjetet e siguruar nga buxheti themelor në llogarinë **63119**
**2.700 mijë denarë** → **1.28%**

mjetet e siguruar nga llogaria e donatorit **78583**
**900 mijë denarë** → **0.43%**

**94%** realizim / **198.916 mijë denarë**

Me sigurimin e mjeteve të mjaftueshme financiare për funksionimin e pandërprerë dhe të rregullt të Entit Shtetëror të Revizionit dhe ushtrimin e kompetencave ligjore dhe autorizimeve të dhëna, është e mundur që Enti Shtetëror i Revizionit të sigurojë kthimin e drejtpërdrejtë të mjeteve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes evazionit të përcaktuar tatimor.

**Pra, me revizionet e kryera në kuadër të Programit Vjetor të Punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025, vlera e shtuar nga revizionet e kryera nga Enti Shtetëror i Revizionit siguron kthim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komunave në raportin 1:135, përkatësisht 1 buxhet i ESHR-së siguron kthim në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komunave në shumën e të paktën 135 buxhete të ESHR-së. Mjetet e paarkëtuara / më pak të llogaritura dhe të paguara gjatë revizionit në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komunave janë 28.225.000 mijë denarë, përkatësisht 459 milion euro.**

## BUXHETI THEMELOR I ESHR-SË PËR VITIN 2025
## 020021504063710

Mjetet e planifikuara për Llogarinë e Buxhetit Themelor të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025 janë 208.051 mijë denarë, prej të cilave janë realizuar mjete në shumën prej 198.062 mijë denarë ose 95,2%.

### Kategoria 40 – Rrogat dhe kompensimet

Në bazë të buxhetit të miratuar të ESHR-së për vitin 2025, në kategorinë 40 – rrogat dhe kompensimet janë planifikuar mjete në shumë totale prej 167.226 mijë denarë, nga të cilat janë realizuar mjete në shumë prej 160.799 mijë denarë, ose shkalla e realizimit është 96,16%.

### Kategoria 42 – Mallrat dhe shërbimet

Projeksioni i përgjithshëm për vitin 2025 në kategorinë 42 – mallrat dhe shërbimet (shpenzime të udhëtimit dhe mëditjeve, shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, materiale dhe inventar i imët, riparime dhe mirëmbajtje rrjedhëse, shërbime kontraktuese dhe shpenzime të tjera rrjedhëse) arrin në 30.300 mijë denarë, nga të cilat janë realizuar mjete në shumë prej 28.669 mijë denarë, ose shkalla e realizimit është 94,62%.

### Kategoria 46 – Subvencionet dhe transferet

Në këtë pozitë, mjetet e planifikuara në Buxhetin e ESHR-së për vitin 2025 janë në shumë totale prej 500 mijë denarë, ndërsa janë realizuar 461 mijë denarë ose 92,2%. në përqindje.

### Kategoria 48 – Shpenzimet kapitale

Mjetet e projektuara në kategorinë 48 – shpenzime kapitale për vitin 2025 në buxhetin e ESHR-së janë në shumë totale prej 10.025 mijë denarë, nga të cilat janë realizuar mjete në shumë prej 8.133 mijë denarësh ose 81,13%.



## LLOGARIA E BUXHETIT THEMELOR - TË HYRA VETANAKE 020021504063119

Enti Shtetëror i Revizionit, përveç llogarisë së tij të rregullt, ka edhe llogari të buxhetit bazë për të hyra vetanake 631-19, përmes së cilës gjatë viteve të kaluara realizoheshin të hyra nga pagesa e kompensimeve nga subjektet që ishin objekt i revizionit, në bazë të tarifës së publikuar në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 30, datë 19.04.2000.

Në përputhje me tarifën e përcaktuar për pagesën e kompensimeve nga revizionet e kryera, ishte përcaktuar procedurë dhe mënyrë për llogaritjen dhe faturimin e kompensimeve nga shërbimi i kryer (revizion shtetëror i subjekteve të sektorit publik që nuk financohen nga Buxheti i shtetit ose Buxheti i NJVL-ve dhe qytetit të Shkupit).

Në këtë llogari, në buxhetin e ESHR-së për vitin 2025 janë planifikuar mjete (të hyra dhe shpenzime) në shumë totale prej 2.700 mijë denarë, ndërsa janë realizuar të hyra në shumë prej 2.323 mijë denarë ose 86,04%, të cilat paraqesin shumë të të hyrave të arkëtuara në bazë të vendimit përmbarues nga subjektet lëndë të revizionit dhe mjeteve të papërdorura të bartura si tepricë e të hyrave nga viti paraprak.

Nuk ka shpenzime të realizuara nga llogaria vetanake e Buxhetit të ESHR-së për vitin 2025.




## LLOGARIA E BUXHETIT TË DONACIONEVE TË ESHR-SË PËR VITIN 2025 – REVIZIONI PARALEL - EUROSAI 020021504078583

Mjetet e planifikuara në llogarinë donatore të EUROSAI – revizion paralel për vitin 2025 në buxhetin e ESHR-së për donacione janë 900 mijë denarë, nga të cilat janë realizuar të hyra dhe shpenzime në shumë prej 854 mijë denarë ose 94,89%

Enti Shtetëror i Revizionit ka paraqitur aplikim në shumë prej 14.000 eurosh në EUROSAI për organizimin e një ngjarjeje ndërkombëtare për revizionin paralel të suksesit të realizuar me temë **"Plakja e popullsisë".** Ngjarja u organizua nga ESHR në periudhën 09–11.09.2025, ku përveç Entit Shtetëror të Revizionit morën pjesë edhe 10 (dhjetë) Institucione Supreme të Revizionit nga Shqipëria, Austria, Lituania, Malta, Paraguai, Polonia, Portugalia,

Sllovakia, Çekia dhe ISR e Izraelit, të cilët kishin rolin e koordinatorëve të këtij revizioni. Ngjarja ndërkombëtare e mbajtur ishte në përputhje me implementimin e Objektivit strategjik 1 të Planit strategjik të Organizatës Evropiane të ISR-ve (EUROSAI) për periudhën 2024–2030: „Mbështetje dhe ndërmjetësim në bashkëpunimin profesional".

Projekti është zbatuar plotësisht në muajin nëntor 2025.




## LLOGARIA E BUXHETIT TË DONACIONEVE TË ESHR-SË PËR VITIN 2025 – EUROSAI – PROJEKT I RI

**020021504078579**

Kjo llogari është realizuar dhe implementuar plotësisht në vitin 2024, ndërsa është mbyllur më 14.01.2025. Në përputhje me këtë, për vitin 2025 është dorëzuar llogaria përfundimtare me saldo zero dhe pa aktivitete rrjedhëse të evidentuara gjatë vitit. Kjo llogari kishte të bënte me organizimin e ngjarjes dhe mbajtjen e konferencës me temë **„Shkëmbimi i përvojave në procesin e komunikimit të ISR-ve me palët e interesuara – mundësi dhe sfida".**

Raporti nga revizioni i kryeri punës materiale dhe finaciare të ESHR-së nga revizori i pavarur është pjesë përbërëse e Raportit Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025.

# 3.5. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR

Bota moderne përballet me një sërë sfidash që e rrezikojnë mbijetesën e mjedisit natyror dhe cilësinë e jetës së njerëzve. Ndryshimet klimatike, ndotja, shkatërrimi i ekosistemeve dhe menaxhimi i paqëndrueshëm i burimeve kërkojnë përgjigje sistematike dhe të koordinuara, **ndërsa Institucionet Supreme të Revizionit (ISR),** përmes revizioneve të politikave dhe financave publike, kontribuojnë në **„ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet"** për menaxhimin efikas të programeve dhe aktiviteteve për të arritur Agjendën 2030 dhe për menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.



Në këtë drejtim, në disa vitet e fundit, ESHR-ja me revizionet i ka mbuluar Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe progresin e tyre.

Përmes rekomandimeve konkrete dhe të qarta drejtuar institucioneve kompetente, ESHR-ja përfshihet në grupin e ISR-ve që marrin pjesë aktive në mbrojtjen e mjedisit jetësor, përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike të jetës së njerëzve, uljen e varfërisë dhe mbështetjen e udhëzimeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe për një të ardhme më të mirë për brezat e ardhshëm.

Në përputhje me dokumentet strategjike dhe Programin Vjetor të Punës për vitin 2025, janë zbatuar **11 revizione të suksesit dhe 3 revizione të pajtueshmërisë** në lidhje me Strategjinë Nacionale të Zhvillimit 2024-2044 dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm.




Enti Shtetëror i Revizionit është thellësisht i përkushtuar për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme në të gjithë punën e vet. Çdo ditë, punonjësit punojnë për të krijuar zgjidhje që kontribuojnë për një të ardhme më të gjelbër dhe më të shëndetshme, me bindjen se çdo veprim i vogël mund të kontribuojë për një ndikim më të madh pozitiv.



### MBROJTJA E EKOSISTEMIT

Ulja e konsumit të letrës, përmes një sistemi kontrolli të materialeve të shtypura, përdorimit të CD-ve dhe përdorimit të shërbimeve Cloud.



### MENAXHIMI ME HEDHURINAT

Përzgjedhja e hedhurinave nga letra, shishet plastike dhe bateritë



### KURSIMI I UJIT DHE ENERGJISË ELEKTRIKE

Optimizimi i përdorimit të burimeve ujore dhe energjisë elektrike.



### MBROJTJA E OBJEKTIT

Mirëmbajtje e vazhdueshme dhe zvogëlim i rreziqeve nga dëmtimet



# 04

# BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR



# 4.1 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Gjatë vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit punoi me përkushtim në forcimin e pozitës së tij ndërkombëtare dhe zgjerimin e bashkëpunimit me institucionet supreme të revizionit, organizatat ndërkombëtare dhe rrjetet partnere, me qëllim zhvillimin e metodologjive të revizionit, kapaciteteve profesionale dhe pavarësisë institucionale. Përmes pjesëmarrjes aktive në kongrese ndërkombëtare, konferenca, trajnime, revizione kooperative dhe paralele, si dhe përmes realizimit të aktiviteteve të shumta bilaterale dhe multilaterale, ESHR e konfirmoi rolin e tij si institucion suprem modern dhe kredibil i revizionit, i përkushtuar ndaj transparencës, llogaridhënies dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare të revizionit.

Theks i veçantë gjatë vitit iu kushtua zhvillimit të revizionit të suksesit, transformimit digjital dhe zbatimit të mjeteve bashkëkohore të TI-së dhe analitike në proceset e revizionit, si dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar përmes iniciativave të përbashkëta, trajnimeve dhe shkëmbimit të përvojave. Aktivitetet e realizuara në kuadër të EUROSAI, INTOSAI, Komitetit Kontaktues të BE-së, si dhe bashkëpunimi bilateral me institucionet supreme të revizionit nga Evropa dhe rajoni, kontribuan në avancimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale, shkëmbimin e praktikave të mira dhe zhvillimin e qasjeve inovative në revizion, në funksion të menaxhimit më efikas dhe më të përgjegjshëm të mjeteve publike.

Veçanërisht i rëndësishëm është bashkëpunimi me:



- Gjykatën Evropiane të Revizorëve **(ECA),**
- Komisionin Evropian,
- Këshillin Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s **(IBAN),**
- Iniciativën për Zhvillim të **INTOSAI-t (IDI),**
- Trupat e punës së **EUROSAI-t dhe INTOSAI-t**,
- Trupin e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave **(UN Women)**,
- Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara **(UNDP),**
- Institutin Demokratik Nacional **(NDI),**
- Fondacionin Vestminster për Demokraci **(WFD),**
- Bankën Botërore,
- **OECD-SIGMA,**
- Qendrën e Ekselencës në Financa **(CEF),**
- Institutin e Autorizuar për Financat Publike dhe Kontabilistët **(CIPFA),**
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik **(OECD),**
- Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore **(IFES).**

si dhe me institucione të shumta supreme të revizionit nga Bashkimi Evropian dhe rajoni.

Përmes këtyre aktiviteteve, ESHR-ja kontribuon drejtpërdrejt në arritjen e prioriteteve nacionale të përmbajtura në dokumentet strategjike dhe qëllimet globale për zhvillimin e qëndrueshëm.

ESHR-ja mori pjesë në ngjarje të shumta ndërkombëtare në vitin 2025, duke përfshirë:

## KOMITETIN E KONTAKTIT TË BE-SË

Përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në takimet e rregullta brenda Komitetit të Kontaktit të BE-së, të cilat kishin të bënin me:

- Takimin e Pranverës së Oficerëve të Lidhjeve të BE-së –26-27 mars 2025, Varshavë, Poloni;
- Konferencë e nivelit të lartë me temë „Siguria në vendet e BE-së", me rastin e Presidencës Polake me Këshillin e BE-së – 3 qershor 2025, Varshavë, Poloni;
- Takimin e Komitetit të Kontaktit të ISR-ve nga vendet anëtare të BE-së – 18-20 nëntor 2025, Florijana, Malltë.




Përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në takimet dhe ngjarjet e rregullta në kuadër të Komitetit të Kontaktit të BE-së, të cilat janë me rëndësi kyçe për koordinimin ndërmjet institucioneve supreme të revizionit të vendeve anëtare dhe vendeve kandidate për anëtarësim në BE, për shkëmbimin e praktikave dhe informatave të mira, realizimin e projekteve të përbashkëta dhe zgjerimin e bashkëpunimit.

**Rrjetin e ISR-ve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në BE**

Përmes aktiviteteve të Rrjetit, ESHR kontribuon në harmonizimin e proceseve të revizionit me praktikat më të mira të BE-së, ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetjen e reformave institucionale për sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë.

Trajnimet për revizionin e suksesit, të realizuara si seri me mbështetjen e Zyrës Kombëtare Suedeze të Revizionit (SNAO), dhanë kontribut të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve institucionale përmes shkëmbimit të përvojave praktike dhe krijimit të një rrjeti të qëndrueshëm rajonal për bashkëpunim profesional. Në kuadër të aktiviteteve të kryera në bashkëpunim me SNAO-në në vitin 2024, shtatë punonjës të ESHR-së morën certifikatë për trajnimin profesional të përfunduar për revizionin e suksesit.

## KOMISIONI EVROPIAN – DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZGJERIM DHE FQINJËSI LINDORE (DG ENEST)

European Commission

Në kushte të intensifikimit të proceseve reformuese të lidhura me Instrumentin për Rritje dhe Zhvillim të Ballkanit Perëndimor dhe Agjendën Reformuese, roli i ESHR-së merr rëndësi të veçantë në sigurimin e mbikëqyrjes së pavarur, llogaridhënies dhe transparencës në implementimin e tyre, që imponon nevojën për forcim të vazhdueshëm të kapaciteteve institucionale dhe profesionale për zbatimin e revizioneve në këtë fushë. Për këtë qëllim, me ftesë të DG ENEST, përfaqësues të ESHR-së morën pjesë në::

- Trajnimin për kontroll dhe revizion të Agjendës Reformuese – 18–19 qershor 2025, Tiranë, Shqipëri;
- Seminarin online për Instrumentin për Rritje dhe Zhvillim të Ballkanit Perëndimor – 17 tetor 2025.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ESHR-së në seminaret dhe punëtoritë për Agjendën Reformuese dhe Instrumentin për Rritje dhe Zhvillim të Ballkanit Perëndimor mundësoi shkëmbim të njohurive me përfaqësues të Komisioni Evropian, OECD/SIGMA dhe institucioneve revizore nga rajoni dhe BE-ja, lidhur me planifikimin, zbatimin dhe raportimin për revizionet e ndërlidhura me Agjendën Reformuese.

## GJYKATA EVROPIANE E REVIZIONIT

CURIA RATIONUM
EUROPEAN COURT OF AUDITORS

Gjykata Evropiane e Revizionit në vitin 2025 organizoi:

- Konferencë për mbrojtje, e organizuar online – 30 qershor 2025.

Konferenca e theksoi rëndësinë në rritje të mbrojtjes dhe sigurisë evropiane në kushte të ndryshuara gjeopolitike, duke kontribuar në kuptim më të mirë të sfidave të lidhura me zbatimin, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e ardhshëm të politikave dhe shpenzimeve në fushën e mbrojtjes.

## BORDIN NDËRKOMBËTAR TË REVIZORËVE TË NATO-S (IBAN)

Bashkëpunimi me Bordin Ndërkombëtar të Revizorëve të NATO-s (IBAN) është forcuar nëpërmjet pjesëmarrjes në:

- Trajnimi dhe takimi i Bordit Ndërkombëtar të Revizorëve në NATO (IBAN) – 13–15 maj 2025, Bruksel, Belgjikë.

Pjesëmarrja e ESHR-së në IBAN paraqet hap të rëndësishëm drejt forcimit të mbikëqyrjes financiare në fushën e mbrojtjes. Përmes pjesëmarrjes në takime dhe bashkëpunimit bilateral në përputhje me Memorandumin e nënshkruar për bashkëpunim, ESHR fiton qasje në standardet dhe praktikat më të larta për revizionin e buxheteve të mbrojtjes dhe sigurisë.

## KONGRESI XXV I INTOSAI-T

Pjesëmarrja e ESHR-së në:

- Kongresi XXV i INTOSAI (INCOSAI) – 27 tetor – 2 nëntor 2025, Sharm El Sheik, Egjipt;

paraqet kontribut të rëndësishëm për forcimin e pozitës ndërkombëtare, dukshmërisë profesionale dhe kapaciteteve institucionale të ESHR-së në kuadër të komunitetit global të institucioneve supreme të revizionit. Përmes pjesëmarrjes aktive në diskutimet për revizionin në kushte të krizave financiare dhe ekonomike, si dhe për zbatimin e inteligjencës artificiale në revizion, ESHR u përfshi në proceset më aktuale globale dhe sfidat bashkëkohore të revizionit. Veçanërisht i rëndësishëm ishte pjesëmarrja e Kryerevizorit Shtetëror, mr. Maksim Acevski, si panelist në ngjarjen e JURISAI, ku u prezantuan rezultatet e revizioneve të lidhura me krizën e COVID-19 dhe bashkëpunimin me Prokurorinë Publike, me ç'rast u konfirmua roli i ESHR-së në forcimin e llogaridhënies dhe integritetit në menaxhimin e mjeteve publike. Takimet e shumta bilaterale me përfaqësues të institucioneve supreme të revizionit dhe organizatave ndërkombëtare, ndër të cilat nga Egjipti, India, Arabia Saudite dhe Rumania, hapën mundësi për bashkëpunim të mëtejshëm, shkëmbim të njohurive, trajnime dhe zhvillim të praktikave të revizionit, veçanërisht në fushat e TI-së, inteligjencës artificiale dhe revizionit të mjedisit jetësor.

## INICIATIVËN PËR ZHVILLIMIN E INTOSAI-T (IDI)

Përmes pjesëmarrjes në aktivitetet e IDI-së që kanë të bëjnë me:

- Ngjarje e nivelit të lartë për zhvillimin e kapaciteteve për revizion dhe sigurimin e raporteve të qëndrueshmërisë në sektorin publik dhe sesioni i 42-të i Grupit Ndërqeveritar të Punës së Ekspertëve për standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit (ISAR), me ftesë të IDI-t dhe UNCTAD – 11–14 nëntor 2025, Gjenevë, Zvicër;

- Ngjarje përmbyllëse me ndërveprim ballë për ballë të pjesëmarrësve në programin për Liderë të Rinj të ISR-ve (SYL), organizuar nga IDI – 8–12 dhjetor 2025, Muskat, Oman,

ESHR siguron forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale dhe udhëheqëse, ndjekjen dhe zbatimin e standardeve dhe praktikave bashkëkohore ndërkombëtare në revizion dhe raportimin për qëndrueshmëri, si dhe përfshirjen aktive në proceset globale për përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë me burimet publike. Njëkohësisht, pjesëmarrja në programet për zhvillimin e lidershipit dhe menaxhimin e ndryshimeve kontribuon në krijimin e një institucioni modern, rezistent dhe proaktiv të revizionit, të gatshëm për t'iu përgjigjur sfidave dhe nevojave të reja të sektorit publik.

## GRUPI I PUNËS SË INTOSAI-T PËR BORXHIN PUBLIK

Pjesëmarrja e Entit Shtetëror të Revizionit në ngjarjet e organizuara nga INTOSAI dhe UNCTAD paraqet kontribut të rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve në fushën e revizionit dhe menaxhimit të borxhit publik, përmes shkëmbimit të përvojave dhe diskutimeve për transparencën, disiplinën fiskale, financimin klimatik, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe faktorët e ndikimit mbi mjedisin jetësor, shoqërinë dhe qeverisjen, me ç'rast ESHR e forcon rolin e saj në iniciativat ndërkombëtare për menaxhim të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të financave publike.

## EUROSAI

ESHR mori pjesë në aktivitete në kuadër të EUROSAI në kuadër të:

- Takimit për revizionin paralel me temë „Përgatitja për plakjen e popullsisë", i cili zbatohet në kuadër të EUROSAI dhe udhëhiqet nga ISR e Izraelit – 9–11 shtator 2025, ESHR nikoqir, Shkup;

- Seminari i EUROSAI-t për ndërtimin e kapaciteteve – 14–15 tetor 2025, Varshavë, Poloni.

Anëtarësimi i ESHR-së në EUROSAI ka rëndësi të veçantë për avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në revizion, shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira, si dhe për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale përmes pjesëmarrjes aktive në revizione të përbashkëta, iniciativa profesionale dhe procese evropiane të orientuara drejt menaxhimit më të mirë të politikave dhe mjeteve publike.

Ngjarja ndërkombëtare kushtuar revizionit paralel me temë „Plakja e popullsisë", e cila udhëhiqet nga ISR e Izraelit dhe në të cilën, përveç Entit Shtetëror të Revizionit, marrin pjesë edhe 9 institucione të tjera supreme të revizionit, paraqet platformë të rëndësishme për zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve supreme të revizionit, shkëmbimin e përvojave dhe shqyrtimin e përbashkët të sfidave demografike, me ç'rast përmes prezantimit të gjetjeve nga revizioni dhe praktikave të mira kontribuohet në krijimin e politikave më efikase dhe përgatitje më të mirë të institucioneve për përballimin e pasojave nga plakja e popullsisë.

## GRUPI I PROJEKTIT TË EUROSAI-T PËR QËLLIMIN STRATEGJIK 1 PËR BISEDAT E REVIZIONIT (AUDIT TALKS)

Në kuadër të Objektivit Strategjik 1 të EUROSAI-t, Grupi projektues për Bisedat e Revizionit (AuditTalks) paraqet iniciativë të rëndësishme për forcimin e dialogut profesional, shkëmbimin e njohurive dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve supreme evropiane të revizionit.

## GRUPI I PROJEKTIT TË EUROSAI-T PËR QËLLIMIN STRATEGJIK 1 MBI MJETET DHE METODOLOGJITË E REVIZIONIT NË KOHË REALE

Revizioni në kohë reale, si qasje që mundëson ndjekjen dhe vlerësimin në kohë të aktiviteteve aktuale për të rritur efektivitetin dhe llogaridhënien, ishte në fokus të:

- Takimi i Grupit Projektues të EUROSAI-t për Objektivin Strategjik 1 për përfitimet dhe metodologjitë e revizionit në kohë reale – 5–6 qershor 2025, Bukuresht, Rumani.

Përfitimet e pjesëmarrjes në takimin e Grupit të Projektit të revizionit në kohë reale shihen në avancimin e njohurive metodologjike, shkëmbimin e përvojave me ISR të tjera, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe inicimin e aktiviteteve për zhvillimin e qasjeve dhe standardeve të përbashkëta në fushën e revizionit në kohë reale.

## GRUPI I PUNËS SË EUROSAI-T PËR REVIZIONIN E KOMUNAVE (WGMA)

Pjesëmarrja e ESHR-së në aktivitetet e Grupit të Punës të EUROSAI-t për revizionin e njësive të vetëqeverisjes lokale paraqet mundësi të rëndësishme që përmes diskutimeve për revizione kooperative, trajnime dhe iniciativa të përbashkëta të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe roli i institucioneve supreme të revizionit në avancimin e menaxhimit transparent dhe efikas në nivel lokal.

## GRUPET E PUNËS PËR REVIZIONIN E MJEDISIT JETËSOR - INTOSAI DHE EUROSAI (WGEA)

Pjesëmarrja aktive e ESHR-së në ngjarjet e INTOSAI dhe EUROSAI WGEA e forcon rolin e saj në përpjekjet globale për monitorim dhe revizion të çështjeve të lidhura me mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike. Përmes pjesëmarrjes në këto ngjarje, ESHR siguron qasje të drejtpërdrejtë në mjete të reja dhe metodologji ndërkombëtare për vlerësimin e politikave ekologjike, si dhe e rrit rëndësinë në përmbushjen e detyrimeve nacionale dhe ndërkombëtare që lidhen me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht QZHQ 13 - Veprimi Klimatik.

## RRJETI I EUROSAI PËR ETIKË (N.ET.)

Pjesëmarrja e ESHR-së në:

- Seminarin për etikë me temë „Zbatimi i parimeve etike në përdorimin e inteligjencës artificiale në revizione", 16–17 tetor 2025, Lisbonë, Portugali,

ishte me rëndësi të veçantë pasi mundësoi shqyrtimin me kohë të ndikimit të inteligjencës artificiale mbi proceset e revizionit, forcimin e standardeve etike dhe integritetit në punë, si dhe shkëmbimin e praktikave dhe përvojave bashkëkohore që kontribuojnë në gatishmërinë për transformimin digjital dhe përballimin e sfidave të reja të epokës digjitale.

## GRUPI PROJEKTUES I EUROSAI PËR ANALIZËN E MBËSHTJELLJES SË TË DHËNAVE (DEA) DHE METODA TË TJERA TË MATJES KRAHASUESE

Zbatimi i metodave dhe mjeteve bashkëkohore analitike në revizion ishte fokus i:

- Takimit të 8-të të Grupit Projektues të EUROSAI për Analizën e Mbështjelljes së të Dhënave (DEA) dhe metoda të tjera të matjes krahasuese – 27–28 nëntor 2025, Bukuresht, Rumani.

Pjesëmarrja e ESHR-së në këtë ngjarje paraqet hap të rëndësishëm drejt avancimit të revizionit të suksesit përmes zbatimit të metodave dhe mjeteve bashkëkohore analitike për matjen e efikasitetit dhe rezultateve dhe kontribuon në forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale, si dhe harmonizimin me trendet bashkëkohore evropiane të revizionit.

## PROJEKTI I EUROSAI-T PËR AKTIVITETE ZHVILLIMORE (EDA)

Zyra Kombëtare Suedeze e Revizionit (SNAO) e filloi Projektin e EUROSAI-t për aktivitete zhvillimore (EDA) si iniciativë e re e përbashkët e institucioneve supreme evropiane të revizionit, e orientuar drejt avancimit të praktikave profesionale të revizionit dhe forcimit të ndikimit të revizionit.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ESHR-së në punëtorinë e parë në kuadër të projektit EDA paraqet hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të metodologjive të revizionit, forcimit të ndikimit të revizionit dhe zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve supreme evropiane të revizionit përmes shkëmbimit të përvojave dhe fitimit të njohurive të reja për planifikimin strategjik, cilësinë e revizionit, raportimin efektiv dhe krijimin e vlerës së shtuar.

## BASHKËPUNIMI BILATERAL ME ISR-TË

Në drejtim të rritjes së njohurive dhe aftësive të të punësuarve në ESHR dhe krijimit të ESHR-së si institucion që mëson vazhdimisht, me integrimin e parimit të të mësuarit gjatë gjithë jetës (lifelong learning) nga njëra anë dhe promovimin e punës së ESHR-së në nivel ndërkombëtar dhe ndarjen e përvojës nga puna e ESHR-së nga ana tjetër, në periudhën raportuese ESHR vendosi bashkëpunim bilateral me disa ISR, edhe atë:

- **Zyra Kombëtare e Revizionit e Norvegjisë;**
- **Gjykata Hollandeze e Revizionit;**
- **Zyra për Llogaridhënie e Qeverisë së SHBA-së;**
- **Gjykata Franceze e Revizionit;**
- **Gjykata e Revizionit e Republikës së Sllovenisë;**
- **Zyra Kombëtare e Revizionit të Maltës;**
- **Zyra Supreme e Revizionit të Republikës së Polonisë;**
- **Gjykata e Revizionit të Republikës së Italisë;**
- **Zyra Supreme e Revizionit të Republikës së Çekisë;**
- **Gjykata Rumune e Revizionit;**
- **Zyra Kombëtare e Revizionit të Bullgarisë;**
- **Gjykata e Revizorëve e Mbretërisë së Belgjikës;**
- **Institucioni Shtetëror i Revizionit i Malit të Zi;**
- **Zyra për Revizionin e Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës;**
- **Kontrolli i Lartë i Shtetit;**
- **Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës.**

Ky bashkëpunim përfshin numër të madh aktivitetesh, duke filluar nga shkëmbimi i njohurive, përvojave dhe praktikave të mira, organizimi i trajnimeve të përbashkëta, punëtorive, vizitave studimore dhe takimeve të ekspertëve, përmes zhvillimit dhe avancimit të metodologjive të revizionit, zbatimit të mjeteve bashkëkohore digjitale dhe të TI-së, aktiviteteve për zhvillim profesional dhe forcim të kapaciteteve institucionale, e deri te zbatimi i revizioneve paralele dhe kooperative me interes të përbashkët. Aktivitetet e detajuara për bashkëpunimin bilateral mund t'i shihni në Shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

# BASHKËPUNIMI BILATERAL ME ISR-TË

## ZYRA NACIONALE E REVIZIONIT TË NORVEGJISË

Memorandumi i Bashkëpunimit i nënshkruar në vitin 2022 midis Entit Shtetëror të Revizionit dhe Zyrës Nacionale të Revizionit të Norvegjisë (NAON), krijoi kornizë formale për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe shkëmbimin e përvojave dhe njohurive, veçanërisht në fushat e revizionit të suksesit dhe revizionit të TI-së, zbatimit të metodave inovative në revizionin, avancimit të praktikave dhe kapaciteteve të revizorit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në vitin 2025, u zbatuan më shumë aktivitete në bashkëpunim me Zyrën Nacionale të Revizionit të Norvegjisë, që kanë të bëjnë me:

### TI-NË DHE LABORATORIN INOVATIV

- Trajnim për revizion bazë të bazave të të dhënave Oracle – 25–27 shkurt 2025, në ESHR, Shkup;
- Punëtori për Inovacione: Përgatitja e aplikacionit për prokurime publike dhe Chatbot-it, si dhe planifikimi i hakatonit të ardhshëm – 23–25 prill 2025, Oslo, Norvegji;
- "Hakatoni i dytë në kuadër të projektit me NAON" – 12–13 qershor 2025, në ESHR, Shkup;
- Trajnim TI-së për bazat e testimit të sigurisë "pen testing" – në kuadër të bashkëpunimit me OAGN, 15–19 shtator 2025, Vlorë, Shqipëri;
- Punëtori për laboratorin e të dhënave (datalab) – 17–19 tetor 2025, në ESHR, Shkup;
- Trajnim për revizion të TI-së – trajnim bazë për revizionin e rrjeteve – 1–5 dhjetor 2025, Oslo, Norvegji.

Këto aktivitete dhe ngjarje paraqesin hap të rëndësishëm në transformimin digjital dhe modernizimin e ESHR-së, përmes forcimit të kapaciteteve të revizionit të TI-së, zbatimit të mjeteve bashkëkohore teknologjike dhe zhvillimit të qasjeve inovative në punën e revizionit.

Veçanërisht i rëndësishëm është Hakatoni i dytë, i cili paraqiti platformë për kreativitet, punë ekipore dhe zbatim praktik të ideve inovative, duke u mundësuar revizorëve të marrin pjesë aktive në zhvillimin e zgjidhjeve digjitale për përmirësimin e proceseve revizore dhe komunikimit me publikun.

Riksrevisjonen

Përmes bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Revizionit të Norvegjisë dhe institucionet e tjera partnere, ESHR i avancon njohuritë teknike dhe ato nga siguria kibernetike, krijon bazë për zhvillimin e laboratorit për të dhëna dhe inovacione, zbatimin e inteligjencës artificiale, revizioneve të avancuara të TI-së dhe shkëmbimit rajonal të ekspertizës, me ç'rast nxitet zhvillimi i ESHR-së si institucion suprem modern, inovativ dhe teknologjikisht i përgatitur i revizionit.

### REVIZIONET E SUKSESIT

Në kuadër të aktiviteteve për rritjen e njohurive dhe aftësive të punonjësve të ESHR-së në fushën e revizionit të suksesit si dhe shkëmbimin e përvojave të ndërsjella, u organizua:

- Punëtori për mësimet e nxjerra nga revizionet e suksesit të realizuara me mbështetjen e Zyrës Kombëtare të Revizionit të Norvegjisë – 6–8 maj 2025, në ESHR, Shkup.

Ky aktivitet paraqet mekanizëm të rëndësishëm për mësim institucional dhe avancim të revizionit të suksesit përmes analizës sistematike të përvojave të fituara nga bashkëpunimi ndërmjet ESHR-së dhe Zyrës Kombëtare të Revizionit të Norvegjisë.

### REVIZIONET E RREGULLSHMËRISË

- Punëtori për planifikimin e revizionit të rregullshmërisë së NOMAGAS, me mbështetjen e NAON – 23–27 qershor 2025, Oslo, Norvegji;
- Punëtori për realizimin e revizionit të rregullshmërisë së NOMAGAS, me mbështetjen e NAON – 22–26 shtator 2025, në ESHR, Shkup.

Këto aktivitete paraqesin aktivitet të rëndësishëm për avancimin e revizionit të rregullshmërisë. Nëpërmjet sesioneve të përbashkëta të punës, shkëmbimit të qasjeve metodologjike dhe përvojave praktike, ekipet revizore patën mundësi t'i krahasojnë dhe avancojnë praktikat e tyre në planifikimin, zbatimin dhe raportimin e revizioneve, si dhe në zbatimin e mjeteve bashkëkohore për analizën e të dhënave, përcaktimin e materialitetit, përzgjedhjen e mostrës dhe konstatimin e parregullsive. Ky bashkëpunim kontribuon në zhvillimin e revizioneve cilësore, relevante dhe me ndikim, si dhe në zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave profesionale të ESHR-së.

## PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE TË PROJEKTIT DHE TAKIMI VJETOR

Në kuadër të aktiviteteve për përcaktimin dhe raportimin e aktiviteteve në kuadër të projektit në nivel vjetor, u zhvilluan ngjarjet e mëposhtme:

- Vizita e koordinatorit të projektit nga NAON për koordinimin e aktiviteteve të projektit – 17 shkurt 2025, në ESHR, Shkup;
- Takimi vjetor i projektit për bashkëpunim me Zyrën Nacionale të Revizionit të Norvegjisë -26-27 maj, Osllo, Norvegji;
- Misioni për planifikimin e aktiviteteve të projektit- 17-19 tetor 2025, në ESHR, Shkup.

Takimet për planifikimin e aktiviteteve të projektit dhe takimi vjetor me Zyrën Nacionale të Revizionit të Norvegjisë mundësojnë koordinimin e prioriteteve, vlerësimin e rezultateve të deritanishme dhe përcaktimin e drejtimeve të ardhshme për zhvillim.

## GJYKATA E REVIZIONIT TË HOLANDËS

Netherlands Court of Audit

Bashkëpunimi rajonal me Gjykatën e Revizionit të Holandës në kuadër të Programit të Konstituencës për vitin 2025 ishte e orientuar drejt avancimit të sistemeve për menaxhimin e cilësisë në institucionet supreme të revizionit dhe forcimit të profesionalizmit, etikës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore përmes zbatimit të standardeve ISSAI 140 dhe ISSAI 150, si dhe zhvillimit të qasjeve bashkëkohore për analizën e rreziqeve, monitorimin, raportimin dhe përdorimin e burimeve teknologjike dhe inteligjencës artificiale në procesin revizor.

Punëtoria për revizione fokusuese paraqet hap të rëndësishëm drejt avancimit të metodologjive të revizionit dhe forcimit të kapaciteteve të ESHR-së përmes fitimit të njohurive dhe aftësive të reja për zbatimin me kohë, fleksibil dhe efektiv të revizioneve me interes publik, me ç'rast nxitet zhvillimi i praktikave bashkëkohore dhe proaktive të revizionit.

## ZYRA PËR LLOGARIDHËNIE E QEVERISË SË SHBA-SË

GAO U.S. GOVERNMENT ACCOUNTABILITY OFFICE

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave në lidhje me praktikat e komunikimit, ESHR mori pjesë në:

- Ngjarje online e organizuar nga Zyra për Llogaridhënie e Qeverisë së SHBA-së dhe revista e INTOSAI-t (INTOSAI Journal) – 16 shtator 2025.

Ngjarja paraqiti mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe njohjen me qasjet bashkëkohore për prezantim të qartë, të kuptueshëm dhe vizualisht efektiv të raporteve revizore dhe avancimin e komunikimit me publikun, me ç'rast nxitet kuptueshmëri dhe ndikim më i madh i gjetjeve revizore.

## GJYKATA FRANCEZE E REVIZIONIT

Cour des comptes

Bashkëpunimi bilateral me Gjykatën Franceze të Revizionit u iniciua përmes:

- Misioni për konstatimin e fakteve nga zëvendësudhëheqësi i Sektorit për çështje ndërkombëtare i Gjykatës Franceze të Revizionit – 3-4 shkurt 2025, në ESHR, Shkup..

Gjatë misionit u shkëmbyen përvoja dhe praktika të mira në fushën e revizionit, zbatimit të teknologjive të reja, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe aktiviteteve për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Ky bashkëpunim paraqiti bazë të rëndësishme për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve supreme të revizionit, ndërsa si rezultat i komunikimit dhe besimit të vendosur, në vitin 2026 u iniciuan aktivitete konkrete, ndër të cilat pjesëmarrja e një revizori nga ESHR-ja si pjesë e ekipit të Gjykatës Franceze të Revizionit në realizimin e revizionit të International Organization for Migration, inicimi i një punëtorie për parandalimin e korrupsionit, si dhe aktivitetet për nënshkrimin e Memorandumit për bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve.

## GJYKATA E REVIZIONIT TË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË

REPUBLIC OF SLOVENIA
COURT OF AUDIT

Bashkëpunimi me Gjykatën e Revizionit të Republikës së Sllovenisë në vitin 2025 u realizua nëpërmjet:

- Takimi multilateral me Kryetarin e Gjykatës së Revizionit të Sllovenisë dhe Kryerevizorin shtetëror të Maltës – 17-19 shtator 2025, në të cilin ESHR ishte nikoqire në Shkup dhe Ohër.

Takimi trilateral i punës ka rëndësi të veçantë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit bilateral ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Gjykatës së Revizionit të Republikës së Sllovenisë. Përmes shkëmbimit të përvojave dhe diskutimeve për sfidat profesionale dhe rolin e institucioneve supreme të revizionit, takimi kontribuoi në forcimin e besimit të ndërsjellë, lidhjeve profesionale dhe qasjes partnere në avancimin e praktikave revizore.

## ZYRA NACIONALE E REVIZIONIT TË MALTËS

National Audit Office
MALTA

Bashkëpunimi ndërmjet ESHR-së dhe Zyrës Kombëtare të Revizionit të Maltës gjatë vitit 2025 ishte i orientuar drejt forcimit të shkëmbimit profesional, pavarësisë së institucioneve supreme të revizionit dhe avancimit të metodologjive të revizionit. Njëkohësisht, u theksua edhe rëndësia e bashkëpunimit me palët e interesuara dhe organin ligjvënës, si parakusht për ndikim më të madh, transparencë dhe besim në punën e revizionit. Theks i veçantë iu kushtua përgatitjes dhe zbatimit të revizionit paralel përmes koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta. Takimet e punës në Maltë dhe Shkup mundësuan thellimin e bashkëpunimit institucional dhe partneritetit ndërmjet dy institucioneve supreme të revizionit.

## ZYRA SUPREME E REVIZIONIT TË REPUBLIKËS SË POLONISË

Si rezultat i procedurës së zbatuar për vlerësimin profesional të cilësisë së punës (peer review) nga Zyra Supreme e Revizionit të Republikës së Polonisë, u përgatit dhe promovua Raporti nga vlerësimi profesional i cilësisë së punës (peer review), në të cilin përmbahet **përfundimi se puna e ESHR-së është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të institucioneve supreme të revizionit, ndërsa në drejtim të arritjes së pavarësisë së plotë është dhënë rekomandim për përpjekje të mëtejshme për miratimin e draft-ndryshimeve të Kushtetutës dhe Ligjit të ri të propozuar për revizionin shtetëror, si parakusht pa të cilin Enti Shtetëror i Revizionit nuk do të mund ta ruajë progresin e arritur.**

Trajnimi i 15 të punësuarve nga ESHR-ja në qendrën trajnuese të Institucionit Suprem të Revizionit të Republikës së Polonisë paraqiti mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e metodologjive të revizionit përmes trajtimit të temave të lidhura me zgjidhjet TI-së në revizion, ndjekjen e rekomandimeve, menaxhimin e cilësisë, revizionet financiare, prokurimet publike dhe komunikimin me palët e interesuara. Trajnimi kontribuoi në zhvillimin e kompetencave profesionale të revizorëve, avancimin e metodologjisë së punës dhe thellimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet institucioneve supreme të revizionit.

## GJYKATA E REVIZIONIT TË REPUBLIKËS SË ITALISË

Bashkëpunimi bilateral me Gjykatën e Revizionit të Republikës së Italisë, i iniciuar me Memorandumin e nënshkruar për bashkëpunim, në vitin 2025 u thellua përmes:

- Vizita bilaterale e Kryetarit të Gjykatës së Revizionit të Republikës së Italisë – 25–27 mars 2025, në ESHR, Shkup.

Takimi bilateral ndërmjet Kryerevizorit shtetëror, mr. Maksim Acevski dhe Kryetarit të Gjykatës së Revizionit të Republikës së Italisë, z. Guido Karlino, paraqiti aktivitet të rëndësishëm për avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e revizionit shtetëror, transparencës dhe zhvillimit institucional. Në fokus ishin forcimi i kapaciteteve revizore, zbatimi i metodologjive bashkëkohore të revizionit, komunikimi transparent me palët e interesuara dhe avancimi i vazhdueshëm profesional, si parakushte të rëndësishme për llogaridhënie dhe besim më të madh në institucionet revizore.

## ZYRA SUPREME E REVIZIONIT E REPUBLIKËS ÇEKE

Thellimi i bashkëpunimit me Zyrën Supreme të Revizionit të Republikës Çeke, si kryesues i fundit i EUROSAI-t për periudhën 2021-2024, është me rëndësi thelbësore për ESHR-në, sepse në vitin 2025 u realizua:

- Praktikë profesionale e 15 të punësuarve nga ESHR-ja në Zyrën Supreme të Revizionit të Republikës së Çekisë – 6–10 tetor 2025, Pragë, Çeki.

Praktika profesionale paraqiti trajnim ndërkombëtar në të cilin morën pjesë përfaqësues nga ESHR-ja dhe Dhoma e Revizionit e Ukrainës. Trajnimi iu kushtua standardeve dhe praktikave bashkëkohore revizore, vlerësimit të rreziqeve, revizioneve të suksesit, përdorimit të mjeteve digjitale për analizë dhe vizualizim të të dhënave, si dhe mundësive për bashkëpunim përmes rrjetit të EUROSAI. Ngjarja mundësoi shkëmbim praktik të njohurive dhe përvojave dhe kontribuoi në modernizimin e mëtejshëm të qasjeve dhe metodologjive revizore.

## GJYKATA RUMUNE E REVIZIONIT

Takimet bilaterale ndërmjet ESHR-së dhe Gjykatës Rumune të Revizionit paraqitën hap të rëndësishëm në thellimin e bashkëpunimit institucional, veçanërisht përmes nënshkrimit të Memorandumit të ri për bashkëpunim, me të cilin hapen mundësi për revizione kooperative dhe paralele, projekte të përbashkëta, trajnime dhe avancim profesional të kuadrit revizor. Në kuadër të takimeve u shkëmbyen përvoja për digjitalizimin, zbatimin e inteligjencës artificiale dhe mjeteve bashkëkohore të komunikimit në revizion, si dhe për rolin e institucioneve supreme të revizionit në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Të dy institucionet e konfirmuan përkushtimin e përbashkët për bashkëpunim të vazhdueshëm, shkëmbim të praktikave të mira dhe zhvillim të iniciativave të përbashkëta me interes të ndërsjellë.

## ZYRA KOMBËTARE E REVIZIONIT TË BULLGARISË

Në frymën e bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Revizionit të Bullgarisë, delegacioni i ESHR-së mori pjesë në:

- Konferencën me temë „Inteligjenca artificiale dhe revizioni i TI-së në mbrojtje të resurseve publike" dhe shënimin e 145-vjetorit të themelimit dhe 30-vjetorit të rivendosjes së Zyrës Kombëtare të Revizionit të Bullgarisë – 9–10 nëntor 2025, Sofje, Bullgari.

Pjesëmarrja e ESHR-së në konferencën ndërkombëtare paraqiti mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave bashkëkohore në fushën e inteligjencës artificiale, revizionit të TI-së dhe sigurisë kibernetike. Në konferencë u diskutuan teknologjitë inovative, transformimi digjital dhe mbrojtja e resurseve publike, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet supreme të revizionit, organizatat evropiane dhe komuniteti akademik.

## GJYKATA E REVIZORËVE E MBRETËRISË SË BELGJIKËS

Vizita në Gjykatën e Revizorëve të Mbretërisë së Belgjikës paraqet hap të rëndësishëm në forcimin e pozitës ndërkombëtare dhe bashkëpunimit institucional të ESHR-së, duke mundësuar shkëmbimin e përvojave, praktikave të mira dhe metodologjive bashkëkohore revizore me një nga institucionet supreme të revizionit më të vjetra dhe më me renome në Evropë, me ç'rast theks i veçantë iu kushtua avancimit të transparencës, komunikimit me publikun dhe krijimit të partneriteteve të qëndrueshme që do të kontribuojnë drejt një revizioni më efikas dhe më të përgjegjshëm në interes të qytetarëve dhe financave publike.

## INSTITUCIONI SHTETËROR I REVIZIONIT I MALIT TË ZI

Zbatimi i revizionit paralel të suksesit me temë „Programet për detektimin e hershëm të sëmundjeve malinje" paraqet hap të rëndësishëm drejt avancimit të praktikës revizore dhe mbështetjes së politikave për mbrojtjen e shëndetit publik. Nëpërmjet takimeve të përbashkëta të punës, shkëmbimit të përvojave dhe koordinimit ndërmjet ekipeve revizore, revizioni u fokusua në efikasitetin, qasjen dhe koordinimin e programeve të skriningut për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje. Aktivitetet mundësuan harmonizimin e metodologjive, shkëmbimin e praktikave të mira dhe përgatitjen e gjetjeve dhe rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e sistemeve shëndetësore dhe sigurimin e përfitimeve më të mëdha për qytetarët e të dy shteteve. Në të njëjtën kohë, këto aktivitete e forcuan më tej bashkëpunimin institucional dhe e konfirmuan rëndësinë e revizioneve kooperative si mekanizëm për ndërtimin e kapaciteteve profesionale, transparencës dhe qasjes së përbashkët ndaj çështjeve me interes të lartë publik.

## ZYRA PËR REVIZIONIN E INSTITUCIONEVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS

Në frymën e Memorandumit të nënshkruar, bashkëpunimi me Zyrën për Revizionin e Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 2025 u forcua përmes pjesëmarrjes në:

- Vizitë bilaterale në Zyrën për Revizionin e Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës – 1–2 prill 2025, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovin;
- Konferenca për menaxhimin e cilësisë, së bashku me shënimin e jubileut 25-vjeçar të ISR-së së Bosnjës dhe Hercegovinës, e organizuar me mbështetjen e OECD/SIGMA – 7–9 tetor 2025, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovin.

Gjatë vizitës bilaterale u shkëmbyen përvoja lidhur me mundësitë për realizimin e revizioneve paralele mbi tema me interes të përbashkët, avancimin e metodologjive revizore, zhvillimin e kompetencave të revizorëve dhe shkëmbimin e praktikave të mira, me qëllim efikasitet më të madh, transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e mjeteve publike.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Në frymën e bashkëpunimit shumëvjeçar me Institucionin Suprem të Revizionit të Shqipërisë, delegacioni i ESHR-së mori pjesë në:

- Shënimi i 100-vjetorit të themelimit të Institucionit Suprem të Revizionit të Shqipërisë – 19–20 maj 2025, Tiranë, Shqipëri.

Ngjarja, në të cilën morën pjesë përfaqësues të shumë institucioneve supreme të revizionit dhe organizatave ndërkombëtare, e theksoi rëndësinë e revizionit të pavarur shtetëror si faktor kyç për demokracinë, transparencën dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar për zhvillimin e mëtejshëm të profesionit të revizionit.

## ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT TË KOSOVËS

Pjesëmarrja e ESHR-së në punëtorinë për revizionet të TI-së, të organizuar nga Zyra Kombëtare e Revizionit të Kosovës në Prishtinë, kontribuoi në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e revizionit të TI-së, sigurisë kibernetike, inteligjencës artificiale dhe transformimit digjital. Gjatë vizitës bilaterale, përmes diskutimeve për qasjet bashkëkohore revizore, përdorimin e të dhënave dhe mjeteve vizuale, revizionin e fondeve të BE-së dhe komunikimin transparent me publikun, të dy institucionet e konfirmuan përkushtimin e tyre ndaj modernizimit të praktikave revizore, zhvillimit të kompetencave profesionale dhe zhvillimit të formave të reja të bashkëpunimit bilateral dhe mësimit të përbashkët.



# 4.2 AKTIVITET E PROJEKTEVE

## 4.2.1. FONDACIONI PËR DEMOKRACI VESTMINSTER WFD

Gjatë vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit vazhdoi bashkëpunimin shumëvjeçar me WFD si partner i rëndësishëm në aktivitetet e orientuara drejt avancimit të transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit me palët e interesuara. Aktivitetet u realizuan në kuadër të programit „Praktiko demokracinë", të mbështetur nga Ambasada Britanike në Shkup.

Në kuadër të aktiviteteve të realizuara të projektit, u sigurua mbështetje për pajisjen teknike të qendrës për shtyp të ESHR-së, me ç'rast u krijuan kushte për komunikim edhe më efikas dhe më të qartë me palët e interesuara, publikun, mediat dhe të tjerët. Me vendosjen e një qendre funksionale për shtyp, u sigurua organizim i qëndrueshëm dhe ekonomik i konferencave për shtyp, punëtorive, takimeve, trajnimeve dhe ngjarjeve të tjera publike në hapësirat vetanake të ESHR-së.

Enti Shtetëror i Revizionit, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e WFD, edhe në vitin 2025, për të tretin vit me radhë, organizoi punëtori kushtuar përfshirjes së palëve të interesuara në procesin e përgatitjes së Programit vjetor të punës të ESHR-së për vitin 2026, përmes sigurimit të komunikimit të hapur dhe marrjes së propozimeve për realizimin e revizioneve. Punëtoria vazhdimisht shënon interes të madh nga organizatat qytetare, mediat dhe palët e tjera të interesuara, ndërsa një pjesë e propozimeve të dorëzuara u morën parasysh gjatë përgatitjes së Programit vjetor të punës të ESHR-së për vitin 2026, me ç'rast avancohen më tej transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja në procesin e planifikimit të revizioneve.

Gjatë vitit u sigurua edhe mbështetje ekspertësh për realizimin e revizionit të suksesit me temë „Plakja e popullsisë", në të cilin u dhanë përgjigje për çështje të rëndësishme të lidhura me përballimin e sfidave demografike.

WFD në vazhdimësi kontribuon në avancimin e praktikave të komunikimit të ESHR-së dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet kyçe dhe palët e interesuara, përfshirë edhe me Prokurorinë Publike, në drejtim të përmirësimit të llogaridhënies dhe menaxhimit të përgjegjshëm të mjeteve publike.

Vlera totale e mbështetjes së siguruar nga WFD gjatë vitit 2025 arriti në **22.000 funta britanike.**

## 4.2.2. INSTITUTI DEMOKRATIK NACIONAL (NDI)

Gjatë vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit vazhdoi bashkëpunimin me NDI përmes Programit për mbështetje parlamentare, të financuar nga Zvicra, si dhe përmes projektit „Komunitete me integritet", të financuar nga Zvicra dhe Suedia, të orientuara drejt forcimit të kapaciteteve institucionale, zhvillimit profesional të të punësuarve dhe avancimit të transparencës në punën e ESHR-së.

Në kuadër të Programit për mbështetje parlamentare u realizuan më shumë aktivitete të orientuara drejt forcimit të kapaciteteve institucionale dhe profesionale të ESHR-së, si dhe avancimit të transparencës dhe komunikimit të tij me publikun.

Në këtë drejtim, përfaqësues të ESHR-së morën pjesë në punëtori me Komisionin parlamentar për financim dhe buxhet, kushtuar menaxhimit të borxhit publik, me ç'rast u prezantuan gjendjet e konstatuara dhe rekomandimet e dhëna të përfshira në raportet përfundimtare të revizionit, me qëllim mbështetjen e mbikëqyrjes parlamentare dhe marrjes së vendimeve të bazuara në të dhëna relevante.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve për transferimin e njohurive ndërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ESHR-së, në periudhën prej 14 deri më 18 korrik 2025, u realizua „Trajnim për trajnerë". Në trajnim morën pjesë 25 përfaqësues nga të dy institucionet, të cilët avancuan aftësitë e tyre për përgatitjen, realizimin dhe evaluimin e trajnimeve, me qëllim vendosjen e një qasjeje të qëndrueshme për transferimin e njohurive dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Të gjithë pjesëmarrësit e përfunduan me sukses trajnimin dhe fituan certifikata përkatëse.

Me qëllim të avancimit të prezantimit vizual të gjendjeve të konstatuara në raportet përfundimtare të revizionit përmes vizualizimit të të dhënave dhe përmirësimit të dizajnit grafik, në vitin 2025, me mbështetjen e NDI, u organizuan punëtori për shkëmbimin e përvojave ndërmjet të punësuarve në ESHR dhe një eksperti për dizajn grafik nga Parlamenti Skocez. Në të njëjtën kohë, në kuadër të programit u sigurua vazhdimisht mbështetje ekspertësh për dizajn grafik dhe vizualizim për nevojat e ESHR-së, veçanërisht gjatë përgatitjes së raporteve përfundimtare të revizionit, Raportit vjetor për punën e ESHR-së për vitin 2024, si dhe për nevoja të tjera të ESHR-së.

Në drejtim të zbatimit më efikas të aktiviteteve të revizionit dhe forcimit të njohurive dhe aftësive të revizorëve shtetërorë, 34 të punësuar në ESHR fituan bursa për avancim profesional përmes trajnimit për Microsoft Excel të avancuar, ndërsa një i punësuar fitoi bursë për trajnim për ISO 27001:2022 etj.

Në kuadër të projektit „Komunitete me integritet", të financuar nga Zvicra dhe Suedia dhe të implementuar nga NDI, në vitin 2025 për Entin Shtetëror të Revizionit u sigurua mbështetje e orientuar drejt forcimit të kapaciteteve institucionale. Në këtë drejtim, 30 të punësuar në Entin Shtetëror të Revizionit fituan bursa për ndjekjen e trajnimit për Microsoft Excel të avancuar. Për më tepër, u sigurua donacion i pajisjeve informatike dhe softuerit të specializuar, i cili përfshiu 5 laptopë profesionalë, 5 licenca për Microsoft Office Home and Business 2024, 5 licenca për Windows 11 Pro dhe 240 licenca për Speed Momentum Tools/Sampling.

Mbështetja e siguruar kontribuoi në avancimin e njohurive dhe aftësive të të punësuarve, si dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale të Entit Shtetëror të Revizionit, me qëllim zbatimin më efikas të aktiviteteve të revizionit, në përputhje me prioritetet strategjike të institucionit.

Vlera totale e mbështetjes së siguruar nga NDI arrin në **47.992 dollarë amerikane.**

## 4.2.3. PROGRAMI I ZHVILLIMIT I KOMBEVE TË BASHKUARA – UNDP

Gjatë vitit 2025 vazhdoi bashkëpunimi ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit dhe Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), i orientuar drejt forcimit të kapaciteteve institucionale, avancimit të metodologjisë së revizionit dhe mbështetjes së proceseve reformuese në fushën e menaxhimit të financave publike.

Në kuadër të projektit „Mbështetje për reformën e menaxhimit të financave publike", përmes mbështetjes ekspertësh dhe teknike janë përgatitur më shumë dokumente dhe vegla të rëndësishme metodologjike për nevojat e Entit Shtetëror të Revizionit, ndër të cilat: **Udhëzim për revizionin e implementimit dhe ndikimit nga Strategjia kombëtare zhvillimore dhe Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Udhëzues për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni në nivel qendror dhe lokal dhe në sektorë të veçantë, si dhe Udhëzim i reviduar për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve,**, me të cilat është bërë **Ylidhja e detyrueshme e objektivave të revizioneve të suksesit dhe pajtueshmërisë me objektivat e Strategjisë kombëtare zhvillimore dhe Objektivave për zhvillim të qëndrueshëm.**

Gjatë vitit 2025 u sigurua edhe mbështetje ekspertize në drejtim të forcimit të kapaciteteve të revizorëve shtetërorë për integrimin e analizës së kostove dhe përfitimeve në revizione, si dhe në fusha të tjera të rëndësishme. Përveç kësaj, u organizua edhe një punëtori për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet ESHR-së dhe KSHPK-së.

ESHR, me përfaqësuesit e saj, mori pjesë aktive në hartimin e Strategjisë Kombëtare Zhvillimore dhe jep kontribut në ndjekjen e implementimit të saj përmes revizioneve.

Projekti rajonal „Financa të mençura për vetëqeverisje lokale të përgjegjshme" ka për qëllim të nxisë menaxhim të përgjegjshëm, transparent dhe modern në nivel lokal përmes zbatimit të mjeteve bashkëkohore financiare, analizës së të dhënave dhe zgjidhjeve inteligjente për përmirësimin e llogaridhënies dhe efikasitetit të institucioneve lokale. Projekti mundëson bashkëpunim rajonal, shkëmbim të praktikave të mira dhe qasje të përbashkët ndaj sfidave bashkëkohore në menaxhimin e mjeteve publike, me ç'rast ESHR përfshihet aktivisht në proceset e modernizimit dhe zhvillimit të qasjeve inovative në revizion dhe menaxhimin financiar në nivel lokal.

Vlera totale e mbështetjes së siguruar nga UNDP në vitin 2025 arrinte në **40.600 dollarë amerikanë.**

## 4.2.4. ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË – ZYRA PËR INSTITUCIONE DEMOKRATIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT - OSBE/ODIHR

Bashkëpunimi ndërmjet Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe Misionit të OSBE në Shkup gjatë vitit 2025 shënoi përparim të rëndësishëm, duke u fokusuar në transparencën e procesit zgjedhor dhe forcimin e kapaciteteve teknike të institucionit.

Në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë, veçojmë disa aktivitete, si më poshtë:

- Takim me vëzhguesit e OSBE/ODIHR, i mbajtur më 15 shtator 2025. Fokusi ishte vendosur në aktivitetet e ESHR-së lidhur me aktivitetet e revizionit për ligjshmërinë e financimit të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore;
- Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit më 17 shtator 2025 ndërmjet institucioneve kyçe për zbatimin e zgjedhjeve, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe demokratik dhe rritjen e besimit të qytetarëve në institucione.
- donacion i 14 kompjuterëve laptop, si pjesë e mbështetjes shumëvjeçare për digjitalizimin dhe efikasitetin e proceseve të revizionit, i siguruar nga Misioni i OSBE në Shkup; organizim i ngjarjeve dhe punëtorive që kryesisht kishin të bënin me trajnime për partitë politike dhe mediat lidhur me detyrimet e reja ligjore për dorëzimin e raporteve financiare për fushatën zgjedhore.

Për realizimin e këtyre aktiviteteve, është siguruar mbështetje e përgjithshme nga OSBE në shumën prej **17.000 euro.**

## 4.2.5. TRUPI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BARAZINË GJINORE DHE FUQIZIMIN E GRAVE – UN WOMEN

Gjatë vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit vazhdoi dhe avancoi bashkëpunimin me UN Women përmes zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara me Memorandumin për bashkëpunim, të orientuara drejt integrimit të perspektivës gjinore në proceset e revizionit dhe forcimit të kapaciteteve të ESHR-së në këtë fushë.

Në vitin 2025, me mbështetjen e UN Women, filloi revizioni i tretë kooperativ i suksesit ndërmjet ESHR-së dhe ISR-ve të Shqipërisë dhe Kosovës me temë „Gratë në pozita udhëheqëse", në të cilin ESHR është koordinatore e këtij revizioni paralel ndërkombëtar.

Gjatë vitit, UN Women siguroi mbështetje strategjike për njësinë e sapoformuar përgjegjëse për zbatimin e revizioneve gjinore në kuadër të Entit Shtetëror të Revizionit, përmes sigurimit të pajisjeve teknike në drejtim të garantimit të funksionalitetit të nevojshëm të saj. Për më tepër, dy përfaqësues nga Enti Shtetëror i Revizionit morën pjesë në trajnim të certifikuar për revizion gjinor participativ, të organizuar nga International Training Centre of the ILO në Torino, Italia. Njohuritë dhe aftësitë e fituara, të konfirmuara me certifikata përkatëse, mundësojnë zbatimin e mëtejshëm të trajnimeve për revizion gjinor, si dhe aplikimin e metodologjive të avancuara gjatë realizimit të revizioneve gjinore.

Me mbështetjen e UN Women, në periudhën prej 17 deri më 19 dhjetor 2025, ESHR organizoi punëtori treditore me temë „Integrimi i perspektivës gjinore në proceset e revizionit në sektorin publik", me qëllim forcimin e kapaciteteve të revizorëve për zbatimin e qasjeve gjinore-sensitive në punën e revizionit dhe menaxhimin e financave publike. Në punëtori morën pjesë 80 revizorë shtetërorë, të cilët

avancuan njohuritë e tyre në pesë fusha: mbrojtja sociale, vetëqeverisja lokale, mbrojtja, shëndetësia dhe sporti.

ESHR, në bashkëpunim me UN Women, edhe gjatë vitit 2025 vazhdoi me aktivitetet e orientuara drejt promovimit të rezultateve nga revizionet gjinore të suksesit të realizuara, përfshirë edhe revizionin me temë „Implementimi i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), me vështrim të posaçëm ndaj shërbimeve të specializuara për gratë viktima të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës familjare". Gjendjet e konstatuara në raportin përfundimtar të revizionit u prezantuan në një ngjarje promovuese të mbajtur më 27 nëntor 2025, në kuadër të fushatës „16 ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore", në prani të përfaqësuesve të institucioneve, ekspertëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Gjithashtu, ky raport përfundimtar i revizionit u shqyrtua edhe në kuadër të Komisionit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, në të cilin mori pjesë edhe presidentja e shtetit.

Për realizimin e aktiviteteve të lidhura me integrimin e perspektivës gjinore në revizionet e suksesit, mbështetja e siguruar nga UN Women, me mbështetje financiare nga Zvicra dhe Suedia, arrinte rreth **40.000 dollarë amerikanë.**

## 4.2.6. FONDACIONI NDËRKOMBËTAR PËR SISTEME ZGJEDHORE (IFES)

Në vitin 2025, në kuadër të „Programit për mbështetje të zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut", projekt i Qeverisë së Zvicrës, i implementuar nga IFES, qëllimi i të cilit është mbështetja e proceseve zgjedhore më inkluzive dhe demokratike përmes forcimit të institucioneve të përfshira në procesin zgjedhor dhe sigurimit të mbikëqyrjes qytetare, ESHR realizoi më shumë aktivitete të orientuara drejt avancimit të revizionit të partive politike në llogaritë e punës së rregullt dhe revizionit të pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit, u sigurua mbështetje teknike për avancimin e programeve të revizionit që përdoren gjatë revizionit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, si dhe sigurimi i trajnimit të specializuar për të punësuarit në ESHR në fushën e revizionit të partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Në bashkëpunim me Misionin e OSBE në Shkup, në të cilin ishin të përfshirë të punësuar nga Enti Shtetëror i Revizionit si trajnerë, u organizuan seri punëtorish praktike/ngjarjesh edukative për pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, me qëllim avancimin e njohurive të tyre për obligimet që lidhen me raportimin financiar për fushatat zgjedhore në prag të zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Për më tepër, ESHR mori pjesë në konferencë të përbashkët në të cilën u prezantuan gjendjet kyçe të konstatuara nga revizionet e realizuara të partive politike për vitin 2024.

Aktivitetet e realizuara kontribuan në avancimin e mëtejshëm të kapaciteteve të ESHR-së në zbatimin e revizioneve në këtë fushë, si dhe në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së financimit të partive politike dhe pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.

Mbështetja e përgjithshme e siguruar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) arrin në **15.000 euro.**



## 4.2.7. OECD – SIGMA (OECD – SIGMA)

Bashkëpunimi i Entit Shtetëror të Revizionit me OECD-SIGMA gjatë vitit 2025 ishte i orientuar drejt fillimit të aktiviteteve për përmirësimin e metodologjisë dhe kapaciteteve institucionale për realizimin e revizionit të Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit, në përputhje me kërkesat e reja ligjore dhe standardet ndërkombëtare të revizionit. Në kuadër të Programit të punës së SIGMA për vitin 2025 u sigurua mbështetje për reformat në menaxhimin e financave publike, me ç'rast në koordinim me ESHR u dakordua mbështetje për revizionin financiar të Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit në periudhën e ardhshme, në përputhje me kërkesat e Ligjit të ri për buxhete..

Si pjesë e bashkëpunimit u realizuan takime pune, konsultime dhe aktivitete ekspertize me përfaqësues të OECD-SIGMA, ndërsa u përgatit edhe një kornizë për mbështetje dyvjeçare që përfshin aktivitete për analizën e praktikave të mira nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe rajonit, përgatitjen e rekomandimeve për përmirësimin e Metodologjisë së revizionit, zhvillimin e një udhëzuesi për revizionin e Llogarisë Përfundimtare të Buxhetit, trajnime dhe mbështetje mentorimi për ekipet e revizionit, si dhe revizion pilot me zbatimin e zgjidhjeve të reja metodologjike. Si rezultat i analizës së realizuar, në hapësirat e ESHR-së u mbajt punëtori në të cilën u prezantuan përvojat evropiane dhe praktikat e mira në revizionin e raporteve të konsoliduara financiare të pushtetit qendror, me fokus të veçantë në zhvillimin e saj të ardhshëm në ESHR.

Për më tepër, ESHR mori pjesë në ngjarjen online të organizuar nga Gjykata Portugeze e Revizionit dhe OECD me temë „Përmirësimi i efikasitetit dhe transparencës së prokurimeve publike me fokus në forcimin e kornizës kontrolluese në Portugali", që paraqet ngjarje të rëndësishme kushtuar avancimit të revizionit dhe mbikëqyrjes në prokurimet publike përmes zbatimit të inteligjencës artificiale, mësimit makinerik dhe analizës së të dhënave. Përmes shkëmbimit të përvojave ndërmjet institucioneve supreme të revizionit, OECD dhe institucioneve evropiane, u theksua rëndësia e transformimit digjital dhe qasjeve bashkëkohore të revizionit për zbulim më efikas të rreziqeve, rritje të transparencës dhe përmirësim të kontrollit në menaxhimin e mjeteve publike.

## 4.2.8. BANKA BOTËRORE (WB)

Pjesëmarrja e Entit Shtetëror të Revizionit në aktivitetet e mbështetura nga Banka Botërore / World Bank (WB) paraqet hap të rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve në fushën e revizionit të borxhit publik, financave publike dhe zbatimit të politikave reformuese.

Gjatë vitit 2025, Banka Botërore vazhdoi të ofrojë mbështetje teknike për Entin Shtetëror të Revizionit në kuadër të „Projektit për Forcimin e Mbikëqyrjes, Transparencës dhe Llogaridhënies së Shpenzimeve për Investimet Publike" i financuar përmes grantit për investime në infrastrukturën e cilësisë (QII).

Projekti ishte i orientuar drejt forcimit të kapaciteteve të ESHR-së për kryerjen e revizioneve të suksesit të investimeve publike, përmes avancimit të njohurive dhe aftësive të të punësuarve, si dhe përmirësimit të cilësisë së gjetjeve dhe rekomandimeve të revizionit.









Në kuadër të aktiviteteve të projektit, është siguruar mbështetje për përgatitjen e Udhëzuesit për revizionin e suksesit të menaxhimit të investimeve publike, si aneks i Doracakut ekzistues për revizionin e suksesit të ESHR-së, i cili u finalizua në nëntor 2025.

Për më tepër, në kuadër të projektit „Mbështetje për zbatimin e revizionit të Planit të Rritjes", ESHR mori mbështetje nga Banka Botërore për përgatitjen e kornizës metodologjike për revizionin sistemor të Instrumentit për Reforma dhe Rritje të Maqedonisë së Veriut. Në bashkëpunim me Ernst & Young, u hartua dhe u miratua Udhëzuesi për revizionin e Agjendës Reformuese, si doracaku i parë i këtij lloji në rajon, ndërsa punëtoria treditore për zbatimin e revizionit të Agjendës Reformuese 2024–2027 kontribuoi në zhvillimin e metodologjive dhe mjeteve praktike për revizionin e kësaj fushe.

Përmes trajnimit në Vjenë, përfaqësuesit e ESHR-së avancuan njohuritë e tyre për vlerësimin e performancës në menaxhimin e borxhit publik dhe analizën e bazuar në dëshmi, ndërsa punëtoria në Shkup mundësoi shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për borxhin publik dhe mbikëqyrjen fiskale.

Këto aktivitete konfirmojnë përkushtimin e ESHR-së për ndjekjen e trendeve bashkëkohore, modernizimin e praktikave të revizionit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

## 4.2.7. CIPFA

CIPFA
The Chartered Institute of Public Finance & Accountancy

Gjatë vitit 2025, Enti Shtetëror i Revizionit e vazhdoi bashkëpunimin me Chartered Institute of Public Finance and Accountancy (CIPFA) dhe Centre of Excellence in Finance (CEF), të orientuar drejt forcimit të kapaciteteve institucionale të ESHR-së, zhvillimit profesional të të punësuarve dhe përmirësimit të njohurive në fushën e menaxhimit të financave publike, integritetit dhe luftës kundër korrupsionit.

Me ftesë të CIPFA, përfaqësues të Entit Shtetëror të Revizionit morën pjesë në disa konferenca ndërkombëtare dhe ngjarje profesionale, ku u shkëmbyen përvoja dhe praktika të mira në fushën e transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit të mjeteve publike.

Në kuadër të fushave të bashkëpunimit të përcaktuara me Memorandumin e bashkëpunimit, ESHR me CIPFA vazhdoi realizimin e programit për menaxhimin e rrezikut nga korrupsioni, përmes aktiviteteve të përmirësimit të vazhdueshëm profesional të orientuara drejt forcimit të kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të njohurive në fushën e integritetit, parandalimit të korrupsionit dhe menaxhimit të rreziqeve në sektorin publik.

Përfaqësues të ESHR morën pjesë edhe në programin e certifikimit „Managing Forensic Assignments in the Public Sector", të realizuar në bashkëpunim ndërmjet CEF dhe CIPFA, me qëllim përmirësimin e njohurive në fushën e revizionit forenzik, parandalimit të mashtrimeve dhe analizës së të dhënave, ku fituan certifikatën për Managing Forensic Assignments in the Public Sector.

Aktivitetet e realizuara kontribuan në forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe institucionale të Entit Shtetëror të Revizionit.

## 4.2.7. PROJEKTI I BE-së „MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR REFORMËN E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE"

Gjatë vitit 2025 filloi realizimi i projektit „Mbështetje për zbatimin e Programit për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike 2024–2027" (nr. EC-NEAR/SKP/2024/EA-RP/0064), i financuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të të cilit për nevojat e Entit Shtetëror të Revizionit u sigurua mbështetje teknike dhe ekspertizë e orientuar drejt përmirësimit të mëtejshëm të praktikave të revizionit dhe forcimit të kapaciteteve të ESHR.

Në përputhje me prioritetet dhe nevojat e identifikuara të Entit Shtetëror të Revizionit, u sigurua mbështetje e targetuar në fushën e revizionit të jashtëm, e orientuar drejt përmirësimit të metodologjisë së revizionit dhe harmonizimit me (МСС) – Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, (МСФИ) – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe (МСР) – Standardet Ndërkombëtare të Revizionit, si dhe forcimit të njohurive dhe aftësive të revizorëve shtetërorë.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit, me mbështetje të aktiviteteve për harmonizimin e Doracakut për revizionin e rregullshmërisë dhe programeve revizore për subjektet që mbajnë libra afaristë mbi bazë të gatshme, si dhe programeve revizore për subjektet që mbajnë libra tregtarë mbi bazë akruale, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Për më tepër, është siguruar mbështetje ekspertësh për zhvillimin e mjeteve metodologjike në fushën e revizionit forenzik, identifikimin e rreziqeve nga mashtrimi dhe avancimin e qasjeve për vlerësimin e rrezikut.

Fokus i veçantë iu kushtua edhe përgatitjes së institucionit për zbatimin e standardeve të reja të INTOSAI – ISSAI 140 – Kontrolli i cilësisë në ISR dhe ISSAI 150 – Kompetencat e revizorëve, përmes harmonizimit të politikave të brendshme, procedurave dhe sistemit për menaxhimin e cilësisë së revizionit me kërkesat e kornizës së re ndërkombëtare.

Në kuadër të projektit janë planifikuar më shumë trajnime, punëtori dhe konsultime profesionale me të punësuarit në Entin Shtetëror të Revizionit, me qëllim avancimin e njohurive dhe aftësive të tyre dhe sigurimin e zbatimit më cilësor dhe më efikas të revizioneve.

Aktivitetet e realizuara kontribuan në forcimin e mëtejshëm të efikasitetit institucional të Entit Shtetëror të Revizionit dhe avancimin e rolit të tij në sigurimin e menaxhimit transparent, llogaridhënës dhe ligjor të mjeteve publike, me ç'rast aktivitetet në kuadër të projektit do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2026.



# 4.3 INTEGRIMI NË BE

Në tetor 2024, Komisioni Evropian e miratoi Agjendën e Reformave të Maqedonisë së Veriut, në kuadër të Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor 2024–2027. Ky hap paraqet përparim të rëndësishëm në procesin e integrimit evropian dhe mundëson qasje në Fondin e Reformave dhe Rritjes së Bashkimit Evropian.

Në kuadër të procesit reformues, Enti Shtetëror i Revizionit do të zbatoi revizion të pajtueshmërisë së sistemit për implementim dhe kontroll për zbatimin e Instrumentit për Reforma dhe Rritje, përkatësisht Agjendës Reformuese. Në vitin 2025, Komisioni Evropian, në bashkëpunim me KPMG, filloi revizionin e sistemit për zbatimin e instrumentit. Pas përfundimit të kësaj procedure, e cila vazhdon gjatë vitit 2026, Enti Shtetëror i Revizionit do të kryejë revizion të Agjendës Reformuese në përputhje me Programin vjetor të punës të ESHR-së për vitin 2026.

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me institucionet kompetente në drejtim të parandalimit dhe zvogëlimit të korrupsionit, në kuadër të Protokollit të bashkëpunimit për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Njëkohësisht, merr pjesë në zbatimin e Programit Kombëtar për Miratimin e së Drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA), përmes aktiviteteve të parashikuara në Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore, 23.2 Politika antikorrupsion, Kapitulli 5 – Prokurimi Publik, Kapitullin 32 – Kontrolli financiar, si dhe në fushën Funksionimi i institucioneve demokratike, Fusha: funksionimi i Kuvendit në sistemin demokratik dhe fusha Procesi zgjedhor, në fushën Reforma e administratës publike, fusha: Korniza strategjike për reformën e administratës publike, si dhe në punën e trupave dhe organeve të tjera për parandalimin e korrupsionit.

Enti Shtetëror i Revizionit është pjesë e "Trupit ndërresor për koordinimin e aktiviteteve kundër korrupsionit", i cili ka për detyrë të koordinojë aktivitetet e institucioneve kompetente në luftën kundër korrupsionit, të avancojë bashkëpunimin ndërinstitucional, shkëmbimin e informatave dhe të dhënave, si dhe zbatimin e rekomandimeve të përfshira në raportet e GREKO-s pranë Këshillit të Evropës dhe organizatave të tjera relevante ndërkombëtare.



A3P



# 05

# REVIZIONET E KRYERA



Rezultatet e aktiviteteve të revizorit të përcaktuara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2025 janë të përmbajtura në pasqyrat e poshtëshënuara grafike:

## REVIZIONET PËRMES NUMRAVE
PROGRAMI VJETOR I ESHR-së PËR 2025

| Numri | Përshkrimi |
|---|---|
| 101 | Raportet e revizorit për Revizionin e Rregullshmërisë |
| 9 | Raportet e revizorit për Revizionin e Suksesit |
| 6 | Revizioni i pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit |
| 4 | Revizioni i TI-së |
| 119 | Raportet e revizorit të dorëzuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| 42 | Raportet e revizorit të dorëzuara te Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| 6 | Raportet e revizorit të dorëzuara në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në përputhje me nenin 35 të Ligjit për Revizion Shtetëror |
| 10 | Raportet e revizorit të dorëzuara në Ministrinë e Punëve të Brendshme |
| 10 | Raporte të revizorit të dorëzuara në Policinë Financiare |
| 244 | Subjektet e përfshira me revizionin |
| 1.500 | Gjetjet dhe çështjet në raportet e revizorit |
| 1.073 | Rekomandimet në raportet e revizorit |
| 542.550 | Të ardhurat publike të përfshira me revizionin (në million) |
| 287.827 | Shpenzimet publike të përfshira me revizionin (në milion) |
| 34 | Kontrollet e kryera për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizorit (follow up) |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **77** | **213.483** | **24.886** | **33** |
| Raportet e lëshuara mbi kontrollet e zbatuara për të përcaktuar statusin e rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizorit (follow up) | Aktiva / pasiva e reviduar nga Bilanci i Gjendjes (në milion) | Taksat/ kompensimet publike të papaguara/ më pak të paguara në Buxhetin e Shtetit (në milion) | Kërkesat nga shteti (në milion) |
| **3.339** | **946** | **576** | **25** |
| Kompensimet e papaguara / më pak të paguara në Buxhetin e komunave të reviduara (në milion) | Shfrytëzimi i paligjshëm i mjeteve (në milion) | Më pak të llogaritura të TVSH-së (në milion) | Tatim mbi të ardhurat personale i përllogaritur më pak (në milion) |
| **1.218** | **179** | **822** | **1.909** |
| Tatim mbi fitimin i përllogaritur më pak (në milion) | Tatime të përllogaritura më pak – kamata (në milion) | Më pak kontribute të llogaritura | Regjistrimet korrigjuese në Bilancin e Gjendjes (në milion) |
| **28.055** | **8.911** | **1.500** | **1.190** |
| Gjendjet e konstatuara që ndikojnë në veprimtarinë e subjektit që është lëndë e revizionit, detyrimet e papaguara dhe investimet kapitale (në milion) | Anulimi / ngecja e granteve të investimeve (në milion) | Provizionet e paguara / llogaritura për mjetet e patërhequra nga kreditë / huatë (në milion) | Kërkesat e parashkruara (në milion) |
| **805.932** | **4.094** | **21** | **14.906** |
| Vlera e kërkesës së padisë në procedurat gjyqësore në të cilat subjekti që është lëndë e revizionit paraqitet në rolin e të paditurit dhe të paditësit (në milion) | Shuma e procedurave të humbura gjyqësore (në milion) | Shuma e shpenzimeve të avokatëve, noterëve dhe shpenzimeve të përmbaruesve (në milion) | Efektet financiare të revizionit / mjetet e paguara gjatë revizionit / kamatat e zvogëluara (në milion) |
| **58.514** | **378.171** | **145.415** | **14.309** |
| Vlera tjetër e shtuar e revizionit / kompensimet e paguara jo në kohë (në milion) | Shuma totale e prokurimeve publike (në milion) | Përfshirja e prokurimeve publike me revizion (në milion) | Shuma totale e parregullsive të konstatuara në prokurimet publike (në milion) |
| **1.171** | **234** | | |
| Prokurimet e kryera për të cilat nuk është zbatuar procedura e prokurimeve publike (në milion) | Kërkesa të shlyera (në milion) | | |

## REVIZIONET PËRMES NUMRAVE

**120** RAPORTET E REVIZORIT

**OPINIONET E REVIZORIT - REVIZIONI I RREGULLSHMËRISË**

- **100** opinione për raportet financiare
  - **22** pa rezervë
  - **19** me rezervë
  - **57** opinione të pafavorshme
  - **2** abstenime nga opinioni
- **94** opinione për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat
  - **14** pa rezervë
  - **33** me rezervë
  - **47** opinione të pafavorshme
  - **/** abstenime nga opinioni

**KONKLUZIONET**

**REVIZIONI I PAJTUESHMËRISË / REVIZIONI I SUKSESIT**

- **6** konkluzione për revizionin e pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit
- **9** konkluzione për revizionin e suksesit
- **4** konkluzione për revizionin e TI-së

**1.500** GJETJE DHE ÇËSHTJET TË DETEKTUARA ME REVIZIONET

- **1.047** revizione të rregullshmërisë
- **239** revizione të suksesit
- **132** revizione të pajtueshmërisë
- **82** revizione të TI-së

**244** SUBJEKTE TË PËRFSHIRA ME REVIZIONET

- **52** revizione të rregullshmërisë
- **152** revizione të suksesit
- **30** revizione të pajtueshmërisë
- **5** revizione të TI-së
- **5** parti politike

**149** DOBËSI TË KONSTATUARA NË GJETJET E PROKURIMEVE PUBLIKE

**SHUMA TOTALE E PROKURIMEVE PUBLIKE**
**378.170.928**
(në 000 denarë)

**PROKURIMET E REVIDUARA PUBLIKE**
**145.415.176**
(në 000 denarë)

**14.308.603**
PARREGULLSI TË KONSTATUARA NË PROKURIMET PUBLIKE
(në 000 denarë)

**1.171.372**
PROKURIME TË KRYERA PËR TË CILAT NUK ËSHTË ZBATUAR PROCEDURA E PROKURIMIT PUBLIK
(në 000 denarë)

- dobësitë në fazën e planifikimit të prokurimeve publike
- parregullsitë në përgatitjen e dokumentacionit të tenderit
- dobësitë në fazën e realizimit të kontratave
- parregullsitë në vlerësimin e ofertave
- procedurat e pazbatuara të prokurimeve publike

* Numri i opinioneve për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret është më i vogël krahasuar me numrin e mendimeve për raportet financiare, duke pasur parasysh se në raportet përfundimtare të revizionit për revizionet e kryera të raporteve financiare dhe revizionit të pajtueshmërisë për llogaritë e të hyrave të buxhetit të dotacioneve (930) për 6 njësi të vetëqeverisjes lokale, opinioni për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret sipas shfrytëzuesve shprehet në raportet e revizionit gjatë revizionit të shfrytëzuesit përkatës të dotacioneve të dedikuara.

## TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET

GJITHSEJ 542.550 MILION DENARË të ardhura publike të reviduara dhe 287.827 MILION DENARË shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2025.

Pjesëmarrjen më të madhe në të ardhurat e reviduara e kanë Buxheti Qendror me 299.161 milion denarë (55%), Buxhetet e Fondeve me 172.744 milion denarë (32%) dhe të Ardhurat Publike të Mbuluara me Revizionet e Suksesit me 41.971 milion denarë (8%).

Struktura e shpenzimeve të reviduara përfshin shpenzimet e mbuluara me revizionet e rregullshmërisë, suksesit dhe pajtueshmërisë, ku vëllim më të madh kanë shpenzimet e Buxheteve të Fondeve me 167.031 milion denarë (58%),

Buxheti Qendror me 27.982 milionë denarë (10%), shpenzimet publike të përfshira me revizionet e pajtueshmërisë si revizione të veçanta në vlerë prej 40.178 milionë denarë (14%) dhe me revizionet e suksesit në vlerë prej 26.472 milionë denarë (9%).

Krahasuar me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2023, u arrit rritja e konsiderueshme e të ardhurave publike të reviduara në shumën totale prej 82.490 milion denarë (23%), veçanërisht në:

- buxhetin qendror për 34.813 milion denarë, përkatësisht 13% më shumë se vitin e kaluar;
- buxhetet e fondeve për 23.528 milion denarë, ose 16% më shumë se vitin e kaluar
- buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale për 2.207 milionë denarë, përkatësisht 31% më shumë krahasuar me vitin e kaluar;
- ndërmarrjet e tjera publike, institucionet e tjera të financuara nga mjetet publike dhe personat juridikë në të cilët shteti është aksionar dominues për 14.059 milion denarë, të cilat janë reviduar për 742% më shumë se vitin e kaluar.
- të hyra publike të përfshira me revizionet e suksesit në vlerë prej 18.616 milionë denarë, përkatësisht 80% më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

Në krahasim me Programin Vjetor të Punës të ESHR-së për vitin 2025, është realizuar një rritje e konsiderueshme e shpenzimeve publike të revizionuara në shumën e përgjithshme prej 60.053 milionë denarësh (26%), veçanërisht te:

- buxhetet e fondeve për 21.668 milion denarë, përkatësisht 15% në krahasim me vitin e kaluar;
- buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale për 5.187 milionë denarë, përkatësisht 42% më shumë krahasuar me vitin e kaluar;
- ndërmarrjet e tjera publike, institucionet e tjera të financuara nga mjetet publike dhe personat juridikë në të cilët shteti është aksionar dominues për 8.972 milion denarë, gjegjësisht 186% në krahasim me vitin e kaluar.
- shpenzime publike të përfshira me revizionet e suksesit në vlerë prej 18.170 milionë denarë, përkatësisht 219% më shumë krahasuar me vitin e kaluar;
- shpenzime publike të përfshira me revizionet e pajtueshmërisë si revizione të veçanta në vlerë prej 40.175 milionë denarë, përkatësisht 13.393 herë më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

## TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË REVIDUARA

GJITHSEJ **542.550 MILION DENARË** të ardhura publike të reviduara dhe **287.827 MILION DENARË** shpenzime publike të reviduara me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2025.



Mbulimi i shpenzimeve të reviduara të Buxhetit të RMV-së për vitin 2024 arrin në 65%. Në strukturën e shpenzimeve të reviduara, janë përfshirë shpenzime me revizionet e rregullsisë në vlerë prej 197.188 milionë denarë, përkatësisht 87%, si dhe shpenzime me revizionet e suksesit dhe të pajtueshmërisë, të zbatuara në përputhje me Programet Vjetore të Punës të ESHR-së për vitet 2024 dhe 2025, në vlerë të përgjithshme prej 29.097 milionë denarësh, përkatësisht 13%.

## MBULIMI I BUXHETEVE PËRMES SHPENZIMEVE TË REVIDUARA

| Shpenzimet e reviduara sipas llojeve të buxheteve (në milion denarë) | Realizimi i buxhetit për vitin 2024 | I reviduar | Pjesëmarrja në % |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| **Shpenzimet e Buxhetit të RMV-së për vitin 2024** (Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të RMV-së për vitin 2024, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 151/2025) | 347.454 | 226.285 | 65 |
| **Buxhetet e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale** | 47.862 | 8.947 | 19 |

# 2025


1.073
TOTALI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA
350 REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DORËZIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
723 REKOMANDIMET PËR TË CILAT NUK KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONEVE KTHYESE
106 REKOMANDIMET PËR TË CILAT NUK ËSHTË PËRCAKTUAR STATUSI PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DORËZIMIN E INFORMACIONIT KTHYES
86% VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE
244 REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR
209 REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT
35 nuk janë të zbatuar
/ Të pazbatueshme

## 2024

**889** REKOMANDIME TË DHËNË

889 REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

142 REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

**76 %** VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

**747** REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR

569 REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT

158 nuk janë të zbatuar

20 Të pazbatueshme

## 2023

**697** REKOMANDIME TË DHËNË

697 REKOMANDIMET PËR TË CILAT KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

**69%** VEPRUAR SIPAS REKOMANDIMEVE

**616** REKOMANDIMET ME STATUS TË PËRCAKTUAR

81 REKOMANDIMET PËR TË CILAT STATUSI NUK ËSHTË PËRCAKTUAR PAVARËSISHT SE KA KALUAR AFATI PREJ 90 DITË PËR DËRGIMIN E INFORMACIONIT KTHYES

423 REKOMANDIMET SIPAS TË CILAVE JANË NDËRMARRË MASAT

178 nuk janë të zbatuar

15 Të pazbatueshme

# 5.1 VLERA E SHTUAR NGA REVIZIONET




Programi Vjetor i Punës i ESHR-së për vitin 2025 përcakton aktivitetet prioritare në dejtim të arritjes së qëllimeve dhe detyrave të ESHR-së, përkatësisht arritjen e qëllimeve strategjike të institucionit.

Aktivitetet e ndërmarra për t'i arritur qëllimet strategjike sigurojnë mbulim adekuat të mjeteve publike të reviduara, rrisin njohuritë dhe aftësitë e punonjësve, kryejnë revizion të suksesit të programeve dhe projekteve të ndryshme që janë në funksion të arritjes së llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë, shqyrtojnë rezultatet në aspektin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të sektorit publik, informojnë palët e interesuara dhe publikun rreth gjendjeve të konstatuara në raportet përfundimtare të revizorit dhe përmirësojnë cilësinë e shërbimeve që sektori publik është i detyruar t'u ofrojë personave juridikë dhe fizikë. Rezultatet kryesore të punës së ESHR-së për vitin 2025 pasqyrohen në:

- mbështetjen e Kuvendit në përmbushjen e kompetencave të tij nëpërmjet identifikimit dhe prezantimit të parregullsive, rasteve të punës së paligjshme dhe rasteve të mundshme të korrupsionit dhe abuzimit të mjeteve publike;
- dhënia e kontributit në realizimin e qëllimeve të përcaktuara të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit, e cila është një dokument gjithëpërfshirës për zhvillimin ekonomik, social, mjedisor dhe kulturor të shtetit tonë në 20 vitet e ardhshme dhe i pasqyron aspiratat, pritjet dhe perceptimet për një shoqëri më të zhvilluar ekonomikisht dhe mirëqenie më të madhe për qytetarët;
- dhënia e kontributit në realizimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara – Agjenda 2030;;
- dhënia e kontributit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe ndërmarrja e veprimeve për njoftim dhe bashkëpunim me organet kompetente lidhur me rreziqet e mundshme ose të zbuluara, dyshimet, veprimet dhe transaksionet e paligjshme të konstatuara gjatë kryerjes së revizioneve, të cilat tregojnë për konflikte të mundshme interesi, korrupsion dhe mashtrim;
- ofrimin e rekomandimeve të qarta dhe efektive institucioneve shtetërore dhe institucioneve të tjera të sektorit publik për të avancuar menaxhimin e mjeteve publike;
- ofrimin e kontributit në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në shfrytëzimin e mjeteve publike / mjeteve të tatimpaguesve, dhe në këtë mënyrë edhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve me respektimin e parimeve të sigurisë në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit, transparencës, disponueshmërisë dhe shërbimit universal, mbrojtjes së përdoruesve dhe qytetarëve;
- konstatimin e gjendjeve të evazionit tatimor, mospagesës së taksave dhe kompensimeve në Buxhetin e shtetit, me çka ESHR-ja siguron kthimin e mjeteve të investuara nga Buxheti në ESHR;
- konstatimi i rasteve të evazionit tatimor, mospagesës së detyrimeve dhe kompensimeve publike në Buxhetin e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të Qytetit të Shkupit, me ç'rast ESHR siguron kthimin e mjeteve të investuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qyteti i Shkupit;
- revizionin e dhënies së kontratave dhe realizimi i prokurimeve publike;
- dhënien e udhëzimeve mbi mënyrën e planifikimit të investimeve kapitale, sigurimin e mjeteve të nevojshme dhe ndjekjen e realizimit të tyre në nivel qendror dhe lokal (me vështrim të veçantë për mjetet e siguruara nga kreditorët ndërkombëtarë), dhe përcaktimin e efekteve të investimeve të lartpërmendura;
- ndjekjen e servisimit të borxhit publik dhe kontributin në mënyrën e menaxhimit të financave publike.

| | |
|---|---|
| Aktiva / pasiva e reviduar nga Bilanci i Gjendjes (në miliona) | 213.483 |
| Taksat / kompensimet publike të papaguara / më pak të paguara në Buxhetin e Shtetit (në miliona) | 24.886 |
| Kërkesat nga shteti (në miliona) | 33 |
| Kompensimet e papaguara / më pak të paguara në Buxhetin e komunave të reviduara (në miliona) | 3.339 |
| Shfrytëzimi i paligjshëm i mjeteve (në miliona) | 946 |
| Më pak TVSH të llogaritur (në miliona) | 576 |
| Tatim mbi të ardhurat personale i përllogaritur më pak (në miliona) | 25 |
| Tatim mbi fitimin i përllogaritur më pak (në miliona) | 1.218 |
| Tatime të përllogaritura më pak – kamata (në miliona) | 179 |
| Më pak kontribute të llogaritura (në miliona) | 822 |
| Regjistrimet korrigjuese në Bilancin e Gjendjes (në miliona) | 1.909 |
| Gjendjet e konstatuara që ndikojnë në veprimtarinë e subjektit që është lëndë e revizionit, detyrimet e papaguara dhe investimet kapitale (në miliona) | 28.055 |
| Anulimi / ngecja e granteve të investimeve (në miliona) | 8.911 |
| Provizionet e paguara / llogaritura për mjetet e patërhequra nga kreditë / huatë | 1.500 |
| Kërkesat e parashkruara (në miliona) | 1.190 |
| Kërkesa të shlyera (në miliona) | 234 |
| Vlera e kërkesës së padisë në procedurat gjyqësore në të cilat subjekti që është lëndë e revizionit paraqitet në rolin e të paditurit dhe të paditësit (në miliona) | 805.932 |
| Shuma e procedurave të humbura gjyqësore (në miliona) | 4.094 |
| Shuma e shpenzimeve të avokatëve, noterëve dhe shpenzimeve të përmbaruesve (në miliona) | 21 |
| Efektet financiare të revizionit / mjetet e paguara gjatë revizionit / kamatat e zvogëluara (në miliona) | 14.906 |
| Vlera tjetër e shtuar e revizionit / kompensimet e paguara jo në kohë (në miliona) | 58.514 |
| shuma totale e prokurimeve (në miliona) | 378.171 |
| Fushëveprimi i prokurimeve publike me revizion (në miliona) | 145.415 |
| Shuma totale e parregullsive të konstatuara në prokurimet publike (në miliona) | 14.309 |
| Prokurimet e kryera për të cilat nuk është zbatuar procedura e prokurimeve publike (në miliona) | 1.171 |
| Detyrime të paraqitura më pak (në miliona) | 4.671 |

# 5.2. REVIZIONET E KRYERA

## 5.2.1. BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

### BUXHETI THEMELOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2024

Menaxhimi i financave publike është baza e zbatimit të politikave të shtetit, në drejtim të sigurimit të rritjes më të lartë ekonomike dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës së qytetarëve. Ministria e Financave, si një nga bartësit kyç të procesit të përgatitjes, miratimit, menaxhimit dhe realizimit të buxhetit të shtetit, përmes planifikimit afatmesëm, i orienton aktivitetet drejt sigurimit të stabilitetit financiar dhe makroekonomik dhe qëndrueshmërisë fiskale të ekonomisë.

Strategjia fiskale, si dokument i rëndësishëm strategjik, përcakton qëllimet dhe politikat më të rëndësishme për veprim, si dhe projeksionet makroekonomike dhe fiskale afatmesme, përmes të cilave do të vendosej lidhja ndërmjet prioriteteve të përcaktuara strategjike dhe burimeve të disponueshme të financimit, pra Buxhetit. Në të njëjtën kohë, udhëzimet dhe politikat në strategjinë fiskale përfaqësojnë bazën për projeksionet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve publike, me qëllim forcimin e disiplinës fiskale dhe shpërndarjen e përshtatshme të mjeteve të disponueshme, në përputhje me prioritetet strategjike.

Përgatitja dhe miratimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 është bërë në kuadër të afateve të përcaktuara me ligj, me një vonesë të vogël gjatë miratimit të Vendimit për prioritetet strategjike për vitin 2024 dhe dorëzimit të Propozim-buxhetit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për miratim.

Planifikimin e mjeteve të nevojshme, përdoruesit e buxhetit e kryejnë përmes kërkesave buxhetore që i dorëzojnë në Ministrinë e Financave. Analiza e kërkesave buxhetore nga 31 përdorues buxhetorë tregoi se, edhe pse ka përmirësim në plotësinë e kërkesave të dorëzuara krahasuar me vitin 2023, vazhdon praktika që ministria të përgatisë propozim-buxhet për një numër të caktuar përdoruesish buxhetorë.

Të ardhurat dhe shpenzimet e Buxhetit Themelor për vitin 2024 janë projektuar në shumën prej 260.113.617 mijë denarë dhe shënojnë ulje krahasuar me vitin 2023, por në raport me shumat maksimale të mjeteve/shpenzimeve të miratuara, ato janë më të larta. Përveç kësaj, me ribalancin e Buxhetit të muajit gusht dhe vendimin për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet përdoruesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe fondeve në dhjetor 2024, Buxheti Themelor për vitin 2024 arrin në 265.418.639 mijë denarë, krahasuar me vitin 2023, është rritur për 1%.

Vazhdon të ekzistojë nevoja për forcimin e procedurës së harmonizimit të propozimeve të kërkesave buxhetore ndërmjet Ministrisë së Financave dhe përdoruesve buxhetorë, me qëllim minimizimin e rrezikut që mjetet e planifikuara të mos pasqyrojnë nevojat reale të përdoruesve buxhetorë, si dhe për nevojën e informimit të Qeverisë mbi arsyet e mospërputhjes së mjeteve të kërkuara dhe të miratuara për përdoruesit buxhetorë.



## SHUMAT MAKSIMALE TË SHPENZIMEVE, MJETET E KËRKUARA, TË MIRATUARA DHE TË REALIZUARA TË SHFRYTËZUESVE BUXHETORË NGA BUXHETI THEMELOR PËR VITIN 2024




| | |
|---|---|
| Shuma maksimale e shpenzimeve | 186.115.230 |
| Mjetet e kërkuara nga përdoruesit buxhetorë | 289.042.374 |
| Mjetet e miratuara nga Buxheti Themelor i RMV-së | 260.113.617 |
| Mjetet e miratuara nga Buxheti Themelor i RMV-së dhe Vendimet për rishpërndarje | 265.418.639 |
| Mjetet e realizuara nga përdoruesit buxhetorë | 261.716.782 |

në 000 denarë

Devijimi më i madh ndërmjet shumës maksimale të përcaktuar të shpenzimeve dhe mjeteve të miratuara është konstatuar në seksionin për Qeverinë dhe Byronë për Zhvillim Rajonal.

Edhe me Buxhetin Themelor për vitin 2024 nuk janë siguruar mjetet e parashikuara me ligj për Pushtetin Gjyqësor, Prokurorinë Publike dhe zhvillimin e barabartë rajonal, të parashikuara me Ligjin për buxhetin gjyqësor, Ligjin për Prokurorinë Publike dhe Ligjin për zhvillimin e barabartë rajonal. Me analizën për vitin 2024 konstatuam se:

## PUSHTETI GJYQËSOR




| | |
|---|---|
| 7.181.552 | SHUMA LIGJORE |
| 2.765.500 | SHUMAT MAKSIMALE E SHPENZIMEVE -637 |
| 4.147.960 | KËRKESAT BUXHETORE |
| 2.647.694 | BUXHETI I PËRGJITHSHËM |

në 000 denarë

## PROKURORIA PUBLIKE




**1.554.764**
SHUMA LIGJORE

**753.356**
SHUMAT MAKSIMALE E SHPENZIMEVE -637

**1.229.240**
KËRKESAT BUXHETORE

**811.655**
BUXHETI I PËRGJITHSHËM

në 000 denarë

Për realizimin e nënprogramit për zhvillim të barabartë rajonal duhet të sigurohet të paktën 1% e BPV-së, ndërsa përmes Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale dhe Byrosë për Zhvillim Rajonal janë siguruar vetëm 0,08% e BPV-së, ose 0,01% më pak krahasuar me vitin 2023.

Përmes programeve që realizohen nga disa institucione, këto mjete arrijnë deri në 1% të BPV-së për vitin 2023.

Sipas Ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, Ministria e Financave ka detyrimin të kryejë transferimin e mjeteve në llogarinë e AVRM-së në një Fond të veçantë të formuar për përmirësimin e kushteve për punësimin dhe punën e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim financimin e aktiviteteve për përmirësimin e kushteve të punësimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara. Konstatuam se ministria nuk ka kryer transfere të mjeteve në Fondin e Veçantë, dhe e njëjta gjë është konstatuar edhe në Raportet Përfundimtare për revizionet e kryera të rregullshmërisë së Agjencisë për Punësim të RMV-së në vitet e kaluara.

Rregullat e reja fiskale, në përputhje me nenin 10 të Ligjit të ri për buxhete, duke filluar nga 1 janari 2023, parashikojnë:

- **deficiti i pushtetit të përgjithshëm** (institucionet që klasifikohen në Sektorin Shtet (S.13), sipas Klasifikimit Kombëtar të sektorëve institucionalë të Entit Shtetëror të Statistikave) për vitin përkatës nuk duhet të kalojë nivel prej 3% të BPV-së nominale,
- **borxhi total i pushtetit të përgjithshëm** nuk duhet të kalojë nivelin prej 60% të BPV-së nominale dhe
- **borxhi publik i garantuar** nuk duhet të kalojë 15% të BPV-së nominale.




**Deficiti buxhetor** në nivel të Buxhetit Qendror, sipas indikatorëve makroekonomikë të publikuar nga Ministria e Financave për vitin 2024, **arrin në 4,4% të BPV-së dhe është më i ulët krahasuar me vitin 2023** kur ishte 4,8% e BPV-së. I njëjti është më i lartë se niveli i përcaktuar me ligj në Strategjinë Fiskale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2024-2028, ku është projektuar në 3,4% të BPV-së.

## PJESËMARRJA PROCENTUALE E DEFICITIT BUXHETOR NË BPV PËR PERIUDHËN 2015-2024




**Të ardhurat dhe të hyrat totale** në vitin 2024 u realizuan në shumën prej 294.025.256 mijë denarë, 13% më shumë krahasuar me vitin 2023.

## TË ARDHURAT DHE TË HYRAT TOTALE NË BUXHETIN THEMELOR NË VITIN 2024

në 000 denarë

| LLOJET E TË ARDHURAVE | 2024 | 2023 | 2024/2023 |
|---|---|---|---|
| Të ardhura tatimore | 174.457.425 | 154.405.427 | 13% |
| Të ardhura jotatimore | 7.110.999 | 6.780.481 | 5% |
| Të ardhurat kapitale | 1.829.374 | 2.060.314 | 11% |
| Transfertat dhe donacionet | 10.743.870 | 14.651.839 | 27% |
| Huamarrja e brendshme | 55.529.371 | 36.156.026 | 54% |
| Huamarrje jashtë vendit | 42.975.791 | 44.795.663 | 4% |
| Të ardhura nga shlyerja e huasë | 1.378.426 | 1.275.378 | 8% |
| GJITHËSEJ: | 294.025.256 | 260.125.128 | 13,03% |

Struktura e Buxhetit për vitin 2024 tregon se të ardhurat tatimore edhe në vitin 2024 kanë pjesëmarrje të madhe në strukturën e të ardhurave të buxhetit themelor, gjë që nënkupton përmirësim të strukturës financiare.

## STRUKTURA E BUXHETIT SIPAS TË ARDHURAVE DHE TË HYRAVE




Në vitin 2024, tek të gjitha llojet e të ardhurave tatimore është vërejtur rritje krahasuar me vitin 2023, përveç tek taksat e veçanta njëhereshe.

## REALIZIMI I TË ARDHURAVE TATIMORE



Nga tatimi i solidaritetit gjatë vitit 2024 janë arkëtuar të ardhura në shumën prej 88.858 mijë denarë, që është 97% më pak krahasuar me vitin 2023, për shkak se u vendos si detyrim njëherësh në shtator të vitit 2023 me qëllim përballimin e krizës së Kovid-19 dhe masave të tjera antikrizë, dhe pjesa më e madhe e të ardhurave u arkëtua nga personat juridikë gjatë vitit 2023. Në shkurt të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Vendim e anuloi Ligjin për tatimin e solidaritetit, për shkak të efektit retroaktiv të Ligjit, pra shkeljes së sundimit të ligjit, parashikueshmërisë juridike dhe sigurisë juridike si parime themelore. Për këtë arsye, ministria duhet të kryejë kthim të mjeteve tek kompanitë që kanë kryer pagesa mbi bazën e tatimit të solidaritetit, në shumën totale prej 3.031.838 mijë denarë ose 49.138.000 euro.

Totali i hyrjeve nga **huamarrja brenda vendit dhe jashtë** në vitin 2024 merr pjesë me 33,5% në të ardhurat totale të Buxhetit Themelor dhe shënon rritje prej 2,5% krahasuar me pjesëmarrjen e tyre në të ardhurat totale të Buxhetit Themelor për vitin 2023.

## HUAMARRJA E BRENDSHME DHE E JASHTME




Hyrjet nga huamarrja brenda vendit marrin pjesë me 56% në hyrjet totale mbi bazën e huamarrjes së shtetit dhe shënojnë rritje të pjesëmarrjes së tyre në strukturën e huamarrjes krahasuar me vitin 2023 kur ajo ishte 45%, ndërsa hyrjet e realizuara mbi bazën e huamarrjes jashtë vendit në shumën prej 42.975.791 mijë denarë janë 4% më pak krahasuar me vitin 2023.

**Shpenzimet dhe daljet totale të Buxhetit Themelor për vitin 2024** arrijnë në 261.716.782 mijë denarë dhe janë 5% më të larta krahasuar me vitin 2023. Raporti ndërmjet shpenzimeve dhe daljeve të realizuara dhe të planifikuara sipas llojeve për vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

## SHPENZIMET DHE DALJET NGA BUXHETI THEMELOR 2022-2024




## STRUKTURA E SHPENZIMEVE DHE DALJEVE TË BUXHETIT THEMELOR PËR VITIN 2024



Struktura e burimeve të mjeteve nga të cilat **Fondi i SPIMV-së** siguron shumat e nevojshme për pagesën e pensioneve dhe në vitin 2024 nuk shënon përmirësim krahasuar me vitet 2023 dhe 2022. Për mbulimin e deficitit të fondit pensional nga Buxheti Themelor janë paguar 23.119.600 mijë denarë, gjegjësisht 26% të mjeteve totale të Fondit për pagesën e pensioneve.

## STRUKTURA E BURIMEVE TË MJETEVE PËR PAGESAT E PENSIONEVE

| | Transfere nga Buxheti bazë – rezervë ligjore | Transfere nga Buxheti bazë – deficit për pagesën e pensioneve | Mjetet e Fondit për SPI (Sigurimi Pensional dhe Invalidor) |
|---|---|---|---|
| 2022 | 13.737.350 | 14.850.580 | 38.981.370 |
| 2023 | 14.863.260 | 16.515.500 | 46.586.560 |
| 2024 | 19.354.459 | 23.119.600 | 48.172.481 |

Drejt **NJVL** mbi bazën e **transfereve të rregullta** gjatë vitit 2024 janë paguar 30.781.183 mijë denarë ose 12% të shpenzimeve totale të Buxhetit Themelor, të cilat krahasuar me vitin 2023 shënojnë rritje prej 12%, nga këto, 84% i takojnë granteve bllok, 14% granteve nga TVSH-ja, dhe 2% granteve të dedikuara.

**Shpenzimet kapitale** në Buxhetin Themelor për vitin 2024 u realizuan në shumën prej 21.435.177 mijë denarë, që është 8,19% i shpenzimeve totale të Buxhetit Themelor. Shpenzimet kapitale, duke filluar nga viti 2020 deri në vitin 2023, kanë trend të rritjes nga viti në vit, por në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, shpenzimet kapitale janë zvogëluar.

### REALIZIMI I SHPENZIMEVE KAPITALE




| | |
|---|---|
| 2020 | **11.160.896** |
| 2021 | **16.802.886** |
| 2022 | **22.360.256** |
| 2023 | **37.649.990** |
| 2024 | **21.435.177** |

në 000 denarë

Struktura e Shpenzimeve Kapitale është paraqitur në grafikonin si vijon:

## STRUKTURA E SHPENZIMEVE KAPITALE NË VITIN 2024




Pjesëmarrjen më të madhe e kanë shpenzimet për blerjen e pajisjeve dhe makinerive me 28,09%, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël e kanë shpenzimet për blerjen e mobilieve me 0,04% dhe blerjen e automjeteve me 0,28%.

Shpenzimet për **investime dhe mjete jofinanciare** në vitin 2024 arrijnë në 5.980.715 mijë denarë dhe, krahasuar me vitin 2023, janë zvogëluar për 34,59%. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve, në shumë prej 4.826.295 mijë denarë ose 81%, ka të bëjë me garancitë e paguara për ndërmarrjet publike për borxhin e jashtëm të papaguar ndaj kreditorëve të huaj:

- 90% për NP për Rrugë Shtetërore për Projektin e ndërtimit të autostradës në segmentin Kërçovë–Ohër, Projektin e ndërtimit të autostradës në segmentin Milladinovc–Shtip dhe për Programin e rrugëve nacionale – për këstin e parë dhe të dytë,
- 8% për HRMV-së Transport për Projektin e furnizimit me mjete të reja tërheqëse dhe
- - 2% për NQP Shkup për realizimin e Projektit për furnizimin me autobusë për Shkup.

**Subvencionet kapitale për ndërmarrjet** janë realizuar në shumën prej 5.310.133 mijë denarë ose 24,77%, nga të cilat 4.100.000 mijë denarë përmes Ministrisë së Transportit, nënprogrami 2M – Investime përmes infrastrukturës rrugore, janë paguar ndaj Ndërmarrjes Publike për ndërtimin e Korridorit infrastrukturor 8 (segmenti Tetovë – Gostivar – Bukojçani dhe Projekti për autostradën Trebenishtë – Strugë – Qafasan) dhe Korridorit 10D (segmenti i autostradës Prilep – Manastir).

**Borxhi shtetëror** si shumë e detyrimeve financiare të krijuara nga huamarrja e shtetit, institucioneve publike të themeluara nga shteti dhe komunave, duke mos përfshirë borxhin e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive

tregtare që janë në pronësi të plotë ose dominuese të shtetit, komunave dhe të Bankës Popullore, më 31.12.2024 arrin në 8.298.000.000 euro dhe, krahasuar me borxhin shtetëror më 31.12.2023 (7.256.200.000 euro), është rritur për 1.041.800.000 euro. Gjendja e borxhit shtetëror më 31.12.2024 arrin në 53,8% të BPV-së dhe është rritur krahasuar me vitin 2023.

**Borxhi publik,** si shumë e borxhit shtetëror dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë në pronësi të plotë ose dominuese të shtetit ose të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit, më **31.12.2024** sipas të dhënave të Ministrisë së Financave arrin në 9.619.000.000 euro dhe, krahasuar me borxhin publik më 31.12.2023 (8.477.000.000 euro), është rritur për 1.142.000.000 euro. Gjendja e borxhit publik në raport me BPV-në më 31.12.2024 arrin në 62,4% dhe është rritur krahasuar me vitin 2023.

## GJENDJA E BORXHIT SHTETËROR DHE PUBLIK SI PËRQINDJE E PJESËMARRJES NË BPV-NË 2015-2024




Burimi: Ministria e Financave, të dhënat e publikuara më datë 26.05.2025

Të dhënat e dorëzuara nga Ministria e Financave për realizimin e projekteve që financohen me mjete nga huatë, shpenzimet që krijohen për realizimin e tyre, si dhe ndikimi i tyre në arritjen e qëllimeve investuese në periudhat e ardhshme, tregojnë për përdorim jo të duhur të mjeteve dhe gjenerim të shpenzimeve të paparashikuara:

## PASQYRË E HUAMARRJES ME HUA/GRANTE, MJETET E PËRGJITHSHME TË TËRHEQURA DHE TË PATËRHEQURA DHE SHPENZIME PËR PROVIZION TË MJETEVE TË PATËRHEQURA PËR PROJEKTET RRJEDHËSE, NGA INSTITUCIONET KOMPETENTE, ME GJENDJE 31.12.2024

në 000 denarë

| | | | | | | | Dinamika e realizimit, në përputhje me periudhën e huamarrjes me hua/grant |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ministria e Financave | 3.068.601 | 431.058 | 2.637.543 | 14% | 86% | 11.567 | 2 projekte nga viti 2021 dhe 2023 |
| Ministria e Transportit dhe Lidhjes | 8.663.108 | 4.724.440 | 3.938.668 | 55% | 45% | 46.774 | 3 projekte nga vitet 2019-2023 dhe 1 pojekt nga viti 2019 |
| Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor | 6.456.975 | 29.210 | 6.427.765 | 0% | 100% | 0 | 2 projekte nga vitet 2022 dhe 2023 |
| MPSDR | 4.304.650 | 1.711.068 | 2.593.582 | 40% | 60% | 24.461 | 3 projekte nga vitet 2018, 2020 dhe 2024 |
| MD- DREJTORIA PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE | 2.890.265 | 1.291.395 | 1.598.870 | 45% | 55% | 0 | 1 projekt nga viti 2010 |
| Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave | 7.994.350 | 378.388 | 7.615.962 | 5% | 95% | 63.474 | 1 projekt nga viti 2019 dhe 1 projekt nga viti 2021/2022 |
| MASH | 4.943.280 | 3.234.414 | 1.708.866 | 65% | 35% | 19.894 | 3 projekte nga vitet 2011/2022 dhe 2021 dhe 1 projekt nga viti 2019 |
| SHA Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut | 12.299.000 | 5.945.522 | 6.353.478 | 48% | 52% | 0 | 2 projekt nga viti 2023 dhe 1 projekt nga viti 2024 |
| NPRRSH | 82.211.910 | 49.843.717 | 32.368.193 | 61% | 39% | 613.680 | 6 projekte nga vitet 2014-2022 dhe 1 projekt nga vitet 2014/2019 |
| NP për Infrastrukturë Hekurullorë HRMV Shkup | 47.567.848 | 4.928.435 | 42.639.413 | 10% | 90% | 405.539 | 2 projekte nga viti 2012 dhe vitet 2014/2018 dhe 1 projekt nga viti 2023 |
| SHA Elektraat e Maqedonisë së Veriut - ESM | 16.565.902 | 8.142.117 | 8.423.785 | 49% | 51% | 89.509 | 4 projekte nga vitet 2015 - 2023 dhe 1 projekt nga vitet 2018/2019 dhe 2 projekte nga viti 2024 |
| SHA MEPSO | 4.550.630 | 2.235.868 | 2.314.762 | 49% | 51% | 131.295 | 2 projekte nga vitet 2013 dhe 2015/2016 |
| SHA NOMAGAS Shkup | 12.361.971 | 0 | 12.361.971 | 0% | 100% | 0 | 1 projekt nga viti 2021 dhe 1 projekt nga viti 2024 |
| M-NAV SHA SHKUP | 625.773 | 192.390 | 433.383 | 31% | 69% | 5.696 | 1 projekt nga viti 2022 |
| Qyteti i Shkupit | 4.304.650 | 0 | 4.304.650 | 0% | 100% | 0 | 1 projekt nga viti 2021 |
| NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi Shkup | 12.039.754 | 1.573.042 | 10.466.712 | 13% | 87% | 0 | 1 projekt nga vitet 2019/2023 |
| | **230.848.666** | **84.661.063** | **146.187.603** | | | **1.411.889** | |

Institucioni kompetent

Shuma totale e huave / granteve investuese

Shuma e mjeteve të tërhequra

Shuma e mjeteve të patërhequra

% e mjeteve të tërhequra

% e mjeteve të pa tërhequra

Shpenzimet e provizioneve për mjetet patërhequra

Pjesa më e madhe, përkatësisht 36% e shumës së huave dhe granteve, realizohet përmes NP për Rrugë Shtetërore, për financimin e shtatë projekteve, si dhe përmes NP Hekurudhat e RMV – Infrastruktura, e cila është kompetente për realizimin e tre projekteve që përfshijnë 21% të shumës totale të huave dhe granteve të miratuara. Pavarësisht obligimit në përputhje me Konkluzionin e Qeverisë nga shkurti i vitit 2024, subjektet e lartpërmendura nuk kanë dorëzuar në Ministrinë e Financave plane veprimi për realizimin e projekteve që janë në kompetencën e tyre.

Sugjerojmë nevojën për

- ekipim më të madhe të institucioneve me kuadro profesionale dhe me përvojë,
- avancimin e monitorimit në të gjitha fazat e ciklit projektues në drejtim të menaxhimit të mirë të projekteve,
- intensifikimin e aktiviteteve për përshpejtimin e dinamikës së realizimit të projekteve kapitale të filluara,

për zhvillim më të shpejtë të shtetit, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, përdorimin racional të mjeteve nga buxheti shtetëror dhe uljen e shpenzimeve jo produktive.

Gjendja me detyrimet e papaguara deri në dhjetor 2024, nga 1.420 subjekte në ESPEO janë dorëzuar të dhëna nga 1.255 subjekte për detyrime të maturuara, por të papaguara, në shumën totale prej 38.515.415 mijë denarë ose 53% më shumë krahasuar me vitin 2023. Pjesëmarrjen më të madhe në detyrimet totale e kanë ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore me 55% dhe ndërmarrjet publike komunale me 18%.

## GJENDJA ME DETYRIMET E PARAQITURA TË MATURUARA, NDËRSA TË PAPAGUARA PËR PERIUDHËN 2020-2024




| | |
|---|---|
| 2020 | **17.819.296** |
| 2021 | **24.159.958** |
| 2022 | **25.829.001** |
| 2023 | **25.142.221** |
| 2024 | **38.515.415** |

në 000 denarë

**Paqëndrueshmëria financiare** e komunës ndodh nëse llogaria e komunës është e bllokuar për më shumë se gjashtë muaj ose nëse, gjatë periudhës prej gjashtë muaj, vazhdimisht çdo muaj, me gjendjen në fund të muajit, shuma totale e detyrimeve të papaguara mbi 60 ditë, tejkalon 60% të të ardhurave të realizuara të buxhetit themelor të komunës në vitin paraprak.

Përfundim me dhjetorin të 2024, nga gjithsej **81** komuna, **10** komuna kanë llogari të bllokuar.

Borxhi i përgjithshëm nga urdhrat e dorëzuar për përmbarim në MF arrin në **1.843.400** mijë denarë ose **49%** të detyrimeve të përgjithshme të paraqitura nga komunat.

Në vitin **2024** janë paguar detyrime në shumë prej **229.823** mijë denarë,




**69,6%** 1.123.398 mijë denarë – kryegjë / borxh

**21,8%** 351.609 mijë denarë – kamatë

**8,6%** 38.570 mijë denarë – shpenzime të tjera

Edhe pse të dhënat tregojnë përqindje të lartë të huamarrjes së komunave, në vitin 2024 **nuk është shpallur paqëndrueshmëria financiare në asnjë komunë.**

Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2022-2025 është dokument strategjik i Qeverisë për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të financave publike në përputhje me reformat e financave publike të nisura në vitin 2018, të cilat synojnë përmirësimin e kornizës fiskale, forcimin e procesit të planifikimit, realizimit dhe njoftimit mbi financat publike, rritjen e arkëtimit të të ardhurave, përmirësimin e sistemit të prokurimeve publike dhe forcimin e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm duke rritur transparencën dhe llogaridhënien në punë.

Duke marrë parasysh se zbatimi i Ligjit të ri për buxhete, i cili hyri në fuqi më 27.02.2022 është anuluar deri më 01.01.2028, është siguruar periudhë e mjaftueshme kohore për miratimin e të gjitha akteve nënligjore, si dhe për vendosjen e Sistemit të Integruar të Menaxhimit Financiar dhe Informativ (IFMIS). Vendosja dhe implementimi i sistemit IFMIS duhet t'i bashkojë aktivitetet për menaxhimin e financave publike, projekt ky i mbështetur nga Banka Botërore.

Si dobësi sistemore, përsëri e theksojmë nevojën:

- për harmonizimin e nenit 35, paragrafi 2, nenit 76 dhe nenit 96 të Ligjit të ri për buxhete,
- për harmonizimin e nenit 14 të Ligjit për buxhetin gjyqësor me nenin 29 të Ligjit për buxhete,
- që MF të iniciojë rregullimin ligjor të mënyrës së evidentimit të pronës shtetërore dhe paraqitjes së saj në raportet financiare.

# EFIKASITETI I MASAVE DHE POLITIKAVE PËR ADMINISTRIMIN E TATIMEVE, TAKSAVE DHE KOMPENSIMEVE NË NIVEL QENDROR, TË CILAT JANË TË ARDHURA TË BUXHETIT TË SHTETIT




Sistemi tatimor në Maqedoninë e Veriut paraqet një tërësi ligjesh dhe rregullash, sipas të cilave shteti siguron të hyra përmes arkëtimit të tatimeve nga qytetarët dhe subjekte juridikë, si burim themelor për financimin e funksioneve publike dhe zbatimin e politikave shtetërore për financimin e shërbimeve publike, si arsimi, shëndetësia, infrastruktura, pensionet, siguria, mbrojtja dhe të ngjashme.

Burimi më i madh i të ardhurave në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë tatimet direkte, të cilat paguhen nga personat fizikë ose juridikë mbi të ardhurat ose fitimin e realizuar, dhe tatimet indirekte, të cilat paguhen përmes konsumit.

## Taksat direkte

### Tatimi mbi të ardhurat personale të personave fizikë

Paguhet çdo vit mbi shumën e të ardhurave personale të qytetarëve, të realizuara në vend dhe jashtë vendit, në bazë të pagës, honorarëve, të ardhurave nga veprimtaria e pavarur, të drejtave autoriale, të ardhurave nga shitja e produkteve bujqësore, të ardhurave nga dhënia me qira ose nënqira e pasurisë dhe të ardhurave të tjera.

### Tatimi mbi fitimin

Paguhet nga personat juridikë rezidentë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët realizojnë fitim nga ushtrimi i veprimtarisë në vend dhe jashtë vendit.

### Kontributet për sigurim social

Kontributet për sigurim pensional dhe invalidor, sigurim shëndetësor dhe sigurim në rast papunësie llogariten si përqindje e pagës.

## Taksat indirekte

### TVSH

Tatim që paguhet nga konsumatorët gjatë blerjes së mallrave dhe shërbimeve me normë prej 18% (norma e përgjithshme), si dhe me norma të privilegjuara prej 10% dhe 5%.

### Akcizat

Tatim i veçantë për produkte të caktuara: alkool dhe pije alkoolike, produkte të duhanit, energjentë dhe energji elektrike.

### Doganat dhe taksat

Pagesa që arkëtohen gjatë importit dhe eksportit të mallrave në përputhje me rregullat doganore dhe tarifore.

Nga të dhënat e llogarive përfundimtare të publikuara të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitet 2019-2023, vërehet një rritje e të ardhurave të arkëtuara në Buxhetin e shtetit.

## TË ARDHURAT E ARKËTUARA NË BUXHET

në milion denarë

| Të ardhurat totale: | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **203.946** | **189.554** | **218.021** | **243.085** | **277.128** | **305.553** |
| Të hyra tatimore dhe kontribute | 178.894 | 173.464 | 196.317 | 220.186 | 250.355 | 283.557 |
| Të hyrat tatimore | 116.728 | 106.900 | 125.690 | 142.567 | 157.733 | 177.889 |
| Tatimi mbi të ardhurat personale | 18.706 | 18.625 | 20.552 | 23.857 | 27.257 | 31.852 |
| Tatimi mbi fitimin | 11.554 | 10.497 | 10.871 | 15.776 | 16.927 | 20.185 |
| TVSH | 52.059 | 46.893 | 58.194 | 64.764 | 70.036 | 81.465 |
| Akciza | 26.087 | 22.450 | 25.548 | 25.483 | 26.818 | 28.705 |
| Dogana | 6.033 | 6.738 | 8.480 | 9.973 | 11.244 | 12.197 |
| Tatime të tjera | 674 | 510 | 641 | 670 | 3.616 | 957 |
| Të hyrat tatimore në llogaritë vetanake | 1.615 | 1.187 | 1.404 | 2.049 | 1.835 | 1.808 |
| Kontribute | 62.166 | 66.564 | 70.627 | 77.619 | 92.622 | 105.668 |
| Kontribut për sigurimin pensional | 41.921 | 45.044 | 47.819 | 52.509 | 62.610 | 71.436 |
| Kontribut për punësim | 2.622 | 2.757 | 2.918 | 3.214 | 3.842 | 4.383 |
| Kontribut për sigurimin shëndetësor | 17.623 | 18.763 | 19.890 | 21.896 | 26.170 | 29.849 |
| Të hyra jotatimore | 18.800 | 11.173 | 13.882 | 17.189 | 16.866 | 16.920 |
| Të hyra kapitale | 2.369 | 1.846 | 1.928 | 2.273 | 2.071 | 1.851 |
| Donacione | 3.883 | 3.071 | 5.894 | 3.437 | 7.836 | 3.225 |

Kemi kryer revizion të suksesit me temën **„„Efikasiteti i masave dhe politikave për administrimin e tatimeve, taksave dhe kompensimeve në nivel qendror, të cilat janë të ardhura të buxhetit shtetëror“** me qëllim që të japim përgjigje në pyetjen **„„A sigurojnë masat dhe aktivitetet e organeve kompetente arkëtim efikase të tatimeve dhe kontributeve në nivel qendror, si të ardhura të Buxhetit shtetëror“.**

Me revizionin e suksesit e përfshimë veprimtarinë e Ministrisë së Financave, Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë së Doganave në periudhën 2020–2025.

Me revizionin e zbatuar fituam siguri të arsyeshme se masat dhe aktivitetet që ndërmerren nga institucionet kompetente, megjithëse kontribuojnë në mbledhjen dhe arkëtimin me kohë të tatimeve si të hyra në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, administrimi i tatimeve dhe kontributeve në nivel qendror nuk siguron garanci se ato janë arkëtuar në shuma reale, të sakta dhe objektive.

## POLITIKAT AFATGJATA TË SHTETIT NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT DHE AVANCIMIT TË SISTEMIT TATIMOR




Dokumentet strategjike në fushën e menaxhimit të financave publike dhe sistemit tatimor sigurojnë bazë solide për vendosjen e një sistemi tatimor të drejtë, efikas, transparent dhe bashkëkohor, por realizimi i objektivave të përcaktuara ka një dinamikë të ngadaltë dhe të pjesshme për shkak të planifikimit joefikas të burimeve financiare dhe njerëzore, ndërkohë që për disa masa është konstatuar zgjatje e afateve për më shumë se tre deri në katër vite.

Realizimi i objektivave të Programës për reformën e menaxhimit të financave publike, në drejtim të përmirësimit dhe avancimit të sistemit tatimor, është me vonesa të konsiderueshme dhe prolongimit të aktiviteteve në të gjitha institucionet kompetente. Tek Ministria e Financave janë konstatuar dobësi në planifikim, koordinim dhe sigurimin e burimeve, për shkak të të cilave janë shtyrë reformat kyçe. Tek Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Drejtoria e Doganave, një pjesë e aktiviteteve të lidhura me digjitalizimin, forcimin e kapaciteteve dhe modernizimin e sistemeve janë në proces ose të shtyra për periudha të ardhshme, gjë që e ul efikasitetin e objektivave të planifikuara.

Realizimi i objektivave të Strategjisë për reformimin e sistemit tatimor zhvillohet me dinamikë të ngadalësuar në të gjitha institucionet. Edhe pse janë ndërmarrë aktivitete të caktuara, veçanërisht në fushën e ndryshimeve ligjore, digjitalizimit dhe harmonizimit me standardet ndërkombëtare, një pjesë e konsiderueshme e masave mbetet në fazën e zbatimit ose është shtyrë për një periudhë të mëvonshme.

Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Drejtoria e Doganave në masë të madhe i kanë integruar objektivat e strategjive kombëtare në dokumentet e tyre strategjike, veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me rritjen e efikasitetit të arkëtimit të të hyrave publike dhe digjitalizimin e proceseve. Megjithatë, në praktikë, realizimi i tyre zhvillohet me ritëm të ngadalësuar, për shkak se një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve ende ndodhen në fazën e implementimit ose nuk janë realizuar, gjë që ndikon në arritjen me kohë të objektivave strategjike.

Nuk ekzistojnë procedura të unifikuara në planifikimin e të ardhurave në Buxhetin e shtetit, pra një metodologji e vetme, për shkak të së cilës Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Drejtoria e Doganave përdorin qasje të veta joformale (modele ad-hoc në Excel), që rezulton me devijime të konsiderueshme ndërmjet asaj që është planifikuar në Buxhet, projeksioneve të institucioneve dhe të ardhurave realisht të arkëtuara nga tatimet, kontributet, akcizat dhe doganat. Si rezultat i kësaj, është e vështirë të përcaktohet nëse realizimi më i ulët i të ardhurave i atribuohet planifikimit joadekuat apo rritjes së hendekut tatimor (ekonomia gri dhe shmangia e tatimeve).

## PROJEKCIONI, PLANI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE NGA TATIMI MBI FITIMIN, TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE DHE TVSH




**Aktivitete të Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë së Doganave në përcaktimin dhe arkëtimin e tatimeve dhe doganave me të cilat administrojnë**

Kapacitetet e Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë së Doganave janë me rëndësi të madhe për administrimin e përkohshëm të detyrimeve publike.

Edhe pse Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Drejtoria e Doganave kanë vendosur sisteme informative që mundësojnë administrimin elektronik të detyrimeve publike, kemi konstatuar dobësi në funksionalitetin, integrimin dhe mbështetjen për përdoruesit, gjë që e zvogëlon kontributin e tyre drejt mbledhjes së përkohshme dhe të plotë të të ardhurave. Këto gjendje ndikojnë në përkohshmërinë dhe cilësinë e të dhënave dhe e kufizojnë efikasitetin e masave dhe politikave për administrimin e tatimeve që janë të ardhura në Buxhetin e shtetit.

Procesi i planifikimit vjetor dhe mujor është me rëndësi të madhe për përdorimin e duhur të burimeve të kufizuara njerëzore në raport me numrin e madh të tatimpaguesve në Drejtorinë e të Ardhurave Publike.

## PLOTËSIMI I VENDEVE TË PUNËS NË SHËRBIMET INSPEKTUESE TË DREJTORISË SË TË ARDHURAVE PUBLIKE DHE NUMRI I TATIMPAGUESVE

| Drejtoritë Rajonale | Nr. i planifikuar inspektorë/kontrollorë | Nr. i plotësuar inspektorë/kontrollorë | Punonjës me kontratë të përkohshme | Subjekte juridike të regjistruara | Kryerës të veprimtarisë të regjistruar |
|---|---|---|---|---|---|
| DR Shkup | 47 | 40 | 3 | 57.200 | 20.262 |
| DR Manastir | 40 | 31 | 3 | 16.413 | 28.119 |
| DR Prilep | 38 | 27 | 2 | 11.964 | 55.263 |
| DR Strumicë | 22 | 20 | 1 | 10.147 | 51.790 |
| DR Tetovë | 36 | 28 | 4 | 13.704 | 20.647 |
| DR Shtip | 32 | 22 | 1 | 14.665 | 41.742 |
| **DGDO** | 18 | 13 | | 342 | 0 |
| **Totali** | **233** | **181** | **14** | **125.331** | **217.823** |

Sistemi i pamjaftueshëm i vendosur dhe i zbatuar për menaxhimin e rrezikut, mungesa e kritereve të dokumentuara qartë për përzgjedhjen e tatimpaguesve për kontroll, si dhe mungesa e stafit të mjaftueshëm në shërbimet inspektuese dhe në njësinë për menaxhimin e rrezikut të përputhshmërisë, ndikojnë në efikasitetin dhe objektivitetin e aktiviteteve kontrolluese të Drejtorisë së të Ardhurave Publike. Edhe pse janë vendosur disa mekanizma dhe procedura për analizën e rrezikut dhe planifikimin e kontrolleve, zbatimi i tyre i kufizuar dhe ndjekja e pamjaftueshme e realizimit krijojnë rrezik nga subjektiviteti në përzgjedhjen e tatimpaguesve dhe shfrytëzimin jo të plotë të burimeve njerëzore të disponueshme. Për më tepër, mungesa e akteve të brendshme dhe metodologjive të unifikuara për lloje të veçanta të kontrolleve tatimore ndikon në veprim jo të njëtrajtshëm dhe subjektiv nga ana e inspektorëve dhe kontrollorëve tatimorë, ndërsa përqindja e lartë e parregullsive të konstatuara gjatë kontrolleve të kryera tregon nevojën për targetim më efikas dhe forcimin e sistemit për menaxhimin e rreziqeve dhe përputhshmërinë tatimore.

## KONTROLLET E PLANIFIKUARA DHE TË REALIZUARA NË DREJTORINË E TË ARDHURAVE PUBLIKE DHE PARREGULLSITË E KONSTATUARA

| Viti | Numri i kontrolleve | | | | Shuma e taksës së mbledhur | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kontrollet e planifikuara | Kontrollet e realizuara | Kontrollet me parregullsi | % e kontrolleve me parregullsi | Tatimi i ri i përcaktuar (000 denarë) | Tatimi i ri i mbledhur (000 denarë) | % e tatimeve të mbledhura shtesë |
| | 1 | 2 | 3 | 4=3/2 | 5 | 6 | 7=6/5 |
| 2020 | 8.231 | 4.046 | 1.434 | 35,4% | 1.008.186 | 601.512 | 59,7% |
| 2021 | 10.966 | 5.984 | 2.731 | 45,6% | 1.740.656 | 1.055.381 | 60,6% |
| 2022 | 15.180 | 5.949 | 2.168 | 36,4% | 1.688.644 | 921.183 | 54,6% |
| 2023 | 4.547 | 7.217 | 3.181 | 44,1% | 2.846.804 | 899.655 | 31,6% |
| 2024 | 6.984 | 4.747 | 1.959 | 41,3% | 2.070.236 | 1.170.393 | 56,5% |
| 2025 | 7.892 | 4.691 | 2.667 | 56,9% | 4.123.597 | 1.729.336 | 41,9% |
| Totali | 53.800 | 32.634 | 14.140 | 43,3% | 13.478.124 | 6.377.460 | 47,3% |

Në vijim paraqesim një paraqitje grafike të detyrimeve tatimore të papaguara sipas llojeve që janë në kompetencë të DAP.

## BORXHI I PAPAGUAR SIPAS LLOJIT TË TATIMIT DAP



**Këto gjendje tregojnë dobësi në mekanizmin e kontrollit dhe lënë mundësi për veprim diskrecional, subjektivitet dhe keqpërdorime të mundshme, si dhe mund të ndikojnë negativisht në përcaktimin dhe arkëtimin e drejtë të tatimeve, e me këtë edhe në lartësinë e të hyrave në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.**

Drejtoria Doganore ka vendosur sistem për menaxhimin e rrezikut, në procesin e të cilit nuk janë përfshirë në mënyrë të mjaftueshme të gjitha njësitë organizative, përkatësisht pjesën më të madhe të profileve të rrezikut (97%) i propozon vetëm Sektori për Kontroll dhe Hetime. Doganat dhe zyrat doganore, edhe pse disponojnë me informacione relevante nga kontrollet e përditshme, nuk marrin pjesë në krijimin dhe përditësimin e profileve të rrezikut.

Konstatuam se në sistemin e menaxhimit të rrezikut nuk është vendosur kanali i kaltër si segment i rëndësishëm gjatë përzgjedhjes së kontrolleve pasdoganore që kryhen nga njësia për kontrollin e shoqërive tregtare, si dhe dobësi në kontrollet gjatë ndryshimit të deklaratave doganore. Sistemi mundëson ndryshimin e të dhënave nga deklaratat pa arsyetim të detyrueshëm, pa evidencë përkatëse dhe pa miratim nga punonjësi përgjegjës. Zbatimi joadekuat i procedurave të vendosura nga personat përgjegjës në dogana dhe zyrat doganore për monitorimin, evidentimin dhe analizimin e aktiviteteve kontrolluese të nëpunësve doganorë, veçanërisht kur nuk veprojnë sipas udhëzimeve të kontrollit të dhëna nga aplikacioni SOCDAD, lë mundësi për veprime subjektive dhe paraqitje të gabimeve.

Dokumentimi i pamjaftueshëm i indikatorëve të rrezikut dhe i përzgjedhjes së subjekteve për kontroll pasdoganor që kryhet nga njësia për kontrollin e shoqërive tregtare, si dhe futja jo e plotë e të dhënave në sistemet informatike, krijojnë rrezik për uljen e efektivitetit të mekanizmave të kontrollit. Gjithashtu, pajisja e pamjaftueshme me burime njerëzore dhe përfshirja e kufizuar e kontrolleve pasdoganore dhe e kontrolleve të mallrave akcizore e zvogëlojnë mundësinë për zbulimin dhe parandalimin me kohë të parregullsive, gjë që mund të ndikojë në arkëtimin e drejtë të doganave, akcizave dhe detyrimeve të tjera publike.

Në vijim paraqesim të dhënat për vendimet e papaguara në procedurë administrative të Drejtorisë Doganore.

## VENDIME TË PAPAGUARA TË DREJTORISË DOGANORE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE

në 000 denarë

| Subjektet | Nr. i tatimpaguesve | Shuma e borxhit doganor | Nr. i vendimeve | Nr. i vendimeve të vjetruara | Shuma e borxhit doganor në vendime të vjetruara | Shuma e borxhit doganor pa vendime të vjetruara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Persona juridikë 1999–2025 | 744 | 3.464.672 | 6.689 | 4.770 | 3.251.232 | 213.440 |
| Sipas evidencës nga ARS | | 125.143 | | | 0 | 125.143 |
| Persona fizikë 2007–2025 | 99 | 3.912 | 118 | - | - | - |
| **Totali** | **843** | **3.595.727** | **6.807** | **4.770** | **3.251.232** | **338.583** |

Dobësitë në veprimin ndaj lëndëve kundërvajtëse, dorëzimi me vonesë i vendimeve për arkëtim të detyrueshëm, evidencat jo të plota dhe niveli i lartë i kërkesave të paarkëtuara dhe të vjetruara nga periudha e mëparshme tregojnë se sistemi i vendosur nuk siguron menaxhim efikas të borxheve dhe arkëtim me kohë të të hyrave publike.

Mungesa e mbikëqyrjes së brendshme nga Drejtoria e të Hyrave Publike mbi punën e inspektorateve tatimore, si dhe numri i reduktuar i burimeve njerëzore për shkak të procedurave të iniciuara kundër të punësuarve para organeve kompetente, ndikon në zbatimin efikas të aktiviteteve kontrolluese dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Në Drejtorinë Doganore, pavarësisht zbatimit të vazhdueshëm të trajnimeve dhe rritjes së numrit të kontrolleve dhe hetimeve, pajisja e pamjaftueshme me burime njerëzore dhe moszbatimi i analizave të nevojave nga Sektori për Përgjegjësi Profesionale e zvogëlojnë mundësinë për identifikimin dhe parandalimin me kohë të parregullsive dhe rreziqeve.

Procedurat disiplinore dhe penale të konstatuara ndaj të punësuarve në Drejtorinë e të Hyrave Publike dhe në Drejtorinë Doganore tregojnë nevojën për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përforcimin e integritetit dhe etikës profesionale, llogaridhënies dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, me qëllim përmirësimin e ligjshmërisë, integritetit dhe efikasitetit në punën e institucioneve.

## EKONOMIA JOFORMALE

Ekonomia joformale është tërësia e aktiviteteve ekonomike që nuk deklarohen ose nuk evidentohen plotësisht para institucioneve kompetente, me qëllim shmangien e pagesës së tatimeve, detyrimeve doganore dhe kontributeve.

Efektiviteti i institucioneve për mbledhjen e tatimeve përmes ngarkimit tatimor të drejtë, gjithëpërfshirës, në kohë dhe të plotë të qytetarëve dhe sektorit të biznesit ndikon në nivelin e ekonomisë joformale.

Në përputhje me Raportin* të përgatitur nga eksperti i angazhuar për nevojat e revizionit në fjalë, pjesëmarrja e ekonomisë joformale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në BPV, e matur sipas Metodës së Konsumit të Energjisë Elektrike (Electricity Consumption Method – ESM) dhe Metodës së Kërkesës për Para të Gatshme (Cash Demand Method – CDM), është paraqitur në grafikun vijues.

### PJESËMARRJA E EKONOMISË JOFORMALE NË BPV




Pavarësisht trendit të moderuar të uljes së ekonomisë joformale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ajo vazhdon të mbetet në nivel relativisht të lartë dhe paraqet një sfidë të rëndësishme për stabilitetin fiskal, konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe efikasitetin e sistemit të arkëtimit të të hyrave publike.

Në lidhje me kornizën strategjike, konstatuam se aktivitetet e parapara në Strategjitë për formalizimin e ekonomisë joformale 2018–2022 dhe 2023–2027 po realizohen me dinamikë të ngadalësuar dhe me shkallë të kufizuar të zbatimit, ku një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të planifikuara nuk janë realizuar ose janë shtyrë për periudha të mëvonshme. Koordinimi i pamjaftueshëm ndërmjet institucioneve, si dhe mungesa e monitorimit sistematik të zbatimit të masave, e zvogëlojnë efektin e tyre në luftimin e ekonomisë joformale.

* Revizioni i ekonomisë joformale si segment i revizionit të suksesit të Entit Shtetëror të Revizionit: „Efikasiteti i masave dhe politikave për administrimin e tatimeve, taksave dhe kompensimeve në nivel qendror, të cilat janë të hyra të buxhetit të shtetit", nga prof. dr. Aleksandar Naumoski.

Në pjesën e bashkëpunimit ndërinstitucional, konstatuam se ekziston shkëmbim i pamjaftueshëm i të dhënave dhe koordinim ndërmjet institucioneve kompetente, veçanërisht ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Tregut dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës me Drejtorinë e të Hyrave Publike dhe Drejtorinë Doganore. Kontrollet e kryera nga shërbimet inspektuese zbulojnë një përqindje të lartë parregullsish, por rezultatet e tyre nuk ndahen me Drejtorinë Doganore dhe Drejtorinë e të Hyrave Publike. Mungesa e sistemeve të integruara informative dhe përdorimi i kufizuar i softuerëve në dispozicion (e-Inspektor) e vështirësojnë identifikimin e subjekteve të paregjistruara, monitorimin e qarkullimit të paregjistruar dhe zbatimin e kontrolleve të targetuara.

Revizioni konstatoi se disa veprimtari ekonomike, si tregtia në tregjet e gjelbra, tregtia elektronike dhe tregtia përmes rrjeteve sociale, janë të rregulluara ose të kontrolluara në mënyrë të pamjaftueshme, me ç'rast një pjesë e konsiderueshme e qarkullimit realizohet me para të gatshme dhe mbetet jashtë sistemit tatimor. Në këto segmente është i pranishëm kontrolli i kufizuar, evidencimi i pamjaftueshëm i subjekteve dhe mungesa e mekanizmave efektivë për monitorimin e qarkullimit.

Në lidhje me punësimin joformal, pavarësisht trendit të uljes, i njëjti vazhdon të përfshijë një pjesë të konsiderueshme të fuqisë punëtore.

## NUMRI I PERSONAVE TË PUNËSUAR NË MËNYRË JOFORMALE NË PERIUDHËN 2017–2022




Kjo gjendje është e theksuar veçanërisht në veprimtaritë e ndërtimtarisë, hotelierisë dhe tregtisë me shumicë dhe pakicë, duke rezultuar me humbje të konsiderueshme të të hyrave nga tatimet dhe kontributet, ndërsa mjetet e vlerësuara të humbura janë të konsiderueshme dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në Buxhetin e shtetit.

## NUMRI I PERSONAVE TË PADEKLARUAR SIPAS VEPRIMTARIVE DHE GJITHSEJ KONTRIBUTET DHE TATIMET E PAARKËTUARA PËR PERIUDHËN 2023-2025

| Veprimtaria | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|
| Ndërtimtaria | 15.207 | 14.310 | 16.213 |
| Tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave | 7.564 | 7.236 | 7.273 |
| Objektet e akomodimit dhe veprimtaritë e shërbimit me ushqim | 4.044 | 3.796 | 4.289 |
| Gjithsej persona të padeklaruar | 26.815 | 25.342 | 27.775 |

në 000 denarë

| | | | |
|---|---|---|---|
| Gjithsej kontribute dhe tatime të papaguara mbi pagën minimale | 225.161 | 273.409 | 323.798 |
| Gjithsej kontribute dhe tatime të papaguara mbi pagën mesatare | 482.661 | 532.171 | 638.819 |

Të dhënat e publikuara në raportet vjetore të punës së Drejtorisë së të Hyrave Publike lidhur me tatimet e paguara për personat e angazhuar me kontratë për vepër tregojnë se edhe sektori publik kontribuon në ekzistimin e ekonomisë joformale, për arsye se në buxhet nuk paguhen kontributet sociale.

## TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE I ARKËTUAR NË BAZË TË KONTRATAVE PËR VEPËR

në 000 denarë

| Përshkrimi | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|
| Të hyrat nga tatimi i arkëtuar mbi kontratat për vepër | 1.611.722 | 1.985.792 | 2.403.760 | 2.767.198 |
| Shuma neto e paguar | 14.506.949 | 17.873.915 | 21.636.004 | 24.907.273 |
| Të hyrat e humbura nga kontributet (28%) | 4.513.228 | 5.560.718 | 6.731.134 | 7.748.852 |

Konstatuam se institucionet kompetente nuk zbatojnë fushata publike të vazhdueshme dhe të koordinuara për ngritjen e vetëdijes lidhur me efektet negative të ekonomisë joformale dhe rëndësinë e përmbushjes me kohë të detyrimeve tatimore, gjë që e zvogëlon efektin e masave për formalizimin e ekonomisë joformale.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara në pjesën e administrimit të tatimeve, taksave dhe kompensimeve në nivel qendror, janë dhënë rekomandime për institucionet kompetente me qëllim tejkalimin e mangësive dhe përmirësimin e gjendjes së konstatuar.

## 5.2.2. GJYQËSORI DHE SUNDIMI I SË DREJTËS

### AKADEMIA PËR GJYKATËS DHE PROKURORË PUBLIKË

Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë është institucion publik dhe ka për qëllim ushtrimin profesional, të pavarur, të paanshëm dhe efikas të funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit publik, si dhe kryerjen profesionale dhe efikase të detyrave nga shërbimet profesionale në gjyqësor dhe në prokurorinë publike.

Kemi kryer revizion të raporteve financiare dhe revizion të pajtueshmërisë për llogarinë e buxhetit themelorë për vitin 2024 dhe për llogarinë e buxhetit të aktiviteteve vetëfinancuese të Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, dhe kemi konstatuar gjendjet në vijim:

- Përllogaritja dhe pagesa e kompensimeve për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe të Këshillit Programor kryhet çdo muaj dhe në tërësi, dhe jo në mënyrë proporcionale me pjesëmarrjen në mbledhje për muajt në të cilët është mbajtur mbledhja, për shkak të së cilës janë paguar mjete më tepër në shumën e përgjithshme prej 958 mijë denarë;

- Tejkalimi i afatit ligjor prej 3 muajsh për përfundimin e fazës së dytë të trajnimit fillestar për gjeneratën e 8-të të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, që ka rezultuar me pagesën e mjeteve shtesë financiare për mentorët dhe koordinatorët në shumën e përgjithshme prej 2.113 mijë denarë;

- Janë paguar mjete në shumën e përgjithshme prej 970 mijë denarë për koordinatorë, statusi, të drejtat dhe detyrimet e të cilëve nuk janë të përcaktuara me Ligjin për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë;

- Anëtarëve të komisioneve për vlerësimin e mësimit praktik u janë paguar kompensime në shumën e përgjithshme prej 353 mijë denarë, megjithëse e drejta dhe pagesa e kompensimeve për vlerësimin e mësimit praktik nuk janë të përcaktuara me Ligjin për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë;

- Janë furnizuar me mallra dhe shërbime pa u zbatuar procedura e prokurimit publik, në shumën e përgjithshme prej 418 mijë denarë.

Në pjesën e Theksimit të çështjeve, veçojmë për:

Aktivitetet e zbatuara sipas shpalljes për pranimin e kandidatëve për ndjekjen të trajnimit fillestar në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë për gjeneratën e 9-të, të filluar në janar të vitit 2023, e cila nuk ka përfunduar dhe me Vendim të Këshillit Drejtues të Akademisë, me datë 25.12.2025, është anuluar.

Arkëtimi i kompensimit për shpenzimet e dhënies së provimit pranues në bazë të Rregullores për dhënien e provimit pranues në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, edhe pse me Ligj është përcaktuar se mjetet për funksionimin e Akademisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes buxhetit të "Pushtetit Gjyqësor", në një shumë të mjaftueshme për të mbuluar organizimin dhe zbatimin e provimeve, programeve të trajnimit, si dhe shpenzimet e tjera që rrjedhin nga funksionimi i rregullt i Akademisë.



# GJYKATA THEMELORE E KUMANOVËS

Gjykata Themelore e Kumanovës

Gjykata Themelore e Kumanovës, në pajtim me nenin 30 të Ligjit për Gjykatat*, është gjykatë e shkallës së parë me kompetencë të zgjeruar, e cila, përveç kompetencës së përcaktuar për gjykatat themelore me kompetencë bazë për zonat për të cilat janë themeluar, është kompetente të vendosë në shkallë të parë për veprat penale dhe kundërvajtjet, si dhe në shkallë të parë për kontestet civile.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të Gjykatës Themelore të Kumanovës për vitin 2024, për llogarinë e buxhetit themelor (603), (631) dhe llogarinë depozituese (696). Me revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë të Gjykatës Themelore të Kumanovës, konstatuam gjendje që kanë të bëjnë me:

- regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është kryer në mënyrën e paraparë me dispozitat ligjore dhe nënligjore;
- një pjesë e mjeteve të luajtshme të gjykatës, të nxjerra gjatë renovimit, janë dorëzuar për ruajtje te një person privat pa dokumentacion përkatës, gjë që ka çuar në humbjen e gjurmueshmërisë së tyre. Komisioni i regjistrimit nuk ka mundur të kryejë regjistrimin e plotë për shkak të mungesës së numrave inventarë, gjendjes së dëmtuar dhe të parregullt të mjeteve, si dhe mungesës së ekspertizës së nevojshme për vlerësimin e përdorshmërisë së tyre.

Pavarësisht aktiviteteve të ndërmarra për vlerësimin dhe shlyerjen nga evidenca, janë konstatuar dobësi serioze në ruajtjen dhe sigurimin e mjeteve (mungesë e kontratës, mbikëqyrjes dhe sigurimit fizik), që krijon rrezik për dëmtimin, humbjen ose tjetërsimin e tyre të paautorizuar;

- kushte të papërshtatshme për ruajtjen e dokumentacionit në hapësirat e bodrumit, pa mbrojtje adekuate nga zjarri dhe lagështia, që nuk është në përputhje me rregullativën ligjore. Në vitin 2023 ka shpërthyer zjarr në hapësirat e bodrumit të gjykatës, me ç'rast janë përfshirë lëndë të arkivuara, ndërsa komisioni nuk ka mundur të përcaktojë saktësisht se cilat dhe sa lëndë janë dëmtuar ose shkatërruar. Një pjesë e materialit është larguar pa procedurë përkatëse dhe pa përcaktimin e gjendjes së tij dhe afateve të ruajtjes;
- dobësi gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit publik;
- depozitat kanë një strukturë sipas moshës dhe i përkasin periudhës nga viti 1999 deri në vitin 2024, por nuk është përcaktuar statusi i çështjeve lidhur me depozitat gjyqësore – të përfunduara / të papërfunduara;
- nuk është vendosur evidencë elektronike për mjetet monetare dhe sendet e konfiskuara, përkatësisht është vendosur një regjistër në formë letre dhe i cili nuk përditësohet me kohë;
- nuk është kryer shqyrtim i plotë i punës së përgjithshme me mjetet e depozitave nga viti paraprak dhe
- nuk është kryer shqyrtimi i tërësishëm i punës materiale dhe financiare, dy herë në vit, nga ana e kryetarit të gjykatës.

Në pjesën e Theksimit të çështjeve janë shpalosur gjendje që kanë të bëjnë me:

- procedura gjyqësore që zhvillohen para gjykatave kompetente, për të cilat deri në ditën e revizionit rezultati përfundimtar nuk është i njohur, për shkak të së cilës ekziston pasiguri lidhur me implikimet financiare në buxhetin e Gjykatës Themelore të Kumanovës në të ardhmen;
- Ministria e Drejtësisë në muajin nëntor 2020 ka miratuar formularë për vlerësimin e nëpunësve gjyqësorë, por të njëjtët nuk vlejnë edhe për policinë gjyqësore. Gjithashtu, për shkak të mospërputhjes së akteve me Ligjin për Shërbimin Gjyqësor, nuk zbatohet vlerësimi i administratorit gjyqësor nga Kryetari i Gjykatës dhe
- mjetet që ndahen nga Buxheti për vitin 2024 për financimin e Pushtetit Gjyqësor nuk arrijnë përqindjen e përcaktuar me ligj prej 0,8% të bruto produktit vendor të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 58/06, e datës 11.05.2006

## GJYKATA SUPREME SHKUP

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqet kategori kushtetuese, pozita e së cilës në raport me gjykatat e tjera në pushtetin gjyqësor është e përcaktuar me nenin 101 të Kushtetutës së shtetit, si gjykata më e lartë në Republikë, e cila siguron zbatim unik të ligjeve nga ana e gjykatave.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024, për llogarinë e buxhetit themelor (603).

Me revizionin e kryer, kemi shpalosur disa gjendje në pjesën e Theksimit të Çështjeve, të cilat kanë të bëjnë me:

- procedura gjyqësore që zhvillohen para gjykatave kompetente, për të cilat deri në ditën e revizionit rezultati përfundimtar nuk është i njohur, për shkak të së cilës ekziston pasiguri lidhur me implikimet financiare në buxhetin e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të ardhmen;
- Ministria e Drejtësisë në muajin nëntor 2020 ka miratuar formularë për vlerësimin e nëpunësve gjyqësorë, por të njëjtët nuk vlejnë edhe për policinë gjyqësore dhe administratorin gjyqësor;
- nga muaji shtator 2023, në gjykatë nuk ka administrator gjyqësor dhe
- mjetet që ndahen nga Buxheti për vitin 2024 për financimin e Pushtetit Gjyqësor nuk arrijnë përqindjen e përcaktuar me ligj prej 0,8% të bruto prodhimit vendor të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



## EFEKTET E PROCEDURAVE GJYQËSORE NGA KONTESTET E PUNËS MBI BUXHETIN E SHTETIT

16 МИР, ПРАВДА И СИЛНИ ИНСТИТУЦИИ

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të suksesit me temë: **„Efektet e procedurave gjyqësore nga kontestet e punës mbi buxhetin e shtetit“**, me qëllim që të vlerësojë **“Nëse institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë vendosur mekanizma dhe sisteme efikase për menaxhimin e kontesteve të punës, si dhe nëse ndërmerren masa të përshtatshme për zvogëlimin e implikimeve të tyre financiare mbi buxhetin e shtetit”.**

Revizioni e përfshiu periudhën 2020–2025 dhe ishte i orientuar në vlerësimin e kornizës ligjore dhe institucionale, mekanizmave për menaxhimin e kontesteve të punës, mënyrës së mbajtjes së evidencave, përdorimit të mekanizmave alternativë për zgjidhjen e kontesteve, si dhe implikimeve financiare të procedurave gjyqësore mbi buxhetin e shtetit.

Në kuadër të revizionit u përfshinë Avokatura Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria Doganore, IKP Idrizovë, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Punës, si dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Revizioni konstatoi se në periudhën e analizuar është i pranishëm një trend i vazhdueshëm rritës i numrit të kontesteve të punës, **me ç’rast numri i lëndëve në procedurë është rritur nga 9.361 lëndë në vitin 2021 në 24.556 lëndë në vitin 2025. Njëkohësisht, numri i lëndëve të reja të paraqitura vazhdimisht e tejkalon numrin e lëndëve të përfunduara, që çon në rritjen e vëllimit të lëndëve në procedurë dhe krijimin e një numri të konsiderueshëm të lëndëve të prapambetura.** Numri i lëndëve aktive sipas viteve, si dhe numri i lëndëve të përfunduara dhe të papërfunduara në bazë të kontesteve të punës, për periudhën 2021–2025, është paraqitur në infografik.

### PASQYRË E LËNDËVE NË PUNË DHE LËNDËVE TË PËRFUNDUARA (2021–2025)



Revizioni konstatoi se rregullativa ekzistuese ligjore dhe nënligjore nuk siguron një sistem plotësisht të harmonizuar dhe funksional për menaxhimin e kontesteve të punës. Janë konstatuar paqartësi dhe mos harmonizim sistemor në rregullimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, të cilat krijojnë interpretime të ndryshme dhe zbatim jo të njëtrajtshëm të dispozitave.

Veçanërisht janë identifikuar dobësi në pjesën e:

- përllogaritjes së stazhit të punës;
- kompensimit për ushqim gjatë punës së natës;
- e drejta për shpërblim në pension;
- shpërblimeve jubilare;
- pagave bonus dhe mungesave të arsyetuara;
- përgjegjësisë në rast të largimit të kundërligjshëm nga puna ose risistemimit

Revizioni konstatoi se nuk ekziston një qasje sistematike për identifikimin dhe analizimin e shkaqeve për inicimin e kontesteve të punës, si dhe nuk ekzistojnë mekanizma për inicimin me kohë të ndryshimeve në kornizën ligjore.

Për më shumë, Avokatura Shtetërore ka kryesisht rol reaktiv, të orientuar drejt përfaqësimit në procedurat gjyqësore, pa funksion të mjaftueshëm të zhvilluar parandalues dhe këshillëdhënës.

Revizioni konstatoi se nuk janë vendosur mekanizma gjithëpërfshirës dhe efikas për menaxhimin e kontesteve të punës. Në pjesën më të madhe të institucioneve mungojnë analiza sistematike të shkaqeve për inicimin dhe humbjen e kontesteve, si dhe mekanizma për përcaktimin e përgjegjësisë dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese.

Evidenca e lëndëve nuk është e unifikuar dhe në një pjesë të konsiderueshme mbahet në mënyrë manuale ose përmes evidencave në Excel, që nuk mundëson:

- ndjekjen analitike të lëndëve;
- përcaktimin e strukturës sipas moshës;
- monitorimin e lëndëve aktive dhe të përfunduara;
- analizën e rezultateve të procedurave gjyqësore;
- identifikimin me kohë të rreziqeve dhe bazave të përsëritura për ngritjen e padive.

Revizioni konstatoi edhe zbatim të kufizuar të mënyrave alternative për zgjidhjen e kontesteve. Edhe pse ekzistojnë mekanizma për ndërmjetësim dhe zgjidhje paqësore të kontesteve, zbatimi i tyre është i kufizuar dhe pa një qasje të vendosur strategjike dhe institucionale, gjë që rezulton me një numër më të madh të procedurave gjyqësore dhe me zgjatje të kohës së nevojshme për zgjidhjen e kontesteve.

Nuk është vendosur sistem funksional për monitorimin dhe menaxhimin e implikimeve financiare që rrjedhin nga kontestet e punës. Shfrytëzuesit buxhetorë nuk disponojnë mekanizma mjaftueshëm të zhvilluar për planifikimin real dhe shlyerjen me kohë të detyrimeve, që rezulton me shpenzime të konsiderueshme shtesë në bazë të kamatave, shpenzimeve gjyqësore dhe atyre përmbarimore.

Me qëllim të grumbullimit të të dhënave për pagesat sipas procedurave gjyqësore nga kontestet e punës, revizioni siguroi të dhëna nga institucionet që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nga 85 institucione të cilave u është dërguar kërkesë për të dhëna, janë pranuar të dhëna nga 69 institucione, prej të cilave 12 institucione nuk kanë pasur pagesa mbi këtë bazë. Në bazë të analizës së të dhënave, revizioni konstatoi se në periudhën 2020–2025 janë paguar gjithsej 3.971.570 mijë denarë, përkatësisht 64.369.000 euro, në bazë të procedurave gjyqësore që rrjedhin nga kontestet e punës, nga ana e institucioneve që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Analiza e mënyrës së pagesës tregon se vetëm 4,64% e mjeteve të përgjithshme të paguara janë realizuar përmes pagesës vullnetare, ndërsa pjesa dominuese, përkatësisht 95,36%, janë paguar nëpërmjet urdhrave për përmbarim.

Në strukturën e mjeteve të paguara, borxhi kryesor i përgjithshëm (pagesat vullnetare dhe urdhrat për përmbarim) arrin në 2.049.648 mijë denarë, që përfaqëson 51,61% të shpenzimeve totale, ndërsa shpenzimet në bazë të kamatave, procedurave kontestimore dhe shpenzimeve përmbarimore arrijnë në 1.921.922 mijë denarë, përkatësisht 48,39% të mjeteve të përgjithshme të paguara. Shuma e përgjithshme e mjeteve të paguara sipas procedurave gjyqësore nga kontestet e punës është paraqitur në Tabelë.

në 000 denarë

| | Pagesë e rregullt sipas kontestit gjyqësor nga marrëdhënia e punës | | | Pagesë sipas urdhrit për përmbarim | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Borxhi kryesor | Interesi | Shpenzimet e procedurës kontestimore | Borxhi kryesor sipas aktvendimit për përmbarim | Interesi sipas aktvendimit për përmbarim | Shpenzime sipas aktvendimit për përmbarim |
| 2020 | 31.542 | 2.719 | 5.408 | 127.528 | 24.280 | 112.170 |
| 2021 | 22.130 | 1.951 | 6.021 | 210.030 | 55.575 | 182.520 |
| 2022 | 23.684 | 2.060 | 4.931 | 257.654 | 50.230 | 254.861 |
| 2023 | 20.168 | 2.209 | 6.105 | 345.081 | 73.858 | 284.513 |
| 2024 | 20.089 | 2.942 | 7.219 | 654.818 | 133.299 | 364.788 |
| 2025 (30.09.2025) | 14.382 | 3.338 | 7.506 | 322.542 | 96.533 | 236.886 |
| GJITHSEJ | 131.995 | 15.219 | 37.190 | 1.917.653 | 433.775 | 1.435.738 |

Mënyra ekzistuese e evidentimit dhe ekzekutimit të pagesave nuk siguron të dhëna të mjaftueshme analitike dhe të strukturuara për monitorimin e plotë të detyrimeve totale dhe strukturës së tyre, që kufizon transparencën, llogaridhënien dhe mundësinë për menaxhim efikas të rreziqeve financiare.

Rekomandimet e dhëna në këtë raport kanë të bëjnë me aktivitetet që institucionet kompetente duhet t'i ndërmarrin me qëllim të eliminimit të shkaqeve të parregullsive të konstatuara, gjendjeve të identifikuara dhe rreziqeve potenciale të paraqitura në këtë raport, përkatësisht të ndërmarrin masa dhe aktivitete me të cilat do të krijojnë kushte për përmirësimin e kornizës normative, forcimin e kapaciteteve institucionale, vendosjen e një qasjeje sistematike dhe analitike në menaxhimin e kontesteve të punës, si dhe avancimin e evidencës, koordinimit dhe planifikimit financiar, me qëllim të zvogëlimit të numrit të kontesteve të punës dhe implikimeve të tyre financiare mbi buxhetin e shtetit.

## 5.2.3. TRAFIKU, TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMET

### NP HRMV INFRASTRUKTURA SHKUP

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të raporteve financiare së bashku me revizion të pajtueshmërisë në **Ndërmarrjen Publike për Infrastrukturë Hekurudhore Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup** për vitin 2024.

Pjesa më e madhe e mjeteve materiale në përgatitje të NP Hekurudhat e RMV – Infrastrukturë Shkup, në vlerë prej 8.898.087 mijë denarë, përfaqësojnë **projekte, zbatimi i të cilave është në vazhdim e sipër**: projekti „Projektimi dhe rehabilitimi i pjesës së mbetur të seksionit të parë Kumanovë – Bellakovcë" (Lot 1) dhe projekti „Ndërtimi i një seksioni të ri dhe rindërtimi i seksionit ekzistues Bellakovcë – Kriva Pallankë – pjesa lindore e linjës hekurudhore të Korridorit 8, faza 2" (Lot 2). Këto projekte financohen me kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat e ligjeve të miratuara për huamarrje. Të dhëna më të hollësishme për kreditë paraqiten në tabelën vijuese:

| Qëllimi i kredisë | Data e miratimit / përfundimit të kredisë | Shuma totale e kredisë së miratuar (korniza) | Shuma totale e patërhequr e mjeteve | Mjetet e tërhequra (në llogarinë në BPRMV) | Gjendja e detyrimeve më 31.12.2024 (kryegjë) | Detyrime të paguara nga kredia deri më 31.12.2024 (kryegjë) | Provizioni i paguar për miratim | Provizioni i paguar për mjetet e pa tërhequra nga miratimi deri më 31.12.2024 | Interesii paguar nga kredia nga miratimi deri më 31.12.2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Korridori 8 Faza 1 (42921) | 21.08.2012 20.04.2027 | 46.400.000 | 38.773* | 125.368 | 16.519.405 | 29.716.453 | 464.000 | 939.456 | 3.007.717 |
| Korridori 8 Faza 2 (44175) | 05.12.2012 20.10.2029 | 145.000.000 | 84.446.171 | 8.093.026 | 41.433.955 | 11.026.848 | 1.450.000 | 6.838.144 | 2.362.864 |
| | | 191.400.000 | 84.484.944 | 8.218.394 | 57.953.360 | 40.743.302 | 1.914.000 | 7.777.600 | 5.370.581 |

* Mjete të pa tërhequra për të cilat nuk dihet nëse do të shfrytëzohen

Analiza e kryer tregon se për rehabilitimin, ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës hekurudhore janë miratuar hua në vlerë totale prej 191,4 milionë euro, prej të cilave 44% ende nuk janë tërhequr. Për këtë arsye, deri në fund të vitit 2024 janë paguar **7,78 milionë euro provizione për mjetet e patërhequra (536 mijë euro në vitin 2024)**, ku pjesa më e madhe i referohet huasë për Korridorin 8 – Faza 2. Gjatë vitit 2024, në bazë të interesave për huatë, norma e të cilave është variabile dhe lëviz nga 4,84% deri në 5,14%, janë paguar gjithsej **2,85 milionë euro.**

Me revizionin konstatuam mungesën e qasjes sistematike dhe analitike, si dhe përgatitje të pamjaftueshme gjatë planifikimit, projektimit fillestar, ndërtimit dhe rindërtimit të seksioneve 1 dhe 2 të pjesës lindore të Korridorit Hekurudhor 8, ndërtimi i të cilit vazhdon që nga viti 1996, për shkak **që nuk është siguruar qasje e vazhdueshme, e pandërprerë dhe cilësore në infrastrukturën hekurudhore, si dhe organizimi dhe rregullimi i një trafiku hekurudhor të sigurt.** Për shkak të punimeve të shumta të paparashikuara dhe shtesë, janë bërë ndryshime dhe plotësime të projekteve bazë (variacione) dhe kërkesa shtesë (claims), që ka shkaktuar **rritje të vlerës së kontratave të lidhura dhe zgjatje të afateve për ndërtimin/rindërtimin e seksioneve.**

Vlera e kontratës për seksionin nr. 1 shënon **rritje prej 96% krahasuar me vlerën e kontratës së lidhur fillimisht** (39,7 milionë euro)*, ndërsa afati për përfundimin e projektit, për shkak të gabimeve në dokumentacionin projektues – gabime konstruktive dhe statike, zgjidhje teknike të papërshtatshme në raport me gjendjen ekzistuese në terren që kanë kërkuar shpronësime shtesë, ndryshime të materialeve, sinjalizimit dhe telekomunikacionit, rrugëve qasëse, ndërprerjes së kontratës dhe përzgjedhjes së një kontraktori të ri **është shtyrë për 8 vjet e 3 muaj.** Për seksionin nr. 2, në korrik të vitit 2022, **18 vjet pas ndërprerjes së ndërtimit dhe 8 vjet pas lidhjes së marrëveshjes së huasë,** është lidhur kontrata për ndërtim në vlerë prej 155 milionë euro, me afat të zgjatur të përfundimit deri më 23.10.2026.

Një pjesë e mjeteve materiale në përgatitje, përkatësisht 33%, janë furnizuar para 15 vitesh dhe asnjëherë nuk janë përdorur, që paraqet **shfrytëzim jo racional të mjeteve publike dhe** e vë në pikëpyetje arsyeshmërinë e furnizimit të tyre, ndërsa njëkohësisht ekziston mundësia e uljes së vlerës së tyre përdoruese. Gjithashtu, ekziston një mjet material në përgatitje (binar në të cilin është vendosur peshorja hekurudhore për matjen e vagonëve) në vlerë prej 49.348 mijë denarë, i cili është funksional dhe përdoret, ndërsa në evidencën kontabël **nuk është adekuat e njohur si patundshmëri.**

Me shqyrtimin e kryer në librat afaristë të ndërmarrjes, konstatuam se:

- për tokën me vlerë prej 7.222.463 mijë denarë nuk janë siguruar fletëpronësi;
- 91% e objekteve ndërtimore, përkatësisht 12.772.972 mijë denarë, përfaqësojnë objekte infrastrukturore lineare, të cilat nuk janë evidentuar në kadastrën e objekteve infrastrukturore pranë Agjencisë për Kadastër të Patundshmërive dhe
- për 88% të objekteve të tjera ndërtimore, ndërmarrja publike nuk posedon fletëpronësi me të cilat do të dëshmohej e drejta e regjistruar e pronësisë.

Ekzistojnë parregullsi edhe në mënyrën e menaxhimit dhe evidentimit të një pjese të rezervave të lëndëve të para, materialeve, pjesëve rezervë, inventarit të imët, ambalazhit dhe gomave të automjeteve.

Duke pasur parasysh se 75% e rezervave, përkatësisht 250.713 mijë denarë, janë më të vjetra se viti 2019, me revizionin konstatuam se në fund të periudhës kontabël nuk është përcaktuar vlera e tyre neto e realizueshme, me qëllim që të përcaktohet nëse ekziston dallim ndërmjet vlerës së vlerësuar të shitjes dhe vlerës së furnizimit, dhe nëse ekziston, të evidentohet në mënyrë përkatëse vlera më e ulët prej tyre, në përputhje me kërkesat e Rregullores për mbajtjen e kontabilitetit dhe SNK 2 – Stoqet



NP Hekurudhat e RMV – Infrastruktura Shkup vazhdimisht paraqet humbje nga veprimtaria operative, ku për vitin 2024 humbja arrin në 188.775 mijë denarë, ndërsa së bashku me humbjen e bartur nga vitet e mëparshme (4.536.122 mijë denarë) arrin shumën totale prej 4.724.897 mijë denarë.

* përfërsisht 2 milionë euro për 1 km për rehabilitimin e Korridorit 8, faza 1




**Humbjet e vazhdueshme në veprimtarinë e ndërmarrjes ndikojnë negativisht në funksionimin aktual dhe të ardhshëm të ndërmarrjes publike, në zhvillimin e saj dhe vënë në pikëpyetje menaxhimin efikas, mirëmbajtjen dhe sigurinë e infrastrukturës hekurudhore dhe të trafikut hekurudhor.**

Nga analiza e kryer e numrit të të punësuarve, strukturës së moshës dhe kualifikimeve, revizioni konstatoi se nga gjithsej 1.314 vende pune të sistematizuara në aktin e sistematizimit, janë plotësuar vetëm 54% ose 718 vende pune. Paraqitja grafike e strukturës së moshës së të punësuarve tregon se përqindjen më të lartë e përbëjnë të punësuarit në moshën nga 56 deri në 60 vjeç. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 30% nuk i plotësojnë kushtet* e veçanta lidhur me shkallën ose llojin e arsimit, ndërsa 5% nuk i plotësojnë kushtet shtesë të përcaktuara me aktin e sistematizimit, që mund **të ndikojë negativisht në organizimin e punës, shpërndarjen e detyrave, si dhe në kryerjen cilësore të veprimtarisë.**




* Provim i dhënë për revizor të brendshëm, licencë për sigurim fizik dhe teknik të pasurisë dhe personave, provim periodik i dhënë, dëshmi për punëtor të kualifikuar, certifikatë për punë me informacione të klasifikuara, licencë për siguri dhe mbrojtje në punë, provim profesional i dhënë në hekurudhë, certifikatë për kontabilist të autorizuar, provim profesional i dhënë për saldim AT, autorizim nga Oda e Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar, kurs për mbrojtje kundër zjarrit.

Nga viti 2020 e deri në periudhën e kryerjes së revizionit është vendosur praktikë, mungesa e personelit të plotësohet përmes sistemimit të të punësuarve me vendime të përkohshme në vende pune të sistematizuara, në vend që të zbatohen procedura për punësim (me shpallje publike) ose avancim (me shpallje të brendshme), **që nuk është në përputhje me parimin e kushteve të barabarta, qasjes së barabartë në vendin e punës, përfaqësimit adekuat dhe të drejtë, si dhe me parimin e profesionalizmit dhe kompetencës gjatë punësimit dhe avancimit të të punësuarve.** Nga gjithsej 96 të punësuar të sistemuar me vendime të përkohshme gjatë vitit 2024, 55% nuk i kanë përmbushur kushtet e veçanta për vendin e punës, ndërsa 12% e të **punësuarve nuk i kanë përmbushur kushtet shtesë të përcaktuara me aktin e sistematizimit të vendeve të punës të ndërmarrjes.** Të punësuarit përgjegjës kanë arsyetuar se kjo mënyrë e plotësimit të vendeve të punës është zbatuar për shkak të mungesës së personelit në ndërmarrjen publike, që paraqet një problem thelbësor për funksionimin e trafikut hekurudhor në shtet.



Traversa të dëmtuara nga zjarri – segmenti Tetovë – Jegunovcë

Në lidhje me kryerjen e veprimtarisë themelore të ndërmarrjes publike, e cila përfshin menaxhimin, ndërtimin, rindërtimin, remontin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore, organizimin dhe rregullimin e trafikut hekurudhor dhe menaxhimin e sistemeve për rregullim dhe siguri, revizioni konstatoi se infrastruktura **hekurudhore është e vjetruar, e mirëmbajtur në mënyrë të pamjaftueshme dhe pjesërisht jofunksionale.** Në një pjesë të korridoreve kryesore (10, 10d dhe 8), qarkullimi zhvillohet me shpejtësi të reduktuar për shkak të defekteve të shumta, sistemeve të vjetruara dhe traversave të dëmtuara nga zjarri, ndërsa në disa seksione trafiku është ndërprerë plotësisht. **Për më shumë se 40 vjet nuk janë realizuar investime të rëndësishme, gjë që rrezikon sigurinë, kapacitetin e trafikut hekurudhor dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë.** Për shkak të këtyre gjendjeve, theksojmë nevojën për investime të konsiderueshme për modernizimin dhe rinovimin e infrastrukturës hekurudhore.

Revizioni konstatoi se **regjistrimi vjetor i mjeteve dhe detyrimeve** si dhe harmonizimi i gjendjes kontabël me gjendjen faktike të përcaktuar me regjistrim, nuk janë zbatuar plotësisht, si dhe mos harmonizimi i politikave kontabël që zbatohen gjatë përgatitjes, prezantimit dhe zbardhjes së raporteve financiare.

Po ashtu, është evidentuar **mungesa e evidencës adekuate për kilometrat e përshkuar nga automjetet zyrtare,** si bazë për llogaritjen dhe monitorimin e konsumit mesatar të karburantit për secilin automjet.

Me revizionin e kryer janë konstatuar edhe një sërë gjendjesh, parregullsish dhe mospërputhjesh të tjera të natyrave të ndryshme.



# HEKURUDHAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TRANSPORT SHA

HEKURUDHAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TRANSPORT SHA – SHKUP

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të raporteve financiare së bashku me revizion të pajtueshmërisë në Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut Transport SHA Shkup për vitin 2024.

Me revizionin e kryer konstatuam gjendje që ndikojnë në funksionimin e shoqërisë dhe në mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve publike, ndër të cilat:

Mjetet materiale në përgatitje në vlerë prej 118.016 mijë denarësh, ose rreth 1.913.000 euro, i referohen objektit të përfunduar të kategorisë së parë **„Rikonstruksioni dhe adaptimi i punishteve për mirëmbajtjen e mjeteve hekurudhore"**, e cila, pavarësisht se janë siguruar të gjitha dokumentet e nevojshme (lejet e ndërtimit dhe leja e përdorimit) nga organi kompetent dhe punishtet janë përdorur për vite me radhë për kryerjen e proceseve të rregullta të punës lidhur me mirëmbajtjen e parkut hekurudhor, në librat afariste të shoqërisë **nuk është njohur/evidentuar në mënyrë adekuate si patundshmëri dhe nuk është përllogaritur dhe njohur shpenzimi i amortizimit** për periudhën paraprake në shumën prej 11.407 mijë denarë dhe për vitin 2024 në shumën prej 2.950 mijë denarë, që ndikon në rezultatin financiar dhe në cilësinë e informacionit dhe të dhënave të paraqitura në raportet financiare.

Rikonstruksioni është pjesë përbërëse e **"„Projektit për rinovimin e parkut hekurudhor të Hekurudhave të Maqedonisë SHA Shkup"**, i financuar me kredi nga BERZH, nëpërmjet të cilit janë furnizuar trena të rinj me naftë me tre njësi motorike dhe trena elektrikë me tre njësi motorike për transportin e udhëtarëve, si dhe 150 vagona të rinj (75 vagona platformë dhe 75 vagona të hapur). Gjithashtu, janë siguruar dhe mjete për rehabilitimin e lokomotivave elektrike. Pavarësisht këtyre furnizimeve, personeli profesional i shoqërisë vë në dukje se **parku hekurudhor është i vjetëruar, me moshë mbi 40 vjet**, duke theksuar se nga gjithsej 1.382 vagona mallrash, vetëm 378 janë me revizion të vlefshëm (janë të aftë për qarkullim), ndërsa 1.004 vagona mallrash kanë revizion të skaduar dhe janë jashtë qarkullimit.



**Halla me punishtet**

**Shoqëria disponon me 62 lokomotiva, nga të cilat vetëm 9 janë funksionale, si dhe 16 garnitura pasagjerësh prej të cilave vetëm 5 janë në funksion, dhe 47 vagona pasagjerësh, prej të cilave vetëm 2 janë në qarkullim të rregullt dhe përdoren për kryerjen e transportit të udhëtarëve.**

Për realizimin e vëllimit të planifikuar të punës dhe të orarit të qarkullimit, shoqëria duhet të disponojë me kapacitete tërheqëse dhe të tërhequra në gjendje të rregullt teknike, ndërsa gjendja e tyre aktuale ndodhet në kufijtë e kapacitetit teknik-teknologjik të shfrytëzimit. Arsyet e gjendjes aktuale të kapaciteteve tërheqëse lidhen me vjetërsinë e tyre dhe me mungesën e investimeve në

kohë për riparime të mesme dhe të mëdha, për shkak të mjeteve të pamjaftueshme financiare, investimeve të parregullta në pjesë këmbimi dhe mungesës së rinovimit të parkut hekurudhor. Struktura e vjetruar e kapaciteteve tërheqëse e rëndon procesin e shfrytëzimit, rrit konsumin e energjentëve dhe shton numrin e lëvizjeve pa ngarkesë të mjeteve hekurudhore.

Kjo gjendje rrit rrezikun për zhvillimin e sigurt të trafikut hekurudhor për shkak të mundësisë së defekteve, ndërsa në të njëjtën kohë kufizon aftësinë e shoqërisë për të kryer në kohë dhe me cilësi veprimtarinë e saj.

Nga shqyrtimi i kryer në librat afariste të shoqërisë konstatuam se për ndërtesat ekonomike dhe objektet e komunikacionit të evidentuara, shoqëria nuk disponon me fletëpronësi që do të dëshmonin të drejtën e regjistruar të pronësisë dhe nuk është kryer as lidhja e fletëpronësive të siguruara me mjetet e evidentuara.

Me revizionin konstatuam se **regjistrimi vjetor** i mjeteve dhe detyrimeve, si dhe harmonizimi i gjendjes kontabël me gjendjen faktike të përcaktuar përmes regjistrimit, nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë.

Ekzistojnë parregullsi edhe në mënyrën e menaxhimit dhe evidentimit të një pjese të stoqeve të lëndëve të para, materialeve, pjesëve rezervë, inventarit të imët, ambalazhit dhe gomave automobilistike. Duke pasur parasysh se 71% e stoqeve, ose 342.345 mijë denarë, përkatësisht 5.548.000 euro, janë më të vjetra se viti 2019, me revizionin konstatuam se në fund të periudhës kontabël nuk është përcaktuar vlera e tyre neto e realizueshme, me qëllim që të përcaktohet nëse ekziston dallim ndërmjet vlerës së vlerësuar të shitjes dhe vlerës së furnizimit dhe, nëse ekziston, të evidentohet në mënyrë të përshtatshme vlera më e ulët, në përputhje me kërkesat e Rregullores për mbajtjen e kontabilitetit SNK 2 – Stoqet.



**Pajisje për matje**

Konstatuam trajtim joadekuat, **joekonomik dhe të pasigurt gjatë pranimit dhe lëshimit të naftës, që mund të rrezikojë sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve, si dhe mjedisin jetësor.** Konkretisht, pajisjet me të cilat disponon shoqëria për matjen e pranimit dhe lëshimit të sasive të naftës janë të vjetruara dhe të improvizuara, për shkak të së cilës nuk paraqesin gjendjen reale në çdo moment, veçanërisht, matësi për lëshimin e naftës është i papërshtatshëm dhe i vjetëruar, ndërsa për shkak të mundësisë që treguesi të kthehet në zero, ai është lehtësisht i manipulueshëm. Gjithashtu dhe furnizimi i automjeteve me karburant kryhet përmes pompave, matësit e të cilave për një periudhë të gjatë kohore nuk janë verifikuar/kalibruar.



**Pajisje për matje**

Shoqëria, në vend të shlyerjes me kohë të detyrimeve të maturuara, ka vendosur praktikën e paraqitjes së kundërshtimeve ndaj urdhërpagesave gjyqësore, që ka rezultuar me zvarritjen e procedurave gjyqësore dhe rritjen e konsiderueshme të detyrimeve në bazë të borxhit kryesor, kamatave dhe shpenzimeve gjyqësore. **Pavarësisht ekzistencës së procedurave gjyqësore të përfunduara me vendime të formës së prerë dhe probabilitetit të lartë për dalje të burimeve ekonomike në shumën prej 260.982 mijë denarësh (4.243.600 euro), shoqëria nuk ka kryer rezervim** të mjeteve në përputhje me SNK 37, për shkak të së cilës detyrimet, shpenzimet dhe rezultati financiar nuk janë paraqitur në mënyrë reale dhe objektive në pasqyrat financiare.

Përmes faturave për konsumin e ujit, të cilat në vitin 2024 arrijnë shumën totale prej 5.471 mijë denarë, është konstatuar një **konsum i tepruar i ujit** që nuk është i përshtatshëm për veprimtari administrative dhe shërbyese, ku uji nuk përbën pjesë përbërëse të procesit të prodhimit. Kjo tregon se shoqëria nuk ka vendosur një sistem të përshtatshëm për monitorimin dhe kontrollin me kohë të konsumit të ujit, që ka rezultuar me shpenzime të konsiderueshme.

Me revizionin konstatuam **të ardhura më pak të paraqitura** se niveli real në bazë të shërbimeve të kryera për përdorimin e lokomotivave, si dhe ofrimin e shërbimeve **pa marrëdhënie kontraktuale të qarta dhe të vlefshme, si dhe pa vendosjen dhe përditësimin e rregullt të një politike çmimesh** që pasqyron kushtet e tregut dhe kostot e veprimtarisë. Konkretisht, në vitin 2022 është lidhur një kontratë me afat vlefshmërie prej një viti me një person juridik, me çmime më të ulëta se ato të përcaktuara në tarifë, dhe pas skadimit të afatit të kontratës është vazhduar me ofrimin e shërbimit pa korrigjim të çmimeve edhe gjatë periudhës së kryerjes së revizionit.

Ekzistojnë **dobësi në menaxhimin e burimeve njerëzore,** në zbatimin e rregullativës ligjore dhe të brendshme në fushën e marrëdhënieve të punës, në organizimin e proceseve të punës, si dhe në sistemin e përllogaritjes dhe pagesës së pagave dhe kompensimeve.

HRMV Transport SHA Shkup **vazhdimisht ka shënuar humbje** nga veprimtaria, ku për vitin 2024 humbja arrin në 331.796 mijë denarë, ndërsa së bashku me humbjen e bartur nga vitet e kaluara (6.442.424 mijë denarë), arrin një shumë totale prej 6.754.219 mijë denarë, përkatësisht 109.115.000 euro.




**Humbjet e vazhdueshme në funksionim ndikojnë negativisht në veprimtarinë aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë, në zhvillimin e saj dhe e vënë në pikëpyetje zhvillimin efikas, të sigurt dhe në kohë të trafikut hekurudhor.**

Me revizionin e kryer konstatuam edhe gjendje të tjera, parregullsi dhe mosharmonizim të natyrave të ndryshme, të cilat ndikojnë në funksionimin e subjektit juridik.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara, kemi dhënë një sërë rekomandimesh ndaj personave përgjegjës për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara.

## 5.2.4. CILËSIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE GRUMBULLIMI, SHPENZIMI DHE SHFRYTËZIMI I MJETEVE DHE BURIMEVE PUBLIKE

### AGJENCIA PËR KADASTËR TË PATUNDSHMËRIVE, SHKUP

Agjencia ka kompetenca në fushën e menaxhimit të sistemit informativ gjeodezik-kadastral, kryerjes së punëve gjeodezike, matjes së pasurive të paluajtshme, themelimit dhe mirëmbajtjes së kadastrës së pasurive të paluajtshme, mbajtjes së disa llojeve të regjistrave të përcaktuar me Ligjin për kadastrën e pasurive të paluajtshme, si dhe kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën e tregtarëve individualë – gjeodetëve të autorizuar dhe shoqërive tregtare për punë gjeodezike, ndërsa për punën e saj përgjigjet para Qeverisë.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2024 të Agjencisë, kemi konstatuar gjendje që tregojnë për vlerë të vlerësuar joreale të objekteve ndërtimore me të cilat menaxhon Agjencia, për shkak të evidencës jo të plotë të tyre dhe vlerës së papërcaktuar për një pjesë të objekteve.

Regjistrimi i mjeteve të përhershme dhe i rezervave nuk është i plotë.

Të hyrat që i realizon Agjencia nga arkëtimi i kompensimeve për shërbimet që i ofron, e që paguhen përmes pos-terminaleve, jo gjithmonë mund të lidhen me llojin e shërbimit të ofruar përmes shenjës së brendshme arkivore dhe kodit të të hyrave në evidencën kontabël, si dëshmi se për shërbimet e ofruara janë arkëtuar kompensimet përkatëse. Kjo për arsye se banka afariste me të cilën është lidhur marrëveshje për vendosjen e pos-terminaleve fizike dhe virtuale për pagesën e shërbimeve të kryera, edhe pse me marrëveshje ka qenë e obliguar të vendosë lidhje të numrave të veçantë arkivorë me kodet/llogaritë përkatëse të të hyrave sipas llojit të shërbimit për më shumë sisteme të Agjencisë, e njëjta nuk është siguruar.

Me qëllim të sigurimit se shërbimet kadastrale të ofruara janë kryer në mënyrë dhe me dokumentacion shoqërues të përcaktuar me rregulloret, dekretet dhe procedurat e brendshme të Agjencisë, kemi kryer kontroll në dosjet e 100 lëndëve të llojeve të ndryshme të shërbimeve, me ç'rast konstatuam se në:




Paplotësia e dokumentacionit dhe autorizimit të tij e vështirëson ndjekjen dhe kontrollin e aktiviteteve të zbatuara në përputhje me procedurat e brendshme dhe rregullativën përkatëse ligjore, si dhe krijon rrezik për veprim dhe marrje të vendimeve pa dokumentacion përkatës mbështetës.

Konstatuam se janë shpenzuar **3.255 mijë denarë** pa zbatimin e procedurave përkatëse, prej të cilave 46% janë shpenzuar për nevojat e organizatës sindikale pranë Agjencisë.

Në pjesën e theksimit të çështjeve, kemi theksuar se në përputhje me nenin 57 të Ligjit për përdorimin dhe disponimin me sendet në pronësi shtetërore dhe me sendet në pronësi komunale, Agjencia ka obligim për vendosjen e evidencës unike për pronën e paluajtshme në pronësi shtetërore që përdoret nga organet shtetërore dhe personat juridikë të themeluar nga shteti, në bazë të Numrit Unik Identifikues (NUI), të cilin e përcakton Qeveria, me propozim të Agjencisë.

NUI caktohet në bazë të të dhënave nga regjistri i të punësuarve në sektorin publik që e mban Ministria e Administratës Publike. Nuk është caktuar NUI për personat juridikë – shoqëritë tregtare të themeluara nga shteti, pasi nuk ekziston obligim ligjor që Ministria e Administratës Publike t'i përfshijë ato në regjistrin e të punësuarve në sektorin publik.

## SHËRBIMI PËR PUNË TË PËRGJITHSHME DHE TË PËRBASHKËTA I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT.




Kemi kryer revizion të raporteve financiare të Shërbimit për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024, me ç'rast kemi konstatuar gjendje që, ndër të tjera, kanë të bëjnë me:

- angazhimi i një numri të madh personash përmes agjencive private të punësimit, me kohë të caktuar dhe me kontratë në vepër për kryerjen e veprimtarisë së SHPPP-së, ndikon në sigurimin e vazhdueshëm të shërbimeve për institucionet e tjera, si dhe në cilësinë e informatave të paraqitura në raportet financiare për organet shtetërore që i shfrytëzojnë shërbimet.

- mjete themelore të vlerësuara në mënyrë joreale:

  - **Tokë – 19.970.454 mijë denarë:** sipërfaqja e tokës në evidencë nuk është harmonizuar me të dhënat nga fletët pronësore; ende evidentohet tokë e cila prej kohësh është shitur dhe mbi të janë ndërtuar objekte të një subjekti juridik privat. Për tokën në Strumicë, Kërçovë, Kumanovë, Veles, Shtip dhe Dojran, SHPPP nuk ka të dhëna dhe informata nëse dhe për çfarë përdoret, si dhe nëse ka ndryshime në pronësi;

  - **Pajisje – 134.704 mijë denarë, me vlerë aktuale:** 92% e vlerës së pajisjeve është e amortizuar, gjë që tregon se SHPPP disponon me pajisje të vjetra. Janë evidentuar 865 pompa uji dhe 18 gjeneratorë të blerë në vitin 2016 për përballimin e përmbytjeve në fshatin Stajkovc, për të cilat janë shpenzuar 19.592 mijë denarë. Pjesa më e madhe u janë dhënë Ministrisë së Mbrojtjes – ARM-së, ndërsa një pjesë komunave Shuto Orizare, Aerodrom, Ilinden dhe Haraçinë, pa u mbështetur me dokumentacion përkatës;

  - **Rezerva – 48.247 mijë denarë,** prej të cilave 95% janë rezerva të vjetruara dhe të papërdorshme, të cilat nuk janë shlyer. Për mungesën e konstatuar të inventarit të imët në përdorim, në shumë prej 4.208 mijë denarë, nuk është përcaktuar nëse e njëjta është rezultat i menaxhimit jo të duhur nga ana e të punësuarve apo për shkak të mospërputhjeve të konstatuara në aplikacionin softuerik për rezervat.

- mosharmonizim në pjesën e „kushteve të tjera të veçanta" për vendin e punës „avio-dispeçer" në Njësinë për transport me mjete ajrore, të parashikuara me rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Shërbim (me ose pa licencë për avio-dispeçer), në raport me kërkesat për posedimin e licencës sipas Rregullores për dispeçerë të fluturimeve, kur me të njëjtin sistematizim, për vendin e punës „ndihmës avio-dispeçer", i cili është vend pune më i ulët se ai paraprak, është paraparë posedimi i detyrueshëm i licencës për avio-dispeçer;

Si gjendje gjatë zbatimit të furnizimeve publike, konstatuam elemente favorizuese në pjesën e dëshmimit të aftësisë teknike dhe profesionale gjatë realizimit të

* „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 78/15, 106/15, 153/15, 190/16, 21/18 dhe „ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 101/19, 275/19, 122/21 dhe 193/25)
* Gazeta zyrtare e RM nr 161/11, 108/12, 9/16 dhe Gazeta zyrtare nr 145/24)

furnizimit me shërbime për sigurimin fizik të objekteve të administratës shtetërore nga viti 2021, si dhe pjesë rezervë të furnizuara për servisimin e automjeteve me të cilat disponon Shërbimi në vitin 2024 nga dy operatorë ekonomikë, prej të cilave afërsisht 50% nuk janë paraparë në specifikacionin teknik dhe listën e çmimeve, gjë që tregon për planifikim jo të duhur të pjesëve të nevojshme.

Në lidhje me shërbimet në objektet hotelierike – restorante dhe bufete me të cilat menaxhon Shërbimi, konstatuam se:

- nuk mbahet Libri i raporteve financiare ditore me të dhëna të regjistruara për qarkullimin e përgjithshëm dhe TVSH-në, të parapara me Ligjin për regjistrimin e pagesave në para të gatshme;
- pagesa e mjeteve monetare të realizuara nga shërbimet e arkëtuara në para të gatshme kryhet me vonesë prej disa muajsh, ndërsa ka edhe pagesa të qarkullimit ditor që rrjedhin nga viti 2023;
- për shkak të ndërprerjes në mirëmbajtjen e aparaturës fiskale ekziston shumë e ulët e qarkullimit ditor të paguar, ndërsa për muajin qershor 2024 nuk janë lëshuar kuponë fiskalë, as blloqe paragoni për qarkullimin e realizuar në para të gatshme;
- për vlerën e paharmonizuar të rezervave të produkteve ushqimore në magazinën kryesore dhe evidencën kontabël në shumë prej 4.187 mijë denarë nuk janë propozuar masa për zgjidhjen e gjendjeve.

Kemi dhënë rekomandime për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve nga personat dhe organet kompetente për tejkalimin dhe përmirësimin e gjendjeve të konstatuara.

Në pjesën e Theksimit të Çështjeve, kemi zbuluar gjendje të caktuara të cilat rrjedhin në punën e SHPPP-së. Për sigurimin e 45 automjeteve të klasës së lartë për më shumë institucione përmes lizingut, kemi theksuar se nevojiten procedura ose udhëzime për përcaktimin e nevojës për furnizim me automjete nga institucionet, duke siguruar informata nëse ndërkohë kanë ndryshuar nevojat e tyre, si dhe kryerjen e një analize të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të arsyeshmërisë ekonomike të lizingut, përkatësisht të merren parasysh të gjitha shpenzimet në raport me të gjitha përfitimet që rrjedhin prej tij ose analiza Cost-benefit.

I sugjeruam organeve kompetente për nevojën e një dinamike më të shpejtë të aktiviteteve për vendosjen e regjistrit të pasurisë së paluajtshme të shtetit nga arsyeja se për shkak të ndryshimeve të shpeshta të përdoruesve, objekteve, sipërfaqes së hapësirave afariste dhe përdorimit të tyre të përkohshëm me vendimet që i merr Qeveria:

- ekziston pasiguria gjatë përdorimit dhe disponimin me token përreth dhe poshtë ndërtesave;
- mbetet e parregulluar çështja për mirëmbajtjen të rregullt dhe investuese të objekteve kur janë të vendosur më shumë institucione;
- rrezik i evidencës jo të plotë të pasurisë me të cilën menaxhojnë Shërbimi për shkak të evidence të vendosur në mënyrë të papërshtatshme.

Gjithashtu zbuluam dhe për gjendjen me burimet njerëzore në SHPPP, me ç'rast numri i madh i të punësuarve me kohë të caktuar dhe i personave të angazhuar përkohësisht, migrimi i shpeshtë si dhe investimi i pamjaftueshëm në avancimin e kompetencave profesionale të të punësuarve, krijon rrezik në sigurimin e vazhdimësisë dhe cilësisë gjatë përgatitjes së raporteve financiare për institucionet shtetërore që janë shfrytëzuese të këtyre shërbimeve.



## ARKIVI SHTETËROR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (Arkivi Shtetëror) kryen rregullimin, mbrojtjen, ruajtjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e materialit arkivor, si dhe mbikëqyrjen inspektuese që lidhet me këtë veprimtari.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2024, konstatuam gjendje, parregullsi dhe mos harmonizim në punën e llogarive të buxhetit themelor (637) dhe (631).

Arkivi Shtetëror nuk i ka siguruar kushtet e nevojshme hapësinore për vendosjen dhe ruajtjen e materialit arkivor në depot arkivore, me qëllim mbrojtjen e materialit arkivor nga ndikimi i dëmshëm i temperaturës, lagështisë, dritës, rrezatimit, pluhurit, mikroorganizmave, insekteve, brejtësve dhe dëmtimeve fizike, si dhe nuk ka siguruar kushte për mbrojtjen nga qasja e paautorizuar në materialin arkivor dhe dokumentar.

### RUAJTJA E MATERIALIT ARKIVOR






Janë konstatuar dobësi edhe në mënyrën e evidentimit të mjeteve të përhershme dhe në mënyrën e zbatimit të regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve, ndërsa njëkohësisht nuk është kryer harmonizimi i gjendjes kontabël me gjendjen faktike të përcaktuar me regjistrim. Për një pjesë të objekteve të Arkivit Shtetëror nuk ekzistojnë dëshmi nëse ato janë evidentuar në librat afaristë dhe nuk janë ndërmarrë aktivitete për sigurimin e mjeteve të përhershme.

Gjithashtu, nuk kryhet evidentim i përditësuar dhe kronologjik i lëvizjes së rezervave të botimeve të publikuara, si dhe janë konstatuar dobësi në mënyrën e zbatimit të procedurave dhe realizimit të prokurimeve publike.

Ekzistojnë mospërputhje në mënyrën e realizimit të të hyrave vetanake, në dhënien e zbritjeve, në pagesën e panevojshme të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për shërbimet që lidhen me veprimtarinë themelore të Arkivit Shtetëror, si dhe janë paguar kompensime për të punësuarit pa bazë ligjore.

Arkivi Shtetëror nuk ka vendosur funksionin e revizionit të brendshëm, që tregon mungesën e një mekanizmi që do të siguronte përmirësimin e proceseve të punës dhe ofrimin e këshillave për menaxhmentin.

Në pjesën Theksimi i Çështjeve është shpalosur gjendja lidhur me objektin e ri të ndërtuar dhe të ndarë, i cili nuk është në përputhje me standardet për veprimtari arkivore, që ndikon në veprimtarinë themelore të Arkivit Shtetëror – ruajtjen e materialit arkivor, i cili paraqet trashëgimi kulturore dhe historike me interes të veçantë kombëtar për shtetin.

## 5.2.5. VEPRIMTARITË KOMUNALE PUBLIKE

### NP HIGJIENA KOMUNALE SHKUP

Është kryer revizion i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2024 në Ndërmarrjen Publike „Higjiena Komunale“ Shkup, me ç'rast janë konstatuar gjendjet si vijojnë:

Janë konstatuar dobësi në evidentimin e paluajtshmërive dhe objekteve infrastrukturore, nuk është siguruar e drejta e pronësisë dhe nuk është evidentuar pajisja (gjysmërimorkio) e regjistruar në pronësi të ndërmarrjes publike, me vlerë prej 29.048 mijë denarë.

Kryegjëja e evidentuar në librat afaristë në vlerë prej 223.146 mijë denarë paraqet gjendje të bartur sipas bilancit të ndarjes nga viti 1992, gjatë ndarjes së NP Komunalec Shkup, kur është themeluar NP Higjiena Komunale – Shkup, por mungon dokumentacioni përkatës dhe i njëjti nuk është regjistruar në Regjistrin Qendror.

Pjesa dominuese e kërkesave ka arkëtueshmëri dukshëm të zvogëluar ose të pasigurt, si rezultat i regjistrimit të shfrytëzuesve pa verifikim përkatës dhe pa kontrata të lidhura, si dhe për shkak të pjesëmarrjes së lartë të kërkesave të harmonizuara në vlerë, të cilat përbëjnë 74,52% të kërkesave të përgjithshme në bazë të shërbimeve komunale.



MAGAZINA – PJESË REZERVË

Nga pjesët rezervë në stoçe, 40% janë furnizuar në vitin 2009, të njëjtat janë të vjetruara dhe pa vlerë reale përdorimi, ndërsa për to nuk është kryer harmonizimi i vlerës. Mungesa e planifikimit dhe koordinimit të duhur të aktiviteteve që lidhen me furnizimin dhe lëshimin e rezervave rezulton me shpenzim jo racional të mjeteve të ndërmarrjes publike dhe ka ndikim negativ në likuiditetin e saj.

Për shkak të mosmiratimit të Planeve Vjetore për Punësim nga themeluesi, ndërmarrja publike gjatë vitit 2024 ka angazhuar 354 persona si ofrues shërbimesh, nëpunës administrativë dhe personel ndihmës-teknik, duke evidentuar shpenzime në vlerë prej 185.680 mijë denarësh, që tregon mungesë të qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore që duhet të kryejnë detyrat e rregullta të punës në ndërmarrje.

## Angazhimi përmes agjencisë private për punësim

ЈП КОМУНАЛНА ХИГИЕНА - СКОПЈЕ
NP HIGJIENA KOMUNALE - SHKUP

**185.680**
Mjete të paguara
(000 denarë)

**338**
Numri mesatar i personave të angazhuar

**315–350**
Diapazoni mujor i personave të angazhuar




Revizioni konstatoi parregullsi në mënyrën e llogaritjes së pagës së drejtorit dhe tek puna jashtë orarit e nëpunësve administrativë.

Ndërmarrja publike evidenton një raport të pafavorshëm ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve (nën 1), profitabilitet negativ (humbje), likuiditet të reduktuar, si dhe efikasitet të përkeqësuar të biznesit, i shprehur përmes periudhës së zgjatur të arkëtimit të kërkesave (140 ditë) dhe periudhës së shtuar të pagesës së detyrimeve (108 ditë).

Për shkak të nivelit të lartë të detyrimeve (736.948 mijë denarë) dhe likuiditetit të zvogëluar, ndërmarrja përballet me vonesa në pagesat ndaj furnizuesve, që rezulton me kamata, gjoba dhe rrezik të bllokimit të llogarive, të cilat i thellojnë humbjet dhe i kufizojnë investimet në parkun e automjeteve, pajisje dhe infrastrukturë, duke e ulur në afat të gjatë efikasitetin dhe duke e rritur varësinë nga kreditë dhe subvencionet.

**Është konstatuar nivel i lartë i jofunksionalitetit të parkut të automjeteve (rreth 60% e automjeteve jashtë përdorimit), përkatësisht nga gjithsej 189 automjete speciale komunale me të cilat disponon ndërmarrja, vetëm 76 janë në gjendje funksionale, ndërsa 80 janë të prishura dhe 33 janë të dëmtuara rëndë, ose gjithsej 113 automjete janë jofunksionale, me moshë mesatare prej 15 vitesh dhe me aftësi të zvogëluar për gjenerimin e përfitimeve ekonomike.**



AUTOMJET JO FUNKSIONAL



AUTOMJET AVARIE

## Struktura dhe gjendja e parkut të automjeteve

**Kapaciteti Total**

**189**

**Statusi Kyç**

**60%** JOFUNKSIONALE

Gjithsej **113** automjete janë jofunksional ose defekt në bazë

**Në përdorim** 40% **76**

Automjete që janë funksionale dhe në dispozicion për kryerjen e detyrave

**Jashtë përdorimit / të prishura** 42% **80**

Automjete që janë të prishura dhe jashtë funksionit për shkak të defekteve

**Të dëmtuara rëndë** 18% **33**

Automjete që janë të dëmtuara rëndë dhe ekonomikisht të paarsyeshme për riparim

Revizioni thekson se janë të nevojshme aktivitete të orientuara drejt eliminimit të vështirësive dhe problemeve të cilat periudhe më të gjatë janë të pranishme në funksionimin e ndërmarrjes, hartimi dhe zbatimi i një strategjie për rinovimin dhe modernizimin e parkut të automjeteve, të përshtatur me vëllimin e aktiviteteve dhe regjimin e punës 24/7, si dhe vendosja e sistemit për monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes teknike dhe arsyeshmërisë ekonomike të mirëmbajtjes. Me këtë do të sigurohet shfrytëzim më efikas i burimeve dhe ruajtja e vazhdimësisë dhe cilësisë në ofrimin e shërbimit publik.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara janë dhënë rekomandime me qëllim ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve nga institucionet kompetente dhe personat përgjegjës.



## NP SISTEMI KOLEKTOR SHKUP

Është kryer revizion i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2024 te NP „Sistemi Kolektor" Shkup, me ç'rast janë konstatuar gjendjet si vijojnë:

NP 'Sistemi Kolektor' Shkup nuk ka qasje të plotë në kërkesat prej 364.491 mijë denarë (5.926.683 euro), të marra pas ndryshimit të statusit nga shoqëritë e lidhura NP „Ujësjellës" Ohër dhe NP „Ujësjellës dhe Kanalizim" Strugë, të cilat lidhen me përdoruesit e lidhur në sistemin kolektor deri më 30.06.2019. Për shkak se shoqëritë e lidhura i posedojnë bazat e përdoruesve dhe nuk kanë interes ekonomik për të nisur procedura për arkëtimin e kërkesave që i takojnë NP „Sistemi Kolektor" Shkup, në praktikë iniciohet fshirja e tyre.

Objektet infrastrukturore (tubacioni me gjatësi prej 40,9 km, stacionet e pompimit, stacioni i pastrimit), të ndërtuara para më shumë se 35 viteve, me vlerë të vlerësuar në 129.948 mijë denarë (2.112.976 euro), nuk janë të regjistruara në Kadastërin e objekteve infrastrukturore.



STACIONI I POMPIMIT PODMOLJE



STACIONI I PASTRIMIT VRANISHTA

Kryegjëja themelor i marrë në vlerë prej 251.452 mijë denarë nuk është regjistruar në Regjistrin Qendror.

Në Regjistrin Qendror nuk është regjistruar pjesa e kapitalit bazë të marrë në vlerë prej 251.452 mijë denarë (4.088.650 euro), në përputhje me ndryshimin statusor – bashkimin e NJP Kolektor Strugë, si pjesë e Ndërmarrjes Publike Ndërkomunale „Proakva", në qershor të vitit 2019.

Në vitin 2024, mbi bazën e shërbimeve avokatore është paguar një paushall prej 519 mijë denarë, në bazë të një kontrate të lidhur në vitin 2020 me kushte të pafavorshme kontraktuale dhe implikime të rëndësishme financiare. Kontrata është me afat prej 10 vitesh, ndërsa në rast të ndërprerjes së njëanshme, ndërmarrja është e detyruar të respektojë një afat njoftimi prej 90 ditësh, të paguajë një kompensim të njëhershëm prej 1.440 mijë denarësh të rritur me TVSH, si dhe të vazhdojë pagesën e paushallit mujor dhe shpenzimeve shoqëruese gjatë periudhës së njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Ndërmarrja, që nga themelimi, **nuk ka marrë leje për shkarkimin e ujërave, sistemi kolektor nuk është i pajisur me matës të rrjedhës (protokomera) për matjen e sasisë së ujërave të ndotura hyrëse, mungon sistemi SCADA për kontroll dhe monitorim të plotë, si dhe nuk disponon me agregatë për furnizim rezervë me energji elektrike.**

Është konstatuar devijim i konsiderueshëm ndërmjet sasisë së ujit të evidentuar si e faturuar dhe sasisë së ujit të pastruar të shkarkuar. Me arkëtimin e vetëm 33% të ujërave të ndotura të pastruara, ndërmarrja publike realizon shpenzime më të larta për trajtimin e ujërave të ndotura pa të ardhura përkatëse, me ç'rast rritet rreziku i akumulimit të humbjeve dhe i jolikuiditetit, dhe nëse kjo gjendje vazhdon, nevoja për mbështetje financiare, subvencione ose investime shtesë nga ana e themeluesit do ta ngarkojë drejtpërdrejt buxhetin e shtetit.

## SASITË E UJIT PËR VITIN 2024




Treguesit financiarë për vitin 2024, në korelacion me detyrimet totale prej 493.108 mijë denarë (8.018.016 euro), tregojnë rrezik të shtuar për uljen e likuiditetit të ndërmarrjes. Përkatësisht, periudha e pagesës së detyrimeve ndaj furnizuesve është 1.139 ditë, ose më shumë se 3 vjet, ndërsa periudha mesatare e arkëtimit të kërkesave është 333 ditë, ose afërsisht një vit. Gjendja e likuiditetit është përkeqësuar më tej për shkak të detyrimeve ndaj personave fizikë, në tokën e të cilëve, të dhënë përmes procedurës së eksproprijimit, janë ndërtuar ose vendosur objekte infrastrukturore dhe për shfrytëzimin e kësaj toke paguhet qira përkatëse, si dhe për shkak të llogarisë së bllokuar të ndërmarrjes që nga viti 2020, menjëherë pas themelimit të saj.

Revizioni thekson nevojën urgjente për hartimin e një plani për stabilitet financiar, i cili do të përfshijë një vlerësim real të rreziqeve të likuiditetit, kornizë kohore për zhbllokimin e llogarisë dhe shlyerjen e detyrimeve, masa për uljen e varësisë nga huamarrjet afatshkurtra, arkëtimin me prioritet të kërkesave dhe optimizimin e shpenzimeve, me qëllim sigurimin e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të funksionimit të ndërmarrjes.

## TREGUESIT E LIKUIDITETIT (2024)




Për më tepër, është e domosdoshme që ndërmarrja të zhvillojë sistemin e vet informativ për evidencën dhe menaxhimin e shfrytëzuesve, si dhe të sigurojë financim të qëndrueshëm dhe afatgjatë përmes investimeve strategjike dhe koordinimit ndërinstitucional, me qëllim përmirësimin e ndjeshëm të efikasitetit të sistemit dhe mbrojtjen e Liqenit të Ohrit.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara janë dhënë rekomandime me qëllim ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve nga institucionet kompetente dhe personat përgjegjës.

## NP PËR PARKINGJE PUBLIKE PARKINGJET E KOMUNËS QENDËR, SHKUP

Është kryer revizion i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2024 në NP për parkingje publike „Parkingjet e Komunës Qendër" Shkup, me ç'rast janë konstatuar gjendjet si vijojnë:

Pajisjet dhe objektet ndërtimore me të cilat disponon ndërmarrja publike (parkomatet, konstruksionet montuese, sistemet e kioskave dhe pajisje të tjera urbane) nuk janë evidentuar në mënyrë të duhur dhe nuk është përllogaritur amortizimi i mjeteve materiale të furnizuara gjatë vitit 2024, të cilat janë vënë në përdorim.

NP „Parkingjet e Komunës Qendër" Shkup ka paraqitur kërkesa në vlerë prej 80.120 mijë denarësh, prej të cilave 20.414 mijë denarë janë më të vjetra se 6 vjet dhe përbëjnë 25% të kërkesave të përgjithshme. Për këto kërkesa nuk janë ndërmarrë aktivitete me kohë për arkëtim dhe nuk është kryer zhvlerësimi për ato kërkesa për të cilat ekzistojnë dëshmi objektive se ndërmarrja nuk do të jetë në gjendje t'i arkëtojë.

### Struktura e kërkesave më 31.12.2024

**TATIM**

Gjatë vitit **2024** është kryer shlyerja e kërkesave në vlerë prej **2.221 mijë denarësh** ndaj personave fizikë, për të cilat nuk është përllogaritur dhe paguar tatimi mbi të ardhurat personale në vlerë prej **247 mijë denarësh**, që ka si efekt pagesë më të ulët të mjeteve në Buxhetin e shtetit.

Gjithsej kërkesa të shlyera në vitin **2024**

**2.221** mijë denarësh

**KOHA E PARASHKRIMIT**

mbi **6** vite



25%

prej **2** deri **5** vjet



58%

deri **1** vjet



17%

Nuk është kryer regjistrimi i një pjese të mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve, gjendjet nuk janë konfirmuar përmes procedurave përkatëse dhe është konstatuar mos harmonizim te mjetet në arkë, ndërsa komisioni i regjistrimit nuk ka përgatitur raport për regjistrimin e kryer.

Ndërmarrja publike nuk ka miratuar politika kontabël për përgatitjen, prezantimin dhe shpalosjen e raporteve financiare, regjistrimet përmbyllëse për vitin 2024 nuk janë kryer brenda afatit të përcaktuar dhe librat tregtarë nuk janë mbyllur, duke mundësuar ndryshime retroaktive.

Përfundim të vitit 2024, ndërmarrja publike ka paraqitur detyrime për taksën komunale në vlerë prej 86.363 mijë denarë, të cilat nuk janë derdhur në Buxhetin e Komunës Qendër, ndërsa pjesa më e madhe e tyre (79.047 mijë denarë) i referohet periudhës 2019–2023.

Për shkak të zbatimit të Rregullores për paga, e cila nuk është harmonizuar me dispozitat ligjore dhe Kontratën e Përgjithshme Kolektive për sektorin publik, janë konstatuar parregullsi në mënyrën e përllogaritjes dhe pagesës së pagave dhe kompensimeve, në lidhje me vlerën e përcaktuar të pikës, koeficientët e kompleksitetit sipas vendeve të punës, si dhe përllogaritjen e shtesës për punën me ndërrime dhe kompensimet për pushim mjekësor.

Revizioni konstatoi dobësi në funksionimin e arkës, përkatësisht mungesë të një akti të brendshëm me të cilin rregullohet menaxhimi i mjeteve në para të gatshme, mosmbajtje të ditarit të arkës, dokumentacion jo të plotë të arkës, si dhe mungesë të masave të ndërmarra për sigurimin e mjeteve në para të gatshme që ruhen në arkë.

Revizioni i brendshëm nuk është organizuar në formën e duhur organizative dhe nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të revizorëve të brendshëm, për shkak të së cilës nuk janë miratuar plani strategjik dhe plani vjetor i revizionit të brendshëm për vitin 2024.

Janë konstatuar dobësi në procedurat për dhënien e kontratave të prokurimit publik në vlerë të përgjithshme prej 4.590 mijë denarë, me realizim gjatë vitit 2024 në vlerë prej 2.589 mijë denarë. Në një pjesë të procedurave janë vendosur kushte joproporcionale për pjesëmarrje, janë pranuar oferta mbi vlerën e vlerësuar pa analizë përkatëse dhe pa mjete të siguruara, njoftimet për kontratat e lidhura dhe të realizuara nuk janë publikuar brenda afatit ligjor në SEPP, specifikimet teknike nuk janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të paekuivokë, ndërsa pyetjeve të parashtruara nga operatorët ekonomikë nuk u është dhënë përgjigje.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara janë dhënë rekomandime me qëllim ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve nga institucionet kompetente dhe personat përgjegjës.



## 5.2.6. VETËQEVERISJA LOKALE DHE ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL

### EFIKASITETI I MASAVE DHE POLITIKAVE PËR ADMINISTRIMIN E TATIMEVE, TAKSAVE DHE KOMPENSIMEVE LOKALE




Kemi kryer revizion të suksesit me temë **„Efikasiteti i masave dhe politikave për administrimin e tatimeve, taksave dhe kompensimeve lokale“,** me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes: **A janë masat dhe politikat për administrimin e tatimeve, taksave dhe kompensimeve lokale efikase në sigurimin e arkëtimit me kohë dhe të plotë të të hyrave dhe në menaxhimin fiskal të përgjegjshëm?**

Nga përfshirja dhe provat që siguruam përmes rrugës së zbatimit të metodologjisë dhe teknikave të revizionit, fituam bindje të arsyeshme se **masat dhe politikat e pushtetit qendror dhe lokal nuk sigurojnë administrim efikas të tatimeve, taksave dhe kompensimeve lokale.**

Mjedisi në të cilin njësitë e vetëqeverisjes lokale i ushtrojnë kompetencat e tyre për administrimin e tatimeve, taksave dhe kompensimeve nuk mundëson përcaktimin dhe arkëtimin efikas të të hyrave vetanake.

Korniza ligjore ekzistuese nuk parashikon përditësimin e regjistrit të pasurisë së paluajtshme me detyrë zyrtare, afatet për pagesën e vendimeve tatimore nuk janë të përcaktuara saktësisht, mënyra e dorëzimit të tyre nuk është e rregulluar, ndërsa ekzistojnë edhe kufizime në zbatimin e revizionit të vlerës së tregut.

### SISTEMET E INFORMACIONIT




Metodologjia për përllogaritjen e vlerës së objekteve është e vjetruar dhe nuk përfshin llojet e reja të objekteve dhe materialeve. Zbatohen çmime që prej vitesh nuk janë përditësuar dhe nuk e pasqyrojnë vlerën reale të tregut, gjë që rezulton me nënvlerësim të bazës tatimore dhe ulje të të hyrave për komunat. Duke pasur parasysh se vetëm 15 komuna kanë kryer rivlerësimin e vlerës së tregut, kjo tregon për zbatim të pabarabartë të dispozitave në sistemin e tatimit mbi pronën.

Në kushtet kur tarifat e taksave komunale nuk janë përditësuar, ndërsa përcaktimi dhe arkëtimi i tyre shpesh kryhet pa vendime të lëshuara dhe pa regjistër të vendosur të tatim paguesve, nuk sigurohet bazë e mirë për arkëtimin e plotë dhe efikas të këtyre të hyrave.

Për më tepër, mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve kompetente të përfshira në proces e zvogëlon krijimin e një mjedisi institucional të favorshëm, në të cilin komunat duhet t'i ushtrojnë kompetencat e tyre dhe të sigurojnë të hyra vetanake të qëndrueshme.

Burimet me të cilat disponojnë komunat në procesin e administrimit të tatimeve, taksave dhe kompensimeve, përkatësisht zgjidhjet e ndryshme softuerike, mosplotësimi i vendeve të punës në njësitë tatimore dhe numri i vogël i vlerësuesve të punësuar në komuna, nuk sigurojnë administrim të drejtë, të plotë dhe me kohë të tatimeve, taksave dhe kompensimeve. Gjithashtu, regjistrat jo të plotë të pasurive të paluajtshme, mungesa e regjistrave të vendosur për pasurinë e luajtshme dhe taksat komunale, mbajtja e regjistrave në formë letre për kompensimet, si dhe moslidhja e sistemeve ndërmjet tyre, e vështirësojnë administrimin dhe arkëtimin dhe e pamundësojnë monitorimin real të tatim paguesve dhe detyrimeve të tyre.

Komunat nuk i shfrytëzojnë plotësisht kapacitetet fiskale në dispozicion për mbledhjen e tatimeve, taksave dhe kompensimeve (arkëtimin me kohë, kamatën për pagesë të vonuar dhe zbatimin e arkëtimit të detyrueshëm), për shkak të së cilës kanë **gjeneruar 2.934.384 mijë denarë (47.761.274 euro)** kërkesa të paarkëtuara mbi bazën e tatimeve, taksave dhe kompensimeve në periudhën **2020–2024,** ndërsa kanë kryer shlyerje të kërkesave në vlerë prej **233.895 mijë denarësh (3.803.170 euro).**

## KËRKESA TË PAARKËTUARA MBI BAZËN E TATIMEVE, TAKSAVE DHE KOMPENSIMEVE PËR PERIUDHËN 2020-2024




**36.471** Kompensime

**1.175.428** Taksa komunale

**1.732.887** Tatime mbi pronën

në 000 denarë

Nga gjithsej kërkesat e paarkëtuara mbi bazën e tatimit mbi pronën, 67% ose 1.163.814 mijë denarë janë më të vjetra se 5 vjet, gjë që tregon për përpjekje të dobëta fiskale të komunave.

Vetëm tri taksa komunale (firma, përkatësisht emërtimi i hapësirës afariste, shfrytëzimi i hapësirës para objektit afarist dhe shfrytëzimi i shesheve dhe hapësirave të tjera në qytete dhe vendbanime të tjera) administrohen dhe arkëtohen në më shumë se 50% të komunave, ndërsa 5 taksat e tjera komunale administrohen dhe arkëtohen në më pak se 25% të komunave.

## ARKËTIMI I TAKSAVE KOMUNALE NGA KOMUNAT

| | |
|---|---|
| 62% | E komunave arkëtojnë taksën komunale për firmë, përkatësisht emërtimin e hapësirës afariste |
| 70% | E komunave arkëtojnë shfrytëzimin e hapësirës para objektit afarist |
| 25% | E komunave arkëtojnë për vendosjen e reklamave, shpalljeve dhe njoftimeve në vende publike |
| 25% | E komunave arkëtojnë taksë komunale për shfrytëzimin e hapësirës për parkim |
| 12% | E komunave arkëtojnë taksë komunale për përdorimin e muzikës në lokalet publike |
| 23% | E komunave arkëtojnë taksë komunale për vendosjen e vitrinave për ekspozimin e mallrave |
| 51% | E komunave arkëtojnë taksë komunale për shfrytëzimin e shesheve dhe hapësirave të tjera në qytete dhe vendbanime të tjera |
| 4% | E komunave arkëtojnë taksë komunale për shfrytëzimin e sipërfaqeve në kampe dhe ngritjen e tendave |

Mungesa e kritereve të përcaktuara qartë për miratimin dhe pagesën me këste të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, praktika e ndryshme në sigurimin e kërkesave (garanci bankare dhe deklaratë noteriale), si dhe monitorimi jo i plotë i arkëtimit, kanë rezultuar, në 14 komuna të akumulohen kërkesa të paarkëtuara në vlerë prej 826.399 mijë denarë, për periudhën 2020–2024.

Me analizën e kryer të të dhënave për të ardhurat e realizuara mbi bazën e tatimeve, taksave dhe kompensimeve, konstatuam se në përgjithësi komunat rurale, me përjashtim të komunave: Petrovec, Ilinden dhe Çuçer-Sandevo, kanë kapacitet fiskal më të dobët në krahasim me komunat urbane.

## KAPACITETI FISKAL I KOMUNAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT




Për më tepër, mbikëqyrja e vendosur në mënyrë jopërkatëse në nivel qendror dhe lokal, me vetëm një inspektor nga ana e Drejtorisë së të Hyrave Publike dhe vetëm 16 inspektorë tatimorë në të gjitha komunat, të cilët kryejnë kontroll nëse tatim paguesit e kanë paraqitur detyrimin e tyre për tatim ose taksë komunale, ndërsa nuk kanë kompetencë të shqiptojnë gjoba, nuk është efikase.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara janë dhënë rekomandime me qëllim ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve nga institucionet kompetente, për krijimin e kushteve që do të kontribuojnë në përmirësimin e procesit të përgjithshëm të administrimit të tatimeve, taksave dhe kompensimeve lokale.

## NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE




Gjatë vitit 2025 është kryer revizion i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2024, te gjashtë njësi të vetëqeverisjes lokale: Ilinden, Kërçovë, Likovë, Ohër, Saraj dhe Sveti Nikollë. Gjatë revizionit janë konstatuar gjendjet si vijojnë::

Komunat e reviduara tregojnë dobësi të konsiderueshme në administrimin e tatimeve. Regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk janë të plotë dhe të përditësuar dhe nuk janë vendosur regjistra për pasurinë e luajtshme që i nënshtrohet tatimit. Nuk kryhet rivlerësimi i vlerës së tregut të pasurisë çdo katër vjet, ndërsa tatim paguesit që kanë fituar pasuri shtesë ose pasuri të re nuk ngarkohen në mënyrë të duhur me detyrime tatimore.

Te komunat e reviduara janë konstatuar dobësi në administrimin e taksave dhe kompensimeve komunale (taksa komunale për: firmën, përkatësisht emërtimin e hapësirës afariste, përdorimin e muzikës në lokalet publike, shfrytëzimin e hapësirës para objekteve afariste për ushtrimin e veprimtarisë, shfrytëzimin e hapësirës për parkimin e automjeteve motorike, taksën për qëndrim të përkohshëm, vendosjen e reklamave, njoftimeve dhe shpalljeve në vende publike, si dhe kompensimin për posedimin e lejes ekologjike të integruar B). Pajisjet urbane vendosen pa leje të lëshuara, ndërsa veprimtaria gastronomike jashtë objektit afarist ushtrohet pa vendime nga kryetari i komunës.

Nga 6 auto-kampe të regjistruara në territorin e Komunës së Ohrit, vetëm njëri kryen pagesën e taksës komunale.

Struktura sipas moshës e kërkesave nuk është përcaktuar dhe nuk është bërë harmonizim i vlerës së kërkesave nga vitet e kaluara për të cilat ekziston pasiguri në arkëtim. Janë konstatuar dallime ndërmjet evidencës kontabël dhe asaj tatimore (Komuna Ilinden për 39.977 mijë denarë, Komuna Likovë për 57.118 mijë denarë dhe Komuna Kërçovë për 32.911 mijë denarë) si dhe 24.765 mijë denarë ndërmjet raportit të Qytetit të Shkupit dhe pasqyrave financiare të Komunës Saraj.

Komunat nuk ndërmarrin masa për arkëtimin e detyruar të borxheve të prapambetura, ndërsa në rast të pagesës me vonesë nuk llogaritet interes për pagesën jo në kohë.

Gjatë zbatimit të procedurave për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, komunat e reviduara nuk i respektojnë afatet e përcaktuara me ligj për miratimin e konkluzioneve dhe vendimeve dhe nuk dorëzojnë raporte vjetore në Ministrinë e Transportit për mjetet e përdorura të realizuara mbi këtë bazë, të cilat janë të destinuara për hartimin e dokumentacionit urbanistik planifikues me të cilin bëhet integrimi i objekteve të ndërtuara pa leje dhe për rregullimin infrastrukturor të hapësirës ku ndodhen ato.

Te komunat Sveti Nikole dhe Likovë, legalizimi i objekteve në tokë bujqësore kryhet pa pëlqimin paraprak të MBPEU-së, ndërsa pa bazë ligjore janë miratuar vendime/konkluzione për përjashtim nga pagesa e kompensimit për përcaktimin e statusit juridik të objekteve fetare në komunat Likovë dhe Kërçovë. Për objektet/mbindërtimet e ndërtuara pa leje, për të cilat janë miratuar vendime për refuzim, nuk merren masa për heqjen e tyre.

Njëkohësisht, Komuna e Kërçovës nuk ka vepruar sipas 13 akteve administrative të formës së prerë për mbindërtime të paligjshme, ndërsa Komuna e Ohrit nuk ka vepruar sipas 456 akteve administrative të formës së prerë për ndërtime pa leje dhe nuk ka miratuar plane urbanistike për 20 vendbanime/fshatra, që ndikon në natyrën dhe autenticitetin kulturor të rajonit.

Në Komunën e Sveti Nikollës janë konstatuar parregullsi në mënyrën e menaxhimit të objektit „Pushimorja e Fëmijëve në Stari Dojran", përkatësisht kapacitete akomoduese të vjetruara dhe të rrënuara, ofrim i shërbimeve (akomodimit) për të cilat komuna nuk ka kompetencë dhe pa pëlqimin e institucioneve kompetente, ndërsa lëshimi i faturave është bërë pa specifikimin e shërbimeve përmes arkës fiskale. Ndërkaq, në Komunën e Sarajit, prona komunale „Objekti sportiv-rekreativ dhe pishina që ndodhen në lokalitetin Saraj" është dhënë me qira për 25 vjet, pa bazë ligjore. Për blerësit që nuk i kanë respektuar afatet e përcaktuara në kontratat për ndërtimin e objekteve në tokë ndërtimore të pandërtuar në pronësi të shtetit, Komuna e Ilindenit nuk ka përllogaritur dhe arkëtuar penale ndëshkuese.

Në buxhetet e komunave janë realizuar më pak të hyra për shkak të mospagesës së kompensimit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike nga ndërmarrjet publike, edhe atë: në Sveti Nikollë në vlerë prej 27.419 mijë denarë, në Kërçovë 5.303 mijë denarë dhe në Ohër 22.880 mijë denarë, ndërsa Komuna e Likovës nuk ka miratuar vendim për lartësinë e këtij kompensimi dhe as program vjetor.

Në komunat Ohër, Kërçovë, Saraj dhe Sveti Nikollë, janë konstatuar dobësi në menaxhimin e gjelbërimit, përkatësisht nuk është vendosur kadastra e gjelbërimit, mungon Strategjia për zhvillimin e gjelbërimit, plani bazë për ngritjen dhe zhvillimin e gjelbërimit, programi vjetor dhe Vendimi për arkëtimin e kompensimit për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra publike pranë rrugëve dhe nuk janë realizuar të hyra mbi këtë bazë.

Komunat Likovë, Kërçovë dhe Saraj në vazhdimësi angazhojnë persona për kryerjen e detyrave të rregullta të punës të parashikuara në aktet e sistematizimit, për të cilat janë paguar gjithsej 7.711 mijë denarë, ndërsa në komunat Saraj dhe Kërçovë janë paguar 1.676 mijë denarë për shërbime avokatie në formë pagese mujore fikse, pa specifikim të shërbimeve të kryera dhe jashtë tarifës së avokatisë. Për angazhimin jashtë orarit të punonjësve në Komunën e Sveti Nikollës janë paguar mjete në vlerë prej 1.952 mijë denarë, pa dëshmi që do ta vërtetonte nevojën për një angazhim të tillë, orët e realizuara të punës dhe pa njoftim paraprak me shkrim të Inspektoratit Shtetëror të Punës.

Në komunat e reviduara janë konstatuar mospërputhje në mënyrën e pagesës së mjeteve për klubet sportive, shoqatat e qytetarëve, fondacionet, nxënësit e talentuar dhe përfitimet sociale, pa programe të miratuara dhe pa kritere të përcaktuara saktësisht për shpërndarjen e mjeteve për mbrojtje sociale, sport, arsim dhe mbështetje të organizatave qytetare, në vlerë të përgjithshme prej 91.855 mijë denarë.

Komuna e Ohrit dhe Komuna e Sarajit kanë kryer subvencionim të ndërmarrjeve publike komunale mbi bazën e kërkesave dhe dokumentacionit jo të plotë për vëllimin e realizuar të aktiviteteve, në vlerë prej 66.505 mijë denarë.

Kontrata për Partneritet Publiko-Privat (PPP) në vlerë prej 376.532 mijë denarë me TVSH të përfshirë, për modernizimin e sistemit të ndriçimit publik në Komunën e Kërçovës, është realizuar pa garanci financiare përkatëse, pa dokumentacion të plotë dhe pa pranim teknik si dëshmi për punët e kryera, që krijon implikime të konsiderueshme financiare dhe juridike për buxhetin e komunës, pasojat e të cilave mund të shfaqen gjatë gjithë periudhës 15-vjeçare të vlefshmërisë së saj.

Gjatë realizimit të aktiviteteve për ndërtimin/rikonstruktimin e rrugëve dhe rrugicave, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, komunat e reviduara nuk i respektojnë dispozitat e Ligjit për Ndërtim, në lidhje me sigurimin e lejes për ndërtim për objektet që bëjnë pjesë në kategorinë e dytë të ndërtimeve, aktivitetet ndërtimore realizohen pa projekt dhe dokumentacion projektues, vetëm në bazë të specifikimeve teknike/parallogarisë së punimeve dhe nuk kryhet pranim - dorëzimi i objekteve të ndërtuara.

Në komunat Likovë, Kërçovë dhe Saraj janë konstatuar parregullsi në mbajtjen e librave afaristë dhe në përgatitjen e raporteve financiare, ndërsa në Komunën e Sarajit mungon transparenca dhe llogaridhënia gjatë krijimit dhe realizimit të buxhetit. Komunat Kërçovë dhe Saraj, gjatë pagesave me cesion dhe asignacion, në vlerë të përgjithshme prej 68.629 mijë denarë, nuk kanë vepruar në përputhje me Udhëzimin për mënyrën e funksionimit të thesarit, përkatësisht nuk kanë dorëzuar kërkesë për pagesë në kuadër të llogarisë së thesarit për pagesë me përllogaritje, që ka rezultuar me të hyra dhe shpenzime të paevidentuara në buxhetin për vitin 2024 dhe me vlerësim jo objektiv të pozicioneve bilancore.

Në komunat e reviduara janë të pranishme mospërputhje gjatë zbatimit të regjistrimit të pasurisë dhe detyrimeve, gjendje e cila është aktuale prej vitesh dhe nuk mundëson harmonizimin e gjendjes së mjeteve dhe detyrimeve ndërmjet evidencës kontabël dhe gjendjes faktike të konstatuar me regjistrim. Prona që është në pronësi të komunave nuk është e evidentuar plotësisht në librat afaristë, ndërsa për pjesën më të madhe të pronës së paluajtshme nuk është siguruar dëshmi e pronësisë së komunave.

Janë kryer shpenzime pa dokumentacion mbështetës, edhe atë: 1.554 mijë denarë për karburant të shpenzuar, fotografim dhe incizim me dron (Komuna e Ohrit) dhe 1.761 mijë denarë janë paguar paraprakisht për punë të parealizuara gjatë ndërtimit të Shtëpisë së Kulturës në fshatin Matejçe (Komuna e Likovës).

Te komunat e reviduara janë konstatuar dobësi në procedurat e prokurimit publik, edhe atë: përcaktim jo i duhur i lëndës së prokurimit, mosparashikim i sasive për pozicionet e veçanta në specifikimin teknik, zgjerim i vëllimit të kontratës (Komuna e Sarajit), kërkesa joproporcionale (komunat Saraj dhe Ilinden), prokurime të realizuara mbi pragun e vlerës në shumën prej 936 mijë denarë (Komuna e Sarajit) dhe prokurime nën pragun e vlerës që nuk janë raportuar në evidencën tremujore (komunat Likovë dhe Kërçovë) në shumën prej 30.830 mijë denarë.

Te komunat e reviduara janë konstatuar dobësi në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit financiar, në lidhje me procedurat e shkruara, ndarjen e detyrave dhe mekanizmat e përcaktuar të kontrollit në proceset afariste, si dhe me mungesën ose jofunksionalitetin e revizionit të brendshëm.

Në pjesën "Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë" janë theksuar gjendje që kanë të bëjnë me procedurat gjyqësore. Komunat Ilinden, Kërçovë, Likovë, Ohër, Saraj dhe Sveti Nikollë paraqiten si paditëse në procedura me vlerë prej 164.010 mijë denarë, ndërsa si palë e paditur në procedura me vlerë prej 140.825 mijë denarë, ndërsa Komuna e Ohrit është e përfshirë në 14 procedura jashtëgjyqësore përmes ndërmjetësimit (mediacionit) me vlerë prej 131.426 mijë denarë.

Komuna e Kërçovës ka detyrime të papaguara në vlerë prej 19.100 mijë denarë mbi bazën e një huaje afatshkurtër të marrë me Vendim të Qeverisë në vitin 2009, në shumën prej 26.000 mijë denarë, e dedikuar për mbulimin e mungesës së përkohshme të mjeteve, me detyrim që të kthehej po atë vit në Buxhetin e shtetit, me këtë janë cenuar parimet e disiplinës buxhetore dhe të përgjegjësisë financiare.

* 1.441 mijë denarë në Likovë, 525 mijë denarë në Kërçovë dhe 5.745 mijë denarë në Saraj;
* 596 mijë denarë në Kërçovë dhe 1.080 mijë denarë në Saraj;
* 1.334 mijë denarë në Ilinden, 74.022 mijë denarë në Ohër, 2.112 mijë denarë në Likovë, 3.941 mijë denarë për persona fizikë në Kërçovë, 4.412 mijë denarë në Saraj dhe 6.034 mijë denarë në Sveti Nikollë;
* Ohri me 36.505 mijë denarë dhe Saraji me 30.000 mijë denarë.
* Kërçova me 51.637 mijë denarë dhe Saraji me 16.992 mijë denarë

# 5.2.7. PARTITË POLITIKE

## KOMISIONI SHTETËROR ZGJEDHOR

**KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është organ shtetëror me kompetencë që të kujdeset për ligjshmërinë në përgatitjen dhe zbatimin e zgjedhjeve, si dhe të ushtrojë mbikëqyrje mbi punën e organeve zgjedhore, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë për llogarinë e buxhetit bazë për vitin 2024 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, me ç'rast kemi konstatuar dobësi në:

- mënyrën e zbatimit të regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve dhe moskryerjen e harmonizimit të gjendjes faktike me gjendjen kontabël;

- planifikimin dhe miratimin e mjeteve për zbatimin e zgjedhjeve përmes programit buxhetor 21 – Aktivitetet Zgjedhore, për shkak se veprimi nuk është në përputhje me raportin e përcaktuar me ligj, që ka për pasojë transferimin e mjeteve që duhet të jenë të dedikuara për aktivitete të tjera zgjedhore, për pagesën e shpenzimeve të reklamimit politik me pagesë të pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore të organizuara gjatë vitit 2024;

- dorëzimin jo në kohë dhe jo i plotë i dokumentacionit të nevojshëm për shpenzimet e aktiviteteve zgjedhore të realizuara, nga organet zgjedhore te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, që ndikon në pagesën adekuate, të plotë dhe në kohë të shpenzimeve për aktivitetet zgjedhore të zbatuara nga organet zgjedhore;

- prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, për shkak se nuk është zhvilluar procedurë e prokurimit publik, me qëllim që të sigurohej konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë, trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi, transparenca dhe integriteti, si dhe shfrytëzimi racional dhe efikas i mjeteve.

Në pjesën Theksimi i çështjeve theksojmë gjendje që kanë të bëjnë me:

- nevojën për sigurimin e përhershëm të hapësirës adekuate për magazinimin dhe ruajtjen e materialit zgjedhor konfidencial dhe jokonfidencial, si dhe të pajisjeve për identifikimin biometrik të votuesve;

- mënyrën e evidentimit, përpunimit të të dhënave dhe përllogaritjes së kompensimit për personat anëtarë të këshillave zgjedhore, të cilëve u paguhet kompensim për angazhimin në aktivitete zgjedhore, për shkak se kjo kryhet në mënyrë manuale, dhe duke pasur parasysh numrin e anëtarëve të këshillave zgjedhore dhe pjesëmarrjen e kompensimit për angazhimin e tyre në zgjedhje në shpenzimet e përgjithshme, kjo mënyrë e përpunimit të të dhënave sjell angazhim shtesë të punonjësve në shërbimin profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe krijon rrezik për përpunimin e plotë dhe me kohë të të dhënave mbi bazën e të cilave kryhet pagesa e mjeteve;

- mënyrën dhe kushtet për zbatimin e votimit të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët gjatë zgjedhjeve ndodhen në punë ose qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, për shkak se në Zgjedhjet Presidenciale të vitit 2024, kushtet për votim i kanë plotësuar gjithsej 2.571 qytetarë në 31 përfaqësi diplomatike-konsullore, prej të cilëve në ditën e zgjedhjeve kanë votuar 809 votues. Për zbatimin e votimit në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK) janë angazhuar 239 persona nga administrata shtetërore, për të cilët janë paguar gjithsej 25.769 mijë denarë, përkatësisht 417.650 euro, mbi bazën e biletave të avionit, akomodimit në hotel, mëditjeve për udhëtime jashtë vendit dhe kompensimit për shpenzime të tjera.

## PARTITË POLITIKE
## LLOGARI PËR VEPRIMTARI TË RREGULLT

Si organ kompetent për ushtrimin e mbikëqyrjes mbi veprimtarinë financiare-materiale të partive politike, Enti Shtetëror i Revizionit kryen në mënyrë të vazhdueshme revizion të llogarive për veprimtarinë e rregullt të disa partive politike në shtet, në përputhje me aktet metodologjike dhe kriteret e përcaktuara. Me Programin vjetor të punës së Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025 u planifikuan dhe u realizuan revizione të raporteve financiare të pesë partive politike: VMRO-DPMNE, LSDM, BDI, Alternativa dhe E Majta (Levica), me të cilat u përfshinë 63% e burimeve të përgjithshme publike të financimit të partive politike në vitin 2024.

Mjetet për veprimtarinë e tyre, partitë politike i sigurojnë nga burime publike dhe private të financimit:

- burime publike të financimit – mjete financiare të parashikuara me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- burime private të financimit – anëtarësia, kredit, donacionet, dhuratat, kontributet, dotacionet, sponsorizimet, legate, shitje e materialit promovues dhe propagandues.

Të ardhurat totale në vitin 2024 të partive politike që ishin objekt i revizionit janë në shumën prej 703.863 mijë denarë dhe krahasuar me vitin 2023 shënojnë rritje prej 69,94%, praktikisht janë rritur për 289.675 mijë denarë.

### TË ARDHURAT TOTALE TË REALIZUARA SIPAS BURIMEVE

në 000 denarë




Pjesa më e madhe e mjeteve sigurohet nga burimet publike, përkatësisht janë mjete nga Buxheti i shtetit, të cilat çdo vit fiskal planifikohen në një shumë të caktuar në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë, prej nga edhe u paguhen partive politike. Rritja më e madhe krahasuar me vitin paraprak është evidentuar te të hyrat e realizuara nga anëtarësimet, dhuratat, donacionet dhe kreditë.

Shpenzimet e përgjithshme në vitin 2024 janë në vlerë prej 528.818 mijë denarë dhe janë 2,6 herë më të larta krahasuar me vitin paraprak 2023, përkatësisht janë rritur për 325.142 mijë denarë.

## SHPENZIMET E REALIZUARA SIPAS DEDIKIMEVE

në 000 denarë




Shpenzimet mbi bazën e mjeteve të transferuara marrin pjesë me 42,3% në shpenzimet e përgjithshme dhe kanë të bëjnë me mjetet e transferuara nga llogaritë për funksionimin e rregullt të partive politike në llogaritë e fushatës zgjedhore, të hapura për zgjedhjet e zbatuara në vitin 2024*.

Në drejtim të realizimit të qëllimeve dhe ushtrimin e aktiviteteve të përcaktuara me statutin e partisë dhe me ligj, partitë politike kanë të drejtë të jenë pronare të pasurisë së paluajtshme, pajisjeve, mjeteve të transportit dhe pronë tjetër të luajtshme.

Me revizionet e kryera janë konstatuar gjendje që tregojnë nevojën për forcimin e aktiviteteve të personave përgjegjës në partitë politike për tejkalimin e tyre, veçanërisht në pjesën e evidentimit të plotë të pasurisë, vendosjes së evidencës së mjeteve materiale dhe vlerësimi i pozicioneve të caktuara bilancore të përfshira në librin kryesor të zbatohet në përputhje me parimin kontabël të ndodhjes së modifikuar të ndryshimeve/transaksioneve afariste.

Në pjesën Theksimi i çështjeve janë shpalosur gjendje që kanë të bëjnë me të hyra të parealizuara nga anëtarësimet dhe detyrime të pashlyera ndaj furnizuesve, të cilat burojnë nga vitet e kaluara.

Me revizionet e kryera, në vazhdimësi kemi sugjeruar dobësi të caktuara sistemore të Ligjit për Financimin e Partive Politike, të paraqitura në mënyrë të detajuar në pjesën „Dobësitë sistemore" të këtij raporti, për tejkalimin e të cilave është e nevojshme të ndërmerren aktivitete.

* Zgjedhjet Presidenciale dhe Zgjedhjet Parlamentare

## 5.2.8. SIGURIA DHE MBROJTJA SHTETËRORE

### MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Republikës së Maqedonisë së Veriut
Ministria e mbrojtjes

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2024 të Ministrisë, kemi lëshuar 4 raporte ku kemi konstatuar gjendje të mospërputhjes së transaksioneve financiare me rregullativën përkatëse ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura. Në të njëjtën kohë, është lëshuar edhe një raport i veçantë që ka shkallë klasifikimi.

Gjendjet që përsëriten edhe në vitin 2024 janë rezultat i moszbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar të Revizionit të Autorizuar Shtetëror për vitin 2022, me ç'rast nga 13 rekomandimet e dhëna, një rekomandim është zbatuar, dy janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 10 rekomandime nuk janë zbatuar.

Rekomandimet e pazbatuara të ESHR-së nga revizionet e mëparshme kanë si efekt gjendje të pandryshuara në lidhje me evidencën e mjeteve të përhershme, rezervave të materialeve, pjesëve rezervë dhe inventarit të imët.

Vlera e mjeteve të përhershme në raportet financiare është e pandryshuar që nga viti 1999, që ndikon në besueshmërinë dhe plotësinë e të dhënave në librat afaristë dhe në cilësinë e informatave që japin raportet financiare.

REVIZIONET E KRYERA

2011 2013 2017 2022 2024

**VLERA E PANDRYSHUAR e mjeteve të përhershme që nga viti 1999**

**TOKAT** 12.139.398 mijë denarë

**OBJEKTET NDËRTIMORE** 1.410.613.557 mijë denarë

**PYJET** 232.500 mijë denarë

**PAJISJET** 14.425 mijë denarë

Edhe pse ekziston evidencë materiale për tokën, objektet ndërtimore (fletë pronësore, të dhëna për sipërfaqen, lokacionin, destinimin dhe të ngjashme) dhe pajisjet, për shkak të moskryerjes së vlerësimit të vlerës së tyre, të njëjtit nuk janë futur në evidencën financiare dhe paraqiten në mënyrë jo të duhur në raportet financiare.

Anëtarësimi në NATO dhe Bashkimin Evropian imponoi nevojën për ndryshime si në modernizimin e pajisjeve, ashtu edhe në përmirësimin e kushteve për Ushtrinë sipas standardeve të NATO-s, për të cilat prej disa vitesh me radhë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndahen mjete për:

## INVESTIME NË OBJEKTE DHE PAJISJE

<table>
<tr><th rowspan="2">NËNPROGRAMET</th><th colspan="2">2018-2022</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr>
<tr><th>në 000 denarë</th><th>në euro</th><th>në 000 denarë</th><th>në euro</th></tr>
<tr><td>5B - Ndërtimi dhe rekonstruimi i objekteve</td><td>801.972</td><td>13.019.026</td><td>310.742</td><td>5.044.513</td></tr>
<tr><td>VA - Integrimi në NATO</td><td rowspan="2">186.044</td><td rowspan="2">3.020.195</td><td rowspan="2">8.503.990</td><td rowspan="2">138.051.786</td></tr>
<tr><td>1A - Modernizimi i Ministrisë</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>988.016</td><td>16.039.221</td><td>8.814.732</td><td>143.096.299</td></tr>
</table>

Për shkak të arsyeve të lartpërmendura, furnizimet në periudhën 2018-2024 në shumë prej 9.802.748 mijë denarë nuk janë paraqitur si rritje e vlerës së objekteve, pajisjeve dhe burimeve të tyre në Bilancin e gjendjes ndër vite, por të njëjtat paraqiten vetëm si shpenzime kapitale.

Gjithashtu blerjet e uniformave, produkteve ushqimore, barnave dhe materialeve mjekësore, materialeve për riparime dhe mirëmbajtje, inventarit të vogël, pjesëve rezervë dhe materialeve të tjera për Ushtrinë, për të cilat në vitin 2024 janë shpenzuar 532.060 mijë denarë, nuk janë paraqitur si vlerë e stokut në pasqyrat financiare.

Konstatuam mospërputhje të disa aktiviteteve me rregullativën ligjore dhe aktet nënligjore:

- pagesa të kompensimeve të caktuara sipas marrëveshjes kolektive pa dokumentacion të konfirmuar në mënyrë të rregullt dhe pa zbatim adekuat të akteve nënligjore;
- pagesat ndaj Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për kompensime për pagesën e pensioneve dhe kontributin për shëndetësi nuk përmbajnë të dhëna për numrin dhe personat (emër, mbiemër, numër amë) me qëllim të konfirmimit të bazës juridike dhe shumës së pagesave të përmendura;
- janë paguar shpërblime në para për personat e punësuar në MM dhe Armatës për shkak të angazhimit të veçantë, përkushtimit personal dhe kryerjes cilësore të detyrave të besuara, pa rregullore përkatëse, edhe pse e njëjta është paraparë me Marrëveshjen Kolektive të MM-së.

Në pjesën e furnizimeve publike konstatuam zbatim të procedurave që nuk janë në përputhje me LPP:

- në dhjetor të vitit 2023 është lidhur kontratë për furnizimin e një sistemi të ri telefonik (2.000 aparate telefonike) me vlerë të përgjithshme prej 94.841 mijë denarë, e cila është paguar në tërësi, por për shkak të inkompatibilitetit të infrastrukturës ekzistuese të rrjetit në objektet e MM-së dhe Armatës (switch-e të vjetruara), 70% e pajisjeve nuk janë instaluar dhe nuk janë vënë në funksion;
- për realizimin e kursit për profesionistë të kibernetikës janë paguar avansi 32.500 dollarë amerikanë pa u zbatuar procedurë për prokurim publik;
- në pesë procedura konstatuam vendosje të një kushti joproporcional ndaj operatorëve ekonomikë për të ardhura minimale vjetore dyfish më të larta se vlera e vlerësuar e furnizimit;

- në pesë procedura, gjatë realizimit të kontratave për kryerjen e punëve ndërtimore janë konstatuar dhe janë paguar teprica në shumë të përgjithshme prej 7.923 mijë denarë pa anekse të lidhura;
- me të njëjtin operator ekonomik janë lidhur tri kontrata për rekonstruktimin e objekteve: librat ndërtimorë dhe ditarët ndërtimorë janë konfirmuar nga një inxhinier i cili nuk është përfshirë në personelin teknik me ofertën e dorëzuar, për të nuk është bashkëngjitur autorizim dhe nuk është evidentuar si person i punësuar ose i angazhuar nga ofertuesi/operatori ekonomik.

## Gjendjet në funksionimin e Shtëpisë së ARM-së dhe kantinave

Për shkak të dobësive në zbatimin e regjistrimit, përkatësisht përcaktimit vetëm të gjendjes numerike të mjeteve pa vlerë financiare, mosmiratimit të politikave kontabël për vlerësimin e mallrave në rezervë, përkatësisht të artikujve ushqimorë për përgatitjen e ushqimit, si dhe mos përcaktimit të normativave për përgatitjen e ushqimeve të gatshme, nuk ishim në gjendje ta konfirmojmë vlerën e mallrave në rezervë në shumë prej 5.706 mijë denarë, si dhe të hyrat e realizuara mbi këtë bazë.

Mjetet monetare që si qarkullim ditor në para të gatshme nga shitja e produkteve dhe shërbimeve në pikat e shitjes, objektet rekreative, kantinat dhe objektet e tjera, paguhen në arkë, nuk derdhen me kohë në dobi të llogarisë së thesarit të Ministrisë, që nuk është në përputhje me Ligjin për shërbime pagesore dhe sisteme pagesore.

Në pjesën e Theksimit të çështjeve kemi bërë të ditur mospërputhjen e procedurës për miratimin, regjistrimin dhe publikimin e marrëveshjes së re kolektive të Ministrisë me dispozitat e Ligjit për marrëdhënie pune dhe Rregullores për procedurën e dorëzimit dhe regjistrimit të marrëveshjeve kolektive. Ministria nuk disponon dëshmi se Ministria e Financave ka dhënë pëlqim në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes Kolektive (shkurt 2024), e as që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale është njoftuar brenda afatit ligjor në kohën e regjistrimit të marrëveshjes kolektive dhe se ministri ka sjellë vendim për regjistrim në regjistër. Marrëveshja e re Kolektive e MM-së është publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV-së nr. 36/2024, më 14.02.2024, në të njëjtën ditë kur janë shpallur zgjedhjet për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Kemi zbardhur gjendjet dhe arsyet për derdhjen e madhe të mjeteve nga Buxheti i Ministrisë në bazë të vendimeve përmbarimore, për të cilat në vitin 2024 janë paguar mjete në shumë të përgjithshme prej 736.168 mijë denarë: borxh kryesor në shumë prej 490.600 mijë denarë, kamatë në shumë prej 90.480 mijë denarë dhe shpenzime për pagesa përmbarimore në shumë prej 155.088 mijë denarë.**

Kemi theksuar se është e nevojshme, në koordinim me Shërbimin për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë së RMV-së, të ndërmerren aktivitete për sigurimin e dokumentacionit të domosdoshëm (procesverbale, fatura, fletëdorëzime) për 792 pompa të cilat, me vendime të Qeverisë për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në fshatin Stajkovc në vitin 2016, i janë dorëzuar ARM-së. Përkatësisht, SHPPP ka furnizuar 865 pompa uji dhe 18 gjeneratorë, ndërsa pas përfundimit të gjendjes së krizës, pjesa më e madhe e pajisjeve i janë dhënë në përdorim Armatës (pa dokumentacion), ndërsa një pjesë më e vogël komunave të tjera.

Konstatuam dobësi në sistemin e kontrolleve të brendshme dhe në procesin e përllogaritjes dhe evidentimit të pagave në MM dhe Armatë.

# NDËRTIMI I SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E KRIZAVE, MBROJTJE DHE SHPËTIM PËRMES INVESTIMEVE NË PAJISJE DHE BURIME, MIRËMBAJTJES SË MJETEVE ME QËLLIM TË RRITJES SË OPERATIVITETIT, EFIKASITETIT DHE EFEKTIVITETIT TË TIJ




Kemi kryer revizion të suksesit me temë **„Ndërtimi i sistemit për menaxhimin e krizave, mbrojtjen dhe shpëtimin përmes investimeve në pajisje dhe burime, mirëmbajtjes së mjeteve me qëllim rritjen e operacionalitetit, efikasitetit dhe efektivitetit”,** me qëllim që të japim përgjigje në pyetjen: **„A është sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit (mbrojtja civile) në Republikën e Maqedonisë së Veriut adekuat për reagim efikas dhe përballim të katastrofave?”**

Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i organizuar si sistem i vetëm, i përbërë nga organet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, njësitë territoriale kundër zjarrit, institucionet, shoqëritë tregtare dhe subjektet e tjera që kanë detyrim të marrin pjesë në parandalim, gatishmëri, reagim me kohë dhe përballim të katastrofave dhe gjendjeve të krizës. Në të njëjtën kohë, shteti ka detyrim që ta harmonizojë këtë sistem me standardet dhe kornizat ndërkombëtare, përfshirë Kornizën Sendai të Kombeve të Bashkuara, Mekanizmin për mbrojtje civile të Bashkimit Evropian dhe standardet e NATO s për rezistencë.

Republika e Maqedonisë së Veriut është gjithnjë e më e ekspozuar ndaj rreziqeve nga zjarret pyjore, përmbytjet, kushtet ekstreme të motit dhe fatkeqësi të tjera, që imponon nevojën për sistem funksional, të integruar dhe rezistencë të mbrojtjes dhe shpëtimit. Sipas të dhënave në „Raportin paraprak për zjarret pyjore në Evropë, Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut për vitin 2024”, të përgatitur nga Qendra e Përbashkët Kërkimore e Komisionit Evropian në kuadër të Sistemit Evropian Informativ për Zjarret Pyjore (EFFIS), të bazuara në vëzhgime satelitore përmes programit Copernicus, në vitin 2024 në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë regjistruar 97.660 hektarë sipërfaqe të djegur, që paraqet nivelin më të lartë në dekadën e fundit dhe më shumë se sipërfaqja e përgjithshme e djegur e regjistruar gjatë gjashtë viteve të mëparshme së bashku.

Sipas të dhënave të Ndërmarrjes Publike „Pyjet Nacionale”, në periudhën 2023–2025 janë evidentuar 82.714 hektarë sipërfaqe të djegur, 914.657 m$^3$ masë drusore të djegur dhe dëme në **vlerë të përafërt prej 133.663.967 euro, ndërsa vetëm në vitin 2024 dëmi arrin në 83.121.333 euro.**

## ZJARRET NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT SIPAS TË DHËNAVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE "PYJET NACIONALE



Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i vendosur në aspektin normativ, por nuk funksionon si sistem plotësisht i integruar dhe efikas, si dhe nuk vepron në përputhje me standardet bashkëkohore për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e rreziqeve nga katastrofat, si dhe me standardet e NATO s për rezistencë.

Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit është i fragmentuar, i paqëndrueshëm dhe kryesisht reaktiv, me kapacitet të kufizuar për reagim të pavarur dhe efikas ndaj katastrofave, që nuk siguron nivel të mjaftueshëm të rezistencës kombëtare.

Pavarësisht dobësive të konstatuara dhe rekomandimeve të dhëna nga vlerësimet ndërkombëtare, përfshirë edhe procesin e skriningut të Bashkimit Evropian, reformat e sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit, të iniciuara në vitin 2014, edhe pas më shumë se një dekade nuk janë zbatuar plotësisht. Në vitin 2026, reformat janë riaktualizuar dhe janë ndërmarrë aktivitete të reja për përgatitjen e zgjidhjeve ligjore dhe institucionale për vendosjen e sistemi të integruar dhe më efikas.

## REFORMA TË SISTEMIT TË MBROJTJES DHE SHPËTIMIT




Mungesa e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje dhe Shpëtim, e programit vjetor për mbrojtje dhe shpëtim, e programit investues, mungesa e transparencës, llogaridhënies, monitorimit dhe mbikëqyrjes, ndikojnë negativisht në sistemin për reagim të shpejtë dhe efikas ndaj fatkeqësive dhe situatave të krizës.

Aktivitetet realizohen pa prioritete dhe orientime të përcaktuara qartë, ndërsa struktura institucionale është e fragmentuar, me kompetenca të papërcaktuara qartë dhe koordinim të kufizuar.

Forcat operative përballen me mungesë të konsiderueshme të burimeve njerëzore, deficit të pajisjeve dhe mungesë të mekanizmave për monitorimin e efektivitetit të tyre, ndërsa në veçanti theksohet mungesa e forcave republikane, numri i pamjaftueshëm i zjarrfikësve, si dhe mungesa e pajisjeve bashkëkohore dhe funksionale për mbrojtje dhe shpëtim.

Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit financohet nga Buxheti i shtetit dhe nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale, pa model të vendosur të qëndrueshmërisë financiare përmes të hyrave vetjake, planifikimit afatgjatë investues dhe shfrytëzimit më efikas të mjeteve donatore dhe ndërkombëtare.

## MJETET E PLANIFIKUARA NË BUXHETIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT DHE NË BUXHETET E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE PËR SISTEMIN E MBROJTJES DHE SHPËTIMIT




Revizioni konstatoi se nuk ekziston program i integruar investues për zhvillimin dhe modernizimin e sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit, ndërkohë që menaxhimi i burimeve kyçe, përfshirë edhe kapacitetet ajrore, përballet me dobësi të theksuara në aspektin e planifikimit, mirëmbajtjes dhe ekonomicitetit të shfrytëzimit të mjeteve.

Analiza e shpenzimeve për mjetet ajrore tregon se në periudhën 2023–2025, për servisimin, furnizimin me pjesë rezervë dhe sigurimin e mjeteve ajrore janë shpenzuar gjithsej 149.905 mijë denarë. Pastaj, në vitet 2023 dhe 2024, shpenzimet vjetore kanë qenë rreth 59.517 mijë denarë, që përfaqëson 7,4% të vlerës së vlerësuar të mjeteve ajrore prej 801.722 mijë denarë, përkatësisht nga 3,7% për servisimin dhe 3,7% për sigurimin.

Fotografia: Mjetet ajrore të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim



Mjetet për mbrojtje kundër zjarrit në periudhën 2022–2024 shënojnë rritje, megjithatë struktura e tyre mbetet e pafavorshme. **Pjesa më e madhe e mjeteve, përkatësisht rreth 98%, janë të orientuara drejt shpenzimeve rrjedhëse, për paga dhe kompensime, ndërkohë që shpenzimet kapitale për mbrojtje kundër zjarrit përfaqësohen me vetëm 1,4%.**

Kjo strukturë tregon se financimi siguron funksionimin bazë të NJTKZ-ve, por nuk krijon hapësirë të mjaftueshme për modernizim, furnizim me pajisje dhe automjete, si dhe për forcimin e gatishmërisë operative.

Revizioni konstatoi se dotacionet e dedikuara nuk sigurojnë financim të plotë të pagave të NJTKZ-ve si kompetencë e transferuar, për shkak të së cilës një pjesë e mjeteve të nevojshme sigurohen nga komunat.

Në periudhën e analizuar, mjetet për mbrojtje kundër zjarrit (W0) arrijnë në 782.898 mijë denarë nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale, 1.409.390 mijë denarë nga dotacionet e dedikuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe 20.609 mijë denarë nga mjetet e donacioneve.

## ANALIZA E STRUKTURËS SË FINANCIMIT TË MBROJTJES KUNDËR ZJARRIT

| | 2022<br>1 | 2023<br>2 | 2024<br>3 | Gjithsej<br>4=1+2+3 | %<br>5 |
|---|---|---|---|---|---|
| 630 – buxhet i NJVL | 207.567 | 260.553 | 335.383 | 803.503 | 36,0% |
| W0 – Mbrojtje kundër zjarrit | 204.295 | 253.508 | 325.095 | 782.898 | 35,1% |
| WA- Shpenzime kapitale për mbrojtje kundër zjarrit | 3.272 | 7.045 | 10.288 | 20.605 | 0,9% |
| 785 – donacione | 7.741 | 12.868 | 0 | 20.609 | 0,9% |
| W0 – Mbrojtje kundër zjarrit | 2.014 | 9.101 | 0 | 11.115 | 0,5% |
| WA – Shpenzime kapitale për mbrojtje kundër zjarrit | 5.727 | 3.767 | 0 | 9.494 | 0,4% |
| 930 – Dotacione të dedikuara nga Buxheti i Republikës | 410.501 | 473.363 | 525.526 | 1.409.390 | 63,1% |
| W0 – Mbrojtje kundër zjarrit | 410.501 | 473.363 | 525.526 | 1.409.390 | 63,1% |
| Gjithsej: | 625.809 | 746.785 | 860.909 | 2.233.503 | 100% |

Revizioni thekson se në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026, dotacionet e dedikuara për NJTKZ-të janë rritur për 90,3%, përkatësisht nga 525.526 mijë denarë në vitin 2025 në 1.000.000 mijë denarë në vitin 2026.

Në menaxhimin e mjeteve materiale në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, revizioni konstatoi dobësi të konsiderueshme.

Drejtoria disponon me mbi 30 depo nëpër njësitë territoriale, pa sistem të integruar të evidencës materiale dhe financiare, me mungesë të magazinierëve dhe të kontrolleve të përshtatshme. Nuk është kryer inventarizimi i plotë dhe harmonizimi i gjendjes, si dhe nuk është siguruar monitorimi i lëvizjes së mjeteve.

Kemi konstatuar se vlera e mjeteve të evidentuara prej 6.592.870 mijë denarë në vitin 2024 është zvogëluar në 3.833.441 mijë denarë në vitin 2025, përkatësisht për 41,9%.

Fotografia: Depo në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim



Sistemi i menaxhimit të krizave funksionon kryesisht në mënyrë reaktive, përmes aktivizimit gradual të burimeve nga niveli lokal drejt atij kombëtar. Në kushtet e kapaciteteve të pamjaftueshme lokale, shpallet gjendje krize dhe angazhohen burimet e Armatës, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ndihma ndërkombëtare.

Gjatë viteve 2024 dhe 2025, gjendja e krizës për shkak të zjarreve është shpallur dhe zgjatur disa herë, që tregon kapacitete të pamjaftueshme për përballimin efikas të fatkeqësive.

Revizioni konstatoi angazhim joproporcional të Armatës dhe Policisë në raport me forcat e mbrojtjes dhe shpëtimit, që tregon se sistemi në masë të konsiderueshme mbështetet në mekanizmat e gjendjes së krizës, në vend që të mbështetet në sistem të rregullt dhe funksional të mbrojtjes dhe shpëtimit.

Analiza dhe raporte sistematike për aktivitetet e zbatuara të mbrojtjes dhe shpëtimit gjatë fatkeqësive natyrore nuk përgatiten, që kufizon ndjeshëm mundësinë për identifikimin e mësimeve të nxjerra.

Edhe pse ekzistojnë raporte individuale analitike për ngjarje të veçanta, ato nuk përmbajnë tregues dhe indikatorë të përcaktuar qartë që do të mundësonin vlerësimin e efikasitetit të burimeve të përdorura, shkallës së dëmeve të shkaktuara dhe cilësisë së intervenimeve.

Raportet vjetore të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMS) nuk sigurojnë të dhëna për analizimin e funksionimit të sistemit, nuk përmbajnë indikatorë të suksesit, efikasitetit dhe shfrytëzimit të burimeve, si dhe nuk miratohen nga Qeveria.

Analiza e pamjaftueshme sistematike, si dhe mungesa e mekanizmave për zbatimin e mësimeve të nxjerra, e kufizojnë kapacitetin e shtetit për parandalimin dhe përballimin efikas të fatkeqësive natyrore dhe katastrofave në të ardhmen.

Njëkohësisht, nuk është siguruar transparencë dhe llogaridhënie e plotë në funksionimin e sistemit, që e kufizon mundësinë për përmirësim të vazhdueshëm dhe planifikim strategjik.

Në pjesën e mbikëqyrjes inspektuese, janë konstatuar kufizime të konsiderueshme: nga tridhjetë e katër (34) vendet e parapara të punës për inspektorë, janë plotësuar vetëm pesëmbëdhjetë (15), me mbulim në katërmbëdhjetë (14) nga tridhjetë e pesë (35) njësitë rajonale. Gjatë vitit

realizohen nga 1.168 deri në 1.369 mbikëqyrje me 14 deri në 17 inspektorë. Numri i kërkesave rritet ndjeshëm dhe arrin në 609 në vitin 2025, ndërsa për kontrollin e të gjitha 72.181 subjekteve, me kapacitetet ekzistuese, do të nevojiteshin nga 23 deri në 55 vjet.

**Si shembull pozitiv në funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit, revizioni veçon Komunën e Ohrit dhe Shërbimin Malor të Shpëtimit të Kryqit të Kuq të Ohrit, ku është vendosur organizim funksional, koordinim dhe gatishmëri operative, me financim të siguruar, burime njerëzore dhe përfshirje të më shumë subjekteve lokale.**

Shërbimi i shpëtimit malor disponon me shpëtimtarë të trajnuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe merr pjesë aktive në aksione shpëtimi dhe ushtrime ndërkombëtare. Megjithatë, revizioni thekson se këto kapacitete operative duhet të integrohen në mënyrë sistematike dhe institucionale në sistemin kombëtar të mbrojtjes dhe shpëtimit, me qëllim të sigurimit të funksionimit të tyre të qëndrueshëm dhe të koordinuar në nivel shtetëror.

Në drejtim të tejkalimit të dobësive të konstatuara, është e nevojshme zbatimi i reformave për vendosjen e sistemit të integruar dhe funksional të mbrojtjes dhe shpëtimit, përmes miratimit të Strategjisë Kombëtare, krijimit të kornize të qartë normative, sigurimit të financimit të qëndrueshëm, forcimit të kapaciteteve dhe vendosjes së sistemit efikas të monitorimit dhe mbikëqyrjes..



## 5.2.9. MEKANIZMAT E KONTROLLIT DHE FUNKSIONIMI I TYRE NË SISTEMIN SHTETËROR

### KOMISIONI SHTETËROR PËR VENDIMMARRJE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURË TË MARRËDHËNIES SË PUNËS NË SHKALLË TË DYTË

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2024, konstatuam gjendje që kanë të bëjnë me:

- nga formimi i Komisionit Shtetëror (nga viti 2011), nuk është themeluar njësia organizative për kryerjen e revizionit të brendshëm, e as nuk është shfrytëzuar mundësia për angazhimin e revizorit të brendshëm nga një subjekt tjetër i sektorit publik ose angazhimin e revizorit nga regjistri i revizorëve të brendshëm që mbahet nga Njësia Qendrore për Harmonizim pranë Ministrisë së Financave.

Ne pjesen e Theksimit te ceshtjeve kemi zbardhur gjendje që kane te bejne me:

- për shkak të numrit të pamjaftueshëm të të punësuarve, për zhvillimin e procedurave nga kompetenca e Komisionit Shtetëror, nëpunësve administrativë u jepen autorizime për veprim në lëndë nga fusha të caktuara. Me këtë rast, vëllimi dhe pesha e detyrave të punës me autorizimet e dhëna për nëpunësit administrativë për punë në lëndë nga fusha të caktuara nuk përputhen me vëllimin dhe peshën e detyrave të punës për vendet e punës në të cilat ata janë sistemuar, për arsye se autorizime u jepen edhe nëpunësve administrativë – bashkëpunëtorë të rinj, të cilët sipas rregullores për sistematizimin e vendeve të punës kryejnë punët më të thjeshta operative.

Theksojmë gjendjen e mospërputhjes së dispozitave të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në shkallë të dytë me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lidhur me afatet për veprimin e Komisionit Shtetëror sipas lëndëve, si dhe kompetencat e pamjaftueshme të përcaktuara ndërmjet Agjencisë për Administratë dhe Komisionit Shtetëror, në përputhje me dispozitat e Ligjit të ri për Nëpunësit Administrativë dhe Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik, në cilësinë e komisioneve të shkallës së dytë.

Në pjesën e kontrolleve të brendshme theksojmë kontrolle jo mjaft efikase për shkak të pajisjes jo të mjaftueshme të sektorit për çështje financiare dhe mbivendosjes së kompetencave të personave të njëjtë, si dhe për aktivitetet e ndërmarra për implementimin e ISO 9001:2015 – Standard Ndërkombëtar për sistemin e menaxhimit të cilësisë.



## AGJENCIA PËR REZERVA TË DETYRUESHME TË NAFTËS – MAKORA

Agjencia është person juridik i pavarur, i mëvetësishëm dhe jofitimprurës, i cili kryen punë me interes publik dhe është e vetmja e autorizuar për formimin, mirëmbajtjen, ruajtjen dhe shitjen e rezervave të detyrueshme të shtetit.

Rezervat e detyrueshme formohen dhe ruhen me qëllim që të sigurohet furnizim i pandërprerë i tregut me naftë të papërpunuar dhe/ose derivate të naftës në rast të cenimit të sigurisë energjetike të shkaktuar nga çrregullime të jashtëzakonshme dhe rënie të konsiderueshme e të papritur në furnizimin e tregut me naftë të papërpunuar dhe derivate të naftës.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2024 të Agjencisë, konstatuam gjendje që, ndër të tjera, kanë të bëjnë me:

- në përputhje me Ligjin për rezervat e detyrueshme të naftës është rregulluar që rezervat e detyrueshme të naftës të formohen, ruhen dhe rinovohen në bazë të: planit aksional për formimin e rezervave të detyrueshme, programit vjetor me plan financiar për vitin rrjedhës dhe vendimit për sasinë dhe strukturën e rezervave të detyrueshme për vitin rrjedhës, të cilin e përgatit Agjencia dhe përmes ministrisë përkatëse e miraton Qeveria. Për vitet 2022 dhe 2023, Qeveria nuk i ka miratuar vendimet e nevojshme, ndërsa për vitet 2024 dhe 2025 nuk është dorëzuar propozim-vendim në ministrinë kompetente. Mosmiratimi i vendimit të nevojshëm krijon rrezik për veprim jo të duhur dhe formim të rezervave në sasi dhe strukturë që nuk janë në përputhje me nevojat dhe prioritetet e Qeverisë;

- dobësi në përllogaritjen dhe pagesën e pagave të të punësuarve në Agjenci dhe gjatë përllogaritjes së kompensimit për pengesë të përkohshme për punë, përkatësisht pushime mjekësore. Përkatësisht, lartësia e pikëve që kanë të bëjnë me pagën është përcaktuar me Marrëveshjen Kolektive të Agjencisë, të cilat janë më të larta në krahasim me pikët e përcaktuara me Ligjin për nëpunës administrativë;

- evidenca për punën jashtë orarit nuk është e plotë, përkatësisht për një pjesë të të punësuarve ekzistojnë të dhëna për orët e realizuara jashtë orarit, ndërsa për të tjerët një evidencë e tillë nuk është siguruar.

Ne zbuluam gjendjen e huasë së pakthyer prej 600.000 kilogramësh mazut, të cilat në vitin 2017 i janë dhënë Ministrisë së Mbrojtjes dhe deri në vitin 2026 ende nuk janë kthyer, si dhe për dhënien e 13.321 tonëve mazut, të cilat gjatë viteve 2024-2025, me vendime të Qeverisë, i janë dhënë Elektranave të Maqedonisë së Veriut, pa kompensim. Edhe pse sasitë e dhëna janë në kuadër të atyre të përcaktuara me ligj, zvogëlimi i tyre për 75% brenda pothuajse një viti ka ndikuar që rezervat e naftës dhe derivateve të naftës, të cilat para dhënies së tyre siguronin mbulim për 52 ditë, të zvogëlohen dhe të sigurojnë mbulim prej 42 ditësh. Kjo mënyrë e shfrytëzimit të rezervave nuk mundëson formimin e rezervave të naftës që Qeveria përmes ligjit dhe Planit të Veprimit për formimin e rezervave të detyrueshme për vitet 2023-2025, është obliguar t'i arrijë dhe t'i mirëmbajë.

Për shkak të paqartësive në Ligjin për rezervat e detyrueshme të naftës, theksuam nevojën për rregullimin e:

- procedurës për harmonizimin e vlerës së rezervave të naftës, për arsye se e njëjta kryhet pa akt nënligjor ose akt të brendshëm me të cilin do të sigurohej vlerësimi i tyre i unifikuar në një periudhë më të gjatë;

- harmonizimit të neneve 26-a dhe 31 paragrafi 3 me nenin 15 paragrafi 3, për shkak të kolizionit të tyre në lidhje me përcaktimin e qartë të organit që do t'i miratojë aktet nënligjore të Agjencisë: Qeveria e RMV-së apo ministria kompetente – MEMLP;

- Nevoja që me dispozitë ligjore të përcaktohet mandati i drejtorit. Gjithashtu, emërimi i "ushtruesit të detyrës drejtor" nga Qeveria nuk ekziston si formë e menaxhimit të organeve shtetërore sipas Ligjit për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore dhe ligjit material të përmendur më parë. Mënyra e vendosur prej shumë vitesh e zgjedhjes dhe emërimit të ushtruesve të detyrës si organ drejtues në institucionet shtetërore, cenon parimin e sundimit të ligjit, krijon rrezik që menaxhimin e institucioneve ta kryejnë persona që nuk disponojnë kualifikimet e nevojshme të parashikuara me ligj, kontribuon në diskontinuitet në punë dhe ndikon në cilësinë e përmbushjes së kompetencave të institucioneve.

* 41-989/8 nga data 07.02.2023

## KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është organ shtetëror i pavarur me cilësi të personit juridik, i pavarur në punën e tij dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Për punën e tij përgjigjet para Kuvendit. Ai përbëhet nga kryetari, katër anëtarë dhe shërbimi profesional.

Mjetet për funksionimin e Komisionit sigurohen nga Buxheti i shtetit.

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për llogarinë e buxhetit bazë (637) për vitin 2024, me ç'rast kemi konstatuar gjendjet si në vijim:

- evidenca materiale dhe kontabël nuk është harmonizuar me gjendjen faktike të mjeteve të konstatuar përmes regjistrimit, për shkak të mungesës së treguesve vlerësorë në listat e regjistrimit;

- Komisioni nuk ka ndërmarrë masa për mbrojtjen e pronës përmes sigurimit, që krijon rrezik nga pamundësia për mbulimin e dëmeve eventuale të pronës dhe sendeve nga kompanitë e sigurimit dhe mund të shkaktojë shpenzime shtesë për buxhetin e Komisionit;

- Komisioni shqipton gjoba për mosveprim ose shkelje të konstatuara të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërsa mjetet nga gjobat e shqiptuara derdhen në Buxhetin e shtetit. Në Komision nuk është vendosur praktikë për evidencë unike të lëndëve dhe të kërkesave që burojnë prej tyre, gjë që mund të çojë në arkëtim jo në kohë të kërkesave, përkatësisht në parashkrimin e tyre;

- dobësi në përmbajtjen e dokumentacionit të tenderit dhe të specifikimeve teknike në dy procedura të prokurimit publik me vlerë të vogël;

Në drejtim të tejkalimit të gjendjeve të konstatuara, kemi dhënë rekomandime për personin përgjegjës, me synim ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për përmirësimin e gjendjeve.

Në pjesën e theksimit të çështjeve, theksojmë se në vitin 2024 Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk ka funksionuar në përbërje të plotë.

## INSPEKTORATI SHTETËROR I TREGUT

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Ekonomisë
**Inspektorati shtetëror i tregut**

Inspektorati Shtetëror i Tregut ushtron mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të nxjerra në bazë të ligjit në veprimtarinë e shoqërive tregtare, personave juridikë dhe fizikë, zbatimin e rregulloreve në fushën e ndalimit dhe parandalimit të ushtrimit të veprimtarisë së paregjistruar, si dhe shqiptimin e masave inspektuese me qëllim eliminimin e parregullsive të konstatuara.

Deri në qershor të vitit 2024, Inspektorati Shtetëror i Tregut funksionon si organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë me cilësi të personit juridik, me llogari të veçantë buxhetore si shfrytëzues buxhetor i vijës së parë, ndërsa pas ndryshimeve në LOFOASH, LMI dhe LISHT, ISHT vazhdon të funksionojë si organ në përbërje të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës, pa cilësi të personit juridik dhe me kompetenca të marra nga Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik.

Nga revizioni i kryer i raportit financiar të ISHT-së për vitin 2024, kemi konstatuar gjendje që ndikojnë në paraqitjen reale të të dhënave në raportet financiare, për shkak të:

- nuk është kryer plotësisht regjistrimi i objekteve ndërtimore, i mjeteve jomateriale dhe i 319 llogarive nga evidenca jashtëbilancore, nuk janë dhënë propozime për veprim lidhur me mungesat dhe tepricat e konstatuara, ndërsa për pajisjet e vjedhura nuk është paraqitur dokumentacion nga organi kompetent për vërtetimin e ngjarjes. Pas

marrjes së Inspektoratit Shtetëror të Tregut (ISHT) në përbërje të MEP, në shkurt të vitit 2025, është paraparë zbatimi i regjistrimit të jashtëzakonshëm të mjeteve të ISHT-së, por deri në ditën e revizionit i njëjti nuk është zbatuar;

- materialet e furnizuara të zyrës në vlerë prej 1.107 mijë denarë, formularët që lidhen me ushtrimin e mbikëqyrjes inspektuese në vlerë prej 791 mijë denarë dhe gomat automobilistike në vlerë prej 249 mijë denarë, nuk evidentohen si evidencën materiale;

- janë paraqitur detyrime në shumë më të lartë për 1.163 mijë denarë, për shkak të ndarjes (përkatësisht periudizimit) jo adekuate sipas periudhës për të cilën ato i përkasin.

Kemi konstatuar gjendje që tregojnë për veprime të ISHT-së që nuk janë në përputhje me rregullativën ligjore, përkatësisht:

- në periudhën janar–tetor janë miratuar 19 vendime për sistemimin e nëpunësve administrativë në vendin e punës inspektor, pa u siguruar mjete në buxhetin e ISHT-së për vitin 2024 dhe pa qenë të njëjtat të planifikuara në Planin Vjetor të Punësimit për vitin 2024. Në dhjetor të vitit 2024, 17 vendime janë shfuqizuar dhe punonjësit janë kthyer në vendet e mëparshme të punës.

- nuk ekzistojnë të dhëna të besueshme që do të konfirmonin se shpenzimet për energjinë elektrike të konsumuar, ujin dhe shërbimet komunale janë në përputhje me madhësinë e hapësirës së përdorur, përkatësisht me numrin e të punësuarve (në njësitë territoriale të ISHT-së në komuna), si kriter i dakorduar për shpërndarjen e shpenzimeve të përbashkëta.

- nuk është vendosur revizioni i brendshëm;

- në lidhje me përmbushjen e kompetencave nga ana e inspektorëve dhe plotësimin e formularëve të detyrueshëm me të dhëna nga kontrollet e kryera, në mënyrën e rregulluar me Ligjin për Mbikëqyrjen Inspektuese, konstatuam se ekziston veprim i ndryshëm, për shkak të mungesës së një akti për rregullimin e mënyrës së pranimit, lëshimit, përdorimit dhe përcaktimit të afateve për ruajtjen e formularëve të shfrytëzuar të procesverbaleve;

- libri „Regjistri i lëndëve nga procedura inspektuese" nuk plotësohet me të gjitha të dhënat e nevojshme, nga të cilat do të mund të vërtetohej se të gjitha lëndët e përfunduara nga mbikëqyrja inspektuese janë kompletuar plotësisht, arkivuar dhe dorëzuar në arkiv, si dhe se regjistrat janë mbyllur në nivel vjetor;

- nuk është miratuar akt i brendshëm për rregullimin e mënyrës së dhënies së deklaratës me shkrim në rastet kur inspektori nuk guxon të kryejë ose të marrë pjesë në mbikëqyrje inspektuese ndaj subjektit të mbikëqyrjes, kur ekziston konflikt interesi ose interes personal;

- listat e kontrollit të përgatitura (check-listat me nenet përkatëse të ligjeve) nuk janë përditësuar në mënyrë adekuate në përputhje me ndryshimet e bëra në ligjet.

Në pjesën e vazhdimësisë së funksionimit kemi theksuar ndryshimin statusor të ISHT-së, nga organ në përbërje me status të personit juridik në organ në përbërje të MEP pa status të personit juridik, në përputhje me ndryshimet në Ligjin për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore (LOPOASH), Ligjin për Mbikëqyrjen Inspektuese (LMI) dhe Ligjin për Inspektoratin Shtetëror të Tregut (LISHT), si një gjendje që do të ndikojë në përmbushjen e kompetencave të ISHT-së në raport me rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të datës 04.11.2025, i cili i referohet ISHT-së në drejtim të „forcimit të personelit, ristrukturimit dhe digjitalizimit të procedurave të brendshme operative për mbikëqyrjen e tregut në ISHT dhe sigurimit të pavarësisë së tij operative".

Në pjesën e theksimit të çështjeve kemi theksuar disa gjendje që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Tregut:

- ekziston nevoja për forcimin e burimeve njerëzore – ekipimin e vendeve të punës udhëheqës të sektorëve/departamenteve, (pesë departamente nuk kanë udhëheqës);

- për shkak se ISHT nuk disponon me softuer kompjuterik që përmban bazat e nevojshme të të dhënave dhe metodologjinë e integruar për vlerësimin e rrezikut për mbikëqyrjet inspektuese;

    - gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, për lëndët ose bagëtinë e gjallë të sekuestruara përkohësisht, ISHT duhet të sigurojë kushte për ruajtjen e tyre deri në dorëzimin te Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar. Duke pasur parasysh se sekuestrimi i sendeve është praktikë e rregullt, si dhe rëndësinë e vlerës së tyre, mungesa e objekteve të nevojshme krijon rrezik për veprim dhe ruajtje jo të përshtatshme të sendeve të sekuestruara, trajtim subjektiv të tyre, si dhe humbje të mundshme me implikime financiare për ISHT-në.

Si dobësi sistemore e theksojmë funksionimin e Departamentit për Mbikëqyrje Inspektuese të Sigurisë së Produkteve, aktivitetet e të cilit janë të orientuara drejt verifikimit të sigurisë së produkteve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, Ligjit për Kërkesat Teknike të Produkteve dhe Vlerësimin e Konformitetit, si dhe Ligjit për Mbikëqyrjen e Tregut. Në periudhën 2022–2025, këto kontrolle realizohen përmes dy projekteve të financuara nga EU4Business dhe CEFTA, të cilat mundësojnë marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike për cilësinë e naftës dhe derivateve të naftës, për sigurinë e materialeve ndërtimore, si dhe testimin dhe ekzaminimin e tyre në laboratorë të akredituar jashtë territorit të shtetit, me qëllim të verifikimit të sigurisë së produkteve të caktuara. Zbatimi i vazhdueshëm i mbikëqyrjeve inspektuese për sigurinë e produkteve në periudhën 2022–2025 ka rezultuar me largimin e 40 produkteve nga tregu, të cilat nuk kanë qenë të sigurta, ose me parandalimin e importit të tyre, por, mbetet e pasigurt nëse ky lloj kontrollesh do të vazhdojë edhe pas përfundimit të projektit, për shkak të mjeteve të kufizuara të parashikuara në buxhetin e ISHT-së për testimin e vazhdueshëm të produkteve të pasigurta.

## DREJTORIA PËR ZONAT ZHVILLIMORE INDUSTRIALE TEKNOLOGJIKE (ZZHIT)

Në territorin e shtetit, Qeveria ka themeluar 16 Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike (ZZHIT) dhe tre Zona Industriale, të cilat menaxhohen dhe janë nën kompetencën e Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike (DZZHIT). Gjithashtu, është filluar procedura për themelimin e ZZHIT-ve të reja në territorin e Komunës së Kumanovës dhe Komunës së Likovës.

Konstatuam gjendje, parregullsi dhe mosharmonizim në punën e subjektit, të cilat ndikojnë në shprehjen e opinionit të pafavorshëm për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2024 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura për llogarinë e buxhetit themelor (637), si dhe opinionit me rezervë për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura për vitin 2024 në llogarinë e buxhetit nga aktivitetet vetëfinancuese (787).

Me revizionin është konstatuar se investimet në vijim, të realizuara në zonat në vlerë prej 4.243.216 mijë denarë, përkatësisht 68.772.000 euro, ende evidentohen si mjete materiale në përgatitje dhe për to nuk llogaritet amortizimi dhe rivlerësimi, edhe pse pjesa më e madhe e tyre tashmë është vënë në përdorim. Shkak për këtë gjendje është mosplotësimi i kushteve dhe zgjidhjeve ligjore për marrjen e miratimit për përdorim.

Regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve është kryer në mënyrë jo të plotë dhe nuk është bërë harmonizimi i evidencës kontabël me gjendjen faktike të konstatuar me regjistrimin.

Nuk është miratuar programi trevjeçar investues përfundim me 2024, si dokument afatgjatë për planifikimin e aktiviteteve të DZZHIT së. Në dhjetor të vitit 2024 është miratuar Programi trevjeçar investues për periudhën 2025–2027.

Ekzistojnë mospërputhje në procesin e planifikimit të prokurimeve publike dhe në realizimin e kontratave të lidhura. Për ndërtimin e objekteve për akomodim të përkohshëm dhe ambulancë për ndihmë të parë, kopshte për fëmijë dhe depo me përmbajtje shoqëruese (parkingje) në ZZHIT Shkup 1 dhe ZZHIT Shkup 2, si dhe objekte për akomodim të përkohshëm, kopshte për fëmijë dhe depo me përmbajtje shoqëruese (parkingje) në ZZHIT Shtip dhe ZZHIT Prilep, sipas parimit "çelësa në dorë", në vitin 2023 është lidhur kontratë me vlerë totale prej 1.781.800 mijë denarë me TVSH, përkatësisht 28.878.400 euro. Kemi konstatuar se prokurimi është planifikuar dhe realizuar pa një analizë paraprake të kostove, pa studim fizibiliteti për arsyeshmërinë ekonomike dhe pa dokumentacion projektesh të përgatitur me preventiv dhe përllogaritje, megjithëse bëhet fjalë për një investim kapital jashtëzakonisht të madh dhe kompleks. Vlera e vlerësuar e prokurimit është përcaktuar pa analiza të plota dhe të besueshme, duke u bazuar ekskluzivisht në tarif për shërbime inxhinierike, ndërkohë që nuk është shfrytëzuar mundësia ligjore për dialog teknik me operatorët ekonomikë, si dhe procedura nuk është zhvilluar si prokurim i ndashëm, pavarësisht llojeve të ndryshme të objekteve dhe lokacioneve. Për realizimin e kontratës, në fund të vitit 2023 është paguar një avans prej 20% të vlerës së kontratës, në shumën prej 302.000 mijë denarë, përkatësisht 4.895.000 euro. Kemi konstatuar dobësi në

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 302/22 dhe nr. 03/25.
* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 48/10 dhe nr. 86/25.
* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 48/10, nr. 79/13 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 86/25.

realizimin e kontratës, e cila njëkohësisht nuk përmban mënyrë të qartë të rregulluar të pagesës për përgatitjen e dokumentacionit projektues, që krijon pasiguri juridike dhe rrezik financiar për organin kontraktues.

DZZHIT, në korrik të vitit 2025, ka dorëzuar Informacion në Qeveri për nevojën e ndërprerjes me marrëveshje të kontratës.

Për ndërtimin e një objekti administrativ në ZZHIT Shtip, në dhjetor të vitit 2022 është lidhur një kontratë në vlerë prej 212.398 mijë denarë me TVSH, përkatësisht 3.442.400 euro, ku kemi konstatuar dobësi të konsiderueshme në realizimin e saj. Në të vërtet është lidhur një aneks për punë shtesë dhe të paparashikuara si pasojë e dokumentacionit projektues dhe preventiv-përllogaritjeve të pamjaftueshme dhe jo mjaftueshëm precize, me ç'rast muri mbajtës dhe rruga hyrëse e ndërtuar nuk janë përfshirë në dokumentacionin projektues për të cilin është lëshuar leja e ndërtimit, që nuk është në përputhje me Ligjin për Ndërtim. Gjithashtu, kontraktuesi ka filluar me furnizimin dhe montimin e një stacioni pastrues pa marrë paraprakisht miratim për ndryshime gjatë ndërtimit nga ministria kompetente.



OBJEKT ADMINISTRATIV NË ZZHIT SHTIP, MUR MBAJTËS DHE RRUGË HYRËSE

Për shërbime konsulence për përzgjedhjen e një partneri për partneritet publik privat për ZZHIT Gjevgjeli, në vitin 2023 është lidhur kontratë në vlerë prej 39.044 mijë denarë, për të cilën kemi konstatuar dobësi në zhvillimin e procedurës dhe në realizimin e saj. Kriteret teknike dhe kualifikuese të vendosura janë kufizuese dhe diskriminuese, për shkak të së cilave është paraqitur vetëm një ofertë. Pas publikimit të dy thirrjeve publike për përzgjedhjen e një partneri për partneritet publik privat, të njëjtat kanë përfunduar me anulim për shkak se nuk është paraqitur asnjë ofertë. Pavarësisht pagesës së 85% të vlerës së kontratës, aktivitetet e parapara sipas programit të projektit nuk janë realizuar në tërësi, që tregon për shfrytëzim jo adekuat të mjeteve publike.

Në vitin 2023 është lidhur një marrëveshje kornizë për promovimin dhe marketingun e investimeve të huaja direkte në vlerë prej 15.340 mijë denarë, si dhe një aneks në vlerë prej 2.950 mijë denarë, ndërsa realizimi i saj arrin në 16.862 mijë denarë. Revizioni konstatoi se një pjesë e shërbimeve janë kryer pavarësisht ekzistimit të një sektori për marketing, pa indikatorë të vendosur për matjen e efekteve të aktiviteteve të përmendura. Gjithashtu, aneksi për rritjen e vlerës së kontratës me 19% nuk paraqet rrethanë që organi kontraktues nuk ka mundur ta parashikojë, që tregon shpenzim jo adekuat të mjeteve publike.

**Kemi zbuluar se 287 hektar nga sipërfaqja e përgjithshme e shfrytëzueshme e Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike (ZZHIT) dhe zonave industriale nuk janë shfrytëzuar në mënyrë funksionale, përkatësisht nuk janë dhënë me qira. Ndërkohë, shtatë nga gjithsej 16 zonat, me sipërfaqe të përgjithshme prej 203,5 ha, si dhe një zonë industriale me sipërfaqe prej 3,2 ha, nuk janë vënë në funksion, përkatësisht hapësira e tyre nuk është dhënë në përdorim për shfrytëzues.**

Në periudhën 2009–2023, në zonat që nuk janë vënë në funksion janë realizuar investime në vlerë të përgjithshme prej 143.408 mijë denarë (2,3 milionë euro), që përbëjnë 3,4% të vlerës së përgjithshme të mjeteve materiale në përgatitje dhe kjo mbi bazën e ndërtimit të infrastrukturës bazë të brendshme, dokumentacionit projektues dhe eksproprijimit të tokës.

ZZHIT RADOVISH, E CILA NUK ËSHTË VËNË NË FUNKSION (E FOTOGRAFUAR ME DRON)



Nën emërtimin e detyrimeve nga depoziti i mbajtur, në evidencën kontabël të DZZHIT së janë evidentuar 39.655 mijë denarë, të cilat rrjedhin nga vitet e kaluara sipas kontratave të lidhura për realizimin e punimeve ndërtimore. Në zonat, infrastruktura ndërtohet në faza, ndërsa sipas lejeve të lëshuara për ndërtim, kontrolli teknik mund të kryhet vetëm mbi një infrastrukturë të përfunduar si tërësi funksionale, përkatësisht pas marrjes së lejes së përdorimit nga ministria kompetente, për shkak që DZZHIT nuk e kthen depozitin e mbajtur ndaj kontraktuesve, ndërsa objektet evidentohen si mjete materiale në ndërtim. Këto gjendje kanë shkaktuar akumulim të detyrimeve mbi këtë bazë dhe paraqesin rrezik real për inicimin e procedurave gjyqësore nga ana e kontraktuesve.

Në raport është evidentuar se, sipas Marrëveshjes për Qiranë e Hapësirës Afariste, të lidhur në janar të vitit 2024, është paguar një depozitë në vlerë prej 7.181 mijë denarë, për shkak të mos harmonizimit në kushtet e kontratës dhe në procesin e pranimit-dorëzimit të hapësirave në dhjetor të vitit 2024, janë ndërmarrë aktivitete për zgjidhjen me marrëveshje të kontratës së qirasë dhe është iniciuar procedurë gjyqësore, por deri në ditën e raportimit nga revizioni, depozita nuk ishte kthyer nga qiradhënësi.

## INSPEKTORATI SHTETËROR PËR NDËRTIMTARI DHE URBANIZËM

Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm ka kompetencë për ushtrimin e mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e Ligjit për Ndërtim dhe të akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij, përkatësisht ushtron mbikëqyrje inspektuese mbi objektet e kategorisë së parë, si dhe mbikëqyrje inspektuese në përputhje me dispozitat e **Ligjit për ndalimin dhe parandalimin e ushtrimit të veprimtarisë së paregjistruar.**

Gjithashtu, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm ushtron mbikëqyrje mbi zbatimin e Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe të akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij, përkatësisht kryen mbikëqyrje mbi procedurat për miratimin dhe zbatimin e planeve urbanistike dhe projekteve urbanistike.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të ISHNU-së për vitin 2024, në llogarinë e buxhetit themelor 637, ku konstatuam:

- dobësi në procesin e kryerjes së regjistrimit të mjeteve dhe burimeve të mjeteve;
- mungesa e vlerës së objekteve ndërtimore të ndara me Vendim të Qeverisë dhe mosndërmarrja e aktiviteteve për vlerësimin e tyre dhe evidentimin përkatës në librat afaristë;
- dobësi në procesin e llogaritjes dhe pagesës së pagave;
- mënyrë joadekuate e organizimit të mbikëqyrjes inspektuese në fushën e urbanizmit, për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore;
- ISHNU nuk ka dorëzuar raporte gjashtëmujore për të dhënat që kanë të bëjnë me veprimin sipas parashtresave dhe propozimeve që janë në kompetencën e tij.

Në pjesën e vazhdimësisë së funksionimit informojmë për ndryshimin e statusit juridik që rrjedh nga ndryshimet ligjore, sipas të cilave Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm vazhdon të funksionojë si organ në përbërje të Ministrisë së Transportit, pa status të personit juridik.

Në pjesën Theksimi i çështjeve janë zbardhur gjendje që kanë të bëjnë me:

- mënyrën e menaxhimit dhe udhëheqjes së subjektit të reviduar;
- dobësi në procesin e bashkëpunimit dhe koordinimit të ndërsjellë të organeve gjatë veprimit sipas parashtresave dhe propozimeve dhe
- mënyrën e ushtrimit të kompetencave të ISHNU-së, realizimin e pamjaftueshëm të masave të urdhëruara nga komunat, si dhe nevojën për koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve kompetente.

Në pjesën e kontrolleve të brendshme theksojmë se nuk janë caktuar persona për kryerjen e kontrollit financiar ex-ante dhe ex-post dhe nuk është siguruar plotësimi i nevojshëm i kapaciteteve kadrovike.

* Gazeta Zyrtare nr. 130/2009; ... 101/2025
* Gazeta Zyrtare nr. 32/20, 111/23, 73/24, 171/24, 224/24.

## INSPEKTORATI SHTETËROR SANITAR DHE SHËNDETËSOR

Me revizionin e rregullshmërisë së raporteve financiare të Inspektoratit për vitin 2024 janë konstatuar gjendje që ndikojnë në cilësinë e procedurave inspektuese, veçanërisht në pjesën e procedurave të zhvilluara me kërkesë të palëve për importin e artikujve për përdorim të përgjithshëm, produkteve kozmetike, lodrave për fëmijë, mjeteve për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe produkteve të tjera.

Revizioni konstatoi se faturat dhe certifikatat shëndetësore të paraqitura në këto procedura janë në disa gjuhë të huaja, që krijon rrezik që inspektorët të mos e kuptojnë plotësisht përmbajtjen e tyre dhe të miratohet importi i mallrave pa u konfirmuar plotësisht autenticiteti dhe siguria e tyre shëndetësore.

Në pjesën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese në fushat e mbrojtjes sanitare-higjienike, epidemiologjike dhe shëndetësore, janë konstatuar gjendje që tregojnë nevojën për forcimin e bazës provuese në procedurën inspektuese, pasi në një pjesë të lëndëve mungon dokumentacioni mbështetës për gjendjen faktike të konstatuar.

Revizioni konstatoi dhe dobësi në funksionimin financiar dhe në kontrollet e brendshme, përkatësisht regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është kryer në tërësi, ndërsa është konstatuar edhe llogaritje dhe pagesë e pasaktë e shtesës për punë me rrezik të lartë për inspektorët.

Revizioni theksoi se lista e substancave që nuk lejohen të përdoren në produktet kozmetike, e miratuar në vitin 2010, deri në ditën e raportimit nga revizioni i kryer nuk është përditësuar asnjëherë dhe nuk e ndjek praktikën e Bashkimit Evropian, ku kjo listë është përditësuar disa herë. Për shkak të kësaj, ekziston rreziku që në treg të vendosen produkte që përmbajnë substanca të cilat në BE janë përcaktuar si të dëmshme për shëndetin, ndërsa nuk janë të ndaluara në territorin e shtetit tonë.

Për më tepër, revizioni theksoi se në kuadër të laboratorëve shtetërorë nuk janë siguruar kushtet dhe pajisjet teknike për testimin e të gjitha substancave të ndaluara në produktet kozmetike, ndërsa asnjë laborator nuk disponon me pajisje për testimin e substancave të ndaluara, siç janë ftalatet dhe bori, në lodrat për fëmijë që importohen dhe hidhen në qarkullim në territorin e shtetit.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara, Enti Shtetëror i Revizionit dha rekomandime të orientuara drejt përmirësimit të procedurave inspektuese, forcimit të dokumentacionit provues, zbatimit të plotë të regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve, llogaritjes së saktë të shtesave në pagë, përditësimit të rregullativës për substancat e ndaluara në produktet kozmetike, si dhe sigurimit të kapaciteteve të përshtatshme laboratorike.



# 5.2.10. ARSIMI DHE SHKENCA

## KONVIKTI SHTETËROR STUDENTOR „PELLAGONIJA" SHKUP

Veprimtaria kryesore e Konviktit Shtetëror Studentor Pelagonia (KSHS) është sigurimi i akomodimit, ushqimit, kujdesit shëndetësor, si dhe organizimi i aktiviteteve kulturore-argëtuese, sportive-rekreative dhe aktiviteteve të tjera për studentët që studiojnë jashtë vendbanimit të tyre.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2024 në llogarinë e buxhetit themelor (637) dhe llogarinë e buxhetit nga aktivitetet vetëfinancuese (787), konstatuam gjendje, parregullsi dhe mos harmonizim në funksionim dhe atë si vijon:

Në evidencën materiale dhe kontabël nuk janë evidentuar disa mjete të përhershëm dhe nuk është kryer harmonizimi i evidencës kontabël dhe materiale, as nuk janë ndërmarrë aktivitete për vlerësimin e vlerës së tyre, sigurimin e fletës poseduese dhe evidentimin e tokës nën ndërtesë, e cila i është dhënë në shfrytëzim konviktit. **Konstatuam se në evidencën e konviktit nuk është evidentuar pajisje në vlerë prej 21.563 mijë denarë, ndërsa për një pjesë të pajisjeve të kuzhinës, që është paguar nga ministria kompetente, nuk u siguruam se ato janë pranuar nga KSHS-ja.**

Kemi konstatuar mospërputhje në procesin e planifikimit dhe zbatimit të prokurimeve publike dhe realizimin e kontratave të lidhura. Nga revizioni i prokurimeve publike për **mish të freskët për vitin 2023, për përpunime të mishit, produkte mishi dhe peshk për vitet 2023 dhe 2024, si dhe për produkte bujqësore për vitin 2023,** për të cilat janë lidhur kontrata në vlerë të përgjithshme prej 20.250 mijë denarë, kemi konstatuar dobësi në aspektin e çmimeve të ofruara. Në procedurat, më së shpeshti është paraqitur vetëm një ofertë, ndërsa kontratat janë lidhur në nivelin e vlerës së vlerësuar pa sasi të përcaktuara paraprakisht. Tek artikujt që prokurohen rregullisht, çmimet e ofruara janë më të larta se çmimet e tregut, ndërsa tek artikujt që nuk prokurohen janë ofruar çmime jorealisht të ulëta, me qëllim arritjen e konkurrueshmërisë së ofertës. Vërehet tejkalim i vlerave të kontraktuara tek një pjesë e kontratave, **që tregon për kontroll të pamjaftueshëm dhe përdorim joekonomik të mjeteve publike.**



Në prokurimin e **bukës dhe miellit** për vitin 2023, kontrata është lidhur me një ofertues, veprimtaria themelore e të cilit nuk është e lidhur me objektin e prokurimit, ndërsa gjatë revizionit nuk është paraqitur garancia e detyrueshme bankare për ekzekutim cilësor të kontratës, që tregon se kontrata është lidhur pa dorëzimin e saj. **Për më tepër edhe pse çmimi i kontraktuar për bukën ka qenë 57,46 denarë për kilogram, gjatë realizimit operatori ekonomik ka faturuar një copë bukë si një kilogram, që për shkak të kontrolleve të brendshme të dobëta është zbuluar vetëm kah fundi i vitit 2024.** Pas vendosjes së evidencës ditore, faturat mujore në vitin 2025 janë përgjysmuar. Revizioni konstatoi gjithashtu se, me kontratën e re në vitin 2025, çmimi i bukës ka arritur në 126 denarë/kg, është dukshëm mbi çmimin e tregut prej rreth 70 denarë/kg, që tregon për përdorim joekonomik të mjeteve publike dhe dobësi në kontrollin e prokurimeve publike.

Dokumentacioni i tenderit për **prokurimin e dyshekëve** nga viti 2023 përmban kushte kufizuese, ndërsa kontrata është lidhur me operatorin ekonomik të përzgjedhur pa u siguruar garancia bankare për ekzekutim cilësor të kontratës. **Janë prokuruar 250 dyshekë në vlerë të përgjithshme prej 1.174 mijë denarë (nga 500 dyshekë të paraparë), me dimensione të ndryshme nga ato të përcaktuara në specifikimin teknik, pa dokumentacion përkatës për pranimin, ndërsa të njëjtit asnjëherë nuk janë vënë në përdorim. Gjithashtu, konstatuam se edhe më herët janë prokuruar 450 dyshekë nga i njëjti furnizues, edhe pse ekzistuesit kanë qenë në gjendje të mirë, ndërsa për shkak se dimensionet e shtretërve kanë qenë më të vogla se ato të dyshekëve, është komprometuar stabiliteti dhe qëndrueshmëria statike e shtretërve.**

Në procedurat me vlerë të vogël **për mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike dhe makinave larëse,** për të cilat është lidhur kontratë në vlerë prej 354 mijë denarë, si dhe në **prokurimin e shërbimeve për mirëmbajtje, riparim dhe furnizim me pjesë rezervë për dhoma mirëmbajtjeje dhe ftohjeje,** prokurimin e shërbimeve për mirëmbajtje,

riparim dhe furnizim me pjesë rezervë për dhoma mirëmbajtjeje dhe ftohjeje.

**Kemi konstatuar dobësi në dokumentacion dhe në arsyeshmërinë e shpenzimeve për mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve në KSHS 'Pellagonija' në vlerë prej 1.027 mijë denarë.** Për një pjesë të shërbimeve të faturuara nuk ekziston dokumentacion i plotë dhe i besueshëm, mungojnë të dhëna të sakta në urdhrat e punës, ndërsa nuk janë siguruar as prova të mjaftueshme se shërbimet janë kryer realisht ose janë kërkuar paraprakisht nga konvikti, që tregon për përdorim joefikas dhe jo të dedikuar të mjeteve publike.

Konstatuam dobësi në rregullimin dhe mënyrën e llogaritjes dhe pagesës së pagave dhe kompensimeve, si dhe mos harmonizimin e akteve të brendshme me rregullativa ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Programi i punës** nuk është hartuar në nivel vjetor me aktivitete konkrete për vitin 2024, ndërsa raporti për realizimin e programit nuk përmban të dhëna për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, veçanërisht në pjesën e përmbushjes së nevojave të studentëve, organizimit të aktiviteteve kulturore-sportive dhe rekreative, si dhe për realizimin e ndërhyrjeve të planifikuara infrastrukturore.

Me revizionin e llogarisë së buxhetit nga aktivitetet vetëfinancuese (787), konstatuam se gjatë evidentimit të transaksioneve nuk zbatohet parimi kontabël i paraqitjes në bazë të arkëtimit dhe pagesës së mjeteve (parimi i parasë së gatshme) dhe se ekziston mos harmonizim ndërmjet evidencës materiale dhe evidencës kontabël të mjeteve të përhershme. Konvikti nuk ka miratuar procedurë për menaxhimin e rezervave dhe konstatuam dobësi në kontrollet e vendosura gjatë pranimit dhe shpërndarjes së rezervave të produkteve ushqimore dhe artikujve të tjerë. Në pjesën e shpenzimeve konstatuam pagesa të mjeteve për **reprezentacion** pa dokumentacion përkatës mbështetës, dhe njëkohësisht janë kryer **furnizime me karburant,** servisim dhe zëvendësim të pjesëve rezervë për një automjet privat, i miratuar për përdorim për qëllime zyrtare, të cilat nuk janë mbështetur me dokumentacion përkatës dhe të besueshëm, gjë që tregon përdorim të mjeteve publike për qëllime private.

Në pjesën e **theksimit të çështjeve** kemi evidentuar këto gjendje:

- pagesa e mjeteve për paga për drejtorët e konviktit për periudhë prej gjashtë muajsh, për shkak se nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nuk është marrë vendim juridikisht i qëndrueshëm për shkarkim, duke përfshirë njëkohësisht sistemimin dhe pagesën e pagës së personit drejtues;

- Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në KSHS Pelagonija, e cila përmban disa mos harmonizim thelbësore dhe formalo-juridike me Ligjin për nëpunësit administrativë dhe Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe

- mënyra e buxhetimit nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe realizimi i mjeteve në nivel vjetor në KSHS, e cila ndikon në planifikimin real, monitorimin dhe realizimin e qëllimshëm të mjeteve sipas zërave, si dhe në harmonizimin e ndërsjellë të buxhetit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe KSHS.

- pagesa jo me kohë e detyrimeve ndaj furnizuesve në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratat e lidhura, e cila çon në vështirësi financiare në veprimtarinë e konviktit (e theksuar në raportin për llogarinë e buxhetit nga aktivitetet vetëfinancuese).



- NYJET SANITARE NË DHOMAT E STUDENTËVE



## KUSHTET NË DHOMAT E STUDENTËVE





Në pjesën e **theksimit të çështjeve kyçe** kemi evidentuar këto gjendje:

- pasigurinë lidhur me qëndrueshmërinë financiare dhe vazhdimësinë e funksionimit të KSHS Pellagonija, për shkak të së cilës është e nevojshme që Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me konviktet shtetërore të studentëve, të kryejë analizë dhe vlerësim të çmimit ekonomik për akomodimin dhe ushqimin e studentëve, si dhe nevojën për korrigjimin përkatës të çmimit, me qëllim që të vlerësohet niveli i qëndrueshmërisë financiare të konvikteve dhe të sigurohet funksionimi i tyre i pandërprerë pa krijimin e borxheve të prapambetura dhe

- Kushtet e qëndrimit të studentëve dhe rikonstruksioni i paralajmëruar i konviktit nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në kuadër të projektit „Rehabilitimi energjetik efikas i konvikteve studentore në Maqedoni".

Në pjesën që i referohet **kontrolleve të brendshme,** raportojmë për mungesë të vendosjes së sistemit të kontrolleve të brendshme në procesin e prokurimeve publike, përkatësisht në fazën e planifikimit, zbatimit dhe realizimit të tyre, si dhe për mungesë të kontrolleve të brendshme në procesin e përllogaritjes dhe pagesës së pagave, në lidhje me evidentimin e orarit të punës së të punësuarve. Gjithashtu, KSHS Pellagonia nuk ka vendosur një sistem funksional të kontrollit të brendshëm financiar, i cili do të siguronte garanci se të gjitha transaksionet janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore dhe se ato mbështeten në dokumentacion kontabël përkatës dhe të besueshëm.

## KONVIKTI SHTETËROR STUDENTOR „TOME STEFANOVSKI – SENIQ" SHKUP

Konvikti Shtetëror i Studentëve „Tome Stefanovski - Seniq", Shkup (KSHS Seniq), është themeluar si institucion publik për realizimin e veprimtarisë së standardit studentor, përkatësisht për përmbushjen e interesave dhe nevojave të studentëve që studiojnë jashtë vendbanimit të tyre, duke siguruar akomodim, ushqim, kujdes shëndetësor, aktivitete kulturore-argëtuese, sportive-rekreative dhe aktivitete të tjera për studentët e vendosur në konvikt.

Kemi konstatuar gjendje, parregullsi dhe mos harmonizim në funksionimin, përmes revizionit të kryer të raportit financiar për vitin 2024, për llogarinë e buxhetit themelorë (603) dhe llogarinë e buxhetit nga aktivitete vetëfinancuese (787), si në vijim:

KSHS "Seniq", edhe pse disponon me tri ndërtesa për akomodimin e studentëve, për shkak të kushteve nën standard njëra ndërtesë është nxjerrë jashtë përdorimit, ndërsa dhomat në objektet e tjera nuk i plotësojnë kushtet minimale për banim, për këtë arsye, pas përfundimit të vitit akademik 2025/2026, do të fillojnë aktivitetet për rindërtimin e plotë të objektit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kuadër të projektit „Rehabilitimi energjetik efikas i konvikteve studentore në Maqedoni".




KUSHTET PËR AKOMODIMIN DHE USHQIMIN E STUDENTËVE NË KSHS SENIQ




Ekzistojnë dobësi në mënyrën e zbatimit të regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve, si dhe nuk është kryer harmonizimi i evidencës kontabël me gjendjen faktike të konstatuar përmes regjistrimit. Nuk është kryer vlerësimi i vlerës së mjeteve të përhershëm të KSHS Seniq dhe nuk është vendosur evidencë materiale për to.

KSHS "Seniq", edhe pse disponon me tri ndërtesa për akomodimin e studentëve, për shkak të kushteve nën standard njëra ndërtesë është nxjerrë jashtë përdorimit, ndërsa dhomat në objektet e tjera nuk i plotësojnë kushtet minimale për banim, për këtë arsye, pas përfundimit të vitit akademik 2025/2026, do të fillojnë aktivitetet për rindërtimin e plotë të objektit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kuadër të projektit „Rehabilitimi energjetik efikas i konvikteve studentore në Maqedoni".

Është konstatuar se në evidencën e kontabilitetit nuk bëhet evidentimi i përditësuar dhe kronologjik i lëvizjes së rezervave të materialeve, nuk është vendosur evidenca e kontabilitetit e kërkesave të studentëve në bazë të akomodimit dhe ushqimit dhe ekzistojnë dobësi në mënyrën e zbatimit dhe realizimit të procedurave të prokurimeve publike.

Në pjesën **Çështjet Kryesore të Revizionit,** i nxjerrim në pah gjendjet në lidhje me qëndrueshmërinë financiare dhe vazhdimësinë e punës së DSD Seniq dhe nevojën për korrigjimin e duhur të çmimit të akomodimit dhe ushqimit për studentët dhe kushtet e akomodimit dhe qëndrimit të studentëve në konvikt.

Në pjesën **Theksimi i Çështjeve,** zbulohet gjendja me pagesën jo në kohë të detyrimeve ndaj furnizuesve në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratat e lidhura, gjë që çon në vështirësi financiare në punën e konviktit dhe dobësi në prezantimin e planifikimit, ndjekjes dhe realizimit me dedikim të mjeteve sipas zërave dhe harmonizimit të ndërsjellë të buxhetit të DSD Seniq dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Në pjesën që lidhet me **kontrollet e brendshme**, njoftojmë se nuk janë miratuar procedurat e shkruara me të cilat do të vendoset korniza në të cilën do të zhvillohet procesi i lëvizjes dhe kontrollit të dokumentacionit financiar dhe procesi i marrjes, lëshimit, konsumit dhe mënyrës së vlerësimit të rezervave.

## 5.2.11. BE

### MINISTRIA PËR ÇËSHTJE EVROPIANE

Republikës së Maqedonisë së Veriut

**Ministria për çështje evropiane**

Ministria ka detyrimin të sigurojë koordinimin dhe harmonizimin e punës së organeve të administratës shtetërore dhe institucioneve të tjera në procesin e përgatitjes së shtetit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke përfshirë negociatat për anëtarësim, zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe marrëveshjeve të tjera me Bashkimin Evropian, punën e organeve të përbashkëta përkatëse, si dhe përgatitjen e versionit maqedonas të së drejtës së Bashkimit Evropian (acquis communautaire).

Nga revizioni i kryer i raporteve financiare për vitin 2024 të ministrisë, rezultojnë më shumë gjendje të konstatuara, ndër të cilat:

- vlera e objekteve ndërtimore që i përdor Ministria nuk është paraqitur në mënyrë reale në raportet financiare për shkak të evidentimit të objekteve që Ministria nuk i përdor;

- regjistrimi vjetor i mjeteve themelore nuk i përfshin të gjitha mjetet me të cilat disponon Ministria: për shkak të ndryshimit të hapësirave afariste dhe zhvendosjes në lokacione të tjera (dy herë në 10 vitet e fundit), një pjesë e madhe e mjeteve që ndodhen në lokacione të tjera nuk janë regjistruar, ndërsa mjetet e prishura dhe të papërdorshme nuk janë propozuar për shlyerje;

- për angazhimin e 24 personave në bazë të kontratës në vepër janë paguar mjete në shumë të përgjithshme prej 8.083 mijë denarë, të cilët në pjesën më të madhe janë angazhuar për kryerjen e punëve organizative për nevojat e ministrit, zëvendësministrit dhe sekretarit shtetëror ose për shërbime këshillimore nga fusha të ndryshme. Pas ndryshimit të personave përgjegjës në Ministri, në korrik të vitit 2024 janë ndërprerë kontratat me 22 persona, ndërsa në vend të tyre janë angazhuar persona të rinj për detyra të ngjashme pune, që tregon se angazhohen persona konkretë, pa marrë parasysh kompetencat e tyre;

- nuk janë ndërmarrë aktivitete për sigurimin vjetor nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore, përmbytjet, vjedhjet dhe prishja e pajisjeve me të cilat disponon, që nuk është në përputhje me Ligjin për përdorimin dhe disponimin me sendet në pronësi shtetërore dhe me sendet në pronësi komunale, për shkak të së cilës ekziston rrezik nga humbja ose dëmtimi i mundshëm i tyre.

Gjatë zbatimit të furnizimeve publike konstatuam gjendje që tregojnë favorizim të operatorëve ekonomikë përmes vendosjes së kritereve specifike gjatë realizimit të furnizimeve për mirëmbajtjen e sistemeve TIK dhe furnizimin me licenca, ndërsa për furnizimin me shërbime për përkthim me shkrim, revizion gjuhësor dhe lekturim të së drejtës së Bashkimit Evropian (acquis) dhe akteve të tjera me rëndësi për procesin e anëtarësimit nga gjuha angleze dhe frënge në gjuhën maqedonase, edhe pse është paraparë që operatori ekonomik të disponojë me resurse të përshtatshme njerëzore me së paku 15 përkthyes, nuk është përcaktuar numri minimal i nevojshëm i përkthyesve për secilën gjuhë veç e veç.

Gjithashtu, Ministria nuk ka vendosur sistem të certifikuar për menaxhimin e cilësisë në përputhje me kërkesat e standardit bazë ISO 9001, si dhe ekziston nevoja për miratimin e procedurave të reja për një sistem efikas të kontrolleve të brendshme.

## ZBATIMI EFIKAS I PROGRAMIT ERASMUS+ PËR ARSIM, TRAJNIM, TË RINJ DHE SPORT

4 ARSIM CILËSOR
17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT

Erasmus+ paraqet një nga programet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit, me buxhet të përgjithshëm prej 26.200.000.000 euro (26,2 miliardë euro) për periudhën programore 2021–2027.

Programi Erasmus+ ka për qëllim të mbështesë zhvillimin arsimor, profesional dhe personal të njerëzve në fushat e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit, përmes promovimit të mësimit gjatë gjithë jetës, mobilitetit për mësim dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit, zhvillimin e aftësive dhe kompetencave, si dhe forcimin e kohezionit social dhe zhvillimit ekonomik.

Për këto arsye, Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të suksesit me temën **„Zbatimi efikas i programit Erasmus+ për arsim, të rinj dhe sport"** me qëllim që t'i përgjigjet pyetjes:

**„A zbatohet programi Erasmus+ (2021–2027) në Republikën e Maqedonisë së Veriut në mënyrë efikase, me realizim të plotë të objektivave të përcaktuara dhe me sigurimin e vlerës së shtuar?**

Objektivat e Programit realizohen përmes tri aktiviteteve kryesore:

- Aksioni Kyç 1 (AK 1) – Mobiliteti për mësim të individëve;
- Aksioni Kyç 2 (AK 2) – Partneriteti ndërmjet organizatave dhe institucioneve;
- Aksioni Kyç 3 (AK 3) – Mbështetje për zhvillimin e politikave.

Me Rregulloren e BE së për programin Erasmus+, është përcaktuar parimi i „vlerës së shtuar evropiane", sipas të cilit programi mbështet ekskluzivisht aktivitete që kanë potencial të krijojnë vlerë në nivel evropian dhe të kontribuojnë në arritjen e objektivave të programit përmes:

- karakter transnacional i aktiviteteve, veçanërisht përmes **mobilitetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar** që krijojnë efekte afatgjata sistemore;
- sigurimin e **kompatibilitetit, koordinimit dhe sinergjisë me programet dhe politikat kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare** dhe
- përdorimin e **instrumenteve të Bashkimit Evropian për njohjen, transparencën dhe transferueshmërinë e rezultateve nga të mësuarit dhe kualifikimeve.**

Në vitin 2014, Republika e Maqedonisë së Veriut, si vend i tretë*, fitoi statusin e vendit përfitues, të ashtuquajtur vend programor, që mundëson:

- pjesëmarrje e barabartë me vendet anëtare të Bashkimit Evropian;
- qasje e plotë në të gjitha aksionet kyçe, dhe
- aplikim i drejtpërdrejtë për grante dhe koordinim i projekteve.
- Ky status i vendit programor **paraqet përparësi të rëndësishme krahasuese**, pasi mundëson qasje më të gjerë në mjete financiare, mobilitete, partneritete dhe aktivitete të tjera në kuadër të programit, duke krijuar mundësi për përmirësimin e cilësisë së arsimit, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Programi zbatohet përmes menaxhimit të drejtpërdrejtë dhe tërthorazi, si në vijim:

- **menaxhim i drejtpërdrejtë (20%)** ku buxheti delegohet përmes Agjencisë Ekzekutive për Arsimin dhe Kulturën të Bashkimit Evropian* në Bruksel;
- **menaxhimi tërthorazi (80%), ku buxheti delegohet** përmes Agjencive Kombëtare

* Në përputhje me rregullativën shfrytëzuesit të programit Erasmus+ respektivisht vende programore janë shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e treta, si në vijim: Norvegjia, Islanda, Lihtenshtajni; Turqia (2004), Republika e Maqedonisë së Veriut (2014) dhe Serbia (2019).

* European Education and Culture Executive Agency – EACEA

Në nivel kombëtar zbatohet përmes sistemit të **menaxhimit tërthorazi, ku Ministria e Arsimit dhe Shkencës** ushtron rolin e **Autoritetit Kombëtar,** ndërsa **Agjencia Kombëtare për Programet Arsimore Evropiane dhe Mobilitet** është përgjegjëse për zbatimin operacional të programit.

Për pjesëmarrje në programet, Republika e Maqedonisë së Veriut siguron kontribut financiar, i cili përbëhet nga kontributi operativ dhe pjesëmarrja vjetore, e ashtuquajtura „biletë hyrëse", që paguhet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në buxhetin e Bashkimit Evropian.

Pagesa e „biletës hyrëse", së bashku me miratimin e Programit Vjetor të Punës, përbën parakusht për lidhjen e Marrëveshjeve të kontributit ndërmjet Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Arsim, Rini, Sport dhe Kulturë pranë Komisionit Evropian (DG EAC).

Sipas të dhënave nga Raporti i Tetorit për vitin 2025, „bileta hyrëse" për periudhën 2021–2027 do të arrijë përafërsisht 17.300.000 euro.

Vlera e marrëveshjeve të lidhura për kontributin e BE për zbatimin e programeve Erasmus+ dhe Korpusi Evropian i Solidaritetit (2021–2027) arrin në 37.717.305 euro, ndërsa për vitin 2026 arrin në 8.171.403 euro.

## MARRËVESHJET E KONTRIBUTIT NË PROGRAMIN ERASMUS+, TË LIDHURA ME BASHKIMIN EVROPIAN, 2021, 2022, 2023, 2024 DHE 2025

| Fusha | Aksioni kyç | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Arsimi i lartë (HED) | AK1 | 1.965.915 | 1.441.767 | 1.535.169 | 1.755.354 | 1.930.919 | 8.629.124 |
| | AK1 ( IPA III, NDICI) | 0 | 284.058 | 276.493 | 285.657 | 239.160 | 1.085.368 |
| | AK2 | 670.178 | 400.000 | 400.000 | 400.000 | 400.000 | 2.270.178 |
| Arsimi profesional (VET) | AK1 | 853.084 | 712.269 | 739.638 | 932.461 | 1.251.247 | 4.488.699 |
| | AK2 | 992.640 | 520.000 | 520.000 | 520.000 | 520.000 | 3.072.640 |
| Arsimi shkollor (SCH) | AK1 | 606.333 | 505.236 | 523.155 | 610.450 | 765.334 | 3.010.508 |
| | AK2 | 465.967 | 520.000 | 520.000 | 520.000 | 520.000 | 2.545.967 |
| Arsimi për të rritur (ADU) | AK1 | 143.719 | 119.642 | 121.404 | 186.882 | 236.086 | 807.733 |
| | AK2 | 411.901 | 520.000 | 520.000 | 520.000 | 520.000 | 2.491.901 |
| | AK3 | 81.187 | 114.311 | 113.769 | 113.769 | 114.236 | 537.272 |
| Arsim dhe shkencë | | 6.190.924 | 5.137.283 | 5.269.628 | 5.844.573 | 6.496.982 | 28.939.390 |
| Rinia (YOU) | AK1 | 259.944 | 428.571 | 478.358 | 565.550 | 650.797 | 2.383.220 |
| | AK2 | 388.054 | 520.000 | 520.000 | 520.000 | 520.000 | 2.468.054 |
| | AK3 | 68.914 | 120.724 | 113.100 | 115.371 | 113.426 | 531.535 |
| Rinia | | 716.912 | 1.069.295 | 1.111.458 | 1.200.921 | 1.284.223 | 5.382.809 |
| Sport (SPO) | AK1 | 0 | 0 | 40.314 | 50.397 | 60.545 | 151.256 |
| | AK3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.541 | 1.541 |
| Sport (SPO) | | 0 | 0 | 40.314 | 50.397 | 62.086 | 152.797 |
| Gjithsej Erasmus+ | | 6.907.836 | 6.206.578 | 6.421.400 | 7.095.891 | 7.843.291 | 34.474.996 |
| Gjithsej Korpusi Evropian i Solidaritetit | | 57.683 | 86.764 | 102.209 | 80.353 | 80.088 | 407.097 |
| Rrjetet | | 35.352 | 66.000 | 66.178 | 67.058 | 63.605 | 298.193 |
| Shpenzimet e menaxhimit | | 507.622 | 455.056 | 498.936 | 520.067 | 555.338 | 2.537.019 |
| Gjithsej kontrata me BE në | | 7.508.493 | 6.814.398 | 7.088.723 | 7.763.369 | 8.542.322 | 37.717.305 |

Nga të dhënat e siguruara nga Agjencia Kombëtare, kemi konstatuar se në periudhën **2021–2025** janë lidhur **614 marrëveshje** granti për financimin e projekteve me vlerë të përgjithshme prej afërsisht **30,8 milionë euro**, ndërsa pjesa më e madhe e mjeteve është përqendruar në Aksionin Kyç 1, gjegjësisht në mobilitet në arsimin e lartë, arsimin dhe aftësimin profesional si dhe arsimin shkollor.

## SHPËRNDARJA E MJETEVE PËR PERIUDHËN 2021–2025 **DHE MARRËVESHJET E LIDHURA**

| Fusha | KA1 – (KA121, KA131,KA151, KA171) - të akredituar | KA 1 –(KA122, KA152, KA153, KA154, KA155) - të paakredituar | KA2 - Partneritet KA 210, KA 220 | Gjithsej (€) | Pjesëmarrja (%) |
|---|---|---|---|---|---|
| HED – Arsimi i lartë (KA131,KA171,KA220) | 8.738.762 | 0 | 2.110.151 | 10.848.913 | 35,10% |
| SCH – Arsimi shkollor (KA121, KA122, KA 210, KA220) | 985.853 | 2.106.735 | 2.689.959 | 5.782.547 | 18,70% |
| VET – Arsimi profesional (KA 121, KA122, KA 210, KA220) | 1.857.655 | 2.330.582 | 2.766.170 | 6.954.407 | 22,50% |
| ADU – Arsimi për të rritur (KA121, KA122, KA) | 226.737 | 404.845 | 2.593.558 | 3.225.140 | 10,40% |
| YOU – Aktivitetet rinore (KA 151, 152, 153, 154) | 736.455 | 1.285.113 | 1.912.819 | 3.934.387 | 12,70% |
| SPO – sport (KA 182, të tjerë | 0 | 133.090 | 0 | 3.934.387 | 0,40% |
| Gjithsej: | 12.545.462 | 6.260.365 | 12.072.657 | 30.878.484 | 100% |

Me revizionin konstatuam se është vendosur strukturë që mundëson pjesëmarrje në program dhe shfrytëzim të mjeteve nga Bashkimi Evropian, megjithatë ekzistojnë dobësi të konsiderueshme në sistemin e programimit, menaxhimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të programit në nivel kombëtar. Ndërmjet dobësitë e identifikuara revizioni i veçon si vijon:

- nuk është vendosur një kornizë ligjore kombëtare për zbatimin e programit, nuk është miratuar rregullore e veçantë për sistemin e menaxhimit tërthorazi sipas modelit të programeve të tjera të BE-së, ndërsa nuk është përcaktuar në mënyrë të saktë as roli i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si Autoritet Kombëtar;
- integrimi i programit Erasmus+ në strategjitë kombëtare do të ketë si efekt realizimin e rezultateve afatgjata, në të kundërtën, ekziston rreziku që programi të funksionojë kryesisht si mekanizëm për financimin e projekteve individuale, në vend që të shërbejë si instrument strategjik për mbështetjen e politikave kombëtare dhe reformave në arsim;
- nuk janë të rregulluara qartë sa duhet procedurat për dhënien e granteve, përzgjedhjen dhe kontrollin e vlerësuesve dhe akreditimit;
- dobësi në sistemin e monitorimit, supervisimit dhe kontrollit mbi zbatimin e projekteve dhe
- vëllim i pamjaftueshëm dhe cilësi e dobët e kontrolleve primare, si dhe mungesë konsistence. Aktivitetet e monitorimit dhe kontrollit nuk bazohen në një qasje të qartë, të definuar dhe të dokumentuar për menaxhimin e rrezikut.

Edhe pse Agjencia Kombëtare ka vendosur sisteme të TI-së, procedura dhe mekanizma kontraktues për menaxhimin e programit, zbatimi i tyre nuk siguron nivel të mjaftueshëm sigurie dhe zhvillohet në kushte të besueshmërisë së pjesshme.

Agjencia Kombëtare, nga viti 2022, funksionon nën regjimin e **„garancisë së pjesshme"** dhe pranimit me kusht, ndërsa një pjesë e vërejtjeve të hapura që nga viti 2018 ende nuk janë mbyllur.

Në nëntor të vitit 2023 është dorëzuar raporti i Zyrës

Evropiane për luftë kundër mashtrimeve (OLAF), janë konstatuar indicie për parregullsi në **22 projekte** me vlerë të përafërt prej 2.276.212 euro, që tregon nevojën për forcimin e kontrolleve dhe mekanizmave të mbikëqyrjes.

Në janar të vitit 2026, Komisioni Evropian ka dorëzuar reagimin (feedback-un) për Raportin e Tetorit, me ç'rast është konstatuar ekzistimi i dobësive të konsiderueshme në sistemin e menaxhimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të programit Erasmus+ në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në kuadër të dobësive në menaxhimin e ciklit të projektit, janë konstatuar vonesa të konsiderueshme në proceset kyçe, si pagesa e parafinancimit, pagesa e pagesave përfundimtare, përpunimi i raporteve të përfituesve dhe zbatimi i procedurave për kthimin e mjeteve, ku në raste të caktuara vetëm një pjesë e vogël e pagesave përfundimtare është realizuar brenda afatit të paraparë.

Agjencia Kombëtare nuk e ka zbatuar numrin minimal të kontrolleve te përfituesit e granteve, në përputhje me rregullat e programit.

Një pjesë e këtyre gjendjeve lidhen me kapacitete të pamjaftueshme administrative dhe kadrovike, dobësi organizative, si dhe me nevojën për përmirësimin e procedurave të brendshme dhe të shpërndarjes së detyrave.

Për shkak të dobësive të lartpërmendura, Komisioni Evropian vlerëson se ekziston rrezik i shtuar për interesat financiare të Bashkimit Evropian, gjë që mund të çojë në ndërmarrjen e masave si rivlerësimi i sistemit të menaxhimit, kufizimi ose pezullimi i mandatit të Agjencisë Kombëtare, si dhe pezullimi i marrëveshjeve aktuale ose të ardhshme të financimit.

**Njëkohësisht, me revizionin konstatuam se po ndërmerren aktivitete për forcimin e sistemit, ku është e dukshme përkushtimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Agjencisë Kombëtare për avancimin e tij, ruajtjen e statusit të shtetit në program dhe shmangien e masave të mundshme nga Komisioni Evropian.**

**Në mars të vitit 2026, në kuadër të Sektorit për Bashkimin Evropian në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, është paraparë formimi i një Njësie të veçantë për monitorimin e programeve evropiane në fushën e arsimit, që tregon vendosjen institucionale të funksionit për monitorimin, koordinimin dhe menaxhimin me programet evropiane arsimore.**

Sistemi i raportimit është i orientuar kryesisht drejt përmbushjes së obligimeve ndaj Komisionit Evropian, ndërsa në nivel kombëtar nuk është vendosur praktikë për përgatitjen e raporteve gjithëpërfshirëse mbi zbatimin e programit Erasmus+, të cilat do të siguronin pasqyrë të plotë të menaxhimit të programit, sistemit të ndarjes së mjeteve dhe rezultateve të arritura.Për shkak të disponueshmërisë së kufizuar të informatave, Qeveria, Kuvendi dhe publiku nuk kanë pasqyrë të plotë mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit të programit, shpërndarjen e mjeteve, mënyrën e përzgjedhjes dhe vlerësimit të projekteve, si dhe mbi rezultatet dhe efektet e zbatimit të programit.

**Edhe pse programi siguron mundësi të rëndësishme për mobilitet, bashkëpunim dhe zhvillim të kapitalit njerëzor, revizioni konstatoi se në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është zbatuar vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar dhe matje e efekteve dhe e vlerës së shtuar të programit mbi sistemin arsimor dhe politikat kombëtare, ndërsa e cila është obligim në përputhje me rregullativën.**

Me revizionin kemi dhënë rekomandime të orientuara drejt përmirësimit të kornizës ligjore dhe institucionale për zbatimin e programit, përcaktimit më të qartë të kompetencave dhe përgjegjësive të institucioneve, forcimit të sistemit të monitorimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit, avancimit të menaxhimit të ciklit të projektit, forcimit të kapaciteteve administrative dhe njerëzore, si dhe përmirësimit të transparencës, llogaridhënies publike dhe vlerësimit kombëtar të efekteve dhe rezultateve të programit.



## 5.2.12. EKONOMIA

### MINISTRIA E EKONOMISË DHE PUNËS

Republika e Maqedonisë së Veriut
**Ministria e Ekonomisë dhe Punës**

Ministria e Ekonomisë, në përputhje me ligjin, është kompetente për monitorimin e gjendjeve në treg, zbatimin dhe propozimin e masave të politikës ekonomike, si dhe për fusha të tilla si prodhimi, tregtia, turizmi, hoteleria dhe mbrojtja e konsumatorëve. Në përbërje të saj funksionojnë disa organe, ndër të cilat inspektorate dhe Byroja e Metrologjisë.

Me ndryshimet e ligjit sistemor të vitit 2024, Ministria vazhdon të funksionojë si Ministria e Ekonomisë dhe Punës, me ç'rast një pjesë e kompetencave (tregtia e jashtme, turizmi, energjetika dhe minierat) transferohen në ministri të tjera përkatëse, ndërsa kompetencat në fushën e punës dhe politikës sociale merren përsipër nga kjo ministri. Një pjesë e organeve vazhdojnë të funksionojnë në përbërje të saj, ndërsa një pjesë kalojnë në institucione të sapoformuara ose në ministri të tjera.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të raporteve financiare, së bashku me revizion të pajtueshmërisë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës për vitin 2024, në llogarinë e buxhetit themelor 637 dhe 631.

Me revizionin e kryer, ndër të tjera, është konstatuar veprim jo adekuat i Njësisë për Procedura Kundërvajtëse, Gjyqësore dhe Administrative dhe i Komisionit për Kundërvajtje në lidhje me kërkesat për inicimin e procedurave kundërvajtëse sipas ligjeve të veçanta, si dhe lëndët të cilat kanë filluar, dhe nuk janë të papërfunduara nga ana e ISHT, që ka efekt te mjetet të papaguara në Buxhetin e shtetit në vlerë prej 2.078.000 euro.

Edhe pse Komisioni për Kundërvajtje është formuar në vitin 2019, veprimi ndaj lëndëve fillon vetëm në vitin 2022, me formimin e komisionit të ri. Dorëzimi i dokumentacionit të përgatitur plotësisht nga Njësia te Komisioni kryhet pas kalimit të një periudhe prej disa vitesh, ndërsa përgatitja e akteve që rrjedhin nga Procesverbalet e Komisionit për Kundërvajtje bëhet pas kalimit të një periudhe prej dy deri në shtatë muaj. Nga ana tjetër, Njësia nuk përgatit raporte mujore, gjashtëmujore dhe vjetore për punën e saj, që nuk është në përputhje me detyrat dhe obligimet e punës të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim.

Deri në nëntor të vitit 2024, për shkak të parashkrimit të Kërkesave për inicimin e procedurave kundërvajtëse, Komisioni ka miratuar 1.534 Vendime për ndërprerjen e procedurave kundërvajtëse, që ka rezultuar me më pak të hyra të arkëtuara në Buxhetin e shtetit në vlerë prej 127.721 mijë denarë, përkatësisht 2.078.000 euro.

Për më tepër, përfundim me majin 2025, nga Inspektorati Shtetëror i Tregut në Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës janë dorëzuar 398 lëndë për veprim, nga të cilat 164 i përkasin vitit 2023, 152 vitit 2024 dhe 82 vitit 2025.

### STATUSI I LËNDËVE KUNDËRVAJTËSE TË DORËZUARA NGA ISHT TE ME – MAJ 2025



**Revizioni gjithashtu thekson se në shtator të vitit 2024, mbi softuerin për lëndët e kundërvajtjeve është kryer një sulm i paautorizuar i targetuar, i cili ka rezultuar me humbje të plotë dhe të pakthyeshme të të dhënave.**

Në drejtim të arritjes së objektivave të politikave për burimet e ripërtëritshme të energjisë, në përputhje me Ligjin për Energjetikë* dhe Programin për mbështetje financiare për prodhimin e energjisë elektrike nga prodhuesit e privilegjuar që përdorin premi për vitin 2019*, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Ekonomisë ka shpallur Thirrje Publike* për ndarjen e kontratës për të drejtën e shfrytëzimit të premisë për energjinë elektrike të prodhuar nga elektrocentralet fotovoltaike të ndërtuara në tokë në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në lokacionet e komunave Sveti Nikollë, KK Amzabegovë – jashtë qytetit, PK 513/1, dhe Makedonski Brod, KK Manastirec në PK 1/1 dhe PK 303.

Për nevojat e rrethimit të parcelave të destinuara për ndërtimin e **elektrocentraleve fotovoltaike**, Ministria e Ekonomisë ka realizuar **dy faza** të prokurimit. Faza e parë, me vlerë kontraktuale **prej 9.750 mijë denarë, përkatësisht 158.536 euro, është përfunduar** në përputhje me projektin dhe lejen për ndërtim. Ndërsa për **fazën e dytë**, me vlerë kontraktuale prej **25.871 mijë denarë, përkatësisht 420.667 euro**, objekti i prokurimit deri në momentin e revizionit **nuk është realizuar**, nuk është paraparë garanci bankare për realizim cilësor të kontratës, **nuk është lidhur aneks** për zgjatjen e afatit, dhe nuk janë ndërmarrë masa juridike për arkëtimin e penaliteteve kontraktuale, me ç'rast nuk janë arritur objektivat e kontratës.

Për shkak të **ndryshimeve** në Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, dokumentacioni për investimet janë dorëzuar te **Ministria e Energjetikës, Xehetarisë dhe Burimeve Minerale**, por deri në momentin e revizionit **nuk është miratuar vendim për ndërprerjen dhe shfrytëzimin e përhershëm**, për shkak të së cilës mjetet ende udhëhiqen në evidencën kontabël të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës.

Gjatë revizionit, **Ministria e Energjetikës, Xehtarisë dhe Burimeve Minerale** paraqiti kërkesë pranë **Avokaturës Shtetërore** për ngritjen e padisë kundër operatorit ekonomik.

Lidhur me sektorin e TI-së, është konstatuar se ai funksionon **vetëm me 3 të punësuar nga gjithsej 12 vende pune të parapara**, ndërsa nuk janë miratuar **politika dhe procedura për sigurinë e informacionit**, nuk është caktuar person përgjegjës për sigurinë e informacionit dhe nuk është përgatitur **analizë e rreziqeve të TI-së**.

Edhe pse është lidhur kontratë për softuer rezervë (backup software), **nuk është përcaktuar monitorim i vazhdueshëm dhe dëshmi për funksionimin e rregullt të kopjeve rezervë**, ndërsa rrezik shtesë është edhe përdorimi i **sistemeve operative të vjetruara**, pa masa të përcaktuara mbrojtëse. Mosmarrja e masave për sigurimin e sigurisë së informacionit ka bërë që Ministria e Ekonomisë dhe Punës të jetë objekt i një sulmi të synuar IT në shtator të vitit 2024, i cili shkaktoi mosfunksionimin e të gjitha shërbimeve, si adresat e e-mailit, serveri i uebit dhe bazat e të dhënave, duke shkaktuar dëme të pallogaritshme në funksionimin e ministrisë.

**Edhe pse sistemet janë rikthyer në funksion pas 37 ditësh përmes kopjeve rezervë, një pjesë e të dhënave, përfshirë evidencën elektronike të lëndëve të Sektorit Juridik, është humbur në mënyrë të pakthyeshme.**



* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 96/18
* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 29/2019
* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 117/2019

# LINJË KREDITORE PËR FINANCIMIN E INVESTIMEVE DHE ZHVILLIMIT TË SHOQËRIVE PRIVATE TREGTARE ME MJETE NGA MARRËVESHJA PËR HUAMARRJE NGA BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Revizion i pajtueshmërisë me temë „Linja kreditore për financimin e investimeve dhe zhvillimit të shoqërive private tregtare me mjete nga Marrëveshja për huamarrje nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup (BZHMV) është e vetmja bankë zhvillimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut e themeluar me ligj të veçantë, me qëllim që përmes promovimit dhe ofrimit të produkteve financiare të favorshme për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të krijohet një ambient për përmirësimin e konkurrencës vendore, mbështetjen e eksportit dhe rritjen e zhvillimin ekonomik.

Revizionin e pajtueshmërisë me temë „Linja kreditore për financimin e investimeve dhe zhvillimit të shoqërive private tregtare me mjete nga Marrëveshja për huamarrje nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut" e realizuam me qëllim që të përcaktojmë nëse aktivitetet e BZHMV-së janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me rregullativën relevante ligjore dhe nënligjore të zbatuar, aktet e brendshme dhe marrëveshjet në lidhje me menaxhimin e mjeteve për kreditë e miratuara.

Në përputhje me vendim të Qeverisë, Ministria e Financave në bashkëpunim me Bankën Zhvillimore ngarkohen të ndërmarrin aktivitete për operacionalizimin e mjeteve nga linja e kredisë për financimin e investimeve dhe zhvillimin e shoqërive tregtare private në shumën prej 250 milionë euro në kundërvlerë denare përmes bankave pjesëmarrëse, nën kushtet e mëposhtme:

- shuma maksimale e kredisë së miratuar për përfituesin deri në 10 milionë euro në kundërvlerë me denarë;
- afat i shlyerjes nga ana e përfituesit përfundimtar deri në 15 vjet, me periudhë grejs deri në 3 vjet të përfshirë dhe pagesë tremujore pas përfundimit të periudhës grejs;
- normë fikse interesi 1,95%;
- pa kompensim për miratim dhe menaxhim dhe
- pjesëmarrja vetjake e përfituesit final prej minimum 20% të vlerës së investimit.

Во периодот од воспоставување на кредитната линија во 2025 година до април 2026 година за одобрените 752 проекти заклучно со февруари 2026 година повлечени се средства во износ од 14.080.298 илјади денари, односно 228.947.935 евра. Со ревизијата извршивме анализа на повлекување транши од Буџетот на државата во износ од 7.334.103 илјади денари за 123 проекти што опфаќа 52% од вкупно повлечените средства.

Në periudhën nga vendosja e linjës kreditore në vitin 2025 deri në prill të vitit 2026, për 752 projektet e miratuara, deri në fund të shkurtit 2026 janë tërhequr mjete në shumë prej 14.080.298 mijë denarë, përkatësisht 228.947.935 euro. Me revizionin kemi kryer analizë të tërheqjes së késteve nga Buxheti i shtetit në shumë prej 7.334.103 mijë denarë për 123 projekte, që përfshin 52% të mjeteve të tërhequra gjithsej.

Konkluduam se aktivitetet e BZHMV-së në lidhje me kornizën ligjore dhe menaxhimin e mjeteve nga linja e kredisë për financimin e investimeve dhe zhvillimin e shoqërive tregtare private janë në përputhje në të gjitha aspektet materiale me rregullativën relevante ligjore dhe nënligjore të zbatuar, aktet e brendshme dhe marrëveshjet.

Struktura e kredive të miratuara sipas madhësisë së subjekteve dhe veprimtarisë që ushtrojnë është paraqitur në tabelën më poshtë.

## STRUKTURA E KREDIVE TË MIRATUARA SIPAS MADHËSISË SË SUBJEKTEVE

në 000 denarë

| Madhësia e subjektit | Numri i projekteve | % pjesëmarrje | Shuma e kredisë së miratuar | % pjesëmarrje |
|---|---|---|---|---|
| Mikro | 47 | 6% | 1.364.600 | 10% |
| I vogël | 455 | 59% | 3.565.574 | 25% |
| I mesëm | 171 | 22% | 4.606.378 | 32% |
| I madh | 94 | 12% | 4.720.384 | 33% |
| **GJITHËSEJ:** | **767** | **100%** | **14.256.936** | **100%** |

Sipas veprimtarisë kryesore të subjekteve të cilëve u janë miratuar kreditë, 44% janë nga veprimtaria prodhuese, ndërsa 25% nga veprimtaria tregtare.

Struktura e kredive të miratuara sipas llojit të investimit është paraqitur në grafikonin si vijonë:

## STRUKTURA E KREDIVE TË MIRATUARA SIPAS LLOJIT TË INVESTIMIT



## FONDI PËR INOVACIONE DHE ZHVILLIM TEKNOLOGJIK

FI2HT

Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik është themeluar në dhjetor të vitit 2013, me qëllim nxitjen e inovacioneve përmes sigurimit të burimeve shtesë për financimin e tyre, për shkak të nevojës për ndërtimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë së **Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik për vitin 2024**, Enti Shtetëror i Revizionit konstatoi dobësi dhe mospërputhje që tregojnë nevojën për përmirësimin e menaxhimit financiar, forcimin e kontrolleve dhe respektimin e plotë të rregullativës ligjore nga subjekti lëndë i revizionit, përkatësisht pasardhësi i tij juridik, pasi në muajin qershor të vitit 2025 Fondi pushon së funksionuari.

Revizioni konstatoi dobësi në evidentimin e detyrimeve të FIZHT-it, me ç'rast një pjesë e detyrimeve nuk janë paraqitur në kohë dhe në mënyrë të plotë në evidencën kontabël. Edhe pse më 31 dhjetor 2024 detyrimet ndaj furnitorëve në vend janë paraqitur në vlerë **prej 853.964 mijë denarë, përkatësisht 13.863.000 euro**, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe procedurat analitike të zbatuara janë konstatuar **detyrime shtesë të paevidentuara** mbi baza të ndryshme, si vijojnë: kontrata për vepër, vlerësimi i projekteve dhe kompensimet për trupat drejtuese, **në vlerë të përgjithshme prej 9.369 mijë denarë, përkatësisht 152.094 euro.**

Me revizionin është konstatuar se **Programi Vjetor i Punës i FIZHT-it për vitin 2024**, me përjashtim të masave dhe aktiviteteve të Shtyllës 1 – Mbështetja financiare e sektorit privat, **nuk përmban** tregues financiarë për mjetet e përgjithshme dhe mjetet sipas masave, instrumenteve dhe aktiviteteve të veçanta. Për shkak se projektet në kuadër të Shtyllës 1 në pjesën më të madhe realizohen për një periudhë më të gjatë se një vit, me **Programin nuk është paraqit pasqyrë reale të mjeteve financiare të nevojshme për vitin 2024**, si dhe nuk specifikon se sa nga mjetet janë të dedikuar për vitin aktual **dhe sa për shlyerjen e detyrimeve të bartura nga vitet e mëparshme.**

**Për më tepër, Programi Afatmesëm i Punës i miratuar** për periudhën 2025–2027 **nuk përmban** dinamikë të thirrjeve, projeksion për pagesat e mjeteve ndaj përfituesve, **si dhe nuk përfshin tregues financiarë sipas instrumenteve dhe viteve, që ndikon në transparencën e funksionimit dhe nuk mundëson vlerësimin nëse menaxhimi i mjeteve buxhetore është në përputhje me parimet buxhetore të përcaktuara me Ligjin për buxhetet dhe dispozitat e Ligjit për ekzekutimin e Buxhetit të shtetit për vitin përkatës.**

**Llogaria vjetore dhe raportet e revizionit nga revizioni i jashtëm nuk janë miratuar nga bordi drejtues dhe nga Qeveria, ndërsa nuk është përgatitur dhe dorëzuar as Raporti vjetor për ndihmën shtetërore të ndarë në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Për më tepër, **FIZHT nuk ka vendosur bazë të dhënash të centralizuar (softuer) për mbështetjen financiare të dhënë, përmes së cilës do të mundësohej monitorimi i zbatimit të instrumenteve individuale të mbështetjes financiare.** Njëkohësisht, **nuk ndërmerren** as masat për monitorim sistematik dhe gjithëpërfshirës të rezultateve të arritura nga projektet e mbështetura pas përfundimit të tyre, **as nuk kryhet analizë e thelluar afariste dhe financiare.**

Me revizionin e kryer mbi mënyrën e zbatimit të thirrjeve publike, është konstatuar se një pjesë e të punësuarve/të angazhuarve me kontratë për vepër dhe anëtarëve të KD **jo gjithmonë nënshkruajnë** deklarata për konflikt interesi, **ndërsa drejtori** i FIZhT së **në asnjë rast nuk është deklaruar** për çështjen e konfliktit të interesit për thirrjet publike që ishin lëndë të revizionit.

Lidhur me **regjistrin e personave profesionalë** për vlerësimin e projekteve, është konstatuar se ai nuk mbahet në mënyrën e përcaktuar me aktet nënligjore, ndërsa nuk **janë ndërmarrë** aktivitete për kategorizimin dhe vlerësimin e personave profesionalë të regjistruar në seksionet përkatëse, me qëllim që **përzgjedhja e tyre të bëhet sipas sistemit të rotacionit. Për thirrjet e realizuara gjatë vitit 2024, revizionit nuk iu vu në dispozicion informacion lidhur me mënyrën e përzgjedhjes së personave profesionalë për vlerësimin e projekteve.** Në kushte të mungesës së një Regjistri të përshtatshëm të vendosur, revizioni konstatoi se **përzgjedhja** e personave

**profesionalë** për vlerësimin e projekteve **nuk kryhet** në përputhje me aktet nënligjore të parashikuara, duke **krijuar mundësi për veprim joobjektiv gjatë përzgjedhjes së personave profesionalë për vlerësimin e projekteve.**

Te **realizimi i kontratave për mbështetje financiare** nga mostra e përzgjedhur prej 55 projekteve, është konstatuar mosrespektim i afateve për dorëzimin e raporteve tremujore të progresit nga ana e përfituesve, si dhe realizim jo në kohë i aktiviteteve, që lidhet edhe me mosrealizimin në kohë të pagesave ndaj përfituesve nga ana e FIZhT së, edhe pas miratimit të raporteve tremujore.

Gjithashtu, është konstatuar **miratim jo në kohë i raporteve tremujore/përfundimtare** për aktivitetet e zbatuara, ndërsa në periudhën **nga dhjetori 2024 deri në qershor 2025 nuk është kryer monitorim,** për shkak të zvarritjes së procedurës së prokurimit publik për shërbimet e menaxhimit të projekteve (monitorimit), që rezultonë **me vonesa në pagesat** ndaj përfituesve dhe me ngecje në realizimin e projekteve nga ana e përfituesve.

**Në bazë të të dhënave të siguruara nga FIZhT, është konstatuar se, me gjendje më 31.12.2024, FIZhT ka detyrime të papaguara ndaj përfituesve për raportet e miratuara në shumën totale prej 349.378 mijë denarë, ndërsa shuma e papaguar e mjeteve të mbajtura nga buxheti i përgjithshëm i projekteve, me gjendje më 31.12.2024, arrin në 14.070 mijë denarë. Një nga arsyet për detyrimet e papaguara ndaj përfituesve është ndryshimi i buxhetit të FIZhT së, me të cilin mjetet në llogarinë subvencione dhe transfere janë zvogëluar për 310.000 mijë denarë, përkatësisht për 32%.**

Me Programin Vjetor të Punës të miratuar të FIZHT-it, gjatë vitit 2024 janë realizuar **tre konkurse publike** për instrumentet në vijim: **grantet e bashkëfinancuara për zhvillim teknologjik për rritje të përshpejtuar ekonomike, grantet e bashkëfinancuara për shoqëri tregtare të sapothemeluara (start-up dhe spin-off) dhe grantet e bashkëfinancuara për komercializimin e inovacioneve.**

Në përputhje **me Konkluzionin e Qeverisë** të datës 28.06.2024, me rekomandim për ndërprerjen e të gjitha thirrjeve të hapura/aktive, KD i FIZhT së ka miratuar Vendim me të cilin ndërpriten të gjitha aktivitetet që lidhen me thirrjet publike. **Deri në mbajtjen e takimit përfundimtar me personin përgjegjës të FIZhT së, revizioni nuk është njoftuar për ndonjë rekomandim apo vendim të KD dhe të Qeverisë në lidhje me këto thirrje publike, që do të kishte ndikim në funksionimin e mëtejmë të FIZhT së.**

Revizioni **ka zbuluar** gjendjen lidhur me strukturën pronësore/menaxhuese të përfituesve të mbështetjes financiare. **Konkretisht, nga analiza e portofolit të projekteve të financuara nga FIZHT-i, është konstatuar se persona të njëjtë fizikë paraqiten si drejtues dhe/ose pronarë të disa personave juridikë që kanë përfituar mjete financiare nga FIZHT-i, shpesh gjatë së njëjtës periudhë ose në periudha kohore të afërta. Këta persona, përmes kompanive të ndryshme, aplikojnë dhe përfitojnë mjete financiare për projekte të ndryshme, duke krijuar mundësi për realizimin paralel të disa financimeve në kuadër të thirrjeve që nuk e kufizojnë një model të tillë.**

Edhe pse nuk ekziston ndalim ligjor apo kufizim i shprehur për një person të marrë pjesë si drejtues/pronar në më shumë aplikime, theksojmë se praktikat e mira kërkojnë shpërndarje të barabartë të mundësive, zvogëlim të përqendrimit të mjeteve te personat e lidhur, sigurimin e zbatimit efektiv të secilit projekt individual, ndërsa shpenzimet e pranuara për bashkëfinancim duhet të jenë reale, të domosdoshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me projektin dhe të bazuara në çmime tregu dhe transaksione të pavarura. Me revizionin e akteve është konstatuar se vetëm te instrumenti për komercializimin e inovacioneve, ekziston klauzolë rregullative, me të cilën nuk lejohet aplikimi nëse aplikuesi tashmë ka projekt aktiv.



Në kornizën momentale ligjore nuk ekziston detyrim që financimi të kufizohet sipas tematikës ose sektorit, si dhe nuk janë përcaktuar kritere për financim prioritar.

Nga analiza e portofolit të përfituesve të FIZHT-it është konstatuar se numri më i madh i projekteve që kanë përfituar mbështetje financiare i përkasin **fushës së teknologjisë informative (26,91%) dhe teknologjisë inxhinierike (16,36%).**

Vlera e përgjithshme e mbështetjes financiare në këto dy fusha arrin në **40.225.079 euro, ose 46,78%** të mjeteve totale të ndara nga FIZhT.

## REALIZIMI I TË ARDHURAVE TATIMORE




Me revizionin e kryer janë konstatuar parregullsi në lidhje me evidentimin e kërkesave në bazë të **rojalteve (kompensim që FIZhT e përfiton nga realizimi i projekteve për inovacione ose transfer teknologjie) dhe fitimit operativ** dhe në mënyrën e mbajtjes së evidencës së përfituesve lidhur me detyrimet pas përfundimit të projektit dhe arkëtimit të rojalteve.

Te instrumenti „Komercializimi i inovacioneve", pavarësisht obligimit kontraktues për pagesën e **5% të të ardhurave vjetore të përfituesit** të realizuara nga shitja e produktit/shërbimit që është rezultat i projektit, FIZHT-i **nuk ka mekanizëm për verifikimin** e lartësisë së të ardhurave të realizuara nga projekti, pasi ato shpesh **nuk evidentohen veçmas** nga përfituesit dhe **as nuk paguhen** në llogari të veçantë.



Projekti „AIRPORT BRIEFING"

Revizioni ka zbuluar rezultatet nga analiza e kryer e dokumentacionit të mostrës së përzgjedhur **prej dhjetë projekteve të përfunduara** të mbështetura nga FIZhT, me qëllim vlerësimin e përmbushjes së **detyrimeve për kthimin** e mbështetjes financiare dhe të suksesit të projekteve.

Nga kontrollet e kryera është konstatuar **se vetëm tre projekte gjenerojnë të ardhura,** ndërsa shtatë projekte nuk gjenerojnë të ardhura nga aktivitetet e realizuara. Vlera e përgjithshme e bashkëfinancimit nga FIZhT për projektet nga mostra është **1.681.660 euro nga të cilat 387.804 euro** janë dedikuar për projekte që gjenerojnë të ardhura, **ndërsa 1.293.856 euro për projekte që nuk gjenerojnë të ardhura.**

Me miratimin e Ligjit për veprimtarinë inovative, zhvillimin shkencor-teknologjik dhe sipërmarrësinë më 29.07.2025, është themeluar Agjencia për Inovacion, Zhvillim Shkencor-Teknologjik dhe Sipërmarrësi, si pasardhëse juridike e Agjencisë për Sipërmarrësi dhe Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, me ç'rast Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik pushon së ekzistuari.

## 5.2.13. ENERGJETIKA

### MINISTRIA E ENERGJITIKËS, XEHTARISË DHE LËNDËVE MINERALE – BYROJA PËR METROLOGJI

Република Северна Македонија
Министерство за енергетика, рударство и минерални суровини
Биро за метрологија

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Energjetikës, Xehetarisë dhe e Lëndëve të Para Minerale
Byroja për Metrologji

Konstatuam gjendje që tregojnë se raportet financiare për vitin 2024 nuk i paraqesin në mënyrë reale dhe objektive efektet e veprimtarisë së Byrosë, për shkak se:

- regjistrimi i mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve është kryer brenda dy ditëve në shkurt të vitit 2025;
- nuk është kryer ndarja e mjeteve që janë jashtë përdorimit, të amortizuara, të vjetruara ose me afat të skaduar nga ato që përdoren dhe janë funksionale;
- nuk janë përfshirë mjetet që për nevojat e Byrosë janë blerë në periudhat e kaluara nga Ministria e Ekonomisë, pasi ato nuk janë dorëzuar tek Byroja; pas ndryshimit të statusit në korrik 2024, i njëjti nga organ në përbërje të ME është shndërruar në organ në përbërje të Ministrisë së Energjetikës, Xehtarisë dhe Resurseve Minerale (MEXRM);
- nuk janë dhënë propozime për mënyrën e veprimit me pajisjet e papërdorshme;
- kërkesat nga blerësit janë joreale.

Për vulat, stampat, etiketat e verifikimit dhe procesverbalet e blera në vlerë totale prej 4.266 mijë denarë, nuk është vendosur evidencë kontabël, megjithëse këto materiale përdoren si dëshmi për verifikimin e instrumenteve matës që kryhet nga Byroja ose nga person tjetër i autorizuar.

Kërkesat nga blerësit në vlerë prej 40.549 mijë denarë janë paraqitur në shumë më të ulët për 11.735 mijë denarë për mjetet e paguara të realizuara, për të cilat në Byronë:

- nuk janë lëshuar me kohë faturat;
- nuk është bërë lidhja e pagesave të klientëve me faturat përkatëse dalëse;
- është vështirësuar lidhja e pagesave për shërbimet e homologimit të automjeteve nga personat fizikë – pronarë të automjeteve, me faturat e lëshuara ndaj shërbimit teknik që e zbaton procedurën e homologimit;
- janë paraqitur kërkesa në vitin 2024 në bazë të faturave të lëshuara në vitin 2023.

Në lidhje me gjendjen e organizimit të brendshëm të të punësuarve në Byronë, konstatuam se revizioni i brendshëm nuk është vendosur në mënyrë të pavarur nga njësitë organizative të Byrosë, por është paraparë si vend pune në kuadër të njësisë për çështje financiare.

Për shkak të mosfunksionimit të njësisë për mbikëqyrje inspektuese, aktivitetet lidhur me përgatitjen e programit vjetor dhe planeve mujore për mbikëqyrje inspektuese, si dhe dorëzimin në Qeveri të raportit vjetor për mbikëqyrjen inspektuese të realizuar, nuk zbatohen.

Të hyrat që realizon Byroja në pjesën më të madhe burojnë nga shërbimet për verifikimin e instrumenteve matëse, të cilat kryhen nga Byroja ose nga person juridik i autorizuar, i përzgjedhur në mënyrën e rregulluar me Rregullore*, e cila ka qenë në zbatim gjatë periudhës së përmendur, me miratim të dhënë nga ministri kompetent. Konstatuam gjendje që tregojnë se të hyrat mblidhen sipas praktikës së vendosur të veprimit, pa procedura të shkruara dhe pa përgjegjësi të përcaktuara për personat kompetentë për ndjekjen e afateve të proceseve. Një pjesë e lëndëve nuk shpërndahen me kohë, ndërsa kontrolli, miratimi i dokumentacionit dhe përgatitja e faturave kryhen me vonesë, që ndikon në lëshimin, evidentimin dhe arkëtimin me kohë të tyre, si dhe në plotësinë e të hyrave të Byrosë. Përkatësisht:

* Rregullore për kushtet shtesë për autorizimin e personit juridik për verifikimin e disa llojeve të mjeteve matëse, vlerësimin e përputhshmërisë së tipit të mjeteve matëse dhe mbikëqyrjen metrologjike mbi produktet e paketuara, procedura për autorizimin e personit juridik, detyrat e personit juridik të autorizuar dhe mbikëqyrja mbi përmbushjen e kërkesave për autorizim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 128/07))

- shpërndarja e lëndëve nuk kryhet automatikisht përmes DMS-së, përkatësisht pas miratimit nga drejtori, kërkesat u shpërndahen të punësuarve. Gjatë vitit 2024 janë hapur 1.539 lëndë për shërbime të verifikimit, prej të cilave 132 lëndë (9%) deri në ditën e revizionit ende nuk ishin shpërndarë për punë, ndërsa 168 kërkesa janë anuluar;

- nuk janë përcaktuar afate kohore për shpërndarjen e lëndëve, për kontrollin dhe miratimin e dokumentacionit në fazat e veçanta të procedurës së verifikimit. Ekziston dallim i konsiderueshëm kohor ndërmjet periudhës së kryerjes së shërbimit dhe datës së lëshimit të faturës dalëse, i cili tejkalon disa muaj, ndërsa në raste të caktuara edhe disa vite nga dita e kryerjes së shërbimit;

- faturat për shërbimet e kryera gjenerohen në mënyrë softuerike, me ç'rast automatikisht u caktohet numri, por jo data e lëshimit të faturës. Data regjistrohet manualisht në arkivë, gjatë lëshimit të faturës. Konstatuam se një pjesë e madhe e faturave për shërbimet e verifikimit janë arkivuar dhe lëshuar në vitin 2024, ndërsa u referohen kërkesave për shërbime nga vitet e kaluara. Një pjesë e faturave të lëshuara për verifikim në vitin 2024, në vlerë të përgjithshme prej 182.966 mijë denarë, janë lëshuar për kërkesa për shërbime të paraqitura në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023:

- nuk kryhet harmonizim periodik i të dhënave për faturat e gjeneruara në DMS me të dhënat në kontabilitet për faturat e lëshuara, të evidentuara dhe të arkëtuara;

- personi i autorizuar për verifikim nuk ka kryer pagesën e shumës së llogaritur për tremujorin e fundit të vitit 2023 në vlerë prej 1.465 mijë denarë, nuk janë dorëzuar të dhëna për shërbimet e kryera në tremujorin e parë të vitit 2024, as nuk janë paguar mjetet nga shërbimet e kryera gjatë periudhës së përmendur, ndërsa nuk është kryer as mbyllja e evidencës për etiketat vulosëse të lëshuara personit juridik të autorizuar pas skadimit të afatit të autorizimit në mars të vitit 2024.

Zbulojmë për gjendje në lidhje me:

- emërimi i vazhdueshëm i „ushtruesit të detyrës" drejtor të Byrosë (duke filluar nga marsi 2023) pa u zbatuar procedura për zgjedhjen e drejtorit përmes shpalljes publike;

- për furnizimin e realizuar të laboratorit mobil (automjet me pajisje) për testimin e vlerave kimike dhe konstantave fizike të hidrokarbureve, për nevojat e Inspektoratit Shtetëror të Tregut për testimin e cilësisë së karburanteve të lëngshme, veçanërisht mazutit, si dhe mënyrës së importit dhe hedhjes së tyre në qarkullim, me qëllim mbikëqyrjen cilësore të tregut dhe kontrollin e tyre, për të cilin në periudhën 2019–2021 janë shpenzuar 62.125 mijë denarë;;

- nuk janë vendosur evidenca elektronike për miratimet e tipit të produktit dhe për pëlqimet për regjistrim të lëshuara nga shërbimi teknik dhe personi juridik për kontroll teknik i autorizuar për procedurën e identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike të automjetit, pasi nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk është vendosur Regjistri i Automjeteve për futjen dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve kompetente.



## SHA MEPSO SHKUP

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të raporteve financiare së bashku me revizion të pajtueshmërisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqëri Aksionare për Transmetimin e Energjisë Elektrike dhe Menaxhimin e Sistemit Elektroenergjetik, në pronësi shtetërore Shkup, për vitin 2024 (SHA MEPSO Shkup).

SHA MEPSO Shkup është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e stabilitetit afatgjatë të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike. Në pronësi të saj është rrjeti i transmetimit të energjisë elektrike, i cili përbëhet nga objekte infrastrukturore lineare (linja të transmetimit, nënstacione transformuese, impiante, objekte dhe mjete) që shërbejnë për kryerjen e transmetimit të energjisë elektrike dhe menaxhimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, i cili funksionon në nivelet e tensionit 400 kV dhe 110 kV.




Me revizionin konstatuam se, edhe pse shërbimet kompetente në vazhdimësi ndërmarrin aktivitete për harmonizimin e punës së shoqërisë me aktet pozitive ligjore, janë evidentuar dobësi në evidencën dhe rregullimin e pronësisë së infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike, përfshirë edhe tokën. Një pjesë e pronës nuk ka status juridik të rregulluar, ndërsa për një pjesë tjetër nuk ekziston evidencë e saktë kontabël.

Rrjeti transmetues i SHA MEPSO Shkup përfshin 112 linja të transmetimit, ku për 53 prej tyre e drejta e pronësisë është regjistruar në Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive, ndërsa për 59 linja të transmetimit shoqëria nuk disponon me fletëpronësi. Për këtë pasuri janë iniciuar procedura për përcaktimin e statusit juridik, por ato janë të ndërlikuara dhe afatgjata për shkak të numrit të madh të lokacioneve dhe marrëdhënieve të pazgjidhura pronësore-juridike, ndërsa në raste të caktuara nuk mund të përcaktohet baza për fitimin e së drejtës së pronësisë.

Ekzistojnë çështje të pazgjidhura pronësore-juridike lidhur me 33 nënstacione transformuese që janë në bashkëpronësi të SHA MEPSO Shkup dhe SHA EVN Maqedoni, ku për këto objekte, e drejta e bashkëpronësisë është regjistruar vetëm në emër të SHA EVN Maqedoni, ose ato ndodhen në procedurë të regjistrimit të të drejtave të pronësisë, përkatësisht në procedurë të marrjes në pronësi. Shoqëria në disa raste ka iniciuar procedura për zgjidhjen e çështjes së pronësisë së nënstacioneve transformuese. Në vitin 2025 është formuar një grup i përbashkët pune, i cili ka rënë dakord që procesi të realizohet në dy faza, përmes transferimit të ndërsjellë të së drejtës së bashkëpronësisë (pjesës përkatëse ideale) mbi nënstacionet transformuese të regjistruara në emër të secilës prej shoqërive, ndërsa për nënstacionet e paregjistruara vazhdon përcaktimi i gjendjes faktike dhe rregullimi përfundimtar i të drejtave pronësore.

Për më tepër, konstatuam se me të dhënat e disponueshme në evidencën kontabël të vendosur për linjat e transmetimit dhe nënstacionet transformuese (të evidentuara sipas pjesëve, në llogari të ndryshme për objekte ndërtimore, impiante dhe pajisje, si dhe me emërtime të paharmonizuara), nuk është e mundur të konfirmohet numri dhe vlera e tyre. Kjo gjendje ndikon në lartësinë e tarifës për transmetimin e energjisë elektrike, e cila përcaktohet me vendim nga Komisioni Rregullator për Energjetikë (KRE), në bazë të të dhënave kontabël dhe evidencave financiare të dorëzuara nga SHA MEPSO Shkup.

Mjetet materiale në përgatitje nuk janë njohur dhe evidentuar në mënyrë të rregullt, ku një pjesë e tyre i referohen projekteve të përfunduara që nuk janë vënë në përdorim (74.176 mijë denarë), ndërsa për një pjesë tjetër nuk mund të konfirmohet gjendja, nevoja dhe arsyeshmëria e tyre për shkak të mungesës së dokumentacionit (19.100 mijë denarë). Për shkak të mosnjohjes me kohë të këtyre mjeteve, nuk është përllogaritur dhe njohur shpenzimi i amortizimit në periudhën paraprake dhe në periudhën rrjedhëse, që ka ndikuar edhe në rezultatin e realizuar financiar nga veprimtaria.

Gjithashtu, në rezultatin e realizuar nga veprimtaria për vitin 2024 ka ndikuar edhe mosparaqitja e shpenzimit në bazë të mjeteve të shpenzuara me vlerë aktuale prej 16.386 mijë denarë, të konstatuara gjatë regjistrimit, si dhe amortizimi i papërllogaritur për një pjesë të mjeteve materiale të sapo furnizuara dhe investimeve që rrisin afatin e dobishëm të përdorimit, kapacitetin dhe funksionalitetin e mjeteve, në vlerë totale prej 16.419 mijë denarë.

Gjatë trembëdhjetë viteve të fundit, SHA MEPSO ka realizuar aktivitete të rëndësishme investuese për ndërtimin, rindërtimin, revitalizimin dhe modernizimin e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike, me ç'rast konstatuam se shkalla e realizimit të tyre varion nga 9% deri në 62%. Te një pjesë e projekteve është evidentuar rritje e vlerës së kontratave të lidhura, zgjatje e afateve për realizimin e tyre, ndërsa dy kontrata, të cilat ishin realizuar pjesërisht, janë ndërprerë. Te tre projekte është evidentuar rritje e vlerës së kontratave të lidhura fillimisht, ku rritja më e madhe, prej 51% (1.481.657 euro), është regjistruar te projekti „Revitalizimi i linjës së transmetimit 110 kV Nënstacioni Shkup 4 – Nënstacioni Veles", vlera e të cilit pas rritjes arrin në gjithsej 4.393.609 euro. Ndërkaq, zgjatja më e madhe e afatit, prej pesë vitesh e tetë muajsh, është konstatuar te projekti „Rindërtimi i linjës së transmetimit 110 kV Nënstacioni Manastir 1 – Nënstacioni Prilep". Njëkohësisht, për projektin „Ndërtimi i linjës së transmetimit 110 kV TS Vallandovë – TS Miletkovë", megjithëse në qershor të vitit 2024 është miratuar një hua nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në shumën prej 26.400.000 euro, ende nuk kanë filluar aktivitetet e ndërtimit. Si pasojë, për miratimin e huasë dhe komisionet për mjetet e patërhequra janë paguar gjithsej 155.672 euro (prej të cilave 22.205 euro në vitin 2024). Këto gjendje ndikojnë negativisht në modernizimin dhe sigurinë e rrjetit të transmetimit dhe tregojnë nevojën për menaxhim më efikas të projekteve investuese.

SHA MEPSO Shkup shfrytëzon disa linja kreditore nga institucione financiare ndërkombëtare për financimin e investimeve, ku një pjesë e konsiderueshme e mjeteve të miratuara nuk është tërhequr, që rezulton me shpenzime shtesë për komisione dhe interesa. Shuma totale e huave aktuale të miratuara arrin në 102.400.000 euro, nga të cilat 52%, përkatësisht 53.434.992 euro, nuk janë tërhequr. Për këtë arsye, gjatë vitit 2024 është paguar një komision në vlerë prej 245.629 euro (gjithsej 2.633.953 euro për periudhën nga miratimi i huave deri në fund të vitit 2025). Përfundim të vitit 2024, për huatë e marra janë paguar provizione për miratim dhe për mjetet e patërhequra, si dhe interesa në shumën totale prej 8.996.052 euro, që përfaqëson 8,8% të shumës së përgjithshme të huave të miratuara. Mosshfrytëzimi me kohë i huave rrit barrën financiare dhe ngadalëson realizimin e projekteve strategjike për sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

Kërkesat nga huatë e dhëna shoqërive aksionare në pronësi shtetërore arrijnë në 591.990 mijë denarë (afërsisht 9.594.652 euro) dhe janë rritur më shumë se 10 herë krahasuar me vitin 2020. Dhënia e huave nuk përbën veprimtarinë themelore të SHA MEPSO Shkup, prandaj kjo praktikë ndikon negativisht në likuiditetin dhe gjendjen financiare të shoqërisë dhe tregon për menaxhim jo mjaftueshëm efikas të mjeteve publike.

Një pjesë e kërkesave të shoqërisë (12%) janë më të vjetra se tre vjet, ku pjesa më e madhe e tyre përbëhet nga kërkesa në bazë të disbalancave të shkaktuara nga persona juridikë – tregtarë të energjisë elektrike (PPB), si dhe nga kërkesa për shfrytëzimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit. Për arkëtimin e kërkesave të maturuara janë ndërmarrë masa përmes riprogramimit të borxheve dhe procedurave përmbarimore, por për disa lëndë që datojnë prej një periudhe më të hershme nuk janë dhënë shpjegime për arsyet që kanë çuar në mosarkëtimin e këtyre kërkesave. Duke pasur parasysh strukturën e vjetërsisë së kërkesave, si dhe pasigurinë që shoqëron procedurat e gjata përmbarimore, theksojmë se ekziston pasiguri lidhur me arkëtimin e tyre.

Me revizionin e kryer konstatuam se të ardhurat nga veprimtaria kryesore – transmetimi i energjisë elektrike – shënojnë rritje, kryesisht për shkak të tarifave më të larta të transmetimit, edhe pse sasia e energjisë së transmetuar ka pësuar një rënie të lehtë. Njëkohësisht, të ardhurat nga kapacitetet ndërkufitare të transmetimit janë rritur ndjeshëm, disbalancat në rrjetin e transmetimit tregojnë trend stabilizimi, ndërsa humbjet në rrjet janë zvogëluar, megjithëse kostot për mbulimin e tyre vazhdojnë të ndikohen nga çmimet e energjisë elektrike.

Te 65% e personave të sapopunësuar (45 persona) janë konstatuar parregullsi lidhur me përmbushjen e kushteve të përcaktuara në shpalljen publike dhe aktin e sistematizimit dhe shpërndarjen në vendet e punës, ndërsa te një pjesë të tyre, menjëherë pas punësimit është kryer risistemim ose avancim.

Për më tepër, konstatuam pagesa të kompensimeve dhe të drejtave për anëtarët e Këshillit Drejtues pa bazë të plotë juridike dhe dokumentare, përfshirë dhe pagesat e largimit nga puna, kompensimet për jetesë të ndarë dhe regresin për pushimin vjetor.



Këto gjendje krijojnë mundësi për interpretim jo të njëjtë të dispozitave kontraktuale dhe për përdorim jo racional të mjeteve publike.

Në vitin 2024, SHA MEPSO Shkup ishte objekt i një sulmi kibernetik që shkaktoi mosdisponueshmëri të përkohshme të një pjese të sistemeve dhe të dhënave të TI-së, pa u cenuar transmetimi i energjisë elektrike. Ky incident tregon nevojën për forcimin e mëtejshëm të sigurisë kibernetike përmes masave teknike dhe organizative. Për më tepër, në raport informojmë për nevojën e sanimit të fasadës së dëmtuar gjatë viteve 2020 dhe 2021, për rikonstruksionin dhe adaptimin e së cilës, në periudhën 2013-2018, janë shpenzuar 547.058 mijë denarë, përkatësisht rreth 8.866.400 euro.

Me revizionin e kryer konstatuam edhe gjendje të tjera që lidhen me inventarizimin e kryer, mjetet e nxjerra jashtë përdorimit, vjedhjen e raportuar, realizimin e Programit Vjetor të Investimeve, mënyrën e financimit të organizatave sindikale pranë SHA MEPSO Shkup, llogaridhënien e personave të angazhuar përmes kontratave autoriale, mënyrën e ndarjes së sponsorizimeve dhe donacioneve dhe çështje të tjera që ndikojnë në funksionimin e shoqërisë.

## SHA NOMAGAS SHKUP

Enti Shtetëror për Revizion kreu revizion të raporteve financiare dhe revizion të pajtueshmërisë së SHA për ushtrimin e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup, në pronësi shtetërore, për vitin 2024.

Me revizionin është konstatuar se pjesa më e madhe e investimeve në vijim i referohet ndërtimit të tre gazsjellësve magjistralë (LOT 1 – 61 km, LOT 1 – 36 km, LOT 2 dhe LOT 5), vlera e përgjithshme e të cilëve arrin në 8.837.849 mijë denarë pa TVSH, përkatësisht rreth 143.239.000 euro. Megjithëse gazsjellësit janë ndërtuar plotësisht gjatë periudhës 2016-2024, ata ende nuk janë vënë në përdorim për shkak të marrëdhënieve të pazgjidhura pronësore-juridike dhe procedurave të zgjatura për miratimin e ndryshimeve gjatë ndërtimit. Me ndryshimet e Ligjit për Ndërtim të muajit prill 2025 është thjeshtësuar procedura për marrjen e lejeve të përdorimit, me ç'rast NOMAGAS SHA Shkup në qershor të vitit 2025 ka lidhur një marrëveshje kornizë për furnizimin me shërbime gjeodezike dhe sigurimin e lejeve ligjore të përdorimit.

NOMAGAS SHA Shkup disponon me fletëpronësi për gazsjellësin magistral Deve Bair–Shkup dhe për gjashtë objekte të tjera infrastrukturore, ndërsa për 78 objekte shoqëruese, si stacione blloku, stacione matëse-rregulluese dhe stacione pastrimi, ende nuk është përcaktuar statusi juridik. Edhe pse një pjesë e objekteve janë ndërtuar që në periudhën 1995–2000 dhe disponojnë dokumentacion të rregullt, ato asnjëherë nuk janë regjistruar në Agjencinë e Kadastrës së Patundshmërive. Për shkak të procedurave shumëvjeçare dhe komplekse të legalizimit pranë institucioneve kompetente, deri në përfundimin e revizionit, NOMAGAS SHA Shkup nuk kishte marrë vendim për asnjërën nga 78 procedurat e filluara.

Ende nuk është vendosur operatori i sistemit të shpërndarjes së gazit natyror, megjithëse në vitin 2019 ishte iniciuar procedura për partneritet publik-privat. Procedura është anuluar me vendim të Qeverisë në gusht të vitit 2024, për shkak të së cilës vazhdon të mbetet e pasigurt përcaktimi i operatorit për shpërndarjen e gazit natyror.

**VLERA E INVESTIMEVE NË NDËRTIMIN E GAZSJELLËSVE MAGJISTRALË NË PERIUDHËN 2016-2024**




Një gjendje shtesë që mund të ndikojë në mënyrë të pafavorshme në cilësinë dhe dinamikën e mirëmbajtjes, zgjerimit dhe lidhjes së sistemit me rrjetet e gazsjellësve në vendet fqinje është fakti se, deri në fund të vitit 2024, NOMAGAS SHA Shkup nuk ka miratuar planin dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit për periudhën 2024–2035.

Me revizionin kemi konstatuar se në librat afariste të NOMAGAS SHA Shkup, kapitali është evidentuar në vlerë

prej 58,3 milionë euro, që është për 28,1 milionë euro më i ulët se vlera e tij e vlerësuar. Diferenca rrjedh nga procesi i themelimit të shoqërisë në vitin 2022, përmes bashkimit të dy shoqërive SHA NER dhe SHA GA MA Shkup. Gjatë procesit të themelimit të NOMAGAS SHA Shkup, ndër të tjera, është miratuar Ligji për zgjidhjen e kontestit shumëvjeçar ndërmjet Qeverisë dhe SHA për tregti me naftë dhe derivate të naftës Shkup, në bazë të të cilit është realizuar blerja e njërës nga dy aksionet në SHA GA MA Shkup, me ç'rast kjo shoqëri ka kaluar në pronësi të plotë shtetërore. Transaksioni është zbatuar në bazë të një vlerësimi të kryer paraprakisht nga Byroja e Ekspertizës Gjyqësore, me të cilin vlera e përgjithshme e kapitalit të SHA GA-MA Shkup është rivlerësuar nga 37,4 milionë euro në 65,5 milionë euro. Me arsyetimin se vlerësimi nuk u ishte dorëzuar personave përgjegjës, i njëjti nuk është evidentuar në mënyrë kontabël në librat afariste të SHA GA MA Shkup.

Konstatuam se rezervat e materialeve, inventarit të imët dhe pjesëve rezervë arrijnë në 264.254 mijë denarë, ndërsa mbi 80% e tyre datojnë nga periudha para vitit 2019 dhe ende nuk janë përdorur. Me këtë vë në pikëpyetje arsyeshmërinë e furnizimit të tyre dhe mundësinë që një pjesë e tyre të jenë vjetruar dhe të papërdorshme. Një pjesë e rezervave, me vlerë prej 98.315 mijë denarë, ishte dedikuar për projektin e mbylljes së unazës së gazsjellësit magjistral në Shkup, i cili nuk u realizua për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm dhe pengesave shtesë infrastrukturore. Në vitin 2025 janë ndërmarrë aktivitete për realizimin e këtij projekti.



Tuba të furnizuara për ndërtimin e rrjetit distributiv për transmetimin e gazit natyror – unaza e Qytetit të Shkupit.

NOMAGAS SHA Shkup kryen shërbimin e balancimit, përkatësisht blen ose shet gaz në bursën e gazit, varësisht nga nevojat e përdoruesve (Palët Përgjegjëse për Balancim – PPB), nga fakti nëse pala PPB bëri jobaraspeshë pozitiv apo negativ.




Me revizionin është konstatuar zbatim i papërshtatshëm i formulës për llogaritjen e kompensimit të neutralitetit, si dhe i mënyrës së shpërndarjes së kompensimit të PPB-të, në përputhje me aktivitetet e tyre. Konkretisht, formula e paraparë me Metodologjinë nuk zbatohet në mënyrë korrekte për shkak të paqartësive që ekzistojnë lidhur me përfshirjen e sasive të parashikuara të importit dhe eksportit të gazit natyror. NOMAGAS SHA Shkup ka paguar kompensim për neutralitet në shumën prej 44.612 mijë denarësh për periudhën e barazimit të vitit 2023 për gjashtë PPB, megjithëse sipas të dhënave të marra nga shoqëria, në vitin 2023 kanë ekzistuar katër grupe balancuese të përfaqësuara nga PPB-të.

Në raportin e revizionit është zbardhur depozita e afatizuar në bankë komerciale në shumën prej 20.000 mijë denarë, përkatësisht 324.000 euro, me të ardhura minimale nga interesi në shumën prej 65 mijë denarë në vit. Revizorët konstatuan se Këshilli i Drejtorëve nuk ka miratuar

vendim për këto depozita, që nuk është në përputhje me Statutin e shoqërisë. Për më tepër, duke pasur parasysh se gjatë të njëjtës periudhë shoqëria kishte kredi të papaguara, vihet në pikëpyetje arsyeshmëria e afatizimit të mjeteve dhe efekti ekonomik i depozitës.

NOMAGAS SHA Shkup ka kërkesa nga një hua afatshkurtër prej 75.000 mijë denarë ndaj SHA Posta e Maqedonisë së Veriut, nga e cila deri në maj të vitit 2025 janë kthyer vetëm 2.000 mijë denarë, ose rreth 2,5% e shumës së përgjithshme të huazuar. Për rrjedhojë, theksojmë se aktivitete të tilla nuk bëjnë pjesë në veprimtarinë themelore të shoqërisë dhe mund të ndikojnë negativisht në likuiditetin dhe rentabilitetin e saj.

Në raportin e revizionit kemi evidentuar se në vitin 2025 kanë filluar aktivitetet për ndërtimin e gazsjellësit interkonektiv me Greqinë, i financuar përmes një kredie dhe granteve nga Banka Evropiane e Investimeve. Marrëveshja e kredisë arrin në 29,9 milionë euro, ndërsa granti investues në 12,4 milionë euro.

Në gusht të vitit 2025, shoqëria ka fituar 6 milionë euro nga granti investues për financimin e shpenzimeve të punimeve, të cilat menjëherë i janë transferuar kontraktorit me të cilin në maj të vitit 2025 është lidhur kontrata për ndërtim. Përveç kësaj, granti për asistencë teknike në vlerë prej 500 mijë euro dhe granti për komunikim dhe vizibilitet janë shfrytëzuar pjesërisht për shërbimet e nevojshme.

Në raport janë theksuar çështjet që rrjedhin nga Ligji i miratuar për shndërrimin e kërkesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të detyrimeve të paguara ndaj kreditorëve të huaj, në kapital të përhershëm në shoqëri, me ç'rast shfuqizohet detyrimi për kthimin e mjeteve nga kredia për ndërtimin e gazsjellësve magjistralë LOT 2 dhe LOT 5 në shumën e përgjithshme prej 7.530.960 mijë denarë (122.158.600 euro). Në këtë pjesë theksojmë edhe shpenzimet për provizionet mbi mjetet e patërhequra nga kredia, në normë prej 2,47% në vit, në shumën totale prej 412.407 mijë denarë, të cilat nuk është dashur të kapitalizoheshin.

Janë konstatuar edhe gjendje të tjera që kanë të bëjnë me mënyrën e evidentimit të aktiveve jomateriale dhe rezervimeve, inventarizimin e kryer, zbatimin e Ligjit për Furnizime Publike, mangësi në aktin e sistematizimit dhe aktet që rregullojnë mënyrën e llogaritjes së pagave, shpërndarjen e fitimit për vitin 2023 pa raporte financiare dhe llogari vjetore të miratuara paraprakisht, objekte për hapësira biznesi dhe magazinimi që janë ndërtuar por nuk përdoren, për shkak të së cilës në një lokacion tjetër paguhet qira e panevojshme, si dhe shpenzime të bëra për sanimin e tubacioneve të dëmtuara të gazsjellësit të shkaktuara nga shërbime të angazhuara nga Komuna e Gazi Babës, si dhe gjendje të tjera.



Marrë nga: https://nomagas.com.mk

## PROKURIMET PUBLIKE NË SHA ESM




Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të pajtueshmërisë së furnizimeve publike në SHA ESM Shkup, për të cilat gjatë vitit 2024 janë marrë detyrime, dhe shprehu përfundimin se planifikimi, zbatimi i procedurave për dhënien e kontratave të furnizimeve publike, si dhe realizimi i kontratave të lidhura, **nuk janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me zbatimin e rregullativës ligjore dhe nënligjore përkatëse, planet dhe kontratat.**

Gjithashtu, me këtë revizion kemi dhënë vlerësim për shkallën e zbatimit të parimeve mbi të cilat bazohen furnizimet publike gjatë dhënies së kontratave të furnizimeve publike, me të cilat sigurohet përdorimi ekonomik, efikas dhe efektiv i mjeteve publike, konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë, transparenca, trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomikë dhe proporcionaliteti i lëndës të furnizimit, veçanërisht në lidhje me përzgjedhjen, përcaktimin dhe zbatimin e kushteve, kërkesave dhe kritereve.

Me revizionin përfshimë procedura të furnizimeve publike të zhvilluara gjatë viteve 2022, 2023 dhe 2024, sipas të cilave në vitin 2024 janë marrë detyrime në shumën e përgjithshme prej 8.858.194 mijë denarë, përkatësisht 143.569.000 euro. Me revizionin u përfshinë gjithsej 27 (njëzet e shtatë) procedura të furnizimeve publike që kanë realizim në vitin 2024, prej të cilave 2 (dy) procedura janë zhvilluar në vitin 2022, 19 (nëntëmbëdhjetë) në vitin 2023 dhe 6 (gjashtë) procedura në vitin që ishte lëndë e revizionit, që paraqet një **mbulim prej 58,42% të detyrimeve të përgjithshme të marra që i nënshtrohen LPP (5.175.014 mijë denarë)** në vitin lëndë e revizionit. Gjatë përzgjedhjes janë marrë parasysh procedurat me rëndësi dhe vlerë të lartë, procedurat e përfshira në Raportin e Flamujve të Kuq për vitin 2024 të BPP, procedurat që janë lëndë të veprimit nga organet e tjera kompetente, si dhe procedurat që janë me interes publik.

Revizioni konstatoi dobësi në planifikimin e furnizimeve publike. Konkretisht, Plani Vjetor i Furnizimeve Publike **përgatitet mbi bazën e të dhënave nga kontratat e lidhura më parë, pa hulumtim përkatës të tregut dhe pa shfrytëzimin e mundësisë ligjore për zhvillimin e dialogut teknik, me përcaktim të pajustifikuar të vlerës së parashikuar dhe me mungesë të një qasjeje analitike gjatë përcaktimit të nevojave të shoqërisë.** Megjithëse është miratuar udhëzim për mënyrën e zbatimit të furnizimeve, i njëjti nuk përmban udhëzime të sakta për përcaktimin e nevojave, sasive dhe vlerës së parashikuar.

Si pasojë e kësaj, gjatë vitit 2024 janë miratuar **19 vendime** për ndryshimin e Planit Vjetor të Furnizimeve Publike, që ndikon negativisht në efikasitetin e procedurave, planifikimin e mjeteve financiare dhe afateve, si dhe në transparencën dhe parashikueshmërinë e tyre.

Me revizionin analizuam dhe konfirmuam një pjesë të gjetjeve nga **„Raporti për flamujt e kuq 2024"** i publikuar nga BPP të cilat ndër të tjera kanë të bëjnë me një numër të konsiderueshëm procedurash ku janë evidentuar ndryshime dhe plotësime të shpalljeve dhe dokumentacionit të tenderit, si dhe procedura të anuluara dhe të ankimuara. Njëkohësisht, i përfshimë kontratat me gjashtë operatorë ekonomikë, të cilët përbëjnë mbi 70% të vlerës së përgjithshme të kontratave të lidhura në vitin 2024, si dhe procedurat në të cilat është paraqitur vetëm me një ofertë. Këto gjendje tregojnë për konkurrencë të kufizuar, dobësi në përgatitjen e dokumentacionit, transparencë të reduktuar dhe rrezik të shtuar për përdorim joekonomik dhe joefikas të mjeteve publike.



Te disa nga procedurat individuale të furnizimeve publike, revizioni konstatoi parregullsi të caktuara. Veçanërisht në procedurën me negocim pa publikimin e shpalljes për furnizimin e një motori me gaz, për të cilën nuk ishte e mundur të konfirmohej arsyeshmëria e thirrjes në urgjencë ekstreme. Edhe pse për këtë furnizim ishte paguar një pjesë e konsiderueshme e vlerës kontraktuale, në shumën prej 153.283 mijë denarë (2.484.300 euro), motori nuk ishte vënë në funksion dhe për një periudhë të gjatë ishte ruajtur në magazinë pa u siguruar kushtet e nevojshme për përdorim, që tregon marrjen e detyrimeve kontraktuale pa kushte të siguruara për instalimin dhe shfrytëzimin e tij operativë.



Konzervimi dhe mbrojtja e motorit me gaz në Degën Energjetika



Aditiv me afat të skaduar në hapësirën magazinuese të KME Osllomej

Janë konstatuar furnizime të mallrave dhe shërbimeve që nuk janë përdorur ose nuk janë realizuar plotësisht, siç është furnizimi i një aditivi, për të cilin janë paguar mjete në shumën e përgjithshme prej 141.600 mijë denarë (2.294.900 euro) prej të cilave pjesa më e madhe e tij ka mbetur e pashfrytëzuar dhe i ka skaduar afati i përdorimit. Gjithashtu, janë paguar 106.200 mijë denarë (1.721.200 euro) për aktivitete të dislokimit të pajisjeve që nuk janë vënë në përdorim. Këto gjendje paraqesin humbje financiare për shoqërinë, përdorim jo racional të mjeteve publike dhe ndikojnë negativisht në kryerjen e veprimtarisë së saj.

Në më shumë procedura konstatuam **dobësi në specifikimet teknike** dhe në kushtet për dëshmimin e aftësisë. Specifikimet teknike, në raste të caktuara, janë përcaktuar në mënyrë që mund të referojnë një dizajn, markë ose prodhues të autorizuar të caktuar, ndërsa kushtet për dëshmimin e aftësisë financiare, si dhe aftësisë teknike dhe profesionale, jo gjithmonë janë proporcionale me lëndën e furnizimit.

Te disa procedura nuk është zbatuar verifikim i plotë dhe i detajuar i dëshmive për përmbushjen e kushteve, ndërsa te mallrat dhe shërbimet e dorëzuara, në raste të caktuara mungon dokumentacioni përkatës teknik, i atestimit dhe dokumentacion tjetër i besueshëm. Konstatuam edhe raste të pranimit të ndryshimeve thelbësore të karakteristikave teknike pas kryerjes së dorëzimit, që vë në pikëpyetje trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe rregullshmërinë e procedurave.

Me revizionin, gjithashtu, konstatuam **dobësi gjatë realizimit të kontratave.** Në raste të caktuara, kontratat janë ndryshuar me anekse pa arsyetim të mjaftueshëm bindëse, ndërsa për disa shërbime nuk është siguruar dokumentacioni me të cilin do të konfirmohej arsyeshmëria dhe vëllimi i aktiviteteve të kryera.

Për më tepër, konstatuam se gjatë vitit 2024 ka pasur **tejkalim të pragut ligjor të vlerës për furnizime pa zhvillimin e procedurës përkatëse, në shumën prej 81.644 euro,** që tregon nevojën për interpretim të drejtë të dispozitave të LPP dhe vendosjen e mekanizmave të kontrollit për furnizimet nën pragun e vlerës.

Në raportin e revizionit të kryer kemi dhënë rekomandime, zbatimi i të cilave duhet të kontribuojë në rritjen e transparencës, konkurrencës, përmirësimin e cilësisë së furnizimeve, si dhe në përdorimin ekonomik, efikas dhe efektiv të mjeteve publike.

# EFIKASITETI I INSTITUCIONEVE NË PROCESIN E LËSHIMIT TË LEJEVE PËR BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË (BRE)

7 ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR

Kemi kryer revizion të suksesit me temë „Efikasiteti i institucioneve në procesin e lëshimit të lejeve për burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE)", duke dhënë kështu kontribut për tejkalimin e disa dobësive në sistemin e vendosur për lëshimin e lejeve për ndërtimin e centraleve fotovoltaike (CFV), si dhe udhëzime për përmirësimin e tij. Njëkohësisht, theksojmë rëndësinë e ndërtimit të CFV-ve, të cilat paraqesin një kontribut të rëndësishëm për realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit në pjesën e „Transformimit të Gjelbër", përmes zëvendësimit gradual të prodhimit nga qymyri me kapacitete nga BRE.

Tema e revizionit është e lidhur ngushtë me Qëllimin 7 – „Sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë". Konkretisht, ky qëllim ka të bëjë me „sigurimin e qasjes universale në shërbime energjetike të përballueshme, të sigurta dhe moderne, rritjen e ndjeshme të pjesëmarrjes së BRE në prodhimin global të energjisë, përmirësimin e efikasitetit energjetik, përdorimin e teknologjive më të pastra në shfrytëzimin e lëndëve djegëse fosile, nxitjen e investimeve në infrastrukturën energjetike dhe teknologjitë e energjisë së pastër, si dhe zgjerimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e teknologjisë për sigurimin e shërbimeve moderne dhe të qëndrueshme energjetike deri në vitin 2030".

Me revizionin është përfshirë periudha nga viti 2022 deri në vitin 2025, ndërsa çështje dhe ngjarje të caktuara janë përfshirë edhe për periudha paraprake dhe pasuese deri në ditën e raportimit të revizionit, me qëllim që të jepet vlerësim për sistemin e vendosur të lëshimit të lejeve për ndërtimin e elektrocentraleve fotovoltaike nga aspekti i pajtueshmërisë ligjore, koordinimit institucional, zbatimit efikas dhe në kohë të procesit nga institucionet kompetente, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e tyre.

Me revizionin e kryer kemi siguruar nivel të arsyeshëm bindëse se në periudhën nga viti 2022 deri në maj të vitit 2025, sistemi i vendosur për lëshimin e lejeve për ndërtimin e CFV, nuk ka mundësuar pajtueshmëri të plotë ligjore, planifikim në kohë, veprim të koordinuar institucional, si dhe zbatim efikas të një pjese të procedurave për lëshimin e lejeve për CFV. Pas miratimit të Ligjit të ri për energjetikë në maj të vitit 2025, megjithëse vërehet progres në planifikimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja për prodhim të energjisë elektrike, theksojmë nevojën për miratimin në kohë të akteve nënligjore, si dhe për ushtrimin e mbikëqyrjes dhe monitorimit adekuat në mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore.

Ndërtimi i objekteve të reja energjetike deri në maj të vitit 2025 është realizuar në mungesë të një Plani Indikativ për ndërtimin e kapaciteteve për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE. Me këtë plan do të duhej të siguroheshin informacione për teknologjitë e prodhimit të energjisë elektrike, kapacitetin total të instaluar sipas rajoneve, si dhe mundësinë e lidhjes në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Në kushte të tilla, ministritë kompetente nuk kanë qenë në gjendje të nxjerrin vendime për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e CFE, si dhe të japin propozim te Qeveria për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e CFE në tokë me kapacitet të instaluar mbi 10 MW. Kështu, lejet për ndërtimin e CFE-së janë lëshuar ekskluzivisht në bazë të dispozitave të Ligjit për ndërtim, ku investitorët nuk kanë pasur obligim për sigurimin e një pëlqimi të tillë. Gjithashtu, në atë periudhë nuk është siguruar interoperabilitet ndërmjet institucioneve për sigurimin e një pjese të dokumentacionit për dhënien e autorizimit për ndërtimin e centraleve të reja fotovoltaike me kapacitet mbi 10 MW, me detyrë zyrtare, që ka ndikuar në dinamikën e procedurës.

Nga maji i vitit 2025, mënyra e procedurës për ndërtimin e CFE-së ndryshon në tërësi, ku është paraparë që në nivel shtetëror çdo vit të miratohet një dokument planifikues vjetor. Kemi konstatuar se Plani Vjetor për ndërtimin e objekteve energjetike për vitin 2026 është miratuar në kohë, por në përgatitjen e tij nuk kanë marrë pjesë të gjitha institucionet e përcaktuara me ligj, përfshirë edhe 74 komunat që kishin detyrim të dorëzojnë plane energjetike komunale. Arsyeja për këtë gjendje është mosmiratimi në kohë i aktit nënligjor me të cilin duhej të përcaktohej forma dhe përmbajtja e planeve energjetike komunale, si dhe metodologjia për përgatitjen e tyre. Nuk

është miratuar as akti nënligjor që rregullon mënyrën e përmbushjes së **kritereve për marrjen e autorizimit** për ndërtimin e objekteve elektroenergjetike nga Ministria e Energjisë, Xehtarisë dhe Burimeve Minerale dhe **nuk është formuar Komisioni për dhënien e autorizimeve** për ndërtimin e objekteve energjetike, që krijon vonesa në lëshimin e autorizimeve për ndërtimin e objekteve elektroenergjetike me kapacitet të barabartë ose më të madh se 1 MW.

Deri në nëntor të vitit 2024 nuk ka qenë e përcaktuar qartë kompetenca për veprim të institucioneve në procesin e lëshimit të lejeve për ndërtim, për shkak të një dobësie sistemore në Ligjin për Ndërtim, në të cilin objektet për panele fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike që ndërtohen në tokë ishin **veçuar si ndërtime të kategorisë së dytë, pa u përcaktuar njëkohësisht fuqia e centralit elektrik,** e cila është kusht për kategorizimin e ndërtimeve (kategori e parë ose kategori e dytë e ndërtimeve).

**Janë miratuar ndërtimet e tre CFE në tokë, me fuqi prej 19 MW, 174 MW dhe 337 MW, në kundërshtim me dispozitat ligjore pozitive,** të cilat njëkohësisht paraqesin ndërtime me rëndësi shtetërore, ku çdo investitori ka paraqitur kërkesë dhe ka marrë leje për ndërtim nga komuna në territorin e së cilës është paraparë ndërtimi i tyre, në vend që leja të lëshohej nga Ministria e Transportit, e cila është kompetente për të vepruar për këtë kategori të ndërtimeve, si dhe nga Qeveria, e cila duhet të miratojë Vendim për autorizimin e ndërtimit të objekteve të reja energjetike. Një pjesë e subjekteve kompetente për infrastrukturën elektroenergjetike, të ujësjellësit dhe kanalizimit japin mendime për mundësinë e kyçjes së CFE në sistem vetëm nga aspekti formal, me qëllim që ato të shërbejnë në procedurën për lëshimin e lejeve për ndërtim. Ekziston rast kur të dhënat për fuqinë e CFE-së ndryshojnë në dokumentet e lëshuara nga organe të ndryshme, si dhe rast kur janë lëshuar dy leje ndërtimi për CFE në bazë të një Ekstrakti nga plani/projekti urbanistik, në të cilin është përcaktuar një parcelë e vetme ndërtimore. Gjithashtu është konstatuar trajtim i pabarabartë i investitorëve lidhur me pagesën e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për CFE, si dhe sa i përket afatit kohor të dhënë për plotësimin e lëndëve.

Nuk është arritur efikasiteti i institucioneve në punën e tyre as nga aspekti i afatshmërisë, plotësisë dhe monitorimit të realizimit të detyrimeve të investitorëve, në përputhje me lejet e lëshuara për ndërtimin e CFE-së.

Interesi për ndërtimin e CFE-së është rritur në periudhën pas shfaqjes së krizës energjetike (vitet 2021 dhe 2022), me ç'rast institucionet në nivel qendror dhe lokal janë përballur me mungesë të kuadrit të trajnuar në fushën e rregullativës ligjore që rregullon mënyrën e ndërtimit të objekteve energjetike, procedurën për lëshimin e lejeve për ndërtimin e CFE -ve, përfshirë edhe mbikëqyrjen e tyre.

### PRODHIMI I EE NGA BRE NË PERIUDHËN 2022–2025 (GWH)

| | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
|  | 1.397 | 1.648 | 1.416 | 1.249 |
|  | 108 | 164 | 194 | 209 |
|  | 77 | 298 | 853 | 1.174 |
|  | 51 | 62 | 53 | 35 |
| ECO | 163 | 2.172 | 2.516 | 2.667 |

Mungon plotësisht mbikëqyrja mbi zbatimin e dispozitave të Ligjit për Energjetikë nga ana e komunave, ndërsa numri i mbikëqyrjeve inspektuese të kryera mbi pajisjet teknike të integruara dhe të instaluara në CFE është i papërfillshëm. Pjesërisht ose plotësisht mungon mbikëqyrja mbi zbatimin e detyrimeve të investitorëve të përcaktuara në lejet e lëshuara për ndërtimin e CFE-ve nga komunat që ishin lëndë i revizionit.

Nuk janë krijuar kushte as për monitorim efikas të CFE-së, për shkak të Regjistrit jo të plotë dhe të paharmonizuar të centraleve elektrike, por edhe për shkak të mungesës së kategorizimit të rregulluar të mbetjeve nga pajisjet e CFE-së dhe sistemet e magazinimit të energjisë, si parakusht për selektimin e tyre me qëllim mbrojtjen me kohë të mjedisit jetësor dhe shëndetit të njerëzve.

# 5.2.14. SISTEMI SHËNDETËSOR

## TERMINI IM" – OPTIMIZIMI I PROCESEVE SHËNDETËSORE DHE PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË MBROJTJES SHËNDETËSORE

3 SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE | 9 INDUSTRI, NOVACION DHE INFRASTRUKTURË | 10 ZVOGËLIM I PABARAZIVE | 16 PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA

Kemi kryer revizion të TI-së si revizion të suksesit me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes: **„A ka kontribuar sistemi "Termini Im" në optimizimin e proceseve shëndetësore dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore?"** Aktivitetet e revizionit u orientuan drejt rreziqeve në fushën e menaxhimit të TI-së dhe operacioneve të TI-së.

Drejtoria për Shëndetësi Elektronike (DSHE) është themeluar si subjekt i veçantë juridik dhe organ në përbërje të Ministrisë së Shëndetësisë, kompetent për avancimin dhe zhvillimin e sistemit të integruar informativ shëndetësor, megjithatë nuk ka kompetenca për zbatimin e prokurimeve publike që lidhen me sistemin.

Për më tepër, termi "Termini Im" nuk është i mbrojtur intelektualishtë nga ministria dhe DSHE, por nga operatori ekonomik me të cilin ministria në vazhdimësi lidh kontrata për mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive, që krijon rrezik të varësisë afatgjatë.

29% e numrit të parapare të të punësuarve në **Drejtorinë për Shëndetësi Elektronike** !

**Një pjesë e nevojave për personel mbulohen përmes kontratave për vepër, të cilat lidhen në baza vjetore.**

Në periudhën nga 01.01.2021 deri më 30.04.2026 **„Termini Im"** nuk ka qenë i mbuluar me kontrata mirëmbajtjeje për gjithsej, që përbën 738 ditësh ose 37.9% të periudhës së analizuar

**Kontratat dhe mirëmbajtja lidhen çdo vit, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e mirëmbajtjes** !

Kemi konstatuar se 48% e investimeve totale në institucionet publike shëndetësore që përdorin sisteme të tjera informatike janë të përqendruara te 3 kompani softuerike

Në të njëjtën periudhë, për mirëmbajtjen janë investuar **333,3 milionë denarë (5,42 milionë euro),**

9% sistemit kombëtar informativ shëndetësor

91% sistemeve të tjera në shëndetësinë publike

**Pastaj me këtë analizë nuk i kemi përfshirë shpenzimet për sistemet që përdoren nga mjekët amë dhe institucionet private shëndetësore.** !

**rrezik të shtuar të përqendrimit dhe konkurrencë të kufizuar** !

Drejtoria **nuk ka vendosur standarde për certifikimin dhe miratimin e zgjidhjeve softuerike që përdoren në shëndetësinë publike,** as mekanizma për validimin dhe kontrollin e të dhënave të futura.

**Rreziqe të veçanta janë konstatuar në fushën e sigurisë së TI-së dhe mbrojtjes së të dhënave personale.** Në Drejtori nuk është caktuar person përgjegjës për sigurinë e TI-së, **nuk monitorohen regjistrat e ngjarjeve (log-et), me çka ekziston varësi të plotë nga operatori ekonomik.**

Qendra e re e të dhënave (data-centre) e Ministrisë së Shëndetësisë ende nuk është përfunduar, ndërsa ekziston iniciativë për shfrytëzimin e qendrës rezervë për rimëkëmbje nga fatkeqësitë.

Edhe pse është promovuar funksionaliteti për transparencën e listave të pritjes, e njëjta nuk e pasqyron gjendjen reale, për shkak të mungesës së të dhënave kyçe që lidhen me datën e rekomandimit (udhëzimit) dhe numrin e përgjithshëm të operacioneve të caktuara nga mjeku. Kontrollet nga ana e ministrisë në ISHP janë planifikuar dhe pjesërisht zbatuar vetëm gjatë vitit 2023, pa vazhdimësi në vitet e tjera.

Për më tepër, **nuk ekzistojnë politika dhe procedura të përcaktuara për qasjen në të dhënat mjekësore dhe personale,** fjalëkalimet nuk ndryshohen rregullisht, ndërsa shpesh mungojnë deklaratat e konfidencialitetit dhe zyrtarët e caktuar për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto gjendje krijojnë **rrezik të lartë për qasje të paautorizuar dhe keqpërdorim, që është konfirmuar edhe nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**



## PROGRAMET PËR ZBULIMIN E HERSHËM TË SËMUNDJEVE MALINJE

3 SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

Kemi kryer revizion të suksesit me temë **„Programet për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje"**, me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes **„A sigurojnë programet për zbulim të hershëm dhe skrining mbulim adekuat të popullatës së synuar, diagnostikim cilësor dhe në kohë dhe a rezultojnë me zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje të gjirit dhe qafës së mitrës dhe uljen e mortalitetit?"**

Me revizionin konstatuam se edhe pavarësisht zbatimit shumëvjeçar të programeve dhe përparimit të caktuar në planifikimin dhe realizimin e tyre, në kushtet e mjeteve të kufizuara buxhetore, **skriningu ende nuk siguron mbulim të mjaftueshëm të popullatës së synuar dhe as diagnostikim në kohë në një shkallë që do të mundësonte konfirmimin sistematik të kontributit të tij në zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje dhe në uljen e mortalitetit.**

Me revizionin janë përfshirë aktivitetet që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e programeve të skriningut për kancerin e qafës së mitrës dhe kancerin e gjirit në periudhën 2021–2024, ndërsa disa çështje dhe ngjarje të caktuara janë trajtuar edhe para dhe pas kësaj periudhe.

**Skriningu për kancerin e qafës së mitrës** zbatohet përmes testeve PAP te gratë e moshës 21 deri në 59 vjeç, në një cikël trevjeçar. Në periudhën 2022–2024, nga gjinekologët amë janë marrë gjithsej 130.093 mostra për testin PAP.





## NUMRI I MOSTRAVE TË MARRA PËR PAP SKRINING NË PERIUDHËN 2021–2024




GJITHSEJ **130.093**

**Skriningu për kancerin e gjirit** zbatohet përmes ekzaminimeve mamografike te gratë e moshës 40 deri në 69 vjeç, në cikël dyvjeçar. Në periudhën 2021–2024 janë realizuar gjithsej 20.946 mamografi skriningu.

## MAMOGRAFI SKRINING TË REALIZUARA NË PERIUDHËN 2021–2024




GJITHSEJ **20.946**

Programet e skriningut miratohen në baza vjetore, pa kornizë strategjike afatgjatë të vendosur, e cila do të siguronte stabilitet në përcaktimin e popullatës së synuar, mbulimit dhe intervaleve të skriningut, burimeve të nevojshme dhe përgjegjësive të institucioneve të përfshira.

Qëllimet dhe indikatorët e suksesit nuk janë përcaktuar në mënyrë konsistente dhe, në masë të konsiderueshme, janë të orientuara drejt vëllimit të aktiviteteve, në vend të efekteve dhe rezultateve shëndetësore.

## KRAHASIM I POPULLATËS SË SYNUAR DHE INTERVALIT TË SKRININGUT TË KANCERIT TË QAFËS SË MITRËS NË NIVEL KOMBËTAR DHE REKOMANDIMEVE EVROPIANE




## KRAHASIM I MBULIMIT TË POPULLATËS DHE INTERVALIT TË SKRININGUT KOMBËTAR PËR KANCERIN E GJIRIT ME REKOMANDIMET EVROPIANE



Planifikimi financiar kryhet në kuadër të mjeteve të kufizuara buxhetore në baza vjetore, pa lidhje të qartë ndërmjet burimeve, mbulimit të planifikuar dhe rezultateve të pritshme, që e vështirëson vlerësimin e efektivitetit të programeve dhe kontributit të tyre në zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje.

Programet e skriningut zbatohen në mënyrë të vazhdueshme, por me mbulim të kufizuar të popullatës së synuar. Te skriningu për kancerin e gjirit, mbulimi varion nga 0,8% до 5,4%, а кај скринингот на рак на грло на матка од 10,3% deri në 15,5% e popullatës së synuar, **që është dukshëm nën nivelet e rekomanduara evropiane për skrining të organizuar popullativ. Me një mbulim të tillë nuk mund të priten efekte të rëndësishme në nivel popullate për zbulimin e hershëm të sëmundjes.**

## POPULLATA E SYNUAR DHE PËRFSHIRJA NË SKRININGUN PËR KANCERIN E QAFËS SË MITRËS NË PERIUDHËN NGA 2022 DERI NË 2024







**2022**

- Popullata **36-45**: vjeç: **123.978**
- Teste PAP të marra nga gjinekologët familjarë: **12.746**
- Teste PAP të realizuara në laboratorë: **8.995**

**2023**

- Popullata **36-45**: vjeç: **426.771**
- Teste PAP të marra nga gjinekologët familjarë: **51.814**
- Teste PAP të realizuara në laboratorë: **58.462**

**2024**

- Popullata **36-45**: vjeç: **422.134**
- Teste PAP të marra nga gjinekologët familjarë: **65.533**
- Teste PAP të realizuara në laboratorë: **51.997**

## POPULLATA E SYNUAR, MBULIM DHE JEHONA NË SKRININGUN PËR KANCER TË GJIRIT NË PERIUDHËN 2021 DERI NË 2024

**2021**

Popullata **50-59 vjeç: 128.855**
Gratë të ftuara: **989**
Gratë të ekzaminuara: **651**
Eksaminime të mëtejshme: **87**

**2022**

Popullata **40-69 vjeç: 385.158**
Gratë të ftuara: **10.962**
Gratë të ekzaminuara: **4902**
Eksaminime të mëtejshme: **1028**

**2023**

Popullata **50-59 vjeç: 129.762**
Gratë të ftuara: **7.054**
Gratë të ekzaminuara: **1.615**
Eksaminime të mëtejshme: **256**

**2024**

Popullata **40-69 vjeç: 382.768**
Gratë të ftuara: **19.573**
Gratë të ekzaminuara: **13.778**
Eksaminime të mëtejshme: **2.144**









Jehona e grave të ftuara nuk mund të vlerësohet plotësisht për shkak të mungesës së të dhënave të plota mbi numrin e ftesave të dërguara dhe numrin e grave që i janë përgjigjur skriningut. Sistemet informative nuk mundësojnë monitorimin sistematik të këtyre të dhënave, ndërsa aktivitetet promovuese nuk zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe në vëllim të mjaftueshëm, që ndikon në nivelin e informimit dhe motivimit të grave për të marrë pjesë në programet e skriningut.

Lidhur me afatin kohor dhe cilësinë e diagnostikimit, nuk janë përcaktuar afate kohore nga realizimi i skriningut deri në lëshimin e rezultateve, si dhe nuk ekzistojnë protokolle për njoftimin e grave. Te skriningu mamografik, rezultatet lëshohen mesatarisht pas rreth 25 ditësh, ndërsa për një numër të konsiderueshëm grash edhe pas më shumë se 60 ditësh. Ndërkaq, te skriningu për kancerin e qafës së mitrës, një pjesë e mostrave për testet PAP analizohen me vonesa të konsiderueshme.

Veprimet e mëtejshme pas skriningut, veçanërisht te gratë me gjetje të dyshimta ose pozitive, nuk janë plotësisht të gjurmueshme. Të dhënat për diagnostikimin shtesë dhe trajtimin nuk janë të lidhura në mënyrë sistematike me të dhënat e skriningut, ndërsa një pjesë e pacienteve e vazhdojnë trajtimin në sektorin privat, që e kufizon edhe më tej mundësinë për vlerësimin e plotë të efektivitetit të programeve.

**Të dhënat nga institucionet shëndetësore tregojnë se rreth 80% e pacienteve me kancer e fillojnë trajtimin në faza më të avancuara të sëmundjes, që tregon se pjesa më e madhe e rasteve nuk zbulohen në fazë të hershme, si rezultat i pritshëm i skriningut të organizuar.**

Mungesa dhe shpërndarja e pabarabartë e burimeve njerëzore, veçanërisht në radiologji, citologji dhe patologji, krijon varësi nga një numër i kufizuar i profesionistëve shëndetësorë dhe paraqet rrezik për zbatimin e vazhdueshëm dhe cilësor të shërbimeve të skriningut. Pajisjet diagnostikuese dhe infrastruktura nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë, ndërsa sistemet informative nuk sigurojnë ndërlidhje dhe shkëmbim të plotë të të dhënave. Në një pjesë të institucioneve publike shëndetësore, vëllimi i shtuar i aktiviteteve të skriningut ndikon edhe në qasjen dhe disponueshmërinë e ekzaminimeve të rregullta diagnostikuese dhe kontrolluese.

Njëkohësisht, nuk është siguruar plotësia dhe harmonizimi i të dhënave të institucioneve zyrtare për numrin e rasteve dhe të vdekjeve. **Të dhënat nga Regjistri i Kancerit tregojnë se numri i rasteve të zbuluara përmes skriningut është relativisht i ulët, veçanërisht te kanceri i gjirit, gjë që tregon për efekt të kufizuar të programeve.**

## RASTE TË REJA TË DIAGNOSTIKUARA ME KANCER

| | 2021 | | 2022 | | 2023 | | 2024 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kanceri i qafës së mitrës | Kanceri i gjirit | Kanceri i qafës së mitrës | Kanceri i gjirit | Kanceri i qafës së mitrës | Kanceri i gjirit | Kanceri i qafës së mitrës | Kanceri i gjirit |
| Pacientë të rinj në KUOR | 102 | 854 | 69 | 957 | 88 | 922 | 67 | 883 |
| Pacientë të rinj në Regjistrin e Kancerit | / | / | 153 | 1010 | 115 | 607 | / | / |
| Raste të zbuluara përmes skriningut | / | / | 31 | 9 | 18 | 13 | / | / |

● KANCERI I QAFËS SË MITRËS ● KANCERI I GJIRIT

Për tejkalimin e gjendjeve të lartpërmendura, kemi dhënë rekomandime të orientuara drejt eliminimit të shkaqeve të gjendjeve të konstatuara dhe krijimit të kushteve për zbatimin e skriningut të organizuar dhe efektiv për kancerin e qafës së mitrës dhe kancerin e gjirit. Si më të rëndësishme veçohen rekomandimet që kanë të bëjnë me hartimin dhe miratimin e Strategjis Kombëtare dhe vendosjen e kornizës adekuate normative për skriningun e organizuar, vendosjen e grupit standard të objektivave dhe indikatorëve me vlera të synuara qartë të përcaktuara dhe përgjegjësi institucionale, zbatimin e aktiviteteve të vazhdueshme promovuese dhe edukative, krijimin e sistemit të integruar informativ dhe vendosjen e modeleve të qarta dhe transparente të kompensimit financiar.

Tregues pozitiv i pranueshmërisë dhe vlerës së shtuar të revizionit është përgjigjja ndaj Raportit Përfundimtar nga drejtori i Fondit, i cili shpreh një qasje konstruktive, i pranon rekomandimet që lidhen me kompetencat e tij dhe paralajmëron aktivitete për zbatimin e tyre, veçanërisht në pjesën e avancimit të modeleve të kompensimit financiar, lidhjes së mjeteve të paguara me vëllimin e shërbimeve të kryera dhe rezultatet e arritura, si dhe forcimit të sistemeve për monitorimin, raportimin dhe kontrollin e programeve të skriningut.

## FONDI PËR SIGURIM SHËNDETËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Me revizionin e kryer të rregullshmërisë së raporteve financiare të Fondit për vitin 2024, **është konstatuar se një pjesë e gjendjeve të konstatuara edhe në raportet e mëparshme të revizionit ende nuk janë tejkaluar.**

Funksionimi i sistemit informativ të Fondit është i kufizuar për shkak të mungesës së burimeve njerëzore në fushën e TI-së, mungesës së strategjive dhe politikave të përditësuara dhe të operacionalizuara të TI-së, funksionalitetit të pjesshëm ose mosshfrytëzimit të moduleve të caktuara aplikative, si dhe mundësive të kufizuara për avancimin e sistemit DRG. Një pjesë e proceseve ende realizohen përmes evidencave dhe përllogaritjeve manuale, që ndikon në efikasitetin, gjurmueshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave.

Aktivitetet e kontrollit ndaj institucioneve shëndetësore nuk janë të vendosura dhe të zbatuara në masë të mjaftueshme për të siguruar verifikimin e plotë të realitetit dhe objektivitetit të shërbimeve shëndetësore të faturuara.

Mungesa e një sistemi të vetëm të integruar për ndërlidhjen e udhëzimeve (referimeve), raporteve mjekësore dhe përllogaritjeve për shërbimet shëndetësore të kryera krijon rrezik për lëshime dhe gabime. Për më tepër, kontrollet nuk planifikohen në bazë të vlerësimit të rrezikut, nuk është vendosur sistem i plotë elektronik për planifikimin dhe monitorimin e kontrolleve, ndërsa mungesa e kuadrit profesional ndikon në rregullsinë dhe shtrirjen e kontrolleve në terren.

Revizioni gjithashtu vuri në dukje dobësi në kontrollet gjatë verifikimit të realitetit dhe objektivitetit të barnave të faturuara, si dhe vonesa në vendosjen e sistemit të recetës elektronike.

Në pjesën e prokurimeve publike të TI-së, nuk është siguruar konkurrencë e mjaftueshme, ndërsa moduli i prokuruar për sigurimin jashtë vendit nuk është vënë në funksion.

Në procedurën për dërgimin e personave të siguruar për mjekim jashtë vendit, për të cilën në vitin 2024 janë realizuar shpenzime në vlerë prej 455.346 mijë denarë, përkatësisht 7.380.000 euro, janë konstatuar më shumë dobësi. Kërkesat në bazë të avanseve të dhëna për mjekim jashtë vendit arrijnë në 296.098 mijë denarë, përkatësisht 4.799.000 euro, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e tyre rrjedhin nga vitet e mëparshme. Nuk është vendosur kontroll i mjaftueshëm mbi dokumentacionin mjekësor dhe faturat e spitaleve të huaja, nuk kryhet në kohë përcaktimi i vlerës reale të shpenzimeve pas përfundimit të trajtimit, ndërsa moduli për ndjekjen e procedurave të mjekimit jashtë vendit nuk përdoret në mënyrë të plotë. Gjithashtu, nuk është vendosur sistem për monitorimin dhe analizimin e suksesit të trajtimit, si dhe nuk ekziston listë e institucioneve shëndetësore të huaja me të dhëna dhe kritere që do të shërbenin si bazë për dërgimin e personave të siguruar për mjekim.

Statusi juridiko-pronësor i një pjese të objekteve ndërtimore dhe tokës që shfrytëzohen nga Fondi nuk është rregulluar plotësisht, vlera e pasurisë së paluajtshme nuk është përcaktuar në tërësi, ndërsa një pjesë e mjeteve nuk janë evidentuar plotësisht në librat afaristë. Për më tepër, për pronën e fituar në procedurat e falimentimit

nuk janë siguruar informacione të plota lidhur me vlerën, regjistrimin, shfrytëzimin dhe disponimin e saj, që ndikon në realitetin dhe besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në raportet financiare.

Në pjesën e theksimit të çështjeve, revizioni bën të ditur se nuk janë siguruar informacione të plota për kërkesat në bazë të kontributit të papaguar për sigurim shëndetësor, ndërsa arkëtimi i kërkesave të krijuara deri në fund të vitit 2008 mbetet i pasigurt.

Gjithashtu, Fondi është i përfshirë në disa procedura gjyqësore me rezultat të pasigurt, çmimet referente të shërbimeve shëndetësore nuk janë përditësuar për një periudhë të gjatë kohore dhe nuk i pasqyrojnë kostot reale, ndërsa kontributet për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor për kategori të caktuara të personave të siguruar nuk janë paguar plotësisht nga institucionet kompetente.

Si çështje kyçe e revizionit është theksuar se nuk është siguruar blerje reale e shërbimeve shëndetësore, pasi Fondi, në vend që ta lidhë financimin me llojin dhe vëllimin e shërbimeve të kryera, ka detyrim ligjor të sigurojë mjete për funksionimin e plotë të institucioneve publike shëndetësore që nuk realizojnë vëllim përkatës të shërbimeve në kuadër të kompensimit të kontraktuar.

Në pjesën e çështjeve të tjera, revizioni vë në dukje nevojën për përditësimin e Listës së barnave në përgjegjësi të Fondit.

## INSTITUCIONE SHËNDETËSORE PUBLIK

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2025, kemi kryer revizion të raporteve financiare së bashku me revizion të pajtueshmërisë për vitin 2024 në Klinikën Universitare për Kirurgji Torakale, Institutin e Shëndetit Publik, Spitalin e Përgjithshëm të Prilepit, Shtëpinë e Shëndetit në Resnjë dhe Institutin e Mjekësisë së Punës. Me revizionet e **kryera janë konstatuar gjendje që tregojnë për dobësi të përsëritura në menaxhimin financiar, evidencën kontabël dhe materiale, prokurimet publike, menaxhimin e rezervave, organizimin e shërbimeve shëndetësore, arkëtimin e kërkesave dhe kontrollet e brendshme.**

Te një pjesë e ISHP-ve të reviduara janë konstatuar mos harmonizimi ndërmjet evidencës kontabël dhe evidencës materiale të mjeteve të përhershme, si dhe regjistrimi jo i plotë i mjeteve, detyrimeve, kërkesave dhe rezervave. Këto gjendje ndikojnë në realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe e kufizojnë mundësinë për monitorimin e plotë të mjeteve me të cilat disponojnë institucionet.

Dobësi të konsiderueshme janë konstatuar edhe në fushën e menaxhimit të rezervave dhe materialeve mjekësore. Në disa institucione nuk është vendosur evidencë e plotë për pranimin, lëshimin dhe konsumin e barnave, reagentëve dhe materialeve mjekësore, si dhe nuk është siguruar monitorimi i konsumit sipas pacientit, sipas referimit, sipas punonjësit shëndetësor ose sipas njësisë organizative. Një gjendje e tillë krijon rrezik për kontroll të pamjaftueshëm mbi konsumin real dhe e zvogëlon mundësinë për përdorim ekonomik dhe racional të mjeteve publike.

Në fushën e prokurimeve publike është konstatuar zbatim jo konsekuent i Ligjit për Prokurime Publike, marrje e detyrimeve pa procedurë të zbatuar të prokurimit publik, përcaktim jo mjaftueshëm i qartë dhe neutral i specifikimeve teknike, konkurrencë e kufizuar, si dhe prokurime që jo gjithmonë bazohen në nevojat reale të përcaktuara të institucioneve. Te një pjesë e prokurimeve për analiza laboratorike, reagentë dhe pajisje mjekësore është konstatuar rrezik nga varësia ndaj sistemeve të mbyllura dhe një numri të kufizuar operatorësh ekonomikë, ndërsa te disa institucione është konstatuar edhe prokurimi i pajisjeve që nuk janë vënë në përdorim ose për të cilat nuk janë siguruar të gjitha kushtet e nevojshme për shfrytëzim.

Janë konstatuar dobësi edhe në menaxhimin e detyrimeve dhe kërkesave. Te një pjesë e institucioneve, detyrimet janë evidentuar dhe paguar me vonesë, në mënyrë selektive dhe pa kontrolle të mjaftueshme, ndërsa janë konstatuar edhe pagesa avansi pa faturë të bashkëngjitur ose pa dokumentacion tjetër financiar përkatës. Njëkohësisht, një pjesë e kërkesave janë më të vjetra se tre vjet, pa aktivitete përkatëse të ndërmarra për arkëtimin e tyre, ndërsa për disa kërkesa mungojnë të dhëna të plota për debitorët ose për bazën e krijimit të tyre, që krijon pasiguri lidhur me arkëtueshmërinë e tyre reale.

Në pjesën e operacioneve me para të gatshme, te një pjesë e institucioneve janë konstatuar parregullsi që lidhen me arkëtimin dhe përdorimin e mjeteve në para të gatshme, moslëshimin e kuponëve fiskalë, mosdepozitimin e mjeteve të arkëtuara në llogarinë e institucionit, si dhe pagesa përmes arkës pa dokumentacion përkatës juridik dhe mbështetës. Gjendje të tilla krijojnë rrezik për përdorim jotransparent dhe jo të dedikuar të mjeteve.

Gjithashtu, janë konstatuar parregullsi në organizimin e orarit të punës, angazhimin e personave me kontratë për vepër dhe pagesën e kompensimeve. Në një pjesë të institucioneve, pagesat nuk kanë qenë gjithmonë të mbështetura me dëshmi përkatëse për punën e kryer, ndërsa janë konstatuar edhe pagesa për kujdestari, punë jashtë orarit ose kompensime të tjera pa respektimin e plotë të procedurave ligjore.

Lidhur me organizimin dhe qasjen në shërbimet shëndetësore, te një pjesë e institucioneve janë konstatuar dobësi në sigurimin e termineve të detyrueshme ligjore përmes sistemit „Termini Im", si dhe raport jo i përshtatshëm ndërmjet shërbimeve shëndetësore të planifikuara rregullisht dhe atyre urgjente, përkatësisht të realizuara jashtë planit. Këto gjendje ndikojnë në qasjen ndaj shërbimeve shëndetësore, trajtimin e barabartë të pacientëve dhe planifikimin real të kapaciteteve.

Çështje kyçe e revizionit është se nuk është siguruar blerje reale e shërbimeve shëndetësore për shkak të detyrimit ligjor të Fondit për të siguruar mjete për funksionimin e plotë të atyre institucioneve publike shëndetësore, të cilat, për shkak të arsyeve të ndryshme, nuk arrijnë të realizojnë llojin dhe vëllimin e duhur të shërbimeve shëndetësore në nivelin e kompensimit të kontraktuar.

Në pjesën „Çështje të tjera, revizioni njofton se ende nuk është vendosur Sistemi Kombëtar për Menaxhimin Material-Financiar dhe Kontabël.



# 5.2.15. KULTURË DHE SPORT

## AGJENCIA E FILMIT

AGJENCIA E FILMIT
e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2024 (revizioni financiar dhe revizioni i pajtueshmërisë), konstatuam se gjendjet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të revizorit të autorizuar shtetëror për vitin 2021, si dhe në raportet e revizionit nga periudhat e mëparshme, vazhdojnë të përsëriten dhe dobësitë e konstatuara nuk janë tejkaluar. Ndryshimet e shpeshta në strukturën drejtuese ndikojnë në mënyrën e funksionimit dhe në realizimin e qëllimit themelor për të cilin është themeluar Agjencia.

Agjencia në vazhdimësi përballet me mungesë të kapaciteteve kadrovike, përkatësisht të burimeve njerëzore profesionale dhe të trajnuara në sektorët kyç për veprimtarinë e saj, që ndikon edhe në cilësinë e kryerjes së veprimtarisë dhe funksionimit të Agjencisë. Këtë mungesë ajo e kompenson përmes angazhimit të personave me kontratë për vepër, pa zhvilluar procedurë për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kualifikimeve të parashikuara për të punësuarit e rregullt.

Detyrimet për projektet e papaguara dhe mjetet e miratuara nga Ministria e Kulturës dhe Turizmit, në bazë të kontratave të lidhura për projektet e ndara për përgatitjen e filmave artistikë me metrazh të gjatë dhe të shkurtër, dokumentarë, të animuar dhe festivale, shënojnë trend të vazhdueshëm dhe të konsiderueshëm rritjeje, veçanërisht në periudhën 2022–2024. Proporcioni i buxhetit të miratuar dhe detyrimeve sipas projekteve është 1:5, që tregon se në vazhdimësi merren përsipër më shumë detyrime sesa buxheti i miratuar.

në 000 denarë




Rritja e konsiderueshme e detyrimeve të Agjencisë cenon kërkesat e Ligjit për Disiplinë Financiare, si dhe parimin e menaxhimit të sigurt financiar të paraparë me Ligjin për Buxhetet, dhe mund të çojë në procedura gjyqësore dhe shpenzime në bazë të kamatave.

Me revizionin e kryer në vitin 2024 gjithashtu është konstatuar se:

- regjistrimi i mjeteve, kërkesave të arkëtueshme dhe detyrimeve nuk është kryer dhe nuk është bërë harmonizimi i gjendjes së paraqitur në librat afaristë me gjendjen faktike, edhe pse janë nxjerrë disa vendime për kryerjen e tij. Regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve në Agjenci nuk është kryer prej disa vitesh me radhë;
- nuk është përgatitur Strategjia për zhvillimin e veprimtarisë filmike, që ndikon në aktivitetet e mëtejshme të Agjencisë;
- nga personat përgjegjës nuk janë dorëzuar në Qeveri raportet gjashtëmujore për punën e Agjencisë, që ndikon në transparencën e funksionimit dhe në informimin e Qeverisë;
- nuk është vendosur evidencë për producentët filmikë, distributorët e filmave dhe shfaqësit e filmave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për filmat e realizuar me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për filmat e distribuuar dhe të shfaqur në kinematë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- është anuluar Konkursi për financimin e projekteve për përgatitjen e filmave artistikë me metrazh të gjatë dhe të shkurtër, dokumentarë dhe të animuar, pa ekzistuar bazë ligjore për një veprim të tillë;
- dobësi në procedurën e zbatimit të konkursit për projekte filmike dhe festivale, si dhe mungesë e një akti të brendshëm – procedure për zbatimin e procedurës pas konkursit, për shkak të shfuqizimit

të Rregullores për mbështetjen e projekteve për prodhimin e filmave artistikë me metrazh të gjatë dhe të shkurtër, dokumentarë dhe të animuar;

- nuk janë vendosur kontrolle të plota dhe në kohë në lëndët që lidhen me projektet filmike dhe festivalet, në pjesën e verifikimit të përmbushjes së kushteve nga shtëpitë producente para lidhjes së kontratave dhe në të gjitha fazat e realizimit të kontratave, si dhe mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga shtëpitë producente, që tregon për përdorim joadekuat të mjeteve;
- dobësi në lidhje me respektimin e dinamikës së realizimit dhe pagesës së projekteve filmike, si dhe periudha të pambuluara me vendim ose konkluzion të Këshillit Drejtues për vazhdimin e afatit për lidhjen e kontratave;
- kontratë e lidhur për financimin e aktiviteteve projektuese të shoqatave nga fusha e veprimtarisë filmike pa bazë ligjore;
- Agjencia nuk ka organizuar dhe vendosur njësi të revizionit të brendshëm në përputhje me rregullativën ligjore, e cila duhet të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së funksionimit;
- për arkëtimin e të ardhurave të përcaktuara me ligj, përdoret një Metodologji e vjetër dhe e papërditësuar nga viti 2015 për përcaktimin e kompensimeve;
- është miratuar Vendim për përcaktimin e kompensimit për administrimin e projekteve filmike të paraqitura sipas Konkursit, i cili nuk ka bazë ligjore;
- Agjencia nuk disponon evidencë të përditësuar për personat juridikë nga të cilët duhet të realizojë të ardhura nga ushtrimi i veprimtarisë themelore të përcaktuar me ligj;
- nuk kryhet në kohë përgatitja e Vendimeve për përllogaritjen e kompensimeve nga personat juridikë, të përcaktuar me Ligjin për Veprimtarinë Filmike;
- nuk janë vendosur mekanizma dhe harmonizime periodike ndërmjet shërbimit që lëshon vendimet dhe evidencës kontabël dhe
- producuesit të cilëve u janë ndarë mjete në bazë të konkurseve dhe filmat e të cilëve janë përfunduar dhe kanë pasur premierën, nuk dorëzojnë dokumentacionin e plotë për të dëshmuar fitimin bruto të realizuar nga projektet filmike, mbi të cilin Agjencia ka të drejtë në pjesë prej 50% të pjesëmarrjes së Agjencisë në financimin e filmit.








## INSTITUCIONI NACIONAL TEATRI SHQIPTAR - SHKUP

TEATRI SHQIPTAR SHKUP
АЛБАНСКИ ТЕАТАР СКОПЈЕ

Institucioni Nacional Teatri Shqiptar – Shkup është themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me Vendimin për përcaktimin e rrjetit të institucioneve kombëtare në fushën e kulturës, me qëllim realizimin e interesit kombëtar në kulturë*.

Veprimtaria themelore e Institucionit Kombëtar Teatri Shqiptar është arti skenik, i cili është me interes kombëtar dhe përfshin: përgatitjen dhe shfaqjen publike të veprave dramatike, përgatitjen dhe realizimin e pajisjeve për projektet dramatike, dhënien me qira të hapësirës skenike, kostumeve, dekorit dhe pajisjeve të tjera teatrore, transportin e pajisjeve të shfaqjeve, si dhe veprimtari të tjera në përputhje me Ligjin për Kulturën.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të Institucionit Nacional Teatri Shqiptar – Shkup për vitin 2024, në llogarinë e buxhetit themelor 603 dhe 631, si dhe në llogarinë e buxhetit të aktiviteteve vetëfinancuese 787, ku ndër të tjera konstatuam gjendje që kanë të bëjnë me:

- dobësi në procesin e kryerjes së inventarizimit të mjeteve dhe burimeve të mjeteve;
- evidentimi i objekteve ndërtimore pa siguruar akt pronësie;
- mjetet e evidentuara materiale në përgatitje dhe për kundër se është siguruar Leja për përdorim dhe janë dhënë rekomandime për vënien në përdorim të objektit ndërtimor dhe të pajisjeve;
- nuk është vendosur evidencë materiale për mjetet materiale;
- nuk është përcaktuar mënyra e prokurimit, pranimit, lëshimit dhe ngarkimit me materiale dhe inventar të imët;
- dobësi në mënyrën e regjistrimit dhe evidentimit të orarit të plotë të punës;
- shlyerja e detyrimeve për projekte nga vitet e kaluara, për të cilat nuk janë paraparë mjete financiare në Planin Vjetor të Punës për vitin aktual;
- mosevidentimi i dokumenteve dalëse në librin e protokollit të institucionit nacional;
- nuk është miratuar akt nga Këshilli Drejtues për përcaktimin e lartësisë së çmimeve të biletave.

* Gazeta Zyrtare nr. 84/03 dhe nr. 13/11



DHOMA E KOSTUMEVE

Në pjesën Theksimi i çështjeve janë zbardhur gjendjet që kanë të bëjnë me:

- mënyrë e parregulluar e përdorimit të pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme, përkatësisht pas themelimit të IN Teatri Shqiptar – Shkup nuk është miratuar akt nga Qeveria me të cilin rregullohet e drejta dhe mënyra e përdorimit të pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme, përfshirë edhe tokën ndërtimore në pronësi shtetërore;
- funksionimi i Këshillit Drejtues pa numrin e anëtarëve të përcaktuar me ligj;
- sistematizimi dhe organizimi i brendshëm i IN Teatri Shqiptar, përkatësisht vende udhëheqëse të paparapara të punës, numri i pamjaftueshëm i vendeve të punës sipas njësive organizative, struktura joadekuate të sektorëve dhe mos harmonizim ndërmjet akteve. Pavarësisht kësaj, për aktet e organizimit dhe sistematizimit janë marrë pëlqimet nga ministria kompetente.
- mënyra e përdorimit të hapësirës së parkimit të dedikuar për publikun e teatrit;
- mënyra e rregullimit të kompensimeve për dhënien me qira të hapësirës afariste. Konkretisht, për dhënien me qira të sallave janë përcaktuar çmime në interval prej 10 deri në 240 mijë denarë, varësisht nga kohëzgjatja, nevojat teknike dhe organizative të ngjarjes, për shkak të së cilës

revizioni thekson se përcaktimi i çmimit për qiranë e hapësirës afariste krijon rrezik për veprim subjektiv gjatë lidhjes së kontratave të qirasë;

- procedura gjyqësore që janë në zhvillim para gjykatave kompetente dhe deri në ditën e revizionit, rezultati përfundimtar për të njëjtit ende nuk është i njohur, ekziston pasiguri për implikimet e ardhshme financiare mbi buxhetin e institucionit nacional.

Në pjesën e kontrolleve të brendshme, theksojmë se nuk janë miratuar procedura të brendshme për proceset me rëndësi në institucion, nuk është sistematizuar vendi i punës i udhëheqësit të njësisë për çështje financiare dhe nuk janë caktuar persona për kryerjen e kontrollit financiar ex-ante dhe ex-post.

## TEATRI TURK SHKUP

Kemi kryer revizion të pajtueshmërisë me temë **„Prokurim publik i shërbimit për realizimin e punimeve ndërtimore në objektin e Institucionit Nacional Teatrit Turk në Shkup për instalime termoteknike, instalime elektronike, instalime hidroteknike dhe pjesë të punimeve ndërtimore dhe zejtare ndërtimore – hera e tretë”** te IN Teatri Turk – Shkup, i zbatuar gjatë vitit 2024. **Ky revizion i pajtueshmërisë është kryer si revizion në kohë reale dhe si rezultat i bashkëpunimit ndërinstitucional me Ministrinë e Financave – Byronë e Prokurimeve Publike.**

Në bazë të revizionit të kryer, konkluduam se mënyra dhe procedura e dhënies së kontratës për prokurim publik për realizimin e punimeve ndërtimore në objektin e Institucionit Nacional Teatri Turk – Shkup për instalime termoteknike, instalime elektroteknike, instalime hidroteknike dhe një pjesë të punimeve ndërtimore dhe zejtare ndërtimore – për herë të tretë, si dhe realizimi i saj, nuk janë në pajtim, në të gjitha aspektet materiale, me rregullativën ligjore relevante, kontratat e lidhura dhe konkluzionet e Qeverisë.

Ndërtimi i një objekti të ri dhe modern për Institucionin Nacional Teatri Turk – Shkup, si qendër kulturore multimediale, funksioni kryesor i së cilës është sigurimi i kushteve të përditshme të punës dhe realizimi i aktiviteteve programore të ansamblit të dramës turke, ka filluar në vitin 2014 dhe po zbatohet në faza. Financimi i projektit bëhet me mjete buxhetore të Institucionit Nacional Teatri Turk – Shkup, të siguruara përmes Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit.

**Me revizionin konstatuam se teatri ende nuk është ndërtuar plotësisht, edhe pse kanë kaluar pothuajse 11 vjet nga dita kur kanë filluar punimet ndërtimore.** Periudha e gjatë e ndërtimit të teatrit është rezultat i disa faktorëve që kanë ndikuar në zgjatjen e aktiviteteve ndërtimore, si: ndryshimet dhe plotësimet e dokumentacionit projektues,



nevoja për mjete të konsiderueshme financiare, si dhe vendimi që realizimi i tij të zhvillohet në disa faza, për të cilat janë zhvilluar procedura të veçanta të prokurimit publik dhe janë lidhur kontrata me operatorët ekonomikë të përzgjedhur. **Pasi ishte ndërtuar konstruksioni i vrazhdë (karabina), projekti në periudhën nga maji i vitit 2017 deri në shtator të vitit 2021 ka qenë në ngecje për shkak të mungesës së mjeteve financiare për vazhdimin e aktiviteteve.** Anulimi i dy procedurave të prokurimit publik gjatë vitit 2024 ka kontribuar gjithashtu në zvarritjen e punimeve për fillimin dhe realizimin e fazës së tretë të instalimeve dhe të një pjese të punimeve ndërtimore në objekt.

Me revizionin e kryer konstatuam dobësi të caktuara në mënyrën e zbatimit të procedurës së prokurimit publik, , si në vijim: si rezultat i një gabimi teknik, të dhënat për vlerën e vlerësuar të prokurimit publik të futura në sistemin e SEPP-së dallohen nga vlera reale e vlerësuar e përcaktuar në Vendimin për prokurim public, nuk janë harmonizuar të dhënat në shpalljen e publikuar për prokurim publik me të dhënat në dokumentacionin e tenderit, nga aspekti i nevojës për dorëzimin e garancisë bankare për realizimin cilësor të kontratës dhe për pagesën e avansit.

Gjithashtu, kriteret për dëshmimin e aftësisë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë nuk janë proporcionale me vlerën e vlerësuar të prokurimit dhe ndikojnë në kufizimin e konkurrencës.

Në kuadër të realizimit të kontratës, konstatuam përmbushje jo me kohë të detyrimeve financiare nga ana e organit kontraktues ndaj realizuesit të punimeve dhe mbikëqyrjes profesionale. Edhe pse Qeveria ka dhënë pëlqim për marrjen e detyrimeve në vlerë prej 120.000 mijë denarë për vitin 2025, ministria kompetente, në përputhje me kontratën e lidhur dhe anekset e saj, disa herë gjatë vitit ka siguruar mjete në shumën e përgjithshme prej 87.750 mijë denarë. Kjo ka kontribuar në shlyerjen e vonuar të detyrimeve ndaj realizuesit të punimeve, ndërsa detyrimet ndaj mbikëqyrjes profesionale në shumën prej 1.669 mijë denarë kanë mbetur të pashlyera. Mjetet buxhetore të siguruara deri në periudhën e raportimit për revizionin nuk janë të mjaftueshme për aktivitetet aktuale dhe ato të planifikuara ndërtimore deri në fund të vitit. Kjo gjendje ndikon negativisht në zbatimin e mëtejshëm të detyrimeve kontraktuale, paraqet rrezik për zgjatjen e afateve të realizimit të punimeve dhe krijon mundësi për aktivizimin e mjeteve të mbrojtjes juridike sipas kontratave.

Për gjendjet e konstatuara, revizioni dha rekomandime për tejkalimin e mangësive dhe organet kompetente duhet të ndërmarrin masa përkatëse për zbatimin e plotë të tyre.



Marrë nga: http://www.turktiyatrosu.mk/

# 5.2.16. PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

## FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË SË VERIUT

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2024, konstatuam se:

Të hyrat nga kontributet e arkëtuara për SPI në vitin 2024 janë rritur për 14% krahasuar me vitin paraprak 2023 dhe arrijnë në 71.435.601 mijë denarë, duke përbërë 61,74% të gjithsej të hyrave të realizuara.

Rritja e realizuar e të hyrave në vitin 2024 ende nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për pensione, të cilat gjithashtu shënojnë rritje çdo vit dhe në vitin 2024 arrijnë në 90.277.241 mijë denarë.

### STRUKTURA E TË HYRAVE TË FONDIT TË REALIZUARA NË VITIN 2024




**61.74%** Kontribute për SPI

**0.14%** Akciza

**1.41%** Të hyra të tjera

**36.71%** Transfere nga Buxheti

në 000 denarë

### PJESËMARRJA E MJETEVE TË TRANSFERUARA NGA BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË TË HYRAT TOTALE PËR PERIUDHËN 2014–2024




* Kontributi për SPI për vitin 2024 arrin në 18,8% të pagës bruto.
* Të hyrat nga kontributet e arkëtuara për SPI në vitin 2023 kanë arritur në 62.609.652 mijë denarë.

Të dhënat e paraqitura në grafik tregojnë se përqindja e mjeteve të ndara nga Buxheti i shtetit deri në vitin 2018 shënon rritje të vazhdueshme, ndërsa nga viti 2019 shënohet trend i rënies. Në vitin 2024, pjesëmarrja e mjeteve të transferuara nga Buxheti i shtetit arrin në 36,71% dhe shënon rritje prej 4,14% krahasuar me vitin 2023.

Në dhjetor të vitit 2024, numri i të siguruarve arrin në 556.294 persona, ndërsa numri i pensionistëve arrin në 343.048 persona, përkatësisht raporti pensionistë/të siguruar në fund të vitit 2024 është 1:1,63, duke shënuar përmirësim krahasuar me vitin 2023, kur ky raport ishte 1:1,70.

Është theksuar gjendja për mënyrën e përllogaritjes dhe pagesën në kohë të kontributeve për të siguruarit në shtyllën e dytë pensionale. Edhe pse Fondi i përgatit përllogaritjet dhe i dorëzon ato në ministrinë kompetente brenda afatit ligjor, mjetet nuk transferohen në kohë, me çka në vitin 2024 vonesa ka qenë mesatarisht rreth dy muaj. Përfundim me datën 27.02.2026 është konstatuar një borxh në bazë të kontributeve të pashpërndara që i takojnë shtyllës së dytë pensionale dhe shoqërive private pensionale, në shumën prej 2.592.918 mijë denarë.

Gjithashtu, konstatuam se Fondi nuk kryen pagesën në kohë të kontributeve për sigurimin shëndetësor të pensionistëve ndaj Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (FSSHRMV), edhe pse ka detyrim ligjor për këtë. Gjatë viteve 2024 dhe 2025, kontributet janë kryer me vonesë prej disa muajsh, ndërsa deri më 28.02.2026 kontributet paguhen me vonesë deri në tetë muaj. Detyrimi i përgjithshëm i papaguar për periudhën nga qershori 2025 deri në janar 2026 arrin në 8.415.865 mijë denarë. Kjo gjendje u mundëson pensionistëve të përdorin shërbime shëndetësore pa qenë të paguara në kohë kontributet përkatëse, ndërsa nga ana tjetër ndikon negativisht në likuiditetin e Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (FSSHRMV).

Fondi në vazhdimësi përballet me mungesë të burimeve njerëzore, përkatësisht të kuadrit profesional dhe të trajnuar në sektorët kyç për veprimtarinë e tij, në njësitë rajonale, në Sektorin e TI-së dhe në njësinë e revizionit të brendshëm, që ndikon në masë të konsiderueshme në cilësinë e kryerjes së veprimtarisë dhe funksionimit të Fondit.

Në pjesën e punës administrative të Fondit janë konstatuar gjendjet e mëposhtme:

- nuk është kryer evidentimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në librat afaristë të mjeteve të përhershme, të fituara në bazë të procedurave të falimentimit, për të cilat Fondi ka të drejtën e pronësisë ose të drejtën e transferuar të përdorimit;
- regjistrimi i tokës është zbatuar në mënyrë jo të plotë dhe nuk është vendosur evidencë e plotë kontabël;
- regjistrimi i një pjese të kërkesave është kryer pa përcaktimin e bazës juridike dhe sa e vjetër është;
- Fondi nuk disponon me të dhëna të plota për mjetet e përgjithshme të arkëtuara nga akcizat të Buxhetit;
- në mënyrën e dhënies me qira të hapësirës afariste kemi konstatuar mospërputhje që nuk janë në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi;
- dobësi në mënyrën e funksionimit të llogarisë për pagesën dhe shpërndarjen e kontributeve, ku në fund të çdo viti mbeten mjete monetare që nuk përdoren për pagesën e pensioneve, përkatësisht nuk shpërndahen për destinimin e tyre përfundimtar;
- dobësi në zbatimin dhe realizimin e kontratave për prokurime publike;
- mospërputhje në mënyrën e ndarjes dhe përmbushjes së kushteve për akomodim në banesat, në shtëpitë për banim të përfituesve të pensionit, me të cilat administron Fondi.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara janë dhënë rekomandime për veprim nga organet kompetente.



## AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kemi kryer revizionin e raporteve financiare për vitin 2024 të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç'rast konstatuam gjendje të caktuara, si në vijim:

**Kompensim në para**

Për mjetet për kompensim në para në rast papunësie, gjatë vitit 2024 janë paguar mjete në shumën e përgjithshme prej 1.326.958 mijë denarë, nga të cilat 876.960 mijë denarë për kompensim në para dhe 449.998 mijë denarë për sigurim material. Këto mjete janë më të larta për 21.239 mijë denarë krahasuar me vitin 2023, kur mbi këtë bazë janë paguar mjete në shumën prej 1.305.719 mijë denarë. Mjetet e paguara në vitin 2024 përbëjnë 40,6% të gjithsej shpenzimeve të APRMV-së për vitin 2024, ndërsa krahasuar me vitin 2023, pjesëmarrja e këtyre shpenzimeve në gjithsej shpenzimet ka qenë 43,7%.

Mjetet e paguara për kompensim në para dhe sigurim material për periudhën 2019–2024, në bazë të së drejtës së fituar, janë paraqitur në grafikën vijuese:




Te një pjesë më e vogël e lëndëve të analizuara, dokumentacioni është jo i plotë, përkatësisht vërehet mungesa e një pjese të dokumentacionit të kërkuar, që është pasojë e mosazhurnimit në punë në disa Qendra të Punësimit, ndërsa një pjesë e dokumentacionit sigurohet ose përgatitet pas skadimit të afatit të përcaktuar me ligj, për shkak të mungesës së këmbimit elektronik të të dhënave dhe lidhjes së evidencave ndërmjet APRMV-së dhe Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor, me ç'rast procesi prolongohet. Pjesa më e madhe e kërkesave për kompensim në para që janë miratuar për pagesë kanë të bëjnë me të punësuar me kontratë me afat të caktuar, që vjen si rezultat i trajtimit të pabarabartë të kësaj kategorie të punësuarish në krahasim me të punësuarit me kontratë me afat të pacaktuar, për të cilët miratimi i kërkesave për kompensim në para është më vështirë i realizueshëm.

**Masat aktive të punësimit**

Për realizimin e gjithsej 14 programeve dhe masave të punësimit të parapara me Planin Operativ për vitin 2024, janë paguar gjithsej 1.442.207 mijë denarë, që paraqet një rritje prej 16,34% krahasuar me vitin 2023, kur janë paguar 1.239.596 mijë denarë.

Shpërndarja e shpenzimeve sipas programeve dhe masave për vitin 2024, në krahasim me vitin 2023, është paraqitur në grafikun vijues:




Ashtu si në vitet e kaluara, edhe në vitin 2024 konstatuam se për një pjesë të rajoneve planore paguhen mjete në vlerë më të lartë se përqindjet e përcaktuara të pjesëmarrjes, në përputhje me Vendimin për klasifikimin e rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit. Zakonisht, më i ulët se niveli i përcaktuar është shuma e paguar për rajonet planore në pjesën qendrore dhe lindore të vendit, ndërsa më e lartë se niveli i përcaktuar është shuma e paguar për Rajonin Planor të Shkupit dhe rajonet planore në pjesën perëndimore të vendit, ku në raste të caktuara tejkalimi është deri në katër herë më i lartë se kuota e përcaktuar me vendim. **Te masa 1 – Vetëpunësimi,** 62,05% e shpenzimeve totale janë paguar në 5 qytete.

## PJESËMARRJA E QENDRAVE TË VEÇANTA TË PUNËSIMIT NË MASËN AKTIVE – VETËPUNËSIMI



E ngjashme është gjendja edhe te masa **2.1 – Subvencionimi i pagave**, ku te 4 Qendra për Punësim (Shkup, Strugë, Tetovë dhe Kumanovë) bien 327 aplikacione të miratuara nga gjithsej 646, përkatësisht 50,6%, si dhe te masa **2.2 – Punësimi dhe rritja e subjekteve juridike**, ku në 5 Qendra për Punësim (Tetovë, Shkup, Strugë, Kumanovë dhe Probishtip) janë miratuar 587 aplikacione nga gjithsej 917, ose 64,1%, ndërsa në 25 qendrat e tjera bie pjesa e mbetur prej 35,9%. Edhe pse në maj të vitit 2024 Këshilli Drejtues i APRMV-së ka miratuar Vendim për mënyrën e zbatimit të parimit për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal –shpërndarjen e kuotave dhe numrin e përfituesve të programeve dhe masave aktive të punësimit sipas rajoneve planore, me këtë vendim nuk është marrë në konsideratë në mënyrë adekuate zhvillimi i barabartë rajonal, si është paraparë me rregullativën ligjore.

Kemi konstatuar se kontrollet e vendosura lidhur me përdorimin e dedikuar dhe ligjor të mjeteve të ndara për masat aktive të punësimit janë të pamjaftueshme, ku pjesa më e madhe e proceseve të kontrollit janë të natyrës formale, me formulime të përgjithshme dhe jo të detajuara, pa përshkrim të hollësishëm të pajisjeve të blera me mjetet e subvencionuara.

Gjatë vitit 2024, për masën **4.1 – Trajnimi për përvetësimin e aftësive në fushën e aftësive të avancuara në TI** është paguar shumë prej 85.835 mijë denarë, ndërsa numri i kandidatëve që kanë kaluar me sukses provimin e paraparë në fund të trajnimit arrin në 25%. Shkalla e kandidatëve që kanë kaluar provimin është jashtëzakonisht e ulët dhe kjo situatë përsëritet nga viti në vit, duke çuar në konstatimin se një pjesë e kandidatëve nuk i qasen trajnimit me seriozitetin e nevojshëm dhe mungon motivimi i duhur për përfundimin me sukses të provimeve. Kjo e bën këtë masë joefikase, veçanërisht duke pasur parasysh se për këtë aktivitet APRMV-ja shfrytëzon një shumë të konsiderueshme të mjeteve publike.

Në pjesën Çështje të tjera, theksojmë çështje që lidhen me paqartësi në kuadrin ligjor, i cili siguron kushtet për realizimin e të drejtave nga kompensimi në para dhe që kontribuojnë në zbatim jo të njëjtë në praktikë, që kanë të bëjnë me mënyrën e përllogaritjes së lartësisë së kompensimit në rast të punës me orar jo të plotë dhe me kushtet për ndërprerjen e së drejtës.

## PLAKJA E POPULLSISË

1 PA VARFËRI

3 SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

Revizioni është zbatuar si pjesë e revizionit paralel ndërkombëtar të suksesit nga disa ISR-ve, i koordinuar nga Institucioni Suprem i Revizionit i Izraelit, me pjesëmarrjen e Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Institucioneve Supreme të Revizionit të Republikës së Shqipërisë, Çekisë, Lituanisë, Maltës, Paraguait, Polonisë, Portugalisë dhe Sllovakisë.

Me revizionin është përfshirë periudha nga viti 2014 deri në qershor 2024, me qëllim që të jepet përgjigje në pyetjen lidhur me masat dhe aktivitetet që ndërmarrin institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut për kujdesin ndaj personave të moshuar mbi moshën 65 vjeçarë dhe qëndrueshmërinë e fondeve pensionale në vend, në kontekst të plakjes së përshpejtuar të popullsisë në vend.

Me revizionin e kryer kemi fituar bindje të arsyeshme se, edhe pse institucionet kompetente kanë ndërmarrë masa dhe aktivitete, nuk është siguruar kujdes i plotë dhe adekuat për personat e moshuar mbi moshën 65 vjeçare, si dhe për menaxhimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit pensional në kushtet e plakjes së përshpejtuar të popullsisë.



**Masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente nuk janë të mjaftueshme për të siguruar qëndrueshmëri në afat të mesëm dhe afatgjatë, përkatësisht nuk janë ndërmarrë masat e nevojshme sistemore për zvogëlimin e plakjes së shpejtë demografike të popullsisë dhe të presioneve në rritje mbi financat publike.** Edhe pse sistemi pensional i konceptuar në tre shtylla siguron pagesë të rregullt të pensioneve, qëndrueshmëria e tij faktike është cenuar për shkak të trendeve të pafavorshme demografike, shkallës së ulët të kontributeve, si dhe rritjeve të pensioneve që nuk bazohen në rritjen e pagave, punësimit dhe kontributeve.

Portofolet investuese të fondeve të detyrueshme pensionale janë të përqendruara në obligacione shtetërore vendore, që kufizon kthimin e mjeteve të investuara për shkak të efektit të inflacionit.

Përveç miratimit të një numri më të madh dokumentesh strategjike, zbatimi i tyre nuk është në nivel të kënaqshëm. Pas përfundimit të Strategjisë Kombëtare për Personat e Moshuar në vitin 2020, shteti nuk ka miratuar një dokument strategjik gjithëpërfshirës, i dedikuar ekskluzivisht popullatës së moshuar. **Shërbimet për personat e moshuar janë të kufizuara; shërbimi i ndihmës në shtëpi është i qasshëm për më pak se 1% të personave mbi moshën 65 vjeçare, ndërsa nuk është fare i vendosur në 31 komuna.** Pjesa dominuese e kujdesit vazhdon t'i takojë sektorit joformal dhe familjeve.

**Projeksionet demografike për vendin tonë janë negative, përkatësisht pjesëmarrja e personave mbi moshën 65 vjeçare do të rritet në mbi 34% deri në vitin 2055, numri i personave mbi 80 vjeç do të rritet më shumë se gjashtë herë krahasuar me gjendjen në vitin 2024, ndërsa popullsia në moshë pune do të zvogëlohet për gati gjysmë milioni persona, që do të intensifikojë më tej presionet mbi financat publike.**

Si rezultat i të lartpërmendurave, nevojitet një angazhim gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial, me afate të qarta, financim të siguruar dhe përcaktim të qartë të përgjegjësive për veprim.

Reformat strukturore të ndërmarra në kohë dhe të koordinuara do të kontribuonin në uljen e rreziqeve, në mënyrë që sistemi i mbrojtjes pensionale dhe sociale të mund të përgjigjet në mënyrë adekuate ndaj plakjes së përshpejtuar të popullsisë.

Raporti i revizionit të kryer nga Enti Shtetëror i Revizionit, i cili analizon në detaje gjendjet në sistemin pensional, trendet demografike dhe kapacitetet për kujdes afatgjatë të personave mbi moshën 65 vjeçare, tregon se sistemi pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut përballet me sfida të qëndrueshmërisë, ndërsa kujdesi për personat e moshuar mbetet i pamjaftueshëm i zhvilluar dhe jofunksional në kushtet e plakjes së shpejtë demografike.

Shtylla e parë e sistemit pensional, e organizuar mbi bazën e solidaritetit, funksionon vazhdimisht me bilanc financiar negativ. Shpenzimet për pensione i tejkalojnë të hyrat nga kontributet, ndërsa diferenca mbulohet përmes transfereve nga Buxheti Qendror i shtetit.

Në periudhën 2014–2024, pjesëmarrja e mjeteve buxhetore në të hyrat e përgjithshme të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor është lëvizur ndërmjet 32,6% dhe 43,6%. Në vitin 2024, transfertat nga Buxheti Qendror arritën në 42.474.000 mijë denarë. Projeksionet për fundin e vitit 2025 tregojnë një rritje të mëtejshme të këtyre transfertave, që paraqet një rrezik të konsiderueshëm fiskal për buxhetin e shtetit.

Harmonizimi i pensioneve kryhet sipas modelit Zviceran, që mundëson rritje të vazhdueshme të pensionit mesatar gjatë periudhës së analizuar 2015–2025. Pensioni mesatar shënon rritje gjatë gjithë periudhës dhe në tetor të vitit 2025 arrin afërsisht në 27.143 denarë.

Portofolet e shoqërive të detyrueshme pensionale (shtylla e dytë) janë të përqendruara në masë të madhe në obligacione shtetërore, që siguron stabilitet, por njëkohësisht kufizon mbrojtjen nga inflacioni dhe potencialin për realizimin e një kthimi real më të lartë të investimeve.

Trendet demografike janë shqetësuese. Mosha mesatare e popullsisë është rritur nga 32,3 vjet në vitin 2000 në 41,8 vjet në vitin 2024. Pjesëmarrja e personave mbi moshën 65 vjeçare është në rritje, ndërsa pjesa e gjeneratave më të reja është në rënie. Shkaku kryesor i rënies demografike nuk është vetëm nataliteti i ulët, por edhe emigrimi i popullsisë. Në vitet e fundit janë regjistruar ulje drastike: te fëmijët e regjistruar në klasën e parë, krahasuar me numrin e fëmijëve të lindur gjashtë vite më parë, numri i nxënësve të regjistruar në arsimin fillor është më i ulët për 2.774 nxënës, ndërsa te maturantët kjo diferencë është edhe më e lartë dhe arrin në 34,6% (nga 22.585 të lindur gjallë në 14.771 maturantë).

Sipas projeksioneve të Entit Shtetëror të Statistikës, pjesëmarrja e personave mbi moshën 65 vjeçare do të rritet nga 19,1% në vitin 2025 në 32,6% në vitin 2050 dhe 34,2% në vitin 2055. Numri i personave mbi moshën 80 vjeçare do të rritet nga rreth 22.000 në vitin 2024 në mbi 144.000 në vitin 2055, ndërsa popullsia në moshë pune (15–64 vjeç) do të zvogëlohet për afërsisht 470.000 persona.

Sistemi i kujdesit për personat e moshuar është i pamjaftueshëm i zhvilluar. Pas përfundimit të Strategjisë Kombëtare për Personat e Moshuar në vitin 2020, shteti tashmë për shtatë vjet nuk ka miratuar një dokument strategjik aktiv dhe gjithëpërfshirës për kujdesin ndaj personave mbi moshën 65 vjeçare. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2024–2044, për herë të parë, e trajton plakjen demografike si çështje ekzistenciale. Strategjitë e mëparshme të lidhura me këtë temë tregojnë dobësi sistemore: objektiva tepër të gjera, afate të paqarta, mungesë të vlerësimeve financiare dhe koordinim joefikas.

Buxheti për mbrojtjen sociale në periudhën 2019–2025 është rritur për 68,8%, por kjo rritje kryesisht është orientuar drejt pagesës së të drejtave në të holla (kompensimi për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër, pensioni social). Kompensimin për përkujdesje në vitin 2024 e kanë shfrytëzuar mbi 33.600 persona mbi moshën 65 vjeçare (60,2% e përfituesve) dhe, në praktikë, ai shërben si zëvendësim i një sistemi formal të kujdesit afatgjatë, kryesisht përmes kujdestarëve që janë anëtarë të familjes së personit që ka nevojë për kujdes.

Pensioni social përfshin 13.230 përfitues, por shuma e tij është dy herë më e ulët se pensioni minimal dhe nuk ndikon në uljen e varfërisë. Shërbimet formale për personat e moshuar janë të kufizuara: shërbimi i ndihmës dhe përkujdesjes në shtëpi përfshin rreth 3.000 përfitues (më pak se 1% e 315.000 personave mbi moshën 65 vjeçare) dhe nuk është i disponueshëm në 31 komuna të vendit. Qendrat

ditore kanë kapacitet prej vetëm 200 personash, ndërsa shtëpitë për të moshuar disponojnë me 2.378 shtretër (7 shtretër për 1.000 banorë mbi moshën 65 vjeçare). Për më tepër, ekzistojnë lista pritjeje dhe një shpërndarje e pabarabartë gjeografike e këtyre kapaciteteve (kryesisht në rajonin e Shkupit), gjë që është një tregues tjetër i kapacitetit dhe qasshmërisë së pamjaftueshme të këtyre shërbimeve. Sipas projeksioneve të kryera, deri në vitin 2024 rreth 63.000 persona mbi moshën 65 vjeçare kanë nevojë për kujdes afatgjatë, ndërsa deri në vitin 2050 ky numër do të rritet në 108.000 persona (për 70%). Për shkak të kësaj, pa një rritje të konsiderueshme të kapaciteteve, barra do të bjerë mbi familjet dhe sektorin joformal.

Republika e Maqedonisë së Veriut ndodhet në një nga proceset më të shpejta të plakjes demografike në Evropë. Gjendja e përshkruar tregon nevojën për reforma urgjente sistemore – duke përfshirë rritjen e moshës së pensionimit, përshtatjen e normave të kontributeve, rishikimin e modelit të harmonizimit të pensioneve, diversifikimin e investimeve në shtyllën e dytë pensionale, rritjen e kapaciteteve të shërbimeve për personat e moshuar dhe sigurimin e qasjes së tyre të barabartë në të gjitha rajonet.

## PAGESA E TË DREJTAVE PËR NDIHMË NË TË HOLLA NGA MBROJTJA SOCIALE



Kemi kryer revizion të pajtueshmërisë me temë: „Pagesa e të drejtave për ndihmë në të holla nga mbrojtja sociale“.

Me revizionin është përfshirë periudha nga viti 2022 deri në muajin qershor 2025, me qëllim të vlerësimit të mënyrës së realizimit të aktiviteteve që lidhen me ushtrimin e të drejtave për ndihmë në të holla nga mbrojtja sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe pagesën e tyre, e cila realizohet përmes Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, përkatësisht Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve (MPSDR). Mbrojtja sociale është veprimtari me interes publik, e cila realizohet përmes masave, aktiviteteve, programeve dhe politikave për mbrojtje nga rreziqet sociale, si dhe për parandalimin dhe tejkalimin e problemeve sociale që ndikojnë në mënyrë të pafavorshme në mirëqenien e qytetarëve.

Procedura për realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale zbatohet përmes Institucioneve Publike – Qendrave për Punë Sociale (IP QPS), të cilat vendosin dhe nxjerrin aktvendime për pagesën e të drejtave. Në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ekzistojnë tridhjetë (30) IP QPS dhe gjashtë Shërbime për të Drejtat në të Holla nga Mbrojtja Sociale në territorin e Qytetit të Shkupit. Me revizionin përfshimë Qendrën Ndërkomunale për Punë Sociale (QNPS) Shkup, e cila përfshin gjashtë shërbime për realizimin e të drejtave nga ndihma në të holla, përkatësisht: Karposh, Gazi Babë, Kisella Vodë, Çair, Qendër dhe Shutkë, si dhe pesë QNPS në nivel shtetëror: Tetovë, Kumanovë, Prilep, Manastir dhe Shtip. Përveç kësaj, përfshimë edhe 18 Qendra për Punë Sociale përmes sigurimit të dokumentacionit dhe të dhënave për të drejtat e realizuara dhe të ndërprera nga mbrojtja sociale.

**TË DREJTAT NGA NDIHMA MONETARE E MBROJTJES SOCIALE**

| Ligji për mbrojtjen sociale | Ligji për sigurinë sociale të të moshuarve | Ligji për invalidët civilë nga lufta | Ligji për mbrojtje ndërkombëtare dhe të përkohshme dhe Ligji për mbrojtjen sociale |
|---|---|---|---|
| - ndihmë minimale e garantuar<br>- kompensim për shkak të aftësisë së kufizuar<br>- kompensim për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër<br>- kompensim pagash për orar të reduktuar pune<br>- shtesë për banim<br>- kompensim i përhershëm<br>- ndihmë monetare e njëhershme | - siguri sociale për personat e moshuar | - e drejta për invaliditet civil | - e drejta për mbrojtje sociale për personat që kanë paraqitur kërkesë për azil, personat me status të refugjatit dhe personat me mbrojtje të subsiduar |

Analiza e **kornizës ligjore** në mbrojtjen sociale tregon mangësi dhe mospërputhje të shumta ndërmjet akteve nënligjore të miratuara dhe kërkesave për realizimin e të drejtave në pjesën e dokumentacionit që duhet të sigurohet sipas detyrës zyrtare, të cilat krijojnë mospërputhje administrative dhe mundësi për zbatim të ndryshëm në praktikë.

**Programi Kombëtar për Zhvillimin e Mbrojtjes Sociale 2022-2032** përcakton një kornizë afatmesme dhe afatgjatë të aktiviteteve dhe masave të planifikuara në fushën e mbrojtjes sociale, por zbatimi i tij është i kufizuar dhe nuk është vendosur mekanizmi koordinues i paraparë për monitorimin dhe vlerësimin e tij. Programet vjetore dhe planet strategjike të MPSDR kanë kryesisht karakter buxhetor, pa bazë sistematike analitike, tregues të matshëm dhe vlerësim të efekteve, që e kufizon rolin e tyre në menaxhimin e reformave..

Nga të drejtat e përgjithshme të paguara në fushën e mbrojtjes sociale në formën e kompensimeve në të holla, duke përfshirë edhe pagesat në bazë të mbrojtjes shëndetësore, gjatë vitit 2024 **janë paguar mjete në vlerë prej 10.003.289 mijë denarë,** që përfaqësojnë 15% të shpenzimeve totale të MPSDR. Mjetet janë paguar për një **numër mesatar prej 113.666 përfituesish të të drejtave sociale.** Pagesat në periudhën 2022-2024 shënojnë një trend rritës prej rreth 30%, që tregon një rritje të vazhdueshme të mjeteve të përfshira nga buxheti.

Pavarësisht kornizës ekzistuese ligjore dhe nënligjore, konstatuam se MPSDR dhe pjesa më e madhe e QPS nuk kanë miratuar procedura të brendshme për rregullimin e procesit të pagesës së të drejtave nga mbrojtja sociale, funksionimin financiar, kontrollet dhe veprimet nga paraqitja e kërkesës deri në realizimin e pagesës.

**Në procedurat për realizimin e të drejtave** konstatuam dobësi në lidhje me dokumentacionin jo të plotë dhe mosrespektimin e kritereve ligjore. Një pjesë e të drejtave janë realizuar pa përmbushjen e plotë të kushteve dhe pa dokumentacionin e detyrueshëm, ndërsa konstatuam edhe lëshime në zbatimin e procedurës, si: moskryerjen e inspektimit të drejtpërdrejtë në ekonominë familjare, rishqyrtimin vjetor të pamjaftueshëm ose të pazbatuar të të drejtave, nxjerrjen me vonesë të aktvendimeve dhe mungesën e plotësisë së evidencës zyrtare. Këto gjendje ndikojnë në shpenzimin e pajustifikuar të mjeteve publike dhe në uljen e efikasitetit të sistemit të mbrojtjes sociale.

**Për shkak të dobësive në kontrollet sistemore dhe në shkëmbimin/marrjen e të dhënave sipas detyrës zyrtare, për vitin 2024 konstatuam 235 përfitues të cilët njëkohësisht kanë fituar, përkatësisht kanë shfrytëzuar edhe të drejta nga mbrojtja sociale dhe pension, për çka janë paguar pa bazë 14.536 mijë denarë, përkatësisht rreth 236 mijë euro, prej të cilave: 10.763 mijë denarë për 190 përfitues në bazë të ndihmës minimale të garantuar, 426 mijë denarë në bazë të kompensimit të përhershëm për 5 përfitues dhe 3.347 mijë denarë në bazë të së drejtës për siguri sociale të personave të moshuar për 40 përfitues.**

**Te e drejta për siguri sociale të personave të moshuar** konstatuam **111 përfitues që e kanë realizuar këtë të drejtë pa e përmbushur kushtin e kufirit të moshës, për çka janë paguar pa bazë 3.211 mijë denarë, ose 52 mijë euro. Për më tepër, te 12 përfitues në sistemin e integruar informativ nuk janë paraqitur të dhëna se personi i papunë shfrytëzon kompensim në të holla për shkak të papunësisë, për shkak të së cilës nuk janë nxjerrë aktvendime për ndërprerjen ose zvogëlimin e shumës së ndihmës minimale të garantuar, me ç'rast janë paguar pa bazë mjete në vlerë prej 740 mijë denarësh, ose 12 mijë euro.**

Për më tepër, kemi konstatuar se QPS dhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (APRMV) nuk e zbatojnë në mënyrë efikase detyrimin ligjor për hartimin dhe monitorimin e planeve individuale të aktivizimit për përfituesit e papunë të Ndihmës Minimale të Garantuar (NMG). Planet individuale të aktivizimit hartohen në një vëllim shumë të kufizuar, kryesisht në mënyrë manuale në vend të formës elektronike, pa bashkëpunim funksional, pa koordinatorë dhe pa takime të rregullta ndërmjet institucioneve. Për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore dhe koordinimit të pamjaftueshëm, nuk ndërmerren aktivitete të mjaftueshme për aktivizimin në punë dhe përfshirjen e përfituesve të NMG në tregun e punës, që kontribuon në varësinë afatgjatë nga ndihma sociale dhe në uljen e efikasitetit të sistemit.

Konstatuam dobësi dhe **veprim jo të njëtrajtshëm në procesin e kthimit të mjeteve të paguara pa bazë nga mbrojtja sociale.** MPSDR nuk ka miratuar udhëzime dhe procedura të qarta për lidhjen dhe monitorimin e marrëveshjeve për kthimin e mjeteve, për shkak të së cilës QPS përcaktojnë në mënyra të ndryshme afatet, numrin dhe lartësinë e kësteve. Pjesa më e madhe e QPS-ve nuk kanë vendosur evidencë të rregullt për kërkesat dhe arkëtimin e mjeteve.

Sektori për Mbrojtje Sociale në kuadër të MPSDR nuk kryen analizë të të dhënave të marra nga QPS dhe nuk e realizon plotësisht rolin e tij në krijimin dhe monitorimin e politikave sociale, që ndikon negativisht në cilësinë dhe efikasitetin e sistemit.

Njëkohësisht, konstatuam kushte të papërshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit në shërbimet për ndihmë në të holla të Qendrës Ndërkomunale për Punë Sociale (QNPS) Shkup. Pjesa më e madhe e shërbimeve janë të vendosura në baraka me kushte të dobëta pune dhe hapësira të papërshtatshme për pranimin e palëve, ndërsa dokumentacioni ruhet në korridore dhe zyra, në kuti kartoni dhe regjistratorë, pa mbrojtje adekuate. Kjo gjendje nuk është në përputhje me Ligjin për Punën Arkivore dhe krijon rrezik për dëmtimin, humbjen ose shkatërrimin e dokumentacionit, si dhe kushte të padenja për punë dhe për pranimin e qytetarëve.

## KUSHTET E PUNËS NË QENDRAT PËR PUNË SOCIALE





QPS KARPOSH





QPS SHUTO ORIZAR





QPS GAZI BABA



QPS ÇAIR



QPS QENDËR





QPS KISELLA VODË

Mbikëqyrja inspektuese në kuadër të MPSDR nuk zbatohet mbi bazën e një evidence të plotë të vlerësimit të rrezikut, nuk i përfshin të gjitha të drejtat nëpërmjet mbikëqyrjes së rregullt, ndërsa zvogëlimi i inspektimeve të rregullta në favor të atyre të jashtëzakonshme krijon mundësi për uljen e efikasitetit të saj në zbulimin dhe parandalimin e parregullsive.

Në pjesën **Theksimi i çështjeve** kemi raportuar për shpërndarjen e pabarabartë dhe ngarkesën me lëndë të burimeve njerëzore ndërmjet QPS, si dhe për procedurat e ngritura pranë organeve kompetente për shkak të paligjshmërive dhe dyshimeve për pagesa të pabazuara gjatë realizimit të së drejtës për siguri sociale të personave të moshuar.

## GRATË LIDERE – GRATË NË POLITIKË, PARLAMENT DHE NË FUNKSIONE DREJTUESE NË ORGANET E PUSHTETIT QENDROR

Kemi kryer revizion të suksesit me temë: **„Gratë lidere – gratë në politikë, në parlament dhe në pozita drejtuese në organet e pushtetit qendror"** që t'i japim përgjigje pyetjes kryesore:

**A janë vendosur politika dhe masa efektive për forcimin e rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në funksione drejtuese në organet e pushtetit qendror?**

Me revizionin e kryer dhe metodologjinë e zbatuar të revizionit, bazuar në dëshmitë e grumbulluara të revizionit, kemi fituar siguri të arsyeshme se nuk janë vendosur politika dhe masa efektive për forcimin e rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në funksione drejtuese në organet e pushtetit qendror.

Strategjia për Barazi Gjinore përcakton si prioritet të qartë sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave në vendimmarrje në të gjitha nivelet e jetës politike dhe publike, por në të dhe në planet e veprimit për zbatimin e saj nuk janë përcaktuar aktivitete konkrete që duhet të ndërmerren në këtë drejtim, si dhe tregues të qartë për vlerësimin e rezultateve.

Funksionaliteti i Grupit Ndërresor Këshillëdhënës dhe Konsultativ duhet të përmirësohet, me qëllim që të sigurohet koordinim i duhur në zbatimin e politikave dhe masave për avancimin e grave në funksione drejtuese në shtet.

Mosrealizimi i trajnimeve nga Qendra e Burimeve për fuqizimin e aftësive udhëheqëse të grave, si dhe mungesa e fushatave dhe masave nga institucionet kompetente për nxitjen dhe inkurajimin e grave, ndikojnë në nivelin e pjesëmarrjes së grave në pozita të larta drejtuese në shtet.

Komisioni për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave miraton propozime dhe konkluzione për përmirësimin e barazisë gjinore, por ato nuk janë detyruese, për shkak të së cilës një pjesë e madhe e tyre nuk janë zbatuar.

Pjesëmarrja e grave deputete në Kuvend tregon se minimumi ligjor i përcaktuar prej 40% për sigurimin e barazisë gjinore në përbërjen e Kuvendit është përmbushur dhe përfaqësimi i grave në Kuvend shfaq rezultate më të mira krahasuar me 83% të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, ndërsa në raport me vendet e rajonit që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian, shteti në vitin 2024 shënon përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes së grave në Kuvend.

Pjesëmarrja e grave në Kuvend në vendet të rajonit që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian në vitin 2024

### PJESËMARRJA E GRAVE NË KUVEND NË VENDET TË RAJONIT QË NUK JANË ANËTARE TË BASHKIMIT EVROPIAN NË VITIN 2024*




Ndryshe nga përfaqësimi në Kuvend, në Qeveri, gratë përfaqësohen me 15%. Krahasuar me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, 73% e vendeve kanë një përqindje më të lartë të grave në pozicione ministrore, dhe krahasuar me vendet e rajonit që nuk janë anëtare të unionit, një përqindje më e ulët e pjesëmarrjes së grave në Qeveri gjendet vetëm në Bosnjë dhe Hercegovinë.

* Burimi i të dhënave: Banka Botërore, viti 2024

## PJESËMARRJA E GRAVE NË POSTE MINISTRORE NË QEVERI NË VITIN 2022 *




| | |
|---|---|
| 11.10% | Bosnja dhe Hercegovina |
| 18.80% | Mali i Zi |
| 66.70% | Shqipëria |
| 36.00% | Serbia |
| 17.60% | Maqedonia e Veriut |

Gjithashtu, konstatuam se nuk është miratuar Ligji për Shërbimin e Lartë Drejtues. Emërimi i personave në funksione drejtuese në organet e pushtetit qendror nuk është i unifikuar dhe realizohet në përputhje me ligje të veçanta që rregullojnë funksionimin e institucioneve përkatëse.

Në trupat punues, komisionet dhe institucionet ku personat drejtues emërohen nga Presidenti i shtetit, sigurohet respektimi i parimit të barazisë gjinore, që nuk ndodh kur Kuvendi, Qeveria dhe një pjesë e ministrive resore emërojnë persona në funksione drejtuese. Një pjesë e personave në funksione drejtuese janë emëruar si ushtrues detyre, pa procedurë me shpallje publike, që e zvogëlon transparencën në përzgjedhje dhe krijon rrezik për cilësinë dhe kompetencën e personave të cilëve u janë besuar funksionet drejtuese.

Mungon sistem i integruar i evidencës për personat që ushtrojnë funksione drejtuese në institucione, për shkak të së cilës nuk është e mundur të sigurohen të dhëna të sakta, në kohë dhe të unifikuara për numrin e tyre dhe strukturën gjinore.

Partitë politike e mbështesin parimin e barazisë gjinore, i njohin pengesat me të cilat përballen gratë dhe, brenda strukturave të tyre, ndërmarrin aktivitete për avancimin profesional të aftësive udhëheqëse të grave. Megjithatë, pjesëmarrja e grave në strukturat drejtuese të vetë partive jo gjithmonë tregon se është respektuar parimi i përfaqësimit të barabartë gjinor, gjë që tregon nevojën për ndërmarrjen e aktiviteteve shtesë me qëllim të sigurimit të një mbështetjeje më të madhe politike për gratë dhe rritjes së pjesëmarrjes së tyre në strukturat drejtuese të partive.

Sigurimi i një mjedisi të sigurt paraqet një sfidë kyçe që duhet të garantohet nga shteti, si dhe rregullimi i gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale, pasi ajo ndikon negativisht në gatishmërinë e grave për të pranuar funksione drejtuese.

Shteti duhet të marrë përgjegjësi dhe të vendosë një sistem të qëndrueshëm që do t'u mundësojë grave një mjedis të sigurt dhe trajtim të drejtë për përfshirje në politikë dhe në funksione të larta drejtuese shtetërore.



* Burimi i të dhënave: Banka Botërore, viti 2022

## 5.2.17. SISTEMET E TI-së, SIGURIA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE




### IMPLEMENTIMI I MASAVE PARANDALUESE PËR SIGURINË E INFORMACIONIT NË SISTEMIN E TI-SË TË FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT




Kemi kryer revizion të sistemeve informatike si revizion i suksesit në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut me temë: **„Implementimi i masave parandaluese për sigurinë informative të sistemit TI-së të FSPIMV-së",** me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes: **"A janë implementuar masat parandaluese për sigurinë informative të sistemit TI të FSPIMV-së?".**

Aktivitetet e revizionit u orientuan drejt rreziqeve në fushën e **menaxhimit të TI-së dhe operacioneve të TI-së.** U kryen verifikime të kontrolleve të sigurisë në konfigurim, u identifikuan dobësitë e tyre dhe u dhanë udhëzime përkatëse për përmirësimin e sigurisë së konfigurimit të autentifikimit në sistemin e TI-së dhe të qasjes në të dhënat në serverin e të dhënave.

Revizioni konstatoi një sërë dobësish: mungesën e një strategjie të TI-së dhe moszbatimin e vlerësimeve të rrezikut të detyrueshme me ligj, mungesën e burimeve njerëzore të TI-së në Sektorin e Informatikës, ku njësia për infrastrukturën informative funksionon me vetëm 8% të vendeve të plotësuara dhe pa strukturë drejtuese, infrastrukturë të vjetëruar me sisteme operative që nuk mbështeten më nga prodhuesi, stacione pune pa mbrojtje antivirus të përditësuar dhe mungesë të autentifikimit shumëfaktorësh. Gjithashtu, u konstatua mungesa e segmentimit të duhur të rrjetit, kontrollues domeni i pa përditësuar, si kopje rezervë të pakriptuara dhe mungesa e planeve për vazhdimësinë e biznesit dhe rikuperimin pas fatkeqësive.

Me revizionin e kryer dhe metodologjinë e aplikuar të revizionit, bazuar në dëshmitë e grumbulluara të revizionit, **kemi fituar bindje të arsyeshme se implementimi i masave parandaluese për sigurinë informative të sistemit të TI-së së Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut ka mangësi që rrezikojnë nivelin e përgjithshëm të mbrojtjes efektive të informacionit dhe të burimeve të TI-së me të cilat menaxhohen të dhënat e përfituesve, të drejtat e të cilëve realizohen përmes Fondit.**



## IMPLEMENTIMI I MASAVE DHE KONTROLLEVE TË SIGURISË NË SISTEMIN E TI-SË TË FONDIT TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Kemi kryer revizion të sistemeve informatike si revizion të suksesit në Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me temë: **„Implementimi i masave dhe kontrolleve të sigurisë në sistemin e TI-së të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut",** me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes: **„A janë implementuar masat dhe kontrollet e sigurisë në sistemin e TI-së të Fondit?".**

Aktivitetet e revizionit u orientuan drejt rreziqeve në fushën e **menaxhimit të TI-së dhe operacioneve të TI-së.** Në proceset e revizionit u kryen verifikime të kontrolleve të sigurisë në konfigurim, u identifikuan dobësitë e tyre dhe u dhanë udhëzime përkatëse për përmirësimin e sigurisë së konfigurimit të autentifikimit në sistemin e TI-së dhe të qasjes në të dhënat në serverin e të dhënave.

Me revizionin e kryer konstatuam gjendje që kanë të bëjnë me:

- mungesën e një strategjie të TI-së, si dhe politika dhe procedura të papërditësuara dhe të pamiratuara për sigurinë informative, përfshirë edhe planet e miratuara për vazhdimësinë e biznesit dhe rikuperimin pas fatkeqësive;
- deficit kritik të burimeve njerëzore në Njësinë për Harduer, Softuer Sistematik dhe Komunikime, me vetëm 9% të vendeve të punës të plotësuara dhe pa asnjë të punësuar përgjegjës për sigurinë informative;
- përdorimin e serverëve virtualë me sisteme operative që nuk mbështeten nga prodhuesi;
- mungesën e ndarjes së privilegjeve ndërmjet llogarive të përdoruesve dhe autentifikimit shumëfaktorësh për përdoruesit kyç;
- nevojën për avancimin dhe rikonfigurimin e infrastrukturës së rrjetit dhe të sistemeve për furnizim të pandërprerë.

Me revizionin e kryer dhe metodologjinë e zbatuar të revizionit, **si dhe në bazë të provave revizore të mbledhura, kemi fituar bindje të arsyeshme se zbatimi i masave dhe kontrolleve të sigurisë në sistemin TI-së të Fondit paraqet dobësi që mund të ndikojnë në nivelin e përgjithshëm të mbrojtjes efektive të informacionit dhe burimeve të TI-së.**



## IMPLEMENTIMI I MASAVE DHE KONTROLLEVE TË SIGURISË NË SISTEMIN E TI-SË TË AGJENCISË SË PUNËSIMIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Kemi kryer revizion të TI-së si revizion të suksesit me temë: „Implementimi i masave dhe kontrolleve të sigurisë në sistemin e TI-së të Agjencisë për Punësim", me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjes: **„A është efektiv implementimi i masave dhe kontrolleve të sigurisë në sistemin e TI-së të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut në sigurimin e mbrojtjes së duhur të informacionit dhe burimeve të TI-së?".**

Aktivitetet e revizionit u përqendruan në rreziqet në fushën **e menaxhimit të TI-së dhe operacioneve të TI-së.** Gjatë procesit të revizionit u përdorën mjete dhe skripte të reja të TI-së, të gjeneruara posaçërisht për sistemin informativ, si dhe një program përkatës revizioni. Në këtë kuadër u kryen kontrolle të masave të sigurisë në konfigurim, u identifikuan dobësitë e tyre dhe u dhanë udhëzime përkatëse për përmirësimin e sigurisë së konfigurimit të autentifikimit në sistemin e TI-së dhe të qasjes në të dhënat në serverin e të dhënave.

Revizioni konstatoi se Agjencia **nuk disponon me një strategji të miratuar të TI-së,** ndërsa aktet dhe procedurat e brendshme ekzistuese për sigurinë e TI-së janë të vjetruara dhe të paharmonizuara me legjislacionin në fuqi. Për më tepër, është evidentuar **një mungesë e konsiderueshme e kuadrit të TI-së,** si dhe mungesa e një personi të caktuar përgjegjës për sigurinë informative, gjë që kufizon kapacitetin për menaxhimin sistematik të sigurisë informative dhe rreziqeve të TI-së.

Në pjesën e menaxhimit të burimeve të TI-së, revizioni konstatoi **nivel të ulët të investimeve në pajisje të TI-së,** ndërsa sistemi në disa raste ka funksionuar **pa mirëmbajtje të kontraktuar zyrtarisht për një periudhë të përgjithshme prej 293 ditësh, që paraqet rrezik të sigurisë dhe operativ.**

Menaxhimi i të dhënave personale është i rregulluar në mënyrë të pamjaftueshme, pa evidencë të centralizuar të qasjes dhe pa mekanizma të automatizuar për arkivimin dhe fshirjen e të dhënave pas skadimit të afateve ligjore.

### PERIUDHA PA KONTRATË MIRËMBAJTJEJE NË PERIUDHËN E ANALIZUAR

Për periudhën nga **01.01.2021 deri më 11.02.2026**

Gjithsej pa kontratë aktive **293 ditë**



Në fushën e operacioneve të TI-së, mungesa e një procedure formale për menaxhimin e privilegjeve të përdoruesve ka rezultuar me ekzistimin e llogarive aktive të përdoruesve për persona të cilëve u ka përfunduar marrëdhënia e punës, si dhe llogarive që nuk janë përdorur asnjëherë.

Infrastruktura e rrjetit nuk është e segmentuar në mënyrë të përshtatshme, ndërsa një pjesë e serverëve dhe stacioneve të punës përdorin sisteme operative të vjetruara **pa mbështetje të sigurisë.**




Kopjet rezervë përgatiten pa enkriptim, **nuk ekziston plan për vazhdimësinë e biznesit dhe rikuperimin pas fatkeqësive (BCP/DRP),** ndërsa proceset për rikthimin e të dhënave nuk testohen rregullisht. Siguria fizike e dhomës së serverëve nuk i plotëson standardet minimale të sigurisë.

Me revizionin e kryer dhe metodologjinë e zbatuar të revizionit, bazuar në dëshmitë e grumbulluara të revizionit, **kemi fituar bindje të arsyeshme se implementimi i masave dhe kontrolleve të sigurisë në sistemin e TI-së të Agjencisë për Punësim ka mangësi që rrezikojnë nivelin e përgjithshëm të mbrojtjes efektive të informacionit dhe të burimeve të TI-së.**

## MINISTRIA E TRANSFORMIMIT DIGJITAL

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, nga qershori i vitit 2024, vazhdon të funksionojë si Ministri e Transformimit Digjital dhe si Ministri e Administratës Publike, me kompetenca të përcaktuara me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore, si pasardhëse juridike të kësaj ministrie. Ministria e Transformimit Digjital e ruan numrin unik tatimor të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Si organ qendror qeveritar për zhvillimin digjital, Ministria e Transformimit Digjital është përgjegjëse për zhvillimin dhe promovimin e shoqërisë informatike, zhvillimin teknologjik dhe kulturën teknologjike..

Kemi kryer revizion të raporteve financiare së bashku me revizion të pajtueshmërisë në Ministrinë e Transformimit Digjital, në llogarinë e buxhetit themelor (637) për vitin 2024, dhe kemi konstatuar gjendjet e mëposhtme:

- për shkak të moskryerjes së harmonizimit të gjendjes kontabël me gjendjen faktike të mjeteve themelore dhe mos zbatimit të Bilancit Ndarës me Ministrinë e Administratës Publike, në Bilancin e Gjendjes së Ministrisë së Transformimit Digjital më 31.12.2024 janë përfshirë të gjitha mjetet themelore të MSHIA, si dhe mjetet materiale dhe jomateriale të sapofurnizuara nga Ministria e Transformimit Digjital, gjendja e të cilës deri në ditën e raportimit nga revizioni i kryer nuk është ndryshuar;

- evidencën kontabël të Ministrisë e mban shërbimi profesional i SHPPP-së, ndërsa është vendosur praktikë që detyrimet të mos evidentohen në periudhën e krijimit të tyre. Një veprim i tillë ndikon në paraqitjen jo reale të detyrimeve ndaj furnitorëve në vend, të cilat në Bilancin e Gjendjes më 31.12.2024 janë paraqitur në shumën prej 14.475 mijë denarë. Konkretisht, gjatë vitit 2024 janë evidentuar fatura për furnizime të mallrave dhe shërbimeve të realizuara në vitin 2023 në vlerë të përgjithshme prej 11.279 mijë denarë, ndërsa gjatë vitit 2025 janë evidentuar detyrime të marra në vitet 2023 dhe 2024 në vlerë të përgjithshme prej 6.276 mijë denarë. Theksojmë se deri në fund të vitit 2025 në Ministri është vendosur një zgjidhje softuerike për evidentimin e detyrimeve ndaj furnitorëve, e lidhur me SHPPP-në dhe po kryhet harmonizimi i detyrimeve;

- nga personat përgjegjës nuk janë ndërmarrë aktivitete për sigurimin vjetor kundër zjarrit dhe fatkeqësive natyrore, përmbytjeve, vjedhjeve dhe dëmtimeve të pasurisë së paluajtshme dhe pajisjeve me të cilat disponon Ministria, që ndikon në sigurinë dhe mbrojtjen e pasurisë dhe nuk mundëson mbulimin e dëmeve eventuale nga kompanitë e sigurimit, duke shkaktuar potencialisht shpenzime shtesë për buxhetin e Ministrisë.

- njësia për revizion të brendshëm nuk ka staf të kuadrove dhe gjatë vitit 2024 nuk janë kryer revizione, me ç'rast është pamundësuar përmbushja e detyrës themelore të revizionit të brendshëm për të kontribuar në rritjen e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të subjektit, përmes zbatimit të një qasjeje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

- pa zbatuar procedurë të prokurimit publik janë paguar mjete për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në vlerë totale prej 3.032 mijë denarë, me ç'rast nuk është siguruar respektimi i parimeve të Ligjit për Prokurime Publike që kanë të bëjnë me sigurimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin, transparencën dhe integritetin në procesin e dhënies së kontratave të prokurimit publik, si dhe shfrytëzimin racional dhe efikas të mjeteve në procedurat për dhënien e kontratave të prokurimit publik.

Në pjesën e theksimit të çështjeve, veçojmë për:

- Strukturat e shpenzimeve të realizuara të Ministrisë nga mjetet e siguruara nga Buxheti i shtetit, të cilat në vitin 2024 arrijnë në 1.953.197 mijë denarë.

Pjesa më e madhe e shpenzimeve ose **83%,** i referohet transferit të mjeteve përmes buxhetit të Ministrisë për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, duke rritur në këtë mënyrë vëllimin e buxhetit dhe duke mos paraqitur një pasqyrë reale të shpenzimeve reale të tij.

Konkretisht, në përputhje me Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale, mjetet për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, për funksionimin dhe zhvillimin e RTM së, Ndërmarrjes Publike Radiodifuzioni i Maqedonisë dhe Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sigurohen nga Buxheti i shtetit, në nivel prej 1% të të ardhurave tatimore të realizuara, të përcaktuara në llogarinë e fundit përfundimtare të miratuar të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mjetet që miratohen në buxhetin e Ministrisë nuk janë në nivelin e përcaktuar me ligj, për shkak të së cilës nga NP Radiotelevizioni Maqedonas dhe Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ndaj MSHIA-së janë paraqitur padi për pagesën e shumës së përcaktuar me ligj. Me qëllim të shmangies së shpenzimeve gjyqësore dhe kamatave nga kontestet gjyqësore, Ministria e Transformimit Digjital ka lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore me Ndërmarrjen Publike Radiodifuzive Radiotelevizioni Maqedonas dhe Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe mjetet janë paguar në tërësi.

- stafi kadrovik i Ministrisë. Konkretisht, nga vendet e punës të sistematizuara, 43% janë të paplotësuara, ndërsa pozitat drejtuese nuk janë plotësuar në 4 nga 10 sektorët e paraparë, ndërsa në 6 njësi organizative nuk është plotësuar asnjë vend pune.

- vazhdimësia në zbatimin e projekteve në fushën e TIK-ut, me të cilat sigurohet zhvillimi i një infrastrukture digjitale të sigurt, të qasshme dhe të qëndrueshme si bazë për transformimin digjital, qarkullimi i përshpejtuar i informacionit ndërmjet organeve të administratës dhe krijimi dhe mbajtja e bazës qendrore të të dhënave, e gjithë me qëllim rritjen e efikasitetit administrativ dhe zvogëlimin e procedurave burokratike për qytetarët dhe bizneset.

# 5.2.18. MARRËDHËNIET NDËRMJET BASHKËSIVE

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive

## MINISTRIA PËR MARRËDHËNIE NDËRMJET BASHKËSIVE

Me revizionin e kryer të raporteve financiare të Ministrisë për vitin 2024, konstatuam disa gjendje që kanë të bëjnë me:

- dobësi në menaxhimin financiar, pagesën e pagave, prokurimet publike, regjistrimin e mjeteve, si dhe realizimin e Programit për financimin e aktiviteteve të shoqatave dhe fondacioneve për vitin 2023.
- Regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është zbatuar në mënyrë të plotë:
    - 28% e mjeteve themelore gjithsej, me vlerë aktuale prej 1.565 mijë denarë, nuk janë gjetur gjatë zbatimit të regjistrimit vjetor të mjeteve themelore;
    - 30 kompjuterë portativë (laptop) nuk janë gjetur gjatë regjistrimit, për shkak se nuk janë lëshuar reverese për ngarkimin e të punësuarve me pajisjet që u janë dhënë në përdorim;
    - për 7 automjete motorike nuk mbahet evidencë kontabël dhe materiale;
    - për kërkesat ndaj të punësuarve në vlerë prej 2.102 mijë denarë, të cilat rrjedhin nga vitet e kaluara (2012–2020), Ministria për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive nuk disponon me dokumentacion se cili person ka detyrim dhe në çfarë shume;

Për një pjesë të gjendjeve të lartpërmendura, pas ndryshimit të udhëheqësisë gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë aktivitete për tejkalimin e tyre, ndërsa për një pjesë tjetër po veprojnë edhe organet e tjera kompetente.

Me Programin për financimin e aktiviteteve të shoqatave dhe fondacioneve për vitin 2023 është paraparë mbështetje për shoqata dhe fondacione për realizimin e aktiviteteve për afirmimin e bashkësive. Për 33 shoqata dhe fondacione janë paguar mjete në vlerë prej 19.800 mijë denarë, përkatësisht 320.900 euro, me ç'rast konstatuam se:

- Qeveria e ka miratuar Programin në tetor të vitit 2023, me vonesë prej 10 muajsh, dhe jo brenda afatit prej 30 ditësh pas miratimit të Buxhetit („Buxheti për vitin 2023 është miratuar më 27.12.2022");
- monitorimi i aktiviteteve të zbatuara nga shoqatat është detyrim i njësisë për bashkëpunim me shoqatat dhe fondacionet, e cila gjatë periudhës së realizimit të programit nuk ka pasur të punësuar (me sistematizim janë paraparë 9);
- Komisioni për ndarjen e mjeteve financiare nuk ka siguruar dokumentacion për pikëzimin e kryer të aplikacioneve nga secili anëtar i komisionit për 138 aplikacione të paraqitura, të përfshira në Propozim-ranglistën;
- Me Raportin për shfrytëzimin e mjeteve të ndara dhe për rezultatet e arritura është konstatuar se, nga gjithsej 33 shoqata dhe fondacione, 17 prej tyre duhet të kryejnë kthimin e mjeteve në Buxhetin e shtetit në vlerë prej 1.225 mijë denarë, për shkak të mosdorëzimit të dëshmive për shpenzimin e mjeteve. Deri në ditën e revizionit, 14 shoqata kanë kthyer mjete në vlerë prej 361 mijë denarë, me dy shoqata është duke u zhvilluar procedurë ndërmjetësimi për kthimin e mjeteve në vlerë prej 264 mijë denarësh, ndërsa për një shoqatë është iniciuar procedurë gjyqësore për kthimin e mjeteve në vlerë prej 600 mijë denarë.

Për pagesën e pagave dhe kompensimeve për 244 të punësuar në Ministri janë paguar 165.010 mijë denarë, prej të cilave për 150 të punësuar sipas Nënprogramit K5 – Përfaqësim adekuat dhe i drejtë i bashkësive dhe përkthyesve, ose për 61% të të punësuarve, pagesa e pagës kryhet pa u siguruar dëshmi për praninë në punë dhe për orar të plotë pune dhe pavarësisht se është vendosur evidencë elektronike e kohës së punës për të punësuarit.

Me Ligjin për marrjen në punë të nëpunësve administrativë të punësuar përmes Nënprogramit K5 në Ministrinë e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive, është paraparë që Ministria, pas marrjes së të punësuarve, të miratojë ndryshime në aktin për sistematizimin e vendeve të punës, me qëllim harmonizimin e tij me nevojat e Ministrisë. Edhe pse aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Ministrisë, në periudhën nga miratimi i tyre në vitin 2019 deri në vitin 2025, janë ndryshuar gjashtë herë dhe për to janë siguruar pëlqimet përkatëse, harmonizimi nuk është bërë. Përfundim me datën 31.12.2024, nga gjithsej 2.556 vende pune të parapara, janë plotësuar 244 vende pune, përkatësisht vetëm 10% e tyre, që ndikon në përcaktimin real të kapaciteteve të nevojshme të Ministrisë.

Në lidhje me pajtueshmërinë në zbatimin e prokurimeve publike dhe realizimin e kontratave, konstatuam se:

- janë shpenzuar 516 mijë denarë për furnizimin me derivate të naftës, ndërsa për shkak të mosvendosjes së kontrolleve përkatëse, karburant kanë shfrytëzuar automjete që nuk janë në pronësi të Ministrisë ose për të cilat nuk ka të dhëna për numrat e regjistrimit, si dhe është furnizuar gaz i lëngshëm i naftës, i cili nuk ishte paraparë në kontratë.

- për servisimin e automjeteve, me pjesë të faturave janë furnizuar pjesë që nuk janë paraparë në listën e dokumentacionit të tenderit, ndërsa për pjesë të zërave janë faturuar çmime disa herë më të larta se ato të ofertës së pranuar.

Në pjesën e Theksimit të çështjeve, kemi bërë të ditur për zgjatjen e procesit të transferimit të punonjësve nga Ministria, në përputhje me Ligjin për transferimin e nëpunësve administrativë të punësuar përmes programit K-5, për shkak të së cilës 43 të punësuar ende nuk janë transferuar në institucione të tjera.

Në lidhje me kontrollet e brendshme, Ministria nuk ka zbatuar një sistem të certifikuar të menaxhimit të cilësisë në përputhje me standardin ISO 9001, ndërsa revizioni i brendshëm është jofunksional.

## PROKURIMET PUBLIKE NË MINISTRINË PËR MARRËDHËNIE NDËRMJET BASHKËSIVE NË VITIN 2023



Me revizionin e pajtueshmërisë me temë „Prokurimet publike në Ministrinë për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në vitin 2023", përfshimë 18 procedura të prokurimeve publike të zbatuara në vitin 2023, vlera kontraktuese e të cilave arrin në 34.642 mijë denarë pa TVSH të përfshirë (97% e vlerës së të gjitha kontratave të lidhura në vitin 2023), të cilat janë realizuar gjatë viteve 2023 dhe 2024.

Konkluduam se aktivitetet e Ministrisë për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në lidhje me planifikimin, zbatimin e procedurave për dhënien e kontratave të prokurimeve publike në vitin 2023, si dhe realizimin e tyre, nuk janë në përputhje me rregullativën dhe aktet nënligjore në fuqi, planet dhe kontratat.

**Planifikimi i prokurimeve publike** kryhet pa akt/procedurë për rregullimin e detyrimeve, procedurave dhe përgjegjësive të personave të përfshirë në procesin e planifikimit dhe zbatimit të prokurimeve publike, ndërsa vlerësimi i vlerës së prokurimeve bëhet mbi bazën e vlerave të kontratave të lidhura në vitet e kaluara, pa marrë parasysh mjetet e shpenzuara realisht sipas kontratës konkrete dhe ndryshimet e kushteve në treg. Si rezultat i kësaj, 9 kontrata janë realizuar më pak se 50%, ndërsa një kontratë nuk është realizuar fare.

Gjatë **realizimit të kontratave** për shënimin e ngjarjeve me rëndësi për bashkësitë, përkatësisht përvjetorin e nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit – 13 gusht, për të cilin janë planifikuar 6.000 mijë denarë dhe janë lidhur dy kontrata (prokurim i ndarë), si dhe Ditën e Alfabetit Shqiptar – 22 nëntor, për të cilën janë planifikuar 3.600 mijë denarë dhe është lidhur një kontratë, konstatuam disa gjendje që kanë të bëjnë me:

* Pranuesi juridik i Ministrisë së Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive.

- të tre kontratat janë lidhur me të njëjtin operator ekonomik, në kuadër të vlerave të planifikuara;

- në dokumentacionin e tenderit, në pjesën e specifikimit teknik, nuk janë përcaktuar sasitë e nevojshme për prokurimin e llojit të caktuar të mallrave ose shërbimeve (oferta është sipas njësisë matëse);

- Qeveria nuk ka miratuar Programë për shënimin e përvjetorit të Marrëveshjes Kornizë për vitin 2023, për shkak të shpërndarjes së dedikuar të mjeteve;

- për shërbimet për marrjen me qira të sallës për koncerte dhe ngjarje artistike, akomodimin hotelier, shërbimet e restorantit, ketëring, marrjen me qira të pajisjeve dhe të ngjashme për dy ngjarjet, janë paguar 5.293 mijë denarë pa u kërkuar ose dorëzuar dokumentacion shtesë si dëshmi se shërbimet janë kryer dhe janë adekuat për pjesëmarrësit e planifikuar në ngjarje;

- për materialet e blera për dy ngjarjet nuk janë dorëzuar prova shtesë (fatura dërgese, pranimore) që ato janë shpërndarë në Ministri, as nuk ekziston regjistrim për pranim/dorëzim në evidencën kontabël të saj;

- edhe pse është paraparë me kontratat, nuk është caktuar personi për koordinimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të shërbimeve që janë objekt i prokurimeve publike dhe për ndjekjen e përmbushjes financiare të kontratës.

Gjithashtu, në lidhej me realizimin e kontratave të tjera, kemi konstatuar gjendje që nuk janë në përputhje me aktet ligjore, dhe ato janë:

- për pajisjet informatike të blera në vlerë prej 999 mijë denarë, oferta është pranuar edhe pse i vetmi ofertues nuk ka siguruar karakteristikat teknike dhe performancat për secilin pjesë të pajisjes veçmas dhe nuk ekziston procesverbal për pranim cilësor dhe sasior si dëshmi që pajisjet e dorëzuara janë në përputhje me karakteristikat teknike të kërkuara;

- për faturat për prokurim e shërbimeve për mirëmbajtjen e sistemit të ftohjes dhe ngrohjes dhe materialeve zyrtare, për të cilat janë shpenzuar 1.070 mijë denarë, nuk janë siguruar urdhra pune, gjegjësisht nuk është vendosur evidencë materiale/hyrje dhe dalje si dëshmi që shërbimet, respektivisht materialet janë prokuruar;

- përdoruesit më të mëdhenj të shërbimeve për larjen e automjeteve, të siguruara me kontratë në vlerë prej 354 mijë denarë, janë automjete që nuk janë në pronësi të Ministrisë;

- nga gjithsej 29 zëra të mjeteve për higjienë dhe dezinfektim, të paraparë me kontratë në vlerë prej 413 mijë denarë, janë furnizuar vetëm 5 zëra me çmimin më të lartë;

Ministria nuk ka ndërmarrë aktivitete për publikimin me kohë të kontratave të lidhura dhe të realizuara në SEPP.



## 5.2.19. LOJËRAT E FATIT

### SHA PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE TË FATIT, LOTARIA SHTETËRORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kemi kryer revizion të raportit financiar, së bashku me revizion të pajtueshmërisë të **SHA për organizimin e lojërave të fatit – Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,** për vitin 2024, me ç'rast kemi konstatuar një sërë gjendjesh të rëndësishme.

Në vitin 2024, shoqëria ka realizuar qarkullim ditor prej 46.039 mijë denarë (746.970 euro) nga shitja e lojërave të fatit lotarike dhe elektronike në 10 pika të veta të shitjes, megjithatë **mjetet nuk janë depozituar rregullisht në llogarinë e saj të pagesave në bankë,** në përputhje me afatet ligjore (çdo ditë ose më së voni deri në ditën e ardhshme të punës). Gjatë vitit janë realizuar vetëm dy pagesa të të ashtuquajturit "qarkullim ditor", dhe atë duke transferuar para të gatshme ndërmjet llogarive të shoqërisë dhe jo nga qarkullimi real i realizuar. Për më tepër, **nuk është mbajtur evidencë dhe dokumentacion i rregullt arkëtar** që ka pamundësuar monitorimin dhe kontrollin e duhur të qarkullimit në para të gatshme. Po ashtu, në shoqëri **nuk janë vendosur kontrolle të përshtatshme të brendshme,** ka munguar qartë ndarja e kompetencave ndërmjet të punësuarve, si dhe monitorimi dhe kontrolli efektiv i transaksioneve gjatë shitjes, evidentimit dhe pagesës së qarkullimit ditor. Megjithëse me aktin e sistematizimit të shoqërisë janë parashikuar dhe plotësuar vendet e punës për arkëtar dhe shefit të kontabilitetit, pjesa më e madhe e aktiviteteve që lidhen me punën në para të gatshme dhe evidentimin kontabël janë kryer nga një person i vetëm – drejtori i Sektorit për financa dhe kontabilitet. Nga ana tjetër, **mosfunksionimi i revizionit të brendshëm** ka mundësuar moszbulimin e parregullsive, që tregon për menaxhim të dobët financiar dhe ngre dyshime për keqpërdorim të mundshëm të mjeteve.

Në të njëjtën kohë, me revizionin kemi konstatuar se drejtori i Sektorit për financa dhe kontabilitet ka kryer drejtpërdrejt **pagesa të avanseve për fitime të vogla ndaj një pjese të partnerëve afaristë** (rreth 320 persona juridikë me kontrata bashkëpunimi), në vlerë prej 13.971 mijë denarë **pa përdorur mënyrën e përcaktuar të pagesës** përmes Master Dealer it*. **Për pjesën më të madhe të këtyre transaksioneve, në vlerë prej 13.054 mijë denarë, janë dorëzuar dokumente të parregullta dhe të pavlefshme ose nuk janë dorëzuar fare dokumente, për shkak të së cilës ekziston pasiguri dhe mospërputhje në lidhje me vërtetësinë e ngjarjeve të evidentuara.**

Konstatuam se dokumentacioni për daljet e evidentuara të mjeteve monetare në para të gatshme në vlerë prej 36.465 mijë denarë dhe hyrjet në vlerë prej 7.897 mijë denarë, në bazë të avanseve të dhëna dhe të kthyera për pagesën e fitimeve të vogla, **është i kontestueshëm dhe jo i besueshëm, dhe deklaratat e siguruara nga të punësuarit se nuk kanë pranuar dhe as nuk kanë kthyer avanse, tregojnë dyshime për parregullsi, keqpërdorim të mundshëm të mjeteve monetare dhe veprimtari të kundërligjshme në administrimin e arkës dhe llogarive të pagesave.**

Me analizën e librave afariste të shoqërisë dhe të dhënave nga sistemi qendror on-line për pagesat dhe arkëtimet e realizuara nga shitja e lojërave të fatit të lotarisë, si dhe të dhënave nga platforma on-line me përmbajtje lojërash për organizimin e lojërave të fatit në internet, janë konstatuar **transaksione kontabël joreale dhe të pajustifikuara mbi baza të ndryshme, në shumën e përgjithshme prej 122.490 mijë denarë (1.987.377 euro), që ngre dyshime për keqpërdorim të mjeteve publike.**

Konstatuam **parregullsi gjatë ndarjes së fitimeve në lëndë** (banesa, automjete dhe skuterë elektrikë), ndër të cilat mungesa e evidencës kontabël, kryerja e prokurimeve para miratimit të rregullave nga Ministria e Financave, si dhe mosevidentimi i shpenzimeve për prokurimin e sendeve në vlerë prej 35.395 mijë denarë në vitin 2024 dhe 37.424 mijë denarë në vitin 2023, si dhe mosevidentimi i detyrimeve prej 23.264 mijë denarë.

Gjatë vitit 2024, në Lotarinë Shtetërore janë evidentuar **shpenzime për reklamim, propagandë, promovim dhe panaire në shumën prej 220.823 mijë denarësh, përkatësisht 3.582.811 euro.** Në periudhën 2020–2024, këto shpenzime shënojnë rritje të vazhdueshme, **gjegjësisht në vitin që ishte lëndë i revizionit, të njëjtit janë 10 herë më të larta krahasuar me vitin 2020.**

* Person juridik me të cilin shoqëria ka lidhur kontratë, ndër të tjera, edhe për shpërndarjen e mjeteve monetare në para të gatshme te 320 partnerë afaristë

SHPENZIMET PËR REKLAMIM, PROPAGANDË, PROMOVIM DHE PANAIRE NË PESË VITET E FUNDIT




Me revizionin theksuam se ekziston **dyshim mbi arsyeshmërinë dhe racionalitetin e një pjese të shpenzimeve për shërbime marketingu.** Konkretisht, konstatuam parregullsi në thirrjet publike për marrjen me qira të hapësirës mediatike dhe në kontratat e dhëna për prokurime publike të marketingut, si dhe në realizimin e tyre, në shumën e përgjithshme prej 73.406 mijë denarë, të cilat kanë të bëjnë me dispozita të paqarta në kontrata dhe mungesën e dokumentacionit përkatës për të vërtetuar se shërbimet janë realizuar.

Për më tepër, për 8 emisione argëtuese janë paguar 2.723 mijë denarë, megjithëse nuk ka qenë e mundur të konfirmohet se ato janë prodhuar, ndërsa për prodhimin e 28 emisioneve janë paguar 3.584 mijë denarë më tepër. Parregullsi janë konstatuar edhe te shërbimet për organizimin e takimeve afariste në vlerë prej 2.580 mijë denarë, për të cilat nuk ekziston dokumentacion përkatës dhe as dëshmi për lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me veprimtarinë e shoqërisë.




Ngjarja e organizuar - Tifoz Zone Euro 2024,
për të cilën janë paguar 14.109 mijë denarë dhe për të cilin ekziston dyshim lidhur me arsyeshmërinë e mjeteve financiare të shpenzuara

Në vitin 2024 është furnizuar pajisje në vlerë prej 26.620 mijë denarë, **pa dokumentacion përkatës për pranimin cilësor dhe sasior. Një pjesë e pajisjes në vlerë prej 15.387 mijë denarë nuk përputhet me performancat e kontraktuara sipas specifikacionit teknik** si dhe me pajisjen e evidentuar në kontabilitet. Për më tepër, me regjistrimin e kryer për vitin 2024 është konstatuar mungesë e kësaj pajisjeje në vlerë prej 3.722 mijë denarë.

Janë konstatuar parregullsi edhe në menaxhimin dhe shfrytëzimin e **objekteve të marra me qira, përdorim jo racional i mjeteve publike për qiramarrje, rikonstruktimin dhe renovimin e tyre, si dhe mungesë e evidencës kontabël për investimet në mjete të tjerëve.**



Pajisje e furnizuar që nuk i përmbush performancat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit

Shpenzimet e përgjithshme të konstatuara për qira gjatë vitit 2024 arrijnë në 71.168 mijë denarë, prej të cilave 47% (33.476 mijë denarë) janë në bazë të qirasë së hapësirave afariste për pikat e veta të shitjes dhe magazinat. Rezultatet e analizës së kryer të këtyre shpenzimeve për periudhën 2020–2024 tregojnë se ato shënojnë trend të vazhdueshëm rritjeje dhe, krahasuar me vitin 2020, **janë pothuajse trembëdhjetë herë më të larta.**




Për tri hapësira afariste në Dellçevë, Veles dhe Aerodrom janë paguar 5.339 mijë denarë për qira (prej të cilave 3.289 mijë denarë në vitin 2024), megjithëse ato **nuk janë shfrytëzuar nga shoqëria, për shkak të së cilës në vitin 2025 kontratat janë ndërprerë.**

Për objektet në Dellçevë dhe Veles janë kryer rikonstruksione në vlerë prej 11.628 mijë denarë, por meqenëse mjetet financiare nuk janë paguar, nga furnizuesi është iniciuar procedurë gjyqësore. Për më tepër, për qiranë e hapësirës afariste në Vizbegë janë paguar 24.647 mijë denarë, megjithëse **hapësira nuk është shfrytëzuar për pesë muaj gjatë vitit 2023, ndërsa në periudhën nga janari deri në tetor të vitit 2024 është përdorur si hapësirë magazinimi për ruajtjen e terminaleve të video-lotarisë dhe pajisjeve të tyre periferike.** Për përshtatjen e kësaj hapësire në seli të re të Drejtorisë së Lotarisë Shtetërore, janë paguar 4.248 mijë denarë për dokumentacionin projektues për rikonstruktimin dhe renovimin e hapësirës afariste, ndërsa rikonstruktimi i planifikuar në vlerë prej 80.000 mijë denarë nuk është realizuar, pas anulimit të procedurës së prokurimit publik dhe ndërprerjes së kontratës.

Sipas të dhënave nga SEPP, në vitin 2024, **54,1%** од procedurave të prokurimit publik të shoqërisë janë zhvilluar **me vetëm një ofertë të dorëzuar dhe 4,9%** e procedurave kanë përfunduar **cme një ofertë të vetme të pranuar** nga disa oferta të paraqitura, që tregon mungesë të konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Gjatë revizionit janë përfshirë 21 procedura, të cilat përfaqësojnë 82% të detyrimeve të përgjithshme të marra nga shoqëria në vitin 2024 që i nënshtrohen Ligjit për Prokurime Publike (831.151 mijë denarë). Pjesa më e madhe e tyre (17 procedura) janë realizuar si **marrëveshje kornizë të lidhura me një operator të vetëm ekonomik,** edhe pse një pjesë e tyre janë zbatuar brenda një afati të shkurtër pas lidhjes së marrëveshjeve. Në 16 procedura, prokurimet janë realizuar **si procedura të pandashme, megjithëse kanë ekzistuar kushte që ato të zhvilloheshin si procedura të ndashme.** Në 3 procedura për shërbime marketingu, njëkohësisht janë prokuruar edhe mallra të destinuara si fitime në sende për lojërat shpërblyese, që paraqet **anashkalim të zbatimit të dispozitave të Ligjit për Prokurime Publike.** Për më tepër, në 11 procedura nuk janë përcaktuar kritere të qarta cilësore gjatë zbatimit të kriterit oferta ekonomikisht më e favorshme.

Gjatë vitit afarist 2024, personi drejtues i shoqërisë ka lidhur kontrata për vepër për kryerjen e punëve të përkohshme me gjithsej 195 persona, prej të cilëve 75 persona nuk kanë ardhur në punë dhe nuk kanë kryer detyra pune, ndërsa për ta janë paguar në mënyrë të kundërligjshme dhe jo sipas dedikimit 14.911 mijë denarë, përkatësisht 241.928 euro.

Parregullsi dhe kundërligjshmëri janë konstatuar edhe **te shpenzimet për udhëtimet zyrtare jashtë vendit, ku një pjesë e tyre nuk janë realizuar (3.331 mijë denarë) ose janë paguar pa dokumentacion që vërteton shpenzimin (2.710 mijë denarë).** Në këto shpenzime janë përfshirë edhe shpenzime për reprezentacion, vizita në institucione kulturore, blerje veshjesh për nevoja personale, suvenire dhe të ngjashme, në shumën e përgjithshme prej 3.092 mijë denarë. Një pjesë e shpenzimeve të reprezentacionit janë arsyetuar në bazë të dokumenteve jo të besueshme. Parregullsi të ngjashme **janë konstatuar edhe te shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve dhe furnizimin me karburant në shumën prej 985 mijë denarë.**

Janë konstatuar gjithashtu gjendje që kanë të bëjnë me mbajtjen e papërshtatshme dhe të pasaktë të evidencës kontabël dhe materiale, kryerjen jo të plotë të regjistrimit të mjeteve, detyrimeve dhe kërkesave, mos sigurimin e pronës dhe mjeteve të shoqërisë nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera elementare, si dhe moskryerjen e revizionit të raporteve financiare së bashku me raportin vjetor të punës së shoqërisë për vitin 2024.

Në raport theksohen edhe çështje që lidhen me ndërprerjen e veprimtarisë së shoqërive tregtare për organizimin e lojërave elektronike dhe internetike të fatit, në të cilat Lotaria Shtetërore ka kontribut jomonetar, si dhe pasiguria lidhur me vënien në përdorim të terminaleve të video-lotarisë të furnizuara për organizimin e lojërave elektronike të fatit në vlerë prej 596.128 mijë denarë (9.700.000 euro), me rrezik të vjetërsimit të tyre teknologjik. Për më tepër, theksohen edhe huatë e dhëna shoqërive aksionare shtetërore dhe të ndërmarrjes publike në pronësi komunale, në shumën e përgjithshme prej 252.542 mijë denarë (4.097.446 euro).

Konsiderojmë të nevojshme të theksojmë se për parregullsitë e konstatuara, përdorimin e kundërligjshëm të mjeteve dhe dyshimet e shprehura për veprimtari të kundërligjshme të subjektit lëndë i revizionit, janë dhënë rekomandime dhe janë ndërmarrë aktivitete në përputhje me dispozitat e Ligjit për Revizionin Shtetëror.

## REVIZIONI I SHOQËRIVE PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE TË FATIT, KU SH.A. PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE TË FATIT LOTARIA SHTETËRORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ËSHTË PRONARI DOMINUES

Kemi kryer revizion të raporteve financiare dhe revizion të pajtueshmërisë për vitin 2024 të shoqërive në të cilat SH.A. për organizimin e lojërave të fatit Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut është pronari dominues dhe merr pjesë me 51% në kapitalin themelor. Me revizionin janë përfshirë shoqëritë në vijim:

Për organizimin e lojërave të fatit:

- ДРЖАВНА ЛОТАРИЈА — LOTARIA SHTETËRORE – 77 BITS SHPK Manastir (LSH–77 Bits)
- ДРЖАВНА ЛОТАРИЈА — LOTARIA SHTETËRORE – VEZUV SHPK Shkup (LSH – Vezuv)
- MOZZART — LOTARIA SHTETËRORE - MOZZART SHPK (LSH – Mozzart)

Shoqëri për organizimin e lojërave të fatit në formë elektronike:

- NOVO VLT — Nova Video-Lotari Shtetërore - NOVO VLT SHPK Shkup (Novo VLT)

Shoqëri për organizimin e lojërave elektronike dhe lojërave të fatit në internet:

- ДРЖАВНА ВИДЕОЛОТАРИЈА НА МАКЕДОНИЈА & CASINOS AUSTRIA — Video-Lotaria Shtetërore Kasinos Austria SHPK Shkup (VLSHM)

Me revizionet e kryera të rregullshmërisë në këto shoqëri janë konstatuar gjendje të caktuara, si në vijim:

Te shoqëritë organizues së lojërave të fatit në internet, të themeluara në vitet 2023 dhe 2024, janë konstatuar dobësi/mosharmonizim ndërmjet marrëveshjeve për investim të përbashkët dhe akteve të themelimit të shoqërive lidhur me lartësinë dhe/ose dinamikën e pagesës së kontributit monetar, janë konstatuar kërkesa të paevidentuara për pjesën e papaguar të kontributit monetar te LSH-Mozzart dhe LSH-Vezuv, si dhe moskryerja e pagesës së plotë të kontributit monetar nga ana e ortakut në LSH-Vezuv.

Shoqëritë organizojnë lojëra të fatit në internet në bazë të një të drejte të transferuar, që rrjedh nga marrëveshjet e investimit të përbashkët dhe aktet e themelimit të shoqërive të lidhura në vitet 2023 dhe 2024, revizionit nuk i është prezentuar akti **"licenca".**

Në pjesën e nevojës për posedimin e licencës, në përputhje me dispozitat e nenit 7 paragrafët 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Lojërat e Fatit dhe Lojërat Argëtuese, nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është nxjerrë Interpretim Autentik, në të cilin, ndër të tjera, është konstatuar "Dispozita e paragrafit (4) të nenit 7 të ligjit duhet të interpretohet në atë mënyrë që për organizimin e lojërave të tjera të fatit (lojëra të fatit në internet, lojëra shpërblyese, lojëra interaktive të fatit, kazino, bastore, klube me automatikë) dhe lojërave argëtuese, nevojitet licencë, përkatësisht leje, për shoqëritë afariste ose afaristë individualë që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj".

Në lidhje me lojërat elektronike të fatit, kemi konstatuar dobësi në lidhje me njohjen e së drejtës për organizimin e tyre, përkatësisht vlerësim joadekuat të mjeteve jomateriale, që ndikon në rezultatin financiar të shoqërisë.

Shoqëritë, ndonëse kanë statusin e autoriteteve kontraktuese sipas Ligjit për Prokurime Publike, procedurat për përzgjedhjen e ofertuesit për marrjen me qira të softuerit dhe platformës me përmbajtje lojërash i kanë zhvilluar në bazë të thirrjes publike të rregulluar me rregullore të brendshme, pa zbatimin e Ligjit për Prokurime Publike, ku në procedurat në pjesën më të madhe të rasteve është paraqitur vetëm një ofertë dhe janë lidhur kontrata me kohëzgjatje prej 15 vitesh.

Gjendjet e konstatuara tregojnë për dobësi në planifikimin dhe zbatimin e procedurave, rrezik nga kufizimi i konkurrencës, cenim të parimeve të prokurimit publik, si dhe rrezik nga vjetërsimi teknologjik dhe ndikime të mundshme negative financiare në funksionimin e shoqërive.

Regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve te Shoqëritë nuk është kryer ose nuk është kryer në tërësi, ndërsa për

* Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/11, 51/11, 132/11, 148/11, 74/12, 171/12, 27/14, 139/14, 156/14, 61/15, 154/15, 23/16, 178/16 dhe 90/17 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 251/22).
* Interpretimi autentik i nenit 7 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/11, 51/11, 132/11, 148/11, 74/12, 171/12, 27/14, 139/14, 156/14, 61/15, 154/15, 23/16, 178/16 dhe 90/17 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 251/22), i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 168/2024.

mbulimin e humbjes së paraqitur nga veprimtaria e shoqërive nuk janë miratuar vendime nga Mbledhja e Ortakëve.

Për shpenzimet e realizuara për reklamë, propagandë dhe promovim te shoqëritë LSH-Mozzart, LSH-77 Bits dhe VLSHM, konstatuam se nuk është siguruar dokumentacion mbështetës i plotë dhe i përshtatshëm, për shkak të së cilës nuk është e mundur të konfirmohet në tërësi përdorimi i mjeteve sipas dedikimit dhe në mënyrë racionale.

Për qiratë të hapësirave afariste, kemi konstatuar parregullsi në procedurat e zhvilluara, në kontratat e lidhura dhe në mënyrën e përdorimit të mjeteve për këtë qëllim në shoqëritë LSH-77 Bits, LSH-Vezuv, NOVO-VLT dhe VLSHM.

Janë konstatuar dobësi në rregullimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës, si dhe në procesin e punësimit, llogaritjes dhe pagesës së pagave, ndërsa te LSH-Mozzart për menaxher është zgjedhur një person që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me ligj.

Në pjesën që ka të bëjë me vazhdimësinë e veprimtarisë, revizioni informoi për aktivitetet e ndërmarra për ndërprerjen e veprimtarisë së shoqërive tregtare për organizimin e lojërave elektronike dhe lojërave të fatit në internet, në përputhje me Interpretimin Autentik të Ligjit për Lojërat e Fatit dhe Lojërat Argëtuese.

Në pjesën Çështje të tjera, revizioni informon për mosmiratimin e akteve nënligjore për lojërat e fatit në internet nga organi kompetent, organizimin e lojërave të fatit në internet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut pa licencë përkatëse, si dhe për nevojën e rregullimit të organizimit të lojërave elektronike të fatit përmes përcaktimit të kërkesave të qarta teknike, hapësinore, të sigurisë dhe të kontrollit, testimit dhe certifikimit të detyrueshëm të pajisjeve dhe sistemeve, si dhe vendosjes së një sistemi efektiv informativ mbikëqyrës për monitorimin e pagesave, fitimeve, qarkullimit dhe të ardhurave.





# 06

# DOBËSITË SISTEMORE



Enti Shtetëror i Revizionit kryen edhe vlerësimin e shkallës së përputhshmërisë së akteve ligjore dhe nënligjore dhe jep rekomandime për ndryshimin, plotësimin dhe harmonizimin e tyre. Në këtë pjesë theksojmë disa nga dobësitë kryesore sistemore të konstatuara, për të cilat nevojitet ndërmarrja e veprimeve nga ana e organeve kompetente të pushtetit ekzekutiv / legjislativ për tejkalimin e tyre.



## LIGJI PËR TAKSA KOMUNALE*

- Taksa komunale për shfrytëzimin e rrugëve nga mjetet motorike të pasagjerëve dhe mallrave, autobusët, automjetet speciale dhe motoçikletat, në përputhje me dispozitat e nenit 20 të Ligjit për taksa komunale (numri tarifor 9), arkëtohet nga personat juridikë të autorizuar për kryerjen e regjistrimit të automjeteve dhe paguhet në llogarinë përkatëse të pagesave në kuadër të llogarisë së thesarit. Zgjidhja ekzistuese ligjore nuk përcakton afatin brenda të cilit personat juridikë duhet ta paguajnë taksën e arkëtuar në llogarinë e komunës dhe nuk janë të detyruar t'i njoftojnë komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, për numrin e automjeteve të regjistruara në varësi të kubikazhit dhe për shumën mujore të mjeteve të mbledhura në mënyrë individuale dhe kumulative.
- Taksa komunale për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, në përputhje me dispozitat e nenit 20, paragrafi 3 të Ligjit për taksa komunale (numri tarifor 10), arkëtohet nga shoqëria tregtare kompetente për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe është e detyruar ta paguajë atë në llogarinë përkatëse të pagesave brenda llogarisë së thesarit. Zgjidhja ekzistuese ligjore nuk përcakton afatin në të cilin duhet të bëhet pagesa, as nuk përcakton detyrimin e shoqërisë tregtare që bën arkëtimin e taksës nga mbajtësit e njehsorëve për t'i njoftuar komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit për numrin e tatimpaguesve sipas kategorive (numri i njehsorëve) në përputhje me numrin tarifor, si dhe për të ardhurat e arkëtuara dhe kërkesat e paarkëtuara mbi këtë bazë.

## LIGJI PËR TATIME MBI PRONË*

Revizioni e thekson pasigurinë lidhur me zbatimin e nenit 39 të Ligjit për tatimet mbi pronën që nga miratimi i tij në vitin 2004, në pjesën e detyrimit për harmonizimin e regjistrit të pronës së patundshme që e mbajnë komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit me regjistrin që e mban Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, ndërsa më së voni deri më 31 dhjetor të vitit, të dhënat nga gjendja e regjistrave duhet të dorëzohen në Regjistrin Qendror dhe në Drejtorinë e të Ardhurave Publike. Për zbatimin e kësaj zgjidhjeje ligjore, nevojiten saktësime të caktuara shtesë në Ligj, si dhe lidhje softuerike e organeve kompetente.

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 61/2004, 64/2005, 92/2007, 123/2012, 154/2015, 192/2015 dhe 23/2016, si dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 151/2021

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 61/2004, 92/2007, 102/2008, 35/2011, 53/2011, 84/2012, 188/2013, 154/2015, 192/2015 dhe 23/2016, dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 151/2021

## LIGJI PËR FINANCIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE*

Me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, për financimin e kompetencave të transferuara në arsim, kulturë, mbrojtjen e hershme të fëmijëve dhe mbrojtjen e të moshuarve për komunat janë futur bllok-dotacionet. Qeveria miraton Urdhëresë për metodologjinë për përcaktimin e kritereve për shpërndarjen e bllok-dotacioneve me propozim të ministrisë kompetente, që bazohet në formulën me shfrytëzimin e treguesve përkatës të nevojave për secilin program. Urdhëresat janë identike çdo vit dhe nuk i pasqyrojnë nevojat dhe standardet reale, gjë që vë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve të kompetencave të transferuara dhe servisimin e rregullt të detyrimeve. Për këto arsye, është e nevojshme të ripërkufizohet mënyra dhe të përcaktohen kriteret për bllok-dotacionet për komunat me formulë të qartë, transparente, efikase dhe funksionale që do t'i përfshijë të gjitha llojet e shpenzimeve me vlera dhe madhësi reale, me qëllim që të vendoset sistemi optimal, ekonomik dhe efikas për financimin e kompetencave të transferuara të komunave. Qeveria, më 29 korrik 2025, ka miratuar Urdhëresën për Metodologjinë për përcaktimin e kritereve për shpërndarjen e dotacioneve bllok për arsimin fillor sipas komunave për vitin 2026, ku shpërndarja e dotacioneve bllok realizohet sipas kriterit të shpenzimit bazë për nxënës, ndërsa dotacioni bllok për arsimin fillor përbëhet nga dy komponentë: komponenti bazë dhe komponenti variabil.

## LIGJI PËR ZJARRFIKJE*

- Në përputhje me nenin 49 të Ligjit për zjarrfikje, i cili i referohet financimit të aktiviteteve të Njësive Territoriale të Zjarrfikjes, Qyteti i Shkupit dhe komunat kanë mundësinë të realizojnë të ardhura shtesë nga dënimet monetare të arkëtuara për kundërvajtjet e kryera në fushën e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet, kontributet vullnetare dhe mjetet e tjera nga shoqëritë e sigurimit, fondacionet, personat juridikë dhe fizikë të dedikuara për avancimin e mbrojtjes nga zjarret dhe të ardhurat nga burimet e veta për shërbimet e ofruara. Qyteti i Shkupit dhe komunat nuk realizojnë të ardhura mbi këto baza, përveç të ardhurave nga shoqëritë e sigurimit në shumën prej 2% të premive të arkëtuara për sigurimin e mjeteve motorike dhe sigurimin e përgjegjësisë nga përdorimi i mjeteve motorike për të cilat nuk kanë dijeni për lartësinë e mjeteve që duhet të paguhen, as nuk janë të detyruar ligjërisht të jenë në gjendje të verifikojnë plotësinë dhe saktësinë e mjeteve të paguara.

- Në përputhje me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, zjarrfikësit profesionistë të punësuar në njësitë territoriale të zjarrfikjes i përkasin grupit II - vende pune të personave të autorizuar zyrtarë në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe zbulimit, ose nëngrupit 11 - personave zyrtarë me autorizim të veçantë në njësitë e mbrojtjes kundër zjarrit.

Me nenin 11-b, paragrafi 8 i Ligjit për zjarrfikjen, janë përcaktuar tri kategori të vendeve të punës, edhe atë: A – Zjarrfikës udhëheqës të lartë shpëtimtarë, B - Zjarrfikës udhëheqës shpëtimtarë dhe C - Zjarrfikës profesionalë shpëtimtarë. Për shkak të llojit dhe natyrës së punëve që i kryejnë, shuma e rrogës së zjarrfikësve profesionistë në njësitë e zjarrfikjes, në përputhje me nenin 13 të Ligjit për zjarrfikje, është për 20% më e lartë se rroga e punonjësve të tjerë me përgatitje profesionale përkatëse për vendet e punës në administratën komunale. Kjo dispozitë ligjore nuk është mjaftueshëm e saktësuar, dhe duke marrë parasysh që struktura e punonjësve në komunat është shumë e ndryshme dhe varet nga më shumë faktorë, mënyra e llogaritjes dhe pagesës së rrogave në një numër të madh komunash kontestohet nga zjarrfikësit profesionistë. Për t'i tejkaluar gjendjet e konstatuara, nevojitet zgjidhja e qartë dhe precize ligjore për të përcaktuar shumën e rrogës së zjarrfikësve profesionistë.

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007, 156/2009, 47/2011, 192/2015, 209/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 244/2019, 53/2021, 77/2021, 150/2021, 173/2022, 170/2024, 37/2025 и 77/2026

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 67/2004, 81/2007, 55/2013, 158/2014, 193/2015, 39/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 152/2019

## LIGJI PËR FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE*

### Financimi i partive politike

- të miratohen udhëzime më konkrete për rregullimin e mënyrës së pagesës dhe evidentimit të anëtarësimit si burim financimi për partitë politike me qëllim të uniformitetit në mënyrën e evidentimit të tyre në kontabilitet dhe konfirmimin e limitit të përcaktuar me ligj për secilin anëtar veç e veç;

- përcaktimi i afateve për aktivitetet të caktuara të cilat i ndërmarrin Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Ministria e Drejtësisë, lidhur me mënyrën e planifikimit, shpërndarjes dhe pagesës së mjeteve nga financimi i rregullt vjetor i partive politike;

### Raportimi financiar dhe transparenca

- ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore që rregullojnë mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse, të cilat do të sigurojnë respektim konsekuent të parimit të kontabilitetit të «ndodhjes së modifikuar të ndryshimeve afariste përkatësisht transaksioneve»;

## LIGJI PËR VEPRIMTARINË FILMIKE*

Sipas nenit 22 të Ligjit për veprimtarinë filmike, për kryerjen e punëve profesionale nga kompetenca e Agjencisë së Filmit, si dhe për ndërmarrjen e masave për avancimin e veprimtarisë filmike, drejtori formon Këshillin e Filmit të Agjencisë, të përbërë nga pesë anëtarë nga radhët e individëve të shquar në fushën e filmit dhe kulturës, me mandat dyvjeçar. Ligji për veprimtarinë filmike nuk e rregullon më hollësisht nocionin individë të shquar në fushën e filmit dhe kulturës, për çka ekziston nevoja për përcaktimin më të saktë të kualifikimeve dhe titujve profesionalë të personave që duhet të jenë anëtarë të Këshillit të Filmit.

## LIGJI PËR KONTROLLIN E NDIHMËS SHTETËRORE*

Me rregullativën ligjore dhe nënligjore, në bazë të së cilës u jepet ndihma individuale përfituesve në ZZHIT, nuk janë përcaktuar kritere të qarta dhe transparente për shumën e ndihmës shtetërore që jepet, me indikatorë të përfshirë për matjen e efekteve të dhënies së saj. Konkretisht, ndihma shtetërore jepet përmes negociatave ndërmjet personave të autorizuar në DZZHIT dhe përfituesit, me lidhjen e një kontrate individuale me secilin përfitues, në bazë të vendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Ekziston nevoja për përcaktimin e dispozitave ligjore për miratimin e një Metodologjie për dhënien e ndihmës shtetërore, me kritere të përcaktuara për caktimin e shumës së ndihmës individuale dhe për matjen e efekteve të ndihmës së dhënë.

Gjithashtu, është e nevojshme të përcaktohen dispozita ligjore për përcaktimin e mënyrës së monitorimit, si dhe të organit kompetent për monitorimin dhe kontrollin e përmbushjes së intensitetit maksimal të përcaktuar të ndihmës shtetërore të dhënë, në kushtet kur ajo jepet nga më shumë ofrues të ndihmës.

Theksojmë gjithashtu dhe nevojën që të përcaktohet vendosja e regjistrit të ndihmës shtetërore në nivel qendror dhe të rregullohet koordinimi ndërinstitucional ndërmjet të gjitha organeve të përfshira në procesin e dhënies së ndihmës shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 76/2004, 86/2008, 161/2008, 96/2009, 148/2011, 142/2012, 23/2013 dhe 140/2018, dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 294/2020
* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2013, 18/2014, 44/2014, 129/2015, 152/2015, 39/2016, 58/2016 dhe 11/2018, dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 275/2019 dhe 3/2025
* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/2010

## LIGJI PËR NDËRTIM*

Nuk janë siguruar zgjidhje adekuate ligjore për pranimin teknik dhe lëshimin e lejes së përdorimit për objektet infrastrukturore të ndërtuara në Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike, për çka është e nevojshme të gjendet një zgjidhje ligjore për sigurimin e lejes së përdorimit për objektet që paraqesin ndërtime parciale – parcela në kuadër të Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike (DZZHIT).

## LIGJI PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR (SPI)*

Në nenet 164-a dhe 164-b të Ligjit për SPI-në, rrogat e punonjësve në shërbimin profesional të Fondit për SPI përcaktohen dhe përshkruhen me pika dhe kategori të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 87 të Ligjit për nëpunës administrativë. Me Ligjin e ri për nëpunës administrativë, zbatimi i të cilit do të fillojë më 1 janar 2027, në nenin 5 parashihet që të punësuarit në Fond të kenë gjithashtu statusin e nëpunësve shtetërorë, pa u përjashtuar si nëpunës të veçantë shtetërorë, siç është përcaktuar në nenin 6. Për këtë arsye, është e nevojshme harmonizimi i Ligjit për SPI me Ligjin për nëpunës administrativë.

## LIGJI PËR PUNËSIM DHE SIGURIM NË RAST TË PAPUNËSISË* (LPSRP)

- Kushtet në të cilat personat e papunë nuk mund të realizojnë kompensim në para, të rregulluara në nenin 67 të LPSRP, dhe që lidhen me bazën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nuk janë plotësisht të harmonizuara me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e punës, me të cilin rregullohet ndërprerja e kontratës së punësimit, që ka kontribuar në paraqitjen dhe zhvillimin e procedurave ankimore dhe gjyqësore me të cilat përballet Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

  - Në nenin 68 të LPSRP nuk është rregulluar në mënyrë të saktë mënyra e përllogaritjes së shumës së kompensimit monetar në rastet e punës me kohë të pjesshme, e konvertuar në kohë të plotë pune, siç është paraparë si e drejtë në nenin 66, alineja 2, që kontribuon në praktika të ndryshme në përllogaritjen e shumës së kompensimit monetar për personat e papunë që kanë pasur marrëdhënie pune me kohë të shkurtuar.

  - Ekzistojnë paqartësi në kushtet për ndërprerjen e së drejtës për kompensim monetar të personit të papunë nga neni 77 i LPSRP, përkatësisht nuk është e përcaktuar nëse ndërprerja e kësaj të drejte zbatohet vetëm në rastet kur personi i papunë është dërguar në një vend pune që përputhet me kualifikimin përkatës profesional, apo edhe kur ai ka deklaruar se pranon punësim me nivel më të ulët të përgatitjes profesionale. Për më tepër, nuk është përcaktuar se e drejta për pagesën e kompensimit në para ndërpritet në rast se personi refuzon të krijojë marrëdhënie pune me punëdhënësin, vetëm nëse i njëjti punëdhënës konsideron se personi i dërguar i plotëson kushtet për punësim, si dhe nuk është rregulluar ndërprerja e së drejtës për kompensim në rastet kur personi është i angazhuar në punë në bazë të kontratës në vepër.

  - Të drejtë për kompensim në para ka personi i papunë për periudhën e kaluar në marrëdhënie pune, për të cilin janë paguar kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social, në përputhje me nenin 66 të Ligjit për Punësimin dhe Sigurimin në Rast Papunësie. Me ligjin nuk është rregulluar në mënyrë të saktë nëse bujqit individualë dhe kategoritë e tjera të personave, të

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 130/2009 ... 51/2026
* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 98/2012 ... 245/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 180/2019 ... 269/2025
* Me përjashtim të dispozitave të nenit 78, të cilat do të zbatohen nga 1 shkurt 2026
* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/1997, 25/2000, 101/2000, ..., 113/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 124/2019, 103/2021, 274/2022, 132/2025 dhe 269/2025

cilët sipas nenit 12 të Ligjit për kontributet nga sigurimi i detyrueshëm social nuk janë të përcaktuar si obligues për pagesën e kontributit për sigurim të detyrueshëm në rast papunësie (por janë obligues për pagesën e kontributeve për SPI dhe sigurimin shëndetësor), kanë të drejtë për kompensim në para. Në praktikë, në përputhje me praktikat e mira dhe qasjen e unifikuar gjatë vendimmarrjes për të drejtën e kompensimit në para, si dhe me vendimet gjyqësore të mëparshme, kësaj kategorie personash u njihet e drejta për kompensim në para, nëse i plotësojnë kushtet e përcaktuara.

- me nenin 82 të Ligjit rregullohet e drejta për të kërkuar kthimin e mjeteve të paguara në emër të sigurimit në rast papunësie, kur personi nuk ka njoftuar për ndryshimet që ndikojnë në ndërprerjen e kësaj të drejte, por i njëjti nen nuk përmban dispozita me të cilat do të rregulloheshin më tej të drejtat e APRMV-së për të kërkuar kthimin e mjeteve financiare (në rast të rikthimit në punë të personit të papunë me vendim gjyqësor), si dhe përcaktimin e afatit për kthimin e mjeteve në Buxhet.

## LIGJI PËR VEPRIMTARINË HOTELIERIKE*

Revizioni thekson mangësi të caktuara të Ligjit për veprimtarinë hotelierike, të cilat kanë të bëjnë me:

- nuk është përcaktuar detyrim ligjor për verifikimin e detyrueshëm të përmbushjes së kushteve minimale teknike para lëshimit të vendimit për kategorizim ose licencë;
- raportimi i ndryshimeve të ndodhura lidhur me përmbushjen e kushteve për ushtrimin e veprimtarisë hotelerike nga ana e hotelierëve drejt Inspektoratit Shtetëror të Tregut bazohet në iniciativën e vetë hotelierëve dhe jo në një detyrim të përcaktuar ligjor;
- nuk është përcaktuar mënyra e dëshmimit të përmbushjes së kushteve sanitare-shëndetësore, kushteve për mbrojtje në punë, kushteve për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor, mbrojtjen kundër zjarrit dhe kushteve për mbrojtje nga zhurma, të përcaktuara me ligj, të cilat duhet t'i përmbushin objektet hotelierike;
- nuk është përcaktuar afati ligjor për zbatimin e mjetit juridik kundër vendimit të ministrit që udhëheq organin e administratës shtetërore kompetent për çështjet e veprimtarisë hotelierike, me të cilin refuzohet kërkesa për lëshimin e licencës ose i merret licenca për ushtrimin e veprimtarisë hotelierike në bar nate, kabare, disko-klub dhe disko-klub në hapësirë të hapur;
- nuk është përcaktuar detyrimi për mbajtjen e një regjistri të licencave të lëshuara për ushtrimin e veprimtarisë hotelierike në bar nate, kabare, disko-klub dhe disko-klub në hapësirë të hapur, për të cilat nuk kryhet kategorizim;
- nuk është përcaktuar mekanizëm për informimin e detyrueshëm dhe veprimin ndërinstitucional ndërmjet RQ dhe MEP në procesin e kategorizimit të detyrueshëm të objekteve hotelierike;
- nuk është përcaktuar detyrimi për verifikimin dhe kontrollin e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së objekteve hotelierike për akomodim (hotel, motel, pansion, apartament turistik, shtëpi malore dhe shtëpi gjuetie), si dhe të objektit hotelierik për ushqim – restorant dhe restorant kombëtar - mehane;
- edhe pse ligji parashikon mënyrën e informimit të bartësve të licencave për skadimin e vlefshmërisë së tyre, megjithatë nuk është përcaktuar mekanizëm për ripërtëritjen e vlefshmërisë së vendimeve për kategorizim dhe të licencave, përmes informimit të detyrueshëm dhe veprimit ndërinstitucional ndërmjet MEP dhe ISHT, përkatësisht kjo varet nga paraqitja e përsëritur e kërkesës nga vetë hotelierët dhe
- mos harmonizimi i Ligjit për veprimtarinë hotelierike, Ligjit për mbikëqyrjen inspektuese dhe Ligjit për Inspektoratin Shtetëror të Tregut lidhur me veprimet që ndërmerren nga organi kompetent në rast të konstatimit të parregullsive gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr: 62/2004, 89/2008, 115/2010, 53/2011, 141/2012, 164/2013, 187/2013, 166/2014, 199/2014, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 53/2016, 71/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr: 31/2020, 111/2020, 154/2020 и 16/2025

## LIGJI PËR LËNDËT E PARA MINERALE*

Revizioni konstatoi disa dobësi në Ligjin për lëndët e para minerale, të cilat kanë të bëjnë me:

- detyrim i papërcaktuar për mbajtjen e një regjistri të kontratave të lidhura dhe të lejeve të lëshuara, kontrata të konfiskuara/të ndërprera që lidhen me koncesionet për eksploatimin e lëndëve të para minerale;
- nuk është përcaktuar detyrim për vërtetimin e aftësisë së ofertuesve në lidhje me disponimin e burimeve adekuate teknike dhe njerëzore për realizimin cilësor të kontratës, apo për dëshmimin e kësaj aftësie përmes kontraktorëve për kryerjen e punimeve minerare;
- nuk është përcaktuar procedurë për zgjidhjen e njëanshme të kontratave të koncesionit mbi të gjitha bazat e përcaktuara me ligj;
- nuk janë të përcaktuara qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në procesin e arkëtimit dhe kontrollit të kompensimeve të koncesionit;
- nuk është përcaktuar forma dhe përmbajtja e llogaritjeve që koncesionarët kanë detyrim t'i dorëzojnë çdo tre muaj për sasitë e shitura, përkatësisht të përdorura të lëndëve të para minerale dhe
- nuk është përcaktuar institucioni kompetent për përllogaritjen dhe ngarkimin me pagesën e kamatës ligjore ndëshkuese në rast të arkëtimit me vonesë të kompensimeve të koncesionit.

## LIGJI PËR MBROJTJE SHËNDETËSORE* DHE LIGJI PËR EVIDENCAT NË FUSHËN E SHËNDETËSISË*

Ligji për mbrojtje shëndetësore dhe Ligji për evidencat në fushën e shëndetësisë nuk sigurojnë rregullim të plotë dhe të harmonizuar të skriningut për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje, përcaktimin e afatit për lëshimin e rezultateve të skriningut dhe vendosjen e një sistemi plotësisht funksional dhe të unifikuar për grumbullimin, përpunimin, shkëmbimin dhe përdorimin e të dhënave për personat e ftuar, përfshirjen, ekzaminimet e realizuara, rezultatet, trajtimin e mëtejshëm dhe rezultatet përfundimtare të skriningut. Organet kompetente duhet të ndërmarrin aktivitete për:

- rregullimin sistemor me të cilin do të përcaktohen qartë kompetencat, standardet, afatet, evidencat dhe mënyra e monitorimit të skriningut,
- miratimin e akteve nënligjore, si vijon:
  - akt nënligjor i përgjithshëm për rregullimin e vazhdueshëm dhe të unifikuar sistematik të skriningut, sipas shembullit të rekomandimeve evropiane;
  - përcaktimin e udhëzimeve të plota profesionale për kryerjen e një pjese të shërbimeve të skriningut, interpretimin e rezultateve, referimin për diagnostikim të mëtejshëm dhe trajtim, dhe
  - miratimi i akteve nënligjore për rregullimin më të detajuar të evidencave dhe regjistrave shëndetësorë për zbulimin e organizuar të ndryshimeve parakanceroze të qafës së mitrës dhe kancerit të gjirit.

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 136/2012, 25/2013, 93/2013, 132/2013, 44/2014, 160/2014, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 53/2016, 120/2016, 189/2016 dhe 7/2019, dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 103/2020, 99/2022, 129/2023, 253/2023, 147/2024, 49/2025 dhe 96/2026

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/2012, ... dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 31/2026

* Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 20/2009, ... 150/2015



# 07

# RAPORTET FINANCIARE TË ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT DHE RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR



**РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
**E** contact@rsm.mk
www.rsm.mk

# ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

**До Собранието на Република Северна Македонија**

## Извештај за ревизијата на финансиските извештаи

### Мислење

Ние извршивме ревизија на финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063710, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2025, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

Според нашето мислење, придружните финансиски извештаи објективно ја презентираат, во сите материјални аспекти финансиската состојба на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063710 заклучно со 31 декември 2025 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

### Основа за мислење

Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со Меѓународните стандарди за ревизија (МСР). Нашите одговорности според наведените стандарди се опишани во делот Одговорности на ревизорот за ревизијата на финансиските извештаи од овој извештај. Ние сме независни од Државниот завод за ревизија во согласност со Меѓународниот кодекс за етика на професионални сметководители (вклучувајќи ги и меѓународните стандарди за независност) (Кодексот на ОМСЕС) на Меѓународниот одбор за стандарди за етика на сметководители кои се во примена во Република Северна Македонија заедно со етичките барања кои се релевантни за нашата ревизија на финансиските извештаи во Република Северна Македонија и ги исполнивме сите други етички одговорности во согласност со овие барања и Кодексот на ОМСЕС кој е во примена во Република Северна Македонија. Веруваме дека ревизорските докази што ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето мислење.



РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
**E** contact@rsm.mk
www.rsm.mk

## Извештај за други правни и регулативни барања

Како што е наведено во пасусот Други информации Раководството на Државниот завод за ревизија е одговорно за изготвување на годишен извештај за работењето на Државниот завод за ревизија за 2025 година во согласност со член 33 од Законот за државната ревизија. Наша одговорност е да изразиме мислење за конзистентноста на посебниот годишен извештај, со историските финансиски информации објавени во годишната сметка и ревидираните финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината која завршува на 31 декември 2025, во согласност со меѓународните стандарди за ревизија, како и во согласност со барањата на член 34, став 1, точка (д) од Законот за Ревизија.

Наше мислење е дека, историските финансиски информации објавени во годишниот извештај за работењето на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината што завршува на 31 декември 2025, се конзистентни, во сите материјални аспекти, со информациите објавени во годишната сметка и ревидираните финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината која завршува на 31 декември 2025 година.

*Скопје, 03.06.2026*

Друштво за ревизија

| Овластен ревизор | РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје |
|---|---|
| Љубица Евтимовска Костовска | Јаглика Јорданова Андријеска |

RSM
Друштво за ревизија РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје

**THE POWER OF BEING UNDERSTOOD**
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Сметката на основен буџет на РСМ 637-10 за годината завршена на 31 декември 2025

## БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

во денари

| Опис на позицијата | Образложение | Буџет 2025 | Реализирано 2025 | Реализирано 2024 |
|---|---|---|---|---|
| **Приходи** | | | | |
| Трансфери и донации | **3.1.** | 208.051.000 | 198.061.920 | 178.024.401 |
| **Вкупно приходи** | | **208.051.000** | **198.061.920** | **178.024.401** |
| **Расходи** | | | | |
| **Тековни расходи** | **3.2.** | | | |
| Плати, наемнини и надоместоци | 3.2.1. | 167.226.000 | 160.799.347 | 141.467.003 |
| Стоки и услуги | 3.2.2. | 30.300.000 | 28.668.904 | 28.379.641 |
| Разни трансфери | 3.2.3. | 500.000 | 461.015 | 448.799 |
| **Вкупно тековни расходи** | | **198.026.000** | **189.929.266** | **170.295.443** |
| **Капитални расходи** | **3.3.** | | | |
| Капитални расходи | | 10.025.000 | 8.132.654 | 7.728.958 |
| **Вкупно капитални расходи** | | **10.025.000** | **8.132.654** | **7.728.958** |
| **Вкупно расходи** | | **208.051.000** | **198.061.920** | **178.024.401** |
| **Нето вишок на приходи - добивка по оданочување** | | - | - | - |

Скопје, 24.02.2026

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Сметката на основен буџет на РСМ 637-10 за годината завршена на 31 декември 2025

## БИЛАНС НА СОСТОЈБА

во денари

| Опис на позицијата | Образложение | 2025 | 2024 |
|---|---|---|---|
| **Актива** | | | |
| **Тековни средства** | **4.1.** | | |
| Побарувања од вработените и краткорочни финансиски побарувања | 4.1.1. | 629.944 | 485.554 |
| Активни временски разграничувања | 4.1.2. | 16.264.193 | 13.723.961 |
| Залихи | 4.1.3. | 3.424.974 | 2.294.893 |
| **Вкупно тековни средства** | | **20.319.111** | **16.504.408** |
| **Постојани средства** | **4.2.** | | |
| Нематеријални средства | 4.2.1. | 8.330.872 | 7.356.621 |
| Материјални средства | 4.2.2. | 465.782.787 | 446.537.431 |
| **Вкупно постојани средства** | | **474.113.659** | **453.894.052** |
| Долгорочни кредити и заеми | 4.2.3. | 2.722.229 | 1.129.002 |
| **Вкупна актива** | | **497.154.999** | **471.527.462** |
| **Вонбилансна актива** | | **467.870** | - |
| **Пасива** | | | |
| **Тековни обврски** | **4.3.** | | |
| Краткорочни обврски спрема добавувачи | 4.3.1. | 2.481.235 | 1.744.009 |
| Краткорочни обврски за плати и други обврски спрема вработените | 4.3.2. | 13.782.958 | 11.979.951 |
| Пасивни временски разграничувања | 4.3.3. | 629.944 | 485.555 |
| **Вкупно тековни обврски** | | **16.894.137** | **14.209.515** |
| **Долгорочни обврски** | **4.4.** | **2.722.229** | **1.129.002** |
| **Извори на средства** | **4.5.** | | |
| Извори на капитални средства | 4.5.1 | 358.332.015 | 358.875.118 |
| Ревалоризациона резерва | 4.5.2 | 119.206.618 | 97.313.827 |
| **Вкупно извори на деловни средства** | | **477.538.633** | **456.188.945** |
| **Вкупна пасива** | | **497.154.999** | **471.527.462** |
| **Вонбилансна пасива** | | **467.870** | - |

Скопје, 24.02.2026

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Сметката на основен буџет на РСМ 637-10 за годината завршена на 31 декември 2025

## ПРЕГЛЕД НА ПРОМЕНИ НА ИЗВОРИ НА СРЕДСТВА

| | | | **во денари** |
|---|---|---|---|
| О П И С | Државен јавен капитал | Останат капитал (залихи на материјали, резервни делови и ситен инвентар и хартии од вредност) | Вкупно |
| | | | |
| **Состојба 01.01.2025 година** | **453.894.052** | **2.294.893** | **456.188.945** |
| | | | |
| **Зголемување по основ на:** | **38.072.969** | **2.071.932** | **40.144.901** |
| Зголемување на вредноста (капитализација) | 16.179.667 | 2.071.932 | 18.251.599 |
| По попис 2025 | | | - |
| Ревалоризација | 21.893.302 | | 21.893.302 |
| | | | |
| **Намалување по основ на:** | **17.853.362** | **941.851** | **18.795.213** |
| Амортизација | 17.839.747 | | 17.839.747 |
| Издатници | | 941.851 | 941.851 |
| По попис 2025 | 13.104 | | 13.104 |
| Ревалоризација | 511 | | 511 |
| **Состојба 31.12.2025 година** | **474.113.659** | **3.424.974** | **477.538.633** |

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
**E** contact@rsm.mk
www.rsm.mk

# ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

**До Собранието на Република Северна Македонија**

## Извештај за ревизијата на финансиските извештаи

### Мислење

Ние извршивме ревизија на финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063119, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2025, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

Според нашето мислење, придружните финансиски извештаи објективно ја презентираат, во сите материјални аспекти финансиската состојба на Државниот завод за ревизија - Сметка на основен буџет на Република Северна Македонија 020021504063119 заклучно со 31 декември 2025 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

### Основа за мислење

Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со Меѓународните стандарди за ревизија (МСР). Нашите одговорности според наведените стандарди се опишани во делот Одговорности на ревизорот за ревизијата на финансиските извештаи од овој извештај. Ние сме независни од Државниот завод за ревизија во согласност со Меѓународниот кодекс за етика на професионални сметководители (вклучувајќи ги и меѓународните стандарди за независност) (Кодексот на ОМСЕС) на Меѓународниот одбор за стандарди за етика на сметководители кои се во примена во Република Северна Македонија заедно со етичките барања кои се релевантни за нашата ревизија на финансиските извештаи во Република Северна Македонија и ги исполнивме сите други етички одговорности во согласност со овие барања и Кодексот на ОМСЕС кој е во примена во Република Северна Македонија. Веруваме дека ревизорските докази што ги имаме прибавено се доволни и соодветни за да обезбедат основа за нашето мислење.



РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
**E** contact@rsm.mk
www.rsm.mk

## Извештај за други правни и регулативни барања

Како што е наведено во пасусот Други информации Раководството на Државниот завод за ревизија е одговорно за изготвување на годишен извештај за работењето на Државниот завод за ревизија за 2025 година во согласност со член 33 од Законот за државната ревизија. Наша одговорност е да изразиме мислење за конзистентноста на посебниот годишен извештај, со историските финансиски информации објавени во годишната сметка и ревидираните финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината која завршува на 31 декември 2025, во согласност со меѓународните стандарди за ревизија, како и во согласност со барањата на член 34, став 1, точка (д) од Законот за Ревизија.

Наше мислење е дека, историските финансиски информации објавени во годишниот извештај за работењето на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината што завршува на 31 декември 2025, се конзистентни, во сите материјални аспекти, со информациите објавени во годишната сметка и ревидираните финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината која завршува на 31 декември 2025 година.

*Скопје, 03.06.2026*

Овластен ревизор
Љубица Евтимовска Костовска

Друштво за ревизија
РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје
Јаглика Јорданова Андријеска

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Сметка на основен буџет на РСМ 631-19 за годината завршена на 31 декември 2025

## БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

*во денари*

| Опис на позицијата | Образложение | Буџет 2025 | Реализирано 2025 | Реализирано 2024 |
|---|---|---|---|---|
| **Приходи** | **3.1.** | | | |
| Трансфери и донации | 3.1.1. | 2.700.000 | 2.323.126 | 401.472 |
| **Вкупно приходи** | | **2.700.000** | **2.323.126** | **401.472** |
| **Расходи** | **3.2.** | | | |
| **Тековни расходи** | | | | |
| Стоки и услуги | 3.2.1. | 2.200.000 | - | - |
| Разни трансфери | 3.2.1. | 500.000 | - | - |
| **Вкупно тековни расходи** | | **2.700.000** | **-** | **-** |
| **Капитални расходи** | | | | |
| Капитални расходи | 3.2.2. | - | - | - |
| **Вкупно капитални расходи** | | **-** | **-** | **-** |
| **Вкупно расходи** | | **2.700.000** | **-** | **-** |
| **Остварен вишок на приходи** | | **-** | **2.323.126** | **401.472** |
| **Даноци, придонеси и други давачки од вишокот на приходи** | | | | |
| **Нето вишок на приходи** | | **-** | **2.323.126** | **401.472** |
| **Распоредување на вишокот на приходи** | | | | |
| Дел од нето вишокот на приходи за пренос во наредна година | | - | 2.323.126 | 401.472 |
| Обврски за данок на добивка | | | - | - |
| **Вкупно распоред на вишок на приходи** | | **-** | **2.323.126** | **401.472** |

Скопје, 24.02.2026

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Сметка на основен буџет на РСМ 631-19 за годината завршена на 31 декември 2025

## БИЛАНС НА СОСТОЈБА

*во денари*

| Опис на позицијата | Образложение | 2025 | 2024 |
|---|---|---|---|
| **Актива** | | | |
| **Тековни средства** | **4.1.** | | |
| Парични средства | 4.1.1. | 2.323.126 | 401.472 |
| Побарувања од купувачите во земјата | 4.1.2. | 7.969.241 | 8.930.068 |
| **Вкупно тековни средства** | | **10.292.367** | **9.331.540** |
| **Постојани средства** | **4.2.** | | |
| Нематеријални средства | 4.2.1. | - | - |
| Материјални средства | 4.2.2. | - | - |
| **Вкупно постојани средства** | | - | - |
| **Вкупна актива** | | **10.292.367** | **9.331.540** |
| **Вонбилансна евиденција - актива** | | - | - |
| **Пасива** | | | |
| **Тековни обврски** | **4.3.** | | |
| Пасивни временски разграничувања | 4.3.1. | 10.292.367 | 9.331.540 |
| **Вкупно тековни обврски** | | **10.292.367** | **9.331.540** |
| **Извори на средства** | **4.4.** | | |
| Извори на капитални средства | | - | - |
| Ревалоризациона резерва | | - | - |
| **Вкупно извори на деловни средства** | | - | - |
| **Вкупна пасива** | | **10.292.367** | **9.331.540** |
| **Вонбилансна евиденција - пасива** | | - | - |

Скопје, 24.02.2026

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
**E** contact@rsm.mk
www.rsm.mk

# ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

**До Собранието на Република Северна Македонија**

## Извештај за ревизијата на финансиските извештаи

### Мислење

Ние извршивме ревизија на финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија - Донаторска сметка EUROSAI - паралелна ревизија 020021504078583, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2025, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

Според нашето мислење, придружните финансиски извештаи објективно ја презентираат, во сите материјални аспекти финансиската состојба на Државниот завод за ревизија - Донаторска сметка EUROSAI - паралелна ревизија 020021504078583 заклучно со 31 декември 2025 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

### Основа за мислење

Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со Меѓународните стандарди за ревизија (МСР). Нашите одговорности според наведените стандарди се опишани во делот Одговорности на ревизорот за ревизијата на финансиските извештаи од овој извештај. Ние сме независни од Државниот завод за ревизија во согласност со Меѓународниот кодекс за етика на професионални сметководители (вклучувајќи ги и меѓународните стандарди за независност) (Кодексот на ОМСЕС) на Меѓународниот одбор за стандарди за етика на сметководители кои се во примена во Република Северна Македонија заедно со етичките барања кои се релевантни за нашата ревизија на финансиските извештаи во Република Северна Македонија и ги исполнивме сите други етички одговорности во согласност со овие барања и Кодексот на ОМСЕС кој е во примена во Република Северна Македонија.



РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
**E** contact@rsm.mk
www.rsm.mk

## Извештај за други правни и регулативни барања

Како што е наведено во пасусот Други информации Раководството на Државниот завод за ревизија е одговорно за изготвување на годишен извештај за работењето на Државниот завод за ревизија за 2025 година во согласност со член 33 од Законот за државната ревизија. Наша одговорност е да изразиме мислење за конзистентноста на посебниот годишен извештај, со историските финансиски информации објавени во годишната сметка и ревидираните финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината која завршува на 31 декември 2025, во согласност со меѓународните стандарди за ревизија, како и во согласност со барањата на член 34, став 1, точка (д) од Законот за Ревизија.

Наше мислење е дека, историските финансиски информации објавени во годишниот извештај за работењето на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината што завршува на 31 декември 2025, се конзистентни, во сите материјални аспекти, со информациите објавени во годишната сметка и ревидираните финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината која завршува на 31 декември 2025 година.

*Скопје, 03.06.2026*

Овластен ревизор
Љубица Евтимовска Костовска

Друштво за ревизија
РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје
Јаглика Јорданова Андријеска

Друштво за ревизија РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје

**THE POWER OF BEING UNDERSTOOD**
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Донаторска сметка EUROSAI - паралелна ревизија 020021504078583 за годината завршена на 31 декември 2025

## БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

во денари

| Опис на позицијата | Образложение | Буџет 2025 | Реализирано 2025 | Реализирано 2024 |
|---|---|---|---|---|
| **Приходи** | **2.1.** | | | |
| Трансфери и донации | 2.1.1. | 900.000 | 853.649 | |
| **Вкупно приходи** | | **900.000** | **853.649** | **-** |
| **Расходи** | **2.2.** | | | |
| **Тековни расходи** | **2.2.1** | | | |
| Стоки и услуги | 2.2.1.1. | 900.000 | 853.649 | |
| **Вкупно тековни расходи** | | **900.000** | **853.649** | **-** |
| **Вкупно расходи** | | **900.000** | **853.649** | **-** |
| **Нето вишок на приходи - добивка по оданочување** | | - | - | - |

Скопје, 24.02.2026

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Донаторска сметка EUROSAI - паралелна ревизија 020021504078583 за годината завршена на 31 декември 2025

## БИЛАНС НА СОСТОЈБА

во денари

| Опис на позицијата | Образло-жение | 2025 | 2024 |
|---|---|---|---|
| **Актива** | | | |
| **Тековни средства** | **4.1.** | | |
| Активни временски разграничувања | 4.1.1. | 203.550 | - |
| **Вкупно тековни средства** | | **203.550** | - |
| **Вкупна актива** | | **203.550** | - |
| **Вонбилансна актива** | | | |
| **Пасива** | | | |
| **Тековни обврски** | **4.2.** | | |
| Краткорочни обврски спрема добавувачите | 4.2.1. | 203.550 | - |
| **Вкупно тековни обврски** | | **203.550** | - |
| **Вкупна пасива** | | **203.550** | - |
| **Вонбилансна пасива** | | | |

Скопје, 24.02.2026

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
Т+389 (0)2 3233 301
**E** contact@rsm.mk
www.rsm.mk

# ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР

**До Собранието на Република Северна Македонија**

## Извештај за ревизијата на финансиските извештаи

### Мислење

Ние извршивме ревизија на финансиските извештаи на Државниот завод за ревизија - Донаторска сметка EUROSAI – нов проект 020021504078579, а коишто го вклучуваат билансот на приходите и расходите за годината којашто завршува на 31 декември 2025, како и билансот на состојба заклучно со таа дата, и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

Според нашето мислење, придружните финансиски извештаи објективно ја презентираат, во сите материјални аспекти финансиската состојба на Државниот завод за ревизија - Донаторска сметка EUROSAI – нов проект 020021504078579 заклучно со 31 декември 2025 година, како и неговите приходи и расходи за годината којашто завршува тогаш во согласност со Законот за сметководството на буџетите и буџетските корисници, Правилникот за сметководството на буџетите и буџетските корисници и Правилникот за примена на Меѓународните сметководствени стандарди за јавниот сектор на готовинска основа.

### Основа за мислење

Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со Меѓународните стандарди за ревизија (МСР). Нашите одговорности според наведените стандарди се опишани во делот Одговорности на ревизорот за ревизијата на финансиските извештаи од овој извештај. Ние сме независни од Државниот завод за ревизија во согласност со Меѓународниот кодекс за етика на професионални сметководители (вклучувајќи ги и меѓународните стандарди за независност) (Кодексот на ОМСЕС) на Меѓународниот одбор за стандарди за етика на сметководители кои се во примена во Република Северна Македонија заедно со етичките барања кои се релевантни за нашата ревизија на финансиските извештаи во Република Северна Македонија и ги исполнивме сите други етички одговорности во согласност со овие барања и Кодексот на ОМСЕС кој е во примена во Република Северна Македонија.



РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

RSM

**РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје**
Даме Груев 8, 1000 Скопје, Р. Северна Македонија
T+389 (0)2 3233 301
**E** contact@rsm.mk
www.rsm.mk

## Извештај за други правни и регулативни барања

Како што е наведено во пасусот Други информации Раководството на Државниот завод за ревизија е одговорно за изготвување на годишен извештај за работењето на Државниот завод за ревизија за 2025 година во согласност со член 33 од Законот за државната ревизија. Наша одговорност е да изразиме мислење за конзистентноста на посебниот годишен извештај, со историските финансиски информации објавени во годишната сметка и ревидираните финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината која завршува на 31 декември 2025, во согласност со меѓународните стандарди за ревизија, како и во согласност со барањата на член 34, став 1, точка (д) од Законот за Ревизија.

Наше мислење е дека, историските финансиски информации објавени во годишниот извештај за работењето на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината што завршува на 31 декември 2025, се конзистентни, во сите материјални аспекти, со информациите објавени во годишната сметка и ревидираните финансиски извештаи на Државниот завод за ревизија со состојба на и за годината која завршува на 31 декември 2025 година.

*Скопје, 03.06.2026*

Овластен ревизор
Љубица Евтимовска Костовска

Друштво за ревизија
РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје
Јаглика Јорданова Андријеска

**THE POWER OF BEING UNDERSTOOD**
AUDIT | TAX | CONSULTING

РСМ МАКЕДОНИЈА ДОО Скопје е член на РСМ мрежата и тргува како РСМ. РСМ е трговското име кое се користи од страна на членките на РСМ мрежата. Секој член на мрежата РСМ е независно друштво кое работи согласно своите доделени права и обврски. Мрежата РСМ самата не е посебно правно лице во ниедна јурисдикција.

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Донаторска сметка EUROSAI – нов проект 020021504078579 за годината завршена на 31 декември 2025

## БИЛАНС НА ПРИХОДИ И РАСХОДИ

во денари

| Опис на позицијата | Образложение | Буџет 2025 | Реализирано 2025 | Реализирано 2024 |
|---|---|---|---|---|
| **Приходи** | **2.1.** | | | |
| Трансфери и донации | 2.1.1. | | | 757.177 |
| **Вкупно приходи** | | **-** | **-** | **757.177** |
| **Расходи** | **2.2.** | | | |
| **Тековни расходи** | **2.2.1** | | | |
| Стоки и услуги | 2.2.1.1. | | | 757.177 |
| **Вкупно тековни расходи** | | **-** | **-** | **757.177** |
| **Вкупно расходи** | | **-** | **-** | **757.177** |
| **Нето вишок на приходи - добивка по оданочување** | | **-** | **-** | **-** |

Скопје, 24.02.2026

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен Државен ревизор
Максим Ацевски

Државен завод за ревизија
Финансиски извештаи за Донаторска сметка EUROSAI – нов проект 020021504078579 за годината завршена на 31 декември 2025

## БИЛАНС НА СОСТОЈБА

во денари

| Опис на позицијата | Образло-жение | 2025 | 2024 |
|---|---|---|---|
| **Актива** | | | |
| **Вкупна актива** | | - | - |
| **Пасива** | | | |
| **Вкупна пасива** | | - | - |

Скопје, 24.02.2026

Раководител на сектор за финансиски прашања
Данче Ангеловска

Главен државен ревизор
Максим Ацевски

Република Северна Македонија * ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА Скопје * Republika e Maqedonisë së Veriut * ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT Shkup

## SHKURTESAT E PËRDORURA

| | |
|---|---|
| CAATs | Teknikat e revizionit të ndihmuar me kompjuter |
| CEF | Qendra për Ekselencë në Financa |
| CIPFA | Instituti i Pavarur i Financave Publike dhe Kontabilitetit (Chartered institute of Public Finance and Accountancy) |
| DEA | Grupi Projektues i EUROSAI-t për Analizën e Mbështjelljes së të Dhënave |
| ECA | Gjykata Evropiane e Revizorëve |
| EDA | Projekti i EUROSAI-t për aktivitete zhvillimore |
| IBAN | Bordi Ndërkombëtar i Revizorëve të NATO-s |
| IDI | Iniciativa Për Zhvillim INTOSAI |
| IFES | Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore |
| INTOSAI Journal | Revista e INTOSAI-t |
| ISAR | Grupi Ndërqeveritar i Punës i Ekspertëve për Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit (ISAR), i koordinuar nga UNCTAD-i. |
| ISSAI 140 | Standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit për menaxhim me cilësi |
| ISSAI 150 | Standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit për kompetenca të revizorëve |
| JICA | Agjencia Japoneze për Bashkëpunim |
| JURISAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit me juridiksion gjyqësor |
| N.ET. | Rrjeti i Etikës i EUROSAI-t. |
| NAON / OAGN | Zyra Kombëtare e Revizionit e Norvegjisë. |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik |
| SNAO | Zyra Kombëtare e Revizionit e Suedisë |
| SYL | Programi i Liderëve të Rinj të Institucioneve Supreme të Revizionit, i organizuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t |
| UN Women | Trupi i Kombeve të Bashkuara për barazi gjinore dhe forcimin e gruas |
| UNCTAD | Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim |
| UNDP | Programi për zhvillim të Kombeve të Bashkuara |
| WB | Banka Botërore |
| WFD | Fondacioni Westminster për Demokraci. |
| WGEA | Grupet e Punës për Revizionin e Mjedisit Jetësor të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t |
| WGMA | Grupi i Punës i EUROSAI-t për Revizionin e Komunave. |
| APRMV | Agjencia për Punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut |
| Agjencia | Agjencia për Film në Republikën e Maqedonisë së Veriut |
| SHA | SHA – Shoqëri Aksionare |
| SH.A. ESM Shkup | SH.A. ESM Shkup – elektroekonomia e Maqedonisë së Veriut SH.A. Shkup |
| SH.A. MEPSO Shkup | Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shoqëri aksionare për transmetimin e energjisë elektrike dhe menaxhimin e sistemit elektroenergjetik, në pronësi shtetërore, Shkup |
| BPV | Bruto prodhimi vendor |

| | |
|---|---|
| BPP | Ministria e financave – Byro për prokurime publike |
| PPB | palë përgjegjëse për balancimin |
| TVL | Terminal i Videolotarisë |
| VMRO–DPMNE | VMRO–DPMNE Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas |
| ISR | Institucioni Suprem i Revizionit / ISR Institucionet Supreme të Revizionit |
| NMG | Ndihmë minimale e garantuar. |
| LP | largpërçues |
| VLSHM | Videolotaria Shtetërore e Maqedonisë KASINOS AUSTRIA |
| ДГ ЕНЕСТ | Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë Lindore. |
| TVSH | Tatimi mbi vlerën e shtuar |
| ESHR | Enti Shtetëror i Revizionit |
| DMSH | Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim |
| ISHNU | Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm |
| KSHZ | Komisioni Shetëror Zgjedhor |
| PDK | Përfaqësi diplomatike konsullore |
| SHPK | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar |
| ISHT | Inspektorati Shtetëror i Tregut |
| ASHRMV | Avokatura Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| Arkivi Shtetëror | Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| Lotaria Shtetërore | SH.A. për organizimin e lojërave të fatit, Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| KSHS | Konvikti Shtetëror Studentor |
| "DZZHIT | Drejtoria për Zonat Zhvillimore Industriale dhe Teknologjike |
| BDI | Bashkimi Demokratik për Integrim |
| NJVL | Njësia e Vetëqeverisjes Lokale |
| SEPP | Sistemi elektronik për prokurime publike |
| BE | Bashkimi Evropian |
| Komiteti i Kontaktit i BE-së | Asamble autonome e drejtuesve të Institucioneve Supreme të Revizionit të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe e Gjykatës Evropiane të Revizorëve |
| EUROSAI | Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Revizionit |
| LPP | Ligji për prokurime publike |
| TIK | Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit |
| INTOSAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Revizionit |
| KZ | Këshillat zgjedhore |
| TI | Teknologjia Informatike |
| ISHP | Institucioni Shëndetësor Publik |
| PP | Prokurime Publike |
| NP | Ndërmarrje Publike |
| PPP | PPP Partneritet Privat Publik |

| | |
|---|---|
| ME | Ministria e Energjetikës |
| MEXBM | Ministria e Energjetikës, Xehtarisë dhe Burimeve Minerale |
| MEP | Ministria e Ekonomisë dhe Punës |
| MBPEU | Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujit |
| MSHIA | MSHIAMinistria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës |
| Termini Im | Sistem i integruar informatik shëndetësor |
| MASH | Ministria e Arsimit dhe Shkencës |
| MPPSDR | Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë |
| QNPS | Qendër ndërkomunale për punë sociale |
| NATO | North Atlantic Treaty Organization (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) |
| IKD | Instituti Kombëtar Demokratik |
| NOMAGAS | NOMAGAS SH.A. Shkup |
| NOMAGAS SH.A. Shkup | NOMAGAS SH.A. Shkup – Shoqëri Aksionare për ushtrimin e veprimtarisë energjetike të transmetimit të gazit natyror NOMAGAS Shkup, në pronësi shtetërore |
| IN | Institucioni Nacional |
| BRE | burimet e ripërtëritshme të energjisë |
| NJT | Njësi territoriale |
| SPI | Sigurimi pensional-ivalidor |
| LSDM | Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë |
| Kuvendi | Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| SHPPP | Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta |
| ZZHIT | Zonat Zhvillimore Industriale dhe Teknologjike |
| NJTKZ | Njësia Teritoriale Kundër Zjarrit |
| ST | stacion transformatori |
| DSHE | Drejtoria për Shëndetësi Elektronike. |
| KD | Këshilli Drejtues |
| CFV | centraleve fotovoltaike |
| FSSHRMV | Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| FIZHT | Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik |
| FSPIRMV | Fondi për Sigurim Pensional Ivalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut |
| QYHQ | Qëllimi për zhvillim të qëndrueshme |
| RQ | RQ Regjistri qendror |
| QPS | Qendra për punë sociale |
| QMK | Qendra për Menaxhim me Kriza |


ДЗР